

DITURIA

Botim i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe arteve
Published by Albanian-American Academy of Sciences and Arts



Nr. 15, Shkurt 2026-Kryeredaktor Av. Halil Rama – Mjeshtëri i Madh



SKËNDERBEU NË PROZËN DHE SHTYPIN AMERIKAN

(Për librin e n/kolonel Halit Dacit me banim në New York)



Prof. Dr. SKËNDER KODRA Ph. D
“Ambasador i Imazhit Shqiptar në Botë”



“Akademik”, titull i merituar për
Prof.dr. SALI KURTIN

Ndër të tjera në brendësi

• NJË KOMB & NJË QËNDRIM - LIRI FITIMTARËVE TË KOSOVËS

Nga Prof. dr. Flori Bruqi dhe Prof. dr. Bardhyl Çipi (kundër absurdit të specialëve të Hagës)

• **REÇENSA/** “Programi Kadare”, një dritare mes dy botësh... - Nga Prof. dr. Fatmir TERZIU

• **ESSE/** Kureshtje për “parajsën” sovjetike - Nga Prof.dr. Eshref YMERI

• **VEPRA&AUTORË/** Libri i Ahmet Prençit “Horizonti i ëndrrës amerikane”: E duam Amerikën, por më shumë Shqipërinë - Nga Sakip Cami– shkrimtar&publicist

• **VEPRA&AUTORË/** HALIL RAMA, KRIJUESI QË NGRITI FJALËN NË KULT TË MEMORIES KOMBËTARE - Nga Dr. Mujë Buçpapaj (Poet. publicist, analist - botuesi i gazetës “Nacional”)

• **IN MEMORIAM/** Trashëgimia studimore-shkencore dhe publicistike e Fatos Dacit - Nga Halil RAMA

• **SUPLEMENTI LETRAT/** Shefki Karadaku, Khajami i ditëve tona - Nga Dr. Lutfi Turkeshi

• **OPINION/** E DREJTA E AUTORIT (Një përvojë nga Amerika për “tapinë” e librit “Viza Amerikane” - Nga Shefqet MEKO – shkrimtar&publicist

• **REPORTAZH/** Përjetësia e heroit, rruga “Isa Boletini” në New York - Nga Akademik XHELAL MARKU

• **PROFILI/** AKADEMIK ARJAN HAMITI – DOKTORI QË E KA BETUAR HIPOKRATIN ME ZEMËR, JO VETËM ME FJALË - Nga Denada Isa Dapellari

BOTIM I AKADEMISË SHQIPTARO-AMERIKANE TË SHKENCAVE
DHE ARTEVE

DITURIA

Revistë periodike, shkencore, historike, kulturore, politike

Nr. 15, Shkurt 2026

Tiranë, Shkurt 2026

Botues: Prof.Dr. Skënder Kodra Phd, Kryetar i Akademisë

Kryeredaktor: Av. Halil Rama – “Mjeshtër i Madh”

KËSHILLI BOTUES:

**Prof. dr. Jordan Daci
Prof. dr. Flori Bruqi Ph.D
Prof. dr. Eshref Ymeri
Prof. dr. Besa Kadriu Ph.D
Prof. dr. Hajri Shehu
Akademik/e Sanie Selita
Prof. dr. Arjan Hamiti
Prof.dr. Astrit Memia
Akademik Xhelal Marku
Prof. Agim Dauti
Akademik Nikoll Kola
Akademik Xhavit Lashi
Akademik/e Rajmonda Maleçka
Poete Bujana Malaj
Akademik Hysen Kosovrasti
Av. Kujtim Bara
Av. Halil Rama**

Botimi i kësaj reviste u sponsorizua nga Znj. Sanie Selita

@Të gjitha të drejtat i takojnë Akademisë Shqiptaro-Amerikane të
Shkencave dhe Arteve

Adresa: E-mail: halilrama9@gmail.com
Telefon: 00355 674070402

PASQYRA E LËNDËS

NJË KOMB-NJË QËNDRIM

LIRI ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS - Nga Prof.dr. Flori Bruqi 5

FJALA E EKSPERTIT

PROVA SHKENCORE TË VRASJEVE TË SHQIPTARËVE NGA SERBËT NË KOSOVË - Prof. dr. Bardhyl Çipi 9

HEROI KOMBËTAR

SI E LEXOI AMERIKA SKËNDERBEUN, STUDIMI - Nga Halil Rama & Sakip Cami 15

JUBILARE

30 VJET NGA THEMELIMI I AKADEMISË SË SHKENCAVE SHQIPTARO-AMERIKANE NË NEW YORK- Nga Prof.dr. Flori Bruqi 19

NDERIMI

PROF. DR. SKËNDER KODRA - "AMBASADOR I IMAZHIT SHQIPTAR NË BOTË"
- Nga Prof.Dr.Astrit Memia 21

LOBIMI

VOTA PËR AKTIN E LUGINËS SË PRESHEVËS, DËSHMI E POTENCIALIT TË LOBIMIT SHQIPTAR NË SHBA - Nga Ruben Avxhiu 23

HISTORIA

HERONJTË ÇAME TË 1912-S, KUSH UA FSHIU EMRAT?! - Nga Hyqmet Zane 27

KONGRESI I LUSHNJËS JANAR 1920 DHE ROLI I KONSULLIT BRITANIK MORTON FREDERIK EDEN - Nga Sakip Cami 29

IN MEMORIAM

TRASHËGIMIA STUDIMORE-SHKENCORE DHE PUBLICISTIKE E PROMOVUESE E FATOS DACIT - Nga Halil Rama 31

PERSONAZH

"AKADEMIK", TITULL MERITOR PËR PROF.DR. SALI KURTIN
- Nga Akademi/e Sanie Selita 34

PROFILI

ARJAN HAMITI – DOKTORI QË E KA BETUAR HIPOKRATIN ME ZEMËR,
JO VETËM ME FJALË - Nga Denada Isa Dapellari 37

FESTIVALI

KOMBI SHQIPTAR ME IMAZH TË UNIFIKUAR NË NJË FESTIVAL VLERASH
- Nga Halil RAMA 40

REÇENSA

"PROGRAMI KADARE", NJË DRITARE MES DY BOTËSH
- Nga Prof. Dr. Fatmir Terziu 44

REPORTAZH

PËRJETËSIA E HEROIT, RRUGA "ISA BOLETINI" NË NEW YORK
- Nga Akademik Xhelal Marku 48

ESSE

KURESHTJE PËR “PARAJSËN” SOVJETIKE - Prof. Dr. Eshref Ymeri 53

TRAJTESË

ROLI I MEDIAS NË OPERACIONET E MBËSHTETJES SË PAQES 56

- Nga Nexhbedin Basha

REÇENSA

“DIELLI NË MËRGIM” DHE ANI WILMS NJË DIELL QË PO LIND NË LETËRSINË
TONË - Nga Shpendi Topollaj 58

ESSE

NËNA MIHANE LUSHI, DHIMBJA QË U BË DINJITET, SAKRIFICA QË U BË LIRI
- Nga Rajmonda Maleçka 61

OPINION

E DREJTA E AUTORIT... - Nga Shefqet MEKO 65

VEPRA & AUTORË

- E DUAM AMERIKËN, POR MË SHUMË SHQIPËRINË - Nga Sakip Cami 66
- “DINASTIA DOMI E CERENIT TË KALASË SË DODËS”, NË PËRMASAT E NJË
VEPRE ENCIKLOPEDIKE - Nga Halil Rama 68
- ROMANI “NISHANI” I AUTORIT SHEFQET MEKO, NJË HISTORI TRONDITËSE
- Nga Fuat Memelli 74
- LIBRI I DR. HASAN DOMIT “LETËRNJOFTIM” PËR 200 BIMË MJEKËSORE
TË KORABIT - Nga Prof.dr. Hajri Shehu 76
- ARTI I PËRJETËSIMIT PËRMES PORTRETEVE DHE MONOGRAFIVE TË
AUTORIT XHELAL MARKU - Nga Fran Lleshi 79
- HALIL RAMA, KRIJUESI QË NGRITI FJALËN NË KULT TË MEMORIES
KOMBËTARE - Nga Dr. Mujë Buçpapaj 81
- “ODA DIBRANE” NË FILADELFIA - Nga Rajmonda Maleçka 87
- PROF. DR. FLORI BRUQI, ME “DIADEMË LETRARE V”
- Nga Akademik PHD, Eshref Ymeri 90

SUPLEMENTI LETRAT

- SHEFKI KARADAKU, KHAJAMI I DITËVE TONA - Nga Dr. Lutfi Turkeshi 91
- CIKËL ME POEZI - Nga Shefki Karadaku 95
- CIKËL ME POEZI - Nga Bujana Malaj 96
- NË DOGANË.... Nga Petraq J.Pali 96
- DALLGËT E JETËS - Cikël me poezi nga Fali Ndreka 100
- DASHA E BLENDARIT - Nga Nexhbedin Basha 102

UDHËTIM

KRIJUESIT, SHKRIMTARËT DHE POETËT QË FARKËTOI UNIVERSITETI
BUJQËSOR I KAMZËS - Nga Spasse Thanasi 103

NJË KOMB-NJË QËNDRIM

Gjykata Speciale e Hagës është “kidnapim i drejtësisë” ndërkombëtare

LIRI ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS



Akademik Prof. Dr. Flori Bruqi, PHD,
Prishtinë

- Kryetari i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, Prof. dr. Skënder Kodra dënon me ashpërsi aktakuzën absurde, bajate, të pabazuar dhe trilluese të Prokurorisë Speciale të Hagës, kundër ish-drejtuesve të UÇK-së, prof. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Prof. dr. Jakup Krasniqit dhe Profesor Rexhep Selimit



AAAS E PËRKUSHTUAR NDAJ SUNDIMIT TË LIGJIT, PAQES DHE DREJTËSISË

Pas njoftimit të Gjykatës Speciale se nga 9 deri më 18 shkurt 2026 do të zhvillohen deklaratat përmbylëse në procesin gjyqësor ndaj prof. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Prof. dr. Jakup Krasniqit dhe Profesor Rexhep Selimit, të cilët ndodhen në paraburgim në Hagë që mbi pesë vjet, Akademia Shqiptaro-amerikane e Shken-

cave dhe Arteve Nju Jork thekson edhe një herë nevojën që ky proces, i shoqëruar me problematika serioze, të përmbyllet me drejtësi.

Sipas AAAS -it, dëshmitarët kyç në këtë proces gjyqësor kanë hedhur poshtë në mënyrë të qartë pretendimet kryesore të aktakuzës, duke rrëzuar çdo dyshim mbi fajësi individuale, grupe apo komanduese.



“Këto dëshmi kanë kontribuar ndjeshëm në sqarimin e rrethanave faktike dhe kanë rrëzuar bazën e akuzave të prokurorisë”, thuhet në komunikatën e Akademisë së Shkencave dhe Arteve në Neë York, Tiranë , Prishtinë dhe Shkup, për revistën e kësaj akademije “Dituria”, në Tiranë, më kryeredaktor Akademik prof. dr. Halil Ramën. “Ne mbetemi të përkushtuar ndaj sundimit të ligjit, paqes dhe drejtësisë, duke besuar se vetëm një vendim i drejtë dhe profesional mund të kontribuojë në mbylljen e këtij kapitulli të rëndësishëm për Dardaninë, drejtësinë ndërkombëtare dhe të ardhmen e rajonit tone”, thuhet në Kumtesën e nënshkruar nga Kryetari dhe nënkryetari i kësaj akademie Prof. dr. Skënder Kodra dhe Profesor dr. Mehdi Hyseni.

POLITIKA KOSOVARE NË UNISON: PROCESI TË PËMBYLLET ME DREJTËSI

Në një komunikatë të PDK-së, thuhet se ky proces është karakterizuar me zvarritje të panevojshme, paqartësi procedurale dhe vendime që kanë ngritur shqetësime të vazhdueshme mbi standardet e drejtësisë dhe respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

Clark: Haga, gjyq special kundër komandantit legjendar të UÇK-së Adem (Shaban) Jasharit

Gjenerali amerikan Wesley Clark plot dinjitet, koherent dhe shumë i qartë.

Çfarë dëshmitari! Dhe çfarë qëndrimi; plot dinjitet, koherent dhe shumë i qartë në çdo fjalë. Argumentues, logjik, i kthjellët dhe mbi të gjitha këto, i vërtetë.

Gjenerali Wesley Clark, edhe përpara Gjykatës Speciale të Dardanisë në Hagë, provoi se sa e drejtë ka qenë lufta e UÇK-së dhe se prej asaj lufte, Dardanisë, iu bë aleate edhe vetë NATO e prirë nga SHBA.

Me gjithë sa tha, por edhe me çfarë nuk tha, Gjenerali Clark konfirmoi edhe një herë se në atë gjyq nuk po gjykohen Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët, në fakt kanë më shumë se 5 vjet që janë marrë peng e mbahen padrejtësisht të burgosur në Hagë, për interesa që nuk kanë të bëjnë me drejtësinë ndërkombëtare.

Në Gjykatën Speciale të Dardanisë në Hagë, po i bëhet gjyqi komandantit legjendar të UÇK-së Adem (Shaban) Jasharit dhe gjithë të rënëve e martirëve të luftës. Po i bëhet gjyqi UÇK-së dhe vetë Dardanisë.

Gjykata Speciale e Dardanisë në Hagë, duhet ta mbyllë farsën e ngritur mbi akuza e sajesa të pabaza, që për paradoks e shëmti, janë ushqyer edhe prej dëshmish të turpshme të disa shqiptarëve jugosllavë të Dardanisë, të cilët, nuk e kanë për gjë të hedhin baltë mbi gjakun e derdhur në themelet e lirisë së Dardanisë dhe mbi luftën e drejtë e patriotike të UÇK-së. Me dëshminë e vet, gjenerali amerikan tregoi edhe si dëshmitar, i ofroi një shans gjykatës ndërkombëtare, që ajo të ketë mundësi të mbrojë nderin e vet dhe të drejtësisë ndërkombëtare, njësoj siç gjenerali ia mbrojti nderin Dardanisë dhe luftës së saj për çlirim dhe pavarësi!

Këto rrethana, sipas PDK-së, kanë cënuar perceptimin e drejtësisë së barabartë dhe kanë rënduar padrejtësisht mbi çlirimtarët dhe ish-udhëheqësit e shtetit tonë, të cilët tashmë kanë kaluar një periudhë të gjatë në paraburgim.

Partia që dikur drejtohej nga Thaçi e Veseli, vlerëson se në këtë fazë përmbyllëse, është thelbësore që gjykimi të përqendrohet ekskluzivisht te drejtësia e paanshme, te faktet dhe te provat, duke u larguar nga çdo qasje politike, interpretuese apo spekulative që e ka shoqëruar këtë proces gjatë këtyre pesë viteve.

Prokuroria e Specializuar në Hagë ka kërkuar dënim prej nga 45 vjet burgim për ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Prof.Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Prof.dr.sci.Jakup Krasniqin dhe Prof.Rexhep Selimin.

Pas kësaj kërkesë, ka reaguar edhe kryeministri në detyrë i Kosovës, Ing.Albin Kurti, i cili e ka cilësuar atë të pabazuar dhe të shkëputur nga realiteti historik i luftës në Dardani.

Në një reagim në Facebook, kryeministri në detyrë Albin Kurti theksoi se thelbi moral dhe

historik i luftës çlirimtare të UÇK-së qëndron në mbijetesën dhe dinjitetin e popullit të Dardanisë.

“UÇK-ja ishte bartëse e një lufte të drejtë, ruajtëse dhe mbrojtëse. Ajo u zhvillua në rrethanat e okupimit të egër, kur dhuna e apart’heidit po shndërrohej në gjenocid shtetëror,” shkroi Kurti. Ai shtoi se “çdo përpjekje për t’i shkëputur veprimet individuale nga ky kontekst historik rrezikon të deformatë të vërtetën e asaj periudhe.”

Poashtu edhe presidentja e Republikës së Dardanisë Prof.dr.Vjosa Osmani thotë se kërkesa e Prokurorisë për dënime kaq të larta “nuk mbështetet në ndonjë standard të pranuar ndërkombëtar të dënimit” dhe “injonon plotësisht kontekstin e luftës në Dardani”.

“Ne nuk kemi pasur kurrë plan shfarosjeje ndaj asnjë populli tjetër apo civilëve. Prokuroria po përpiket ta vendosë këtë çështje në një vakum juridik, duke shkëputur veprimet nga realiteti i një lufte çlirimtare,” theksoi presidentja Vjosa Osmani. Ajo deklaroi se institucionet e Dardanisë mbeten të përkushtuara në mbrojtjen e së vërtetës historike dhe faktike për luftën, duke

kundërshtuar çdo përpjekje për shtrembërimin e saj. “Republika e Dardanisë do të vazhdojë të mbrojë vlerën dhe dinjitetin e luftës për liri dhe parimet themelore të drejtësisë,” përfundoi ajo.

TIRANA ZYRTARE NË MBROJTJE TË ISH DREJTUESVE TË UÇK-së

Kryeministri Edi Rama ka reaguar pasi prokurorët specialë kërkuar dënimin me nga 45 vite burg për Hashim Thaçin dhe 3 ish-krerët e tjerë të UÇK-së, kur nisën deklarata përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë.

Kreu i qeverisë shqiptare shkruan se “ende po mundohem ta gjej ku buron filli logjik që ka ndjekur prokuroria për të dalë me kërkesën për varrosje për së gjalli të katër burrave”.

“Më pyesin miq nga Prishtina pse nuk po shprehesh për mikun tënd që u ngarkua me 45 vjet burg në pretencën e prokurorisë së Hagës?!

Nuk po shprehem dot, pasi ende po mundohem ta gjej ku buron filli logjik që ka ndjekur prokuroria për të dalë me kërkesën për varrosje për së gjalli të katër burrave dhe si kurrë ndonjëherë, fjalët nuk më vijnë në ndihmë për t’u shprehur... Ndjesë, më duhet kohë ta gëlltis gjithë atë mal me mut që nxorri sot ajo prokurori në zemër të Europës demokratike”,- shkroi Rama.

Po ashtu edhe Ministria e Jashtme, Elisa Spiropali në reagimin e saj zyrtar, ndër të tjera nënvizoi faktin se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një lëvizje çlirimtare që gëzoi mbështetjen e gjerë të bashkësisë ndërkombëtare në përballje me një regjim që ushtroi dhunë sistematike, spastrim etnik dhe krime të dokumentuara gjerësisht ndaj popullsisë civile.

Absurditeti dhe brutaliteti i prokurorëve special të Hagës është dënuar me ashpërsi edhe nga kryetari i PDSH Prof.dr. Sali Berisha. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Berisha u shpreh se nuk është paraqitur asnjë provë, fakt apo dokument që të provojë krime konkrete të kryera nga të akuzuarit. Kreu i PD tha se akuzat e ngritura ndër vite për trafikim organesh, janë trillime të fabrikuara nga ish-prokurori serb Vukçeviç.

Aktakuzën, Berisha e ka cilësuar si të pabazuar dhe ripërsëritje të shpifjeve të propagandës ultranacionaliste serbe. Sipas tij akuzat e ngritura ndër vite për trafikim organesh, janë trillime të fabrikuara nga ish-prokurori serb Vukçeviç.

OVL-UÇK-së: DO VAZHDOJMË TË MBROJMË DINJITETIN E LUFTËS SONË



OVL e UÇK-së ka shprehur shqetësim të thellë dhe ka kundërshtuar fuqishëm përmbajtjen dhe gjuhën e përdorur në fjalët përmbyllëse të Prokurorisë në Dhomat e Specializuara në Hagë.

Në reagim thuhet se pretendimet e paraqitura, përfshirë etiketimin e udhëheqjes së UÇK-së si pjesë e një “Ndërmarrjeje të Përbashkët Kriminale”, përbëjnë një tentativë të papranueshme për kriminalizimin e luftës çlirimtare dhe për rishkrimin e historisë së rezistencës së drejtë të popullit të Kosovës.

“UÇK-ja ishte dhe mbetet ushtri çlirimtare, e lindur nga nevoja për mbijetesë dhe liri, e mbështetur nga populli dhe e njohur nga bashkësia ndërkombëtare si palë legjitime në luftën kundër regjimit gjenocidal serb”, thuhet në reagim.

OVL UÇK riafirmoi bindjen se kjo gjykatë po zhvillon një proces selektiv dhe të njëanshëm, duke injoruar krimet shtetërore të Serbisë dhe duke u fokusuar padrejtësisht mbi drejtuesit e luftës çlirimtare.

“Ne do të vazhdojmë të mbrojmë të vërtetën historike, dinjitetin e luftës sonë dhe figurën e bashkëluftëtarëve tanë. Drejtësia e vërtetë nuk ndërtohet mbi shtrembërim faktesh, por mbi të vërtetën e plotë”, thonë nga OVL e UÇK-së.

KU KONSISTON ABSRIDITETI I AKTAKUZËS?!

Në Gjykatën Speciale në Hagë kanë nisur deklaratat përmbyllëse për rastin gjyqësor kundër ish-presidentit të Kosovës, prof.Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve, Prof.Kadri Vese-

li dhe prof.dr. Jakup Krasniqi, dhe ish-deputetit, prof.Rexhep Selimi.

- Ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, për të cilat të katërtit janë deklaruar të pafajshëm. Për këto akuza, Prokuroria ka kërkuar dënim me burgim prej 45 vjetësh për secilin - 180 vjet në total.

- Krimet pretendohet se janë kryer midis muajit mars të vitit 1998 dhe shtatorit të vitit pasues në disa lokacione në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë.

- Pas përmbjlljes së deklaratave, çështja do të kalojë te trupi gjykues. Gjykatësit kanë tre muaj kohë që të marrin një vendim për çështjen, ose të kërkojnë zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit.

Avokatja Tavakoli tha se Hashim Thaçi në cilësinë e kryeministrit në Qeverinë e përkohshme nuk kishte pushtet të vërtet.

“Ai nuk mundte të nënshkruante asnjë angazhim domethënës për kosovarët në rolin e tij si kryeministër”, tha ajo, duke kujtuar dëshminë e ish-diplomatit britanik, John Steëart Duncan se Hashim Thaçi nuk mund ta nënshkruante marrëveshjen për çarmatosje e UÇK-së si kryeministër i Qeverisë së përkohshme.

“Kryeministër ishte një titull, nuk ishte shtysë përmes së cilës Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale [term që ZPS-ja përdor në aktakuzë për t’iu referuar të akuzuarve dhe disa ish-eporëve të tjerë të UÇK-së] mund të jetësohej”, tha ajo.

Tavakoli tha se fillimisht, në ditët e para të UNMIK-ut, Hashim Thaçi kishte konkurruar me këtë institucion për pushtet, por më pas e pranoi autoritetin e kësaj administrate dhe bashkëpunoi me të.

Ajo ngriti pyetjen se si Thaçi synonte të merrte nën kontroll Dardaninë, kur ai ishte pajtuar për çarmatosjen e UÇK-së, pranoi të bashkëpunonte me UNMIK-un, kishte pranuar humbjen në zgjedhje pasluftës deri më 2007, kur i fitoi ato. Mbrojtësja e Thaçit, Nina Tavakoli, foli për pretendimin e ZPS-së se Qeveria e përkohshme u përdor si mjet nga të akuzuarit për të ekzekutuar “një plan të përbashkët kriminal”.

Ajo tha se janë disa faktorë që rrëzojnë këtë pretendim. E para, ekzekutivi përbëhej nga shumë parti, kishte mbështetje ndërkombëtare dhe Qeveria “nuk ishte një mekanizëm pushteti”.

“Krijimi i sa u mbështet nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar dhe fuqi të tjera, si mënyrë për të

unifikuar shqiptarët e Dardanisë. Kjo mbështetje ndërkombëtare ngre dyshime se ajo u krijua si shtysë për të ekzekutuar një plan të përbashkët kriminal nga të akuzuarit për të marrë nën kontroll Dardaninë”, tha ajo, duke shtuar se kjo mund të qëndrojë vetëm nëse ZPS-ja pretendon se SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar dhe Evropa ishte në mbështetje të një plani të tillë kriminal.

“Si është e mundur që klienti ynë, që ishte 29 vjeç në atë kohë, t’i ketë gënjyer të gjithë ata”, tha avokatja Nina Tavakoli.

Mbrojtja e Hashim Thaçit tha se Prokuroria pretendon se Kryeministri i Dardanisë Hashim Thaçi ka qenë në dijeni se ndonjë anëtar i Qeverisë së përkohshme kishte kryer krime.

“Nuk ka prova përtej dyshimit të arsyeshëm që Thaçi të ketë caktuar bashkë të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të Qeverisë [së përkohshme]. Prokuroria nuk ka arritur që të provojë se Thaçi të ketë pasur njohuri që ndonjë anëtar i Qeverisë së përkohshme të ketë kryer krime”, tha avokati.

Sipas tij, Prokuroria kishte argumentuar se KFOR-i nuk kishte marrë njoftime nga UÇK-ja se po hetonte krimet e pretenduara nga anëtarët e saj.

“Nuk ka prova përtej dyshimit të arsyeshëm që Thaçi të ketë pasur njohuri për krime specifike të bëra nga anëtarët e UÇK-së që të ishin vartës të tij dhe për të cilët nuk ka pasur dijeni UNMIK-u dhe KFOR-i”, tha Mishetiç.

Mbrojtja e Thaçit tha se Prokuroria pretendon se Hashim Thaçi ka qenë në dijeni se ndonjë anëtar i Qeverisë së përkohshme kishte kryer krime.

“Nuk ka prova përtej dyshimit të arsyeshëm që Thaçi të ketë caktuar bashkë të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të Qeverisë [së përkohshme]. Prokuroria nuk ka arritur që të provojë se Thaçi të ketë pasur njohuri që ndonjë anëtar i Qeverisë së përkohshme të ketë kryer krime”, tha avokati.

Sipas tij, Prokuroria kishte argumentuar se KFOR-i nuk kishte marrë njoftime nga UÇK-ja se po hetonte krimet e pretenduara nga anëtarët e saj.

“Nuk ka prova përtej dyshimit të arsyeshëm që Thaçi të ketë pasur njohuri për krime specifike të bëra nga anëtarët e UÇK-së që të ishin vartës të tij dhe për të cilët nuk ka pasur dijeni UNMIK-u dhe KFOR-i”, tha Mishetiç.

FJALA E EKSPERTIT

Ekzaminimet mjekoligjore të disa viktimave Shqiptare pas mbarimit të luftës së Kosovës të vitit 1999.

PROVA SHKENCORE TË VRASJEVE TË SHQIPTARËVE NGA SERBËT NË KOSOVË



Prof. dr. Bardhyl Çipi

- **Akademik, Profesor i Mjekësisë Ligjore dhe një nga themeluesit e shkencës së Bioetikës në Shqipëri. Autor i mjaft librave dhe shkrimeve në fushat e Mjekësisë Ligjore dhe Bioetikës, i fundit “Prova shkencore të vdekjeve mbresëlënëse”, Tiranë 2023.**

Pas përfundimit të luftës në Kosovë në vitin 1999, filluan të kryhen ekspertimet mjekoligjore të viktimave Shqiptare. Ato u realizuan kryesisht nga ekspertët e huaj, por disa prej tyre edhe nga dy ekupe mjekoligjore nga Shqipëria që shkuan atje njëri pas tjetrit gjatë muajit tetor 1999, për të kryer disa nga këto ekzaminime së bashku me kolegët Kosovarë.

Me aq sa mbaj mend, gjatë qëndrimit tonë një-javor në Prishtinë, na ranë në sy vështirësitë nga mungesa atje e energjisë elektrike të rregulltë dhe furnizimit me ujë të qytetarëve, kur kishin kaluar tashmë disa muaj nga mbarimi i luftës dhe çlirimi i Kosovës nga zgjedha Serbe.

Mjekët ligjorë të Kosovës na treguan shumë prej godinave të qytetit, të dëmtuara gjatë bombardimeve të NATO-s, si dhe shtëpi dhe apartamente të lëna bosh të shtetasve serbë, prej të cilave ata ishin larguar me shpejtësi ose i kishin

shitur gjatë kësaj kohe.

Këto pamje menjëherë na sollën në kujtesë ngjarjet e shumë muajve më parë te ne në Shqipëri, në Kukës më shumë por edhe në Tiranë dhe në të gjitha rrethet e tjera, ku banorët e vendit tonë strehuan me dashuri dhe dhembshuri në banesat e tyre disa qindra mijra shqiptarë, një pjesë e madhe fëmijë, gra dhe të moshuar, të dhunuar, të torturuar dhe masakruar, që kishin braktisur Kosovën për shkak të violencës së egër ndaj tyre.

Por ajo që më preku më shumë ishin gjurmët ende të freskëta të vrasjeve kriminale të kryera nga ushtria dhe paramilitarët serbë, kryesisht ndaj popullatës civile Shqiptare të Kosovës.

Gjatë qëndrimit tonë atje, kolegët Kosovarë na njohën me raste kufomash të copëtuara, të kalbëzuara, të pjesëve skeletike të kalcinuara apo karbonizuara, kufoma të zbuluara brenda puseve disa me prerje të gjymtyrëve, të femrave të përdhunuar etj., të gjitha këto me qëllim të zhdukjes së tyre, si dhe varreza masive të shumta, disa prej të cilave të minuara që kërkonin kujdes të madh gjatë kryerjes së zhvarrimeve. Të gjitha këto ne i vërejtëm në shumë zona të Kosovës.

Gjithashtu, mësuam edhe për raste të shumta të personave të zhdukur, që ishin rrëmbyer dhe dërguar në Serbi, sikurse ishte rasti i një të afërmi të një prej kolegëve mjekoligjorë Kosovarë, i rrëmbyer nga ushtria serbe dhe që rezultonte i zhdukur. Gjatë atyre ditëve të qëndrimit atje, unë mora pjesë në këto ekspertime mjekoligjore kryesisht të mbetjeve kufomore të kryera prej ekipit nga Shqipëria, të drejuar prej meje, të cilat po i paraqes në mënyrë kronologjike, si vijon:

Të dhëna të disa ekspertimeve mjekoligjore të mbetjeve kufomore të kryera prej nesh më datat 23, 24, 25, 26 dhe 27.10.1999

-Më datë 23.10.1999, rreth orëve të mesditës, në varrezën e dëshmorëve të fshatit Kleçkë të komunës së Gllogovcit, u krye nga ana jonë ekzaminimi i një kufome të panjohur. Kjo kufomë mendohej se i përkiste shtetasit shqiptar të Kosovës, G.H., me moshë 45 vjeç, me profesion arsimtar, i cili më datën 14.12.1998 në fshatin Pashtrik në kufi me Republikën e Shqipërisë, ishte vrarë nga ushtria dhe paramilitarët serbë së bashku me disa luftëtarë të tjerë të UÇK-së.

Pas identifikimit dhe hapjes së varrit, u nxorr përjashta kufoma që paraqitej në një gjendje të përparuar të kalbëzimit në stadin e lëngëzimit dhe pjesërisht e saponifikuar që tregonte që vdekja kishte ndodhur jo më pak se 6 muaj më parë.

Pas kryerjes së ekzaminimit mjekoligjor, u konkludua që të dhënat përshkruese dhe ato matëse përputheshin plotësisht me ato të personit të vrarë G.H.

Në kufomë u vunë re disa plagë me armë zjarri: në kokë një plagë e tillë me puthitje dhe me drejtim nga e majta në të djathtë dhe tri plagë të tjera në trup dhe krahun e majtë, me drejtim kryesisht nga prapa përpara.

Shkaku i vdekjes duhet të ketë qenë kontuzioni i trurit.

Nga këto konstatime kuptohet që viktima nuk ka qenë duke i sulmuar agresorët, pasi ka qenë i kthyer me kurriz, ose duke u larguar prej tyre. Në këtë pozicion ata ka shumë mundësi ta kenë qëlluar në trup nga prapa duke e plagosur rëndë

dhe më pas kur është rrëzuar në tokë, por ende i gjallë, i janë afruar dhe i kanë dhënë fund menjëherë me anën e qitjes me puthitje në kokë.

-Më datën 24.10.1999, në morgun e Institutit Mjekoligjor të Prishtinës, u ekzaminuan prej nesh mbetjet kockore të katër viktimave Shqiptare Sh.M., R.M., A. M. dhe H.G., të gjetura në katër vende të veçanta të fshatit Krushev Obeliq të Kosovës.

Nga këqyrja e kujdesshme e tyre pasi u nxorën secila nga katër qeset e plastmasit ku ishte futur secila prej tyre, u vu re sa vijon. Ajo që binte menjëherë në sy në këto mbetje të pakta kockore, ishte gjendja e tyre shumë e tharë, me sipërfaqe me ngjyrë të errët, aty këtu me ngjyrë më të çelur, të bëra si porcelan, me plasaritje të shumta dhe të thyeshme gjatë prekjes dhe shtrëngimit të tyre. Këto janë veçori të eshtrave të djegura në shkallë të ndjeshme (eshtra të kalçinuara).

Përcaktimi i origjinës humane të tyre u mbështet kryesisht në metodën e përshkrimit anatomik të tyre, por edhe të përdorimit të indeksit medular që përcaktohet nga raporti i diametrit minimal të kanalit medular ndaj diametrit diafizar minimal. Ai rezultoi në shifrat 0.44 që flet në favor të origjinës humane të eshtrave.

Edhe në këtë rast, ekzaminimi i këtyre mbetjeve kockore të pakta dhe të kalçinuara (të djegura), vërteton për përpjekjet që kanë bërë agresorët serbë për të zhdukur çdo gjurmë të vrasjeve të popullsisë civile kosovare të kryera prej tyre.

-Më datën 25.10.1999, në fshatin Sllatinë e Madhe morëm pjesë në këqyrjen e një varreze masive në formë katërkëndëshe me përmasa 6.7 x 4 m, e kufizuar nga disa shtëpi dhe disa parcela. Rreth 15 m më tutje gjendet një varrezë





Pamje gjatë zbulimit dhe këqyrjeve të kufomave të viktimave Shqiptare.

tjetër masive, e rrethuar me shirita me ngjyrë të kuqe të lidhur me katër drurë në qoshet e saj, me sipërfaqen në nivelin e parcelës, të mbuluar me barishte dhe shkurre. Në këto dy varreza ndodheshin të varrosura kufomat e shumë shtetasve Shqiptarë të Kosovës të vrarë nga Serbët.

Atje nuk arritëm të kryejmë asnjë veprim, sepse ato ishin të minuara dhe për këtë arsye duhej të kryhej më parë kontrolli dhe çminimi i tyre.

- **Më datën 26.10.1999** u krye prej nesh zhvarrosja e shtatë kufomave të shtetasve Shqiptarë të Kosovës nga një varrezë masive pranë varrezës së Romëve në fshatin Miradie e Lartë e komunës së Fushë Kosovës. Kjo varrezë ndodhej në një parcelë bujqësore djerrë, e vendosur midis hekurudhës Prishtinë – Shkup dhe lumit Graçanica. Ajo përbëhej nga dy pjesë me forma katërkëndëshe, njëra më e madhe, me përmasa 14 x 4 m dhe tjetra më e vogël, me përmasa 4x 1.5 m.

Në këqyrjen e njëres prej kufomave tyre, të përbërë nga disa mbetje kufomore të ndara, me fenomenin e kalbëzimit të pranishëm, u përcaktua se ato i takonin një personi të seksit mashkull, me moshë mbi 50 vjeç, me dëmtime të shumta kryesisht nga veprimi i temperaturave të larta.

- **Më datë 27.10.1999**, në morgun e Institutit të Mjekësisë Ligjore të Prishtinës, ne drejtuan ekspertimin mjekoligjor të një kufome tjetër të ekzumuar nga varreza e mësipërme e fshatit Miradie.

Kufoma është e seksit mashkull, paraqitet në një stad të përparuar të kalbëzimit, me fenomene të mumifikimit dhe saponifikimit. Nga këqyrja e

teshave dhe shenjave të tjera identifikuese, u vërtetua se i përkiste viktimës Shqiptare, Sh.A., 71 vjeç, banor në Fushë Kosovë, i vrarë nga forcat ushtarake serbe në muajin Maj 1999.

Nga këqyrja e jashtme dhe e brendshme e kufomës, ku indet e buta dhe organet e brendshme ishin të tretura dhe shiheshin vetëm mbeturina të tyre, u konstatuan dy plagë të tejprtejme me armë zjarri: njëra në kokë me drejtim nga para-përpara dhe tjetra në gjoks me drejtim nga para – prapa.

Shkaku vdekjes: dëmtimet e rënda të trurit dhe organeve të gjoksit.

Pra, ky një rast i pastër vrasjeje me armë zjarri të një banori shqiptar civil, ku me sa duket, plaga e kokës është bërë për t’i dhënë fund menjëherë jetës së viktimës.

Dokumente të tjera të zhdukjes së viktimave dhe vrasjeve të zbuluara pas luftës në Kosovë

Vrasjet e viktimave shqiptare dhe zhdukjet e tyre të zbuluara pas luftës në Kosovë, janë të vërtetuara nga ekzaminimet mjekoligjore dhe dokumentet e dëshmitë e panumërta që tregojnë krimet e rënda të kryera nga ushtria dhe paramilitarët serbë, kryesisht në vitet 1998 dhe 1999.

Si të dhëna të tilla të dokumentuara mund të përmenden studimet e Prof.Naim Haliti dhe Prof. Jusuf Osmani, në të cilat jepen në mënyrë të përmbledhur këto të dhëna kryesore të tyre:

“Gjatë periudhës shkurt 1998 – qershor 1999 janë keqtrajtuar 19.440 persona shqiptarë në Kosovë; janë vrarë 9183 të tjerë, janë marrë peng 700 persona dhe dhunuar 126 femra. Gjithashtu janë shpërngulur me dhunë nga trojet e tyre 987000 shqiptarë si dhe 500000 të tjerë janë detyruar të largohen nga banesat e tyre. Pra, më shumë se 1.5 milion persona u bënë viktima të krimeve të shumëllojshme e çnjerëzore të forcave serbe”.

Kufomat e shumë shqiptarëve të Kosovës të vrarë, janë zhvendosur jashtë Kosovës me qëllim të zhdukjes së shenjave të krimeve të kryera. Kjo po vërtetohet me hapjen tani të varrezave të shumta në Serbi.

Gjithashtu dyshohet se shumë kufoma janë



Foto të fytirave të disa prej viktimeve Shqiptare të luftës së Kosovës (1999) dhe varrezave të tyre.

djegur në furra, si në atë të Zverçanit etj.

Në dokumente të tjera dëshmohet se kur Serbët u larguan nga Kosova për shkak të bombardimeve të Natos, ata morën me vete të gjithë dokumentacionin të ngarkuar në kamiona ose thjesht e asgjësuan.

Po kështu nuk duhet harruar që një pjesë e viktimeve Shqiptare të këtyre krimeve, nuk janë shoqëruar me ekspertime mjekoligjore menjëherë pas ndodhjes së këtyre vrasjeve. Kjo është arsyeja që ato nuk janë pasqyruar në disa studime të kryera më vonë, të mbështetura në shqyrtimin e akteve mjekoligjore të asaj kohe, të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Prishtinës.

Sipas një dokumenti të Wikipedia të vitit 2016, krimet serbe kundër popullsisë shqiptare në Kosovë mund të përmbliidhen në: Persekutimi dhe spastrimi etnik, shkatërrimi i vendbanimeve, përdhunimet e femrave, shkatërrimi i xhamive, monumenteve dhe ndërtimeve me arkitekturë tradicionale, zhdukja e identitetit, me anë të konfiskimit të letrave të identitetit, pasaportave për ta bërë të vështirë ose të pamundur për personat e larguar që të ktheheshin përsëri në Kosovë, masakrat e shumta me vrasje të civilëve: Raçak, Imeraj, Pemishtë/ Cërkolez, Suva Reka, Drenica, Izbika, Bela Crkva, Meja, Orahovac, burgu i Dubravës, Vuçiterni etj., fshehja e kufomave duke i dërguar në vende të tjera, si në minierën e Trepces, në Serbi, apo duke i djegur.

Por duhet shtuar se gjatë kësaj kohe, nga disa qarqe evropiane proserbe, antikosovare dhe antishqiptare, u ngritën shumë akuza të pavërteta kundër UÇK-së, ku më të rëndësishmet janë

ato të Karla del Ponte, prokurore e përgjithshme e Zvicrës, që ishte caktuar kryeprokurore e Gjykatës së Hagës në krimet e luftës në Jugosllavi. Në librin e saj “The hunt: Me and War Criminals in 2008”, ajo ngriti pretendimin se pas mbarimit të luftës të vitit 1999, Shqiptarët e Kosovës dhe ata të UÇK-së kishin përdorur për trafikun e organeve humane nga Kosova për në Shqipëri, 100 deri në 300 shtetas Serbë dhe të minoriteteve të tjera. Në mbështetje të saj, Dick Marty, senator Zvicerian i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, bëri një akuzë të rëndë, por të pavërtetë, që e përpiloi në raportin e tij: “Trajtimi i paligjshëm i organeve në Kosovë dhe Shqipëri”, që e paraqiti në Këshillin e Evropës në vitin 2011. Por kanë kaluar më shumë se 10 vjet dhe asnjë nga pretendimet e ngritur në këtë raport nuk është vërtetuar. Për këtë arsye, kuvendi i Shqipërisë në muajin korrik 2022 i dorëzoi Këshillit të Evropës një rezolutë kundër raportit të Dick Marty. Megjithatë, në periudhën janar 1998 deri më 12 qershor 1999 janë vrarë edhe 281 civilë serbë të paarmatosur (211 meshkuj, 70 femra), janë zhdukur 123 civilë serbë (99 meshkuj dhe 24 femra). Pavarësisht nga këto të dhëna të dokumentuara, një e vërtetë e pamohueshme është se në shumicën dërrmuese, viktimat e vrara dhe të masakruara kanë qenë ato të shtetasve shqiptarë të Kosovës.

Për të gjitha këto raste të ekspertimeve që kryem ato ditë, që kishin të bënin me vrasje kriminale të egra, ato kanë qenë shumë tronditëse për ne. Kjo sepse, ne mjekët ligjorë si shqiptarë, serbë apo edhe të vendeve të tjera, që jemi ndeshur me vrasje dhe masakra të egra, pavarësisht nga

kombësia e viktimave: Shqiptarë, Serbë etj., jemi prekur prej tyre duke na u shfaqur një ndjenjë e rëndë vuajtje dhe dëshpërimi.



Me këtë rast po përmend, kujtimet e Prof. D.Lecomte, që ka qenë në atë kohë, drejtor e Institutit Mjekoligjor të Parisit. Ajo mori pjesë menjëherë pas mbarimit të luftës në Kosovë, në ekzaminimet mjekoligjore të viktimave kosovare të vrara dhe të masakruara nga ushtria dhe paramilitarët serbë.

Në librin e saj: “Quai des Ombres” (Platforma e hijeve), botuar në Paris në vitet 2003 dhe 2012, ajo tregon midis të tjerave sa vijon:

“Kam përshtypjen që ky mision i pasluftës i kalon të gjitha tmerret, që kam parë gjatë ushtrimit 20-vjeçar të profesionit tim...”

“...Në një fushë janë varrosur në mënyrë të çrregullt, të futura në thasë me ngjyrë jeshile, kufoma të personave meshkuj, me mundësinë më të madhe banorë të qyteteve, sepse janë me veshje të mira. Pothuajse të gjitha paraqesin shenja të torturave. Kyçet e duarve dhe këmbëve i kanë të dërrmuara. Pra gjithçka për të shkatërruar, për të mbjellur terror....”

“...Në një vend tjetër, një banor na tregon se në fundin e puseve të ujit atje, gjenden të futura gra. Pas gërmimit nxirren prej tyre kufoma femrash të ruajtura mirë, por që duhet kryer menjëherë ekzaminimi mjekoligjor, sepse procesi i kalbëzimit ndodh shpejt në këto raste. I zhveshëm viktimat, teshat e të cilave ishin të tejmbushura me ujë. Ekzaminimi i tyre ka qenë shumë i rëndë; këto gra kanë qenë përdhunuar në fillim dhe më pas janë hedhur të gjalla në pus, ku janë mbytur...”

“Në një fshat tjetër, në një shtëpi janë vrarë të gjithë anëtarët e një familjeje. Gjaku është i

shpërndarë kudo. Gratë dhe fëmijët janë vrarë në sytë e burrave, të cilët më pas janë qëlluar në rrugë me nga një plumb në kurriz”.

“...Më kujtohet një rast tjetër ku të gjitha shtëpitë ishin të shkatërruara. Një banor na tregon shenjat e goditjeve të plumbave në mure dhe një grumbull hiri në oborr, duke na shpjeguar që personi i moshuar që ruante shtëpinë, u vra me një plumb dhe u dogj në zjarrin e shtëpisë. Nga shtëpia në shtëpi na tregohet i njëjti skenar....”

Analiza e të dhënave mjekoligjore të mësipërme, në një këndvështrim të gjerë penal, kriminologjik, etik, historik

Nga gjithçka sa u pa dhe u ekzaminua prej nesh, si dhe nga analiza e materialeve të tjera, na u përforcua idea se ngjarjet tragjike që paraprinë luftën në Kosovë mund të konsiderohen si vrasjet më masive të shqiptarëve nga fqinjët e tyre.

Shqyrtimi i tyre nga pikëpamja mjekoligjore është shumë i rëndësishëm, sepse, siç dihet, Mjekësia ligjore është një shkencë që përfshihet më shumë se disiplinat e tjera në ngjarjet që ndodhin në çdo periudhë kohore, duke pasur një lidhje të ngushtë me kriminologjinë (dituria e studimit shkencor të fenomeneve kriminale).

Pikërisht, në një këndvështrim të tillë të gjerë jo vetëm mjekoligjor – kriminologjik, por edhe penal, etik, historik etj., analizohen edhe të dhënat mjekoligjore të rasteve të ekzaminuara nga ana jonë si dhe e materialeve të tjera të dokumentuara.

Këto vrasje kanë qenë të tmerrshme dhe shumë të egra, me ndarje të pjesëve trupore të kufomave, mbytje në puse, përdhunime të femrave, vrasje të fëmijëve, djegie të tyre për t'i zhdukur dhe shumë mënyra të tjera të paimagjinueshme, sikurse përmenden në këtë material.

Për të justifikuar këto krime të rënda dhe për të zhvlerësuar efektin e tyre shumë të keq në opinionin botëror, nga ana e qarqeve të caktuara evropiane filloserbe, u ngrit akuza false, që gjoja edhe Shqiptarët e Kosovës, kanë kryer krime të rënda ndaj Serbëve duke i vrarë dhe ju marrë atyre organet për të kryer trafikun ilegal të tyre. Përveç kësaj, Serbia, duke përfutur edhe nga dobësitë e shtetit të ri të Kosovës është përpjekur të ampli-

fikojë, vrasjet e Serbëve, që mund të kenë qenë kryer nga UÇK-ja gjatë kësaj kohe.

Së pari, ato nga shifrat e paraqitura kanë qenë shumë të pakta dhe prandaj krahasimi i tyre do të ishte krejt i pavend dhe i pavlerë.

Në të vërtetë, Serbia ka kryer një gjenocid të egër prej një shekulli e gjysmë ndaj popullit shqiptar; kjo ka bërë që ndjenja e urrejtjes sot të jetë ngulitur në mendjen e shqiptarëve, për shkak të masakrave historike të kryera ndaj tyre nga fqinjët e tyre.

Gjenocidi, siç dihet, përbën atë që quhet shkatërrim i qëllimshëm i plotë ose i pjesshëm, gradual ose i menjëhershëm i një grupi etnik, ose populli, kryesisht me anën e vrasjeve, dezintegrimin të gjuhës, kulturës, ndjenjës kombëtare, të pasuar me largimin nga trojet ku jeton etj.

Si shfaqje më tipike e tij ndaj popullit shqiptar vlen të përmenden gjenocidi i egër grek kundër popullsisë çame të pasuar me aneksimin e trojeve të tyre nga ana e shtetit grek, masakrat serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, Mal i Zi (masakra e Tivarit) dhe Maqedoni, që sollën dëbimin dhe largimin e popullsisë shqiptare prej krahinave ku ata jetonin që prej shumë shekujsh.

Dokumentet e këtij gjenocidi, me qëllim për t'i dëbuar shqiptarët nga trojet e tyre shekullore janë të panumurta.

Vlen të kujtohen në këtë studim, masakrat kundër shqiptarëve në luftat ballkanike të viteve 1912-1913, nga ushtritë Serbe dhe Malazeze, nga të cilat u vranë ose vdiqën nga 10000 deri 25000 mijë shqiptarë, midis tyre shumë fëmijë, gra dhe të moshuar, ku mjaft prej tyre ishin me hundën dhe gojën e copëtuar, si dhe të tjerë në Kosovë të varrosur të gjallë. Shumë prej tyre me heqje të veshëve, hundës dhe gjuhës me anën e prerjeve, me nxjerrje të syve apo edhe me heqje të kokës (dekapitim) si dhe një pjesë tjetër e viktimave të djegura. Aq e madhe ishte frika që sollën këto krime monstruoze të ushtrisë serbe, sa 40 mijë shqiptarë u detyruan të braktisin banesat e tyre, ndërsa disa gra shqiptare kanë vlarë fëmijët e tyre që mos të binin në dorën e serbëve.

Trocki, një nga udhëheqësit e revolucionit Bolshevik në Rusi dhe kundërshtar i Stalin-it, në intervistat si korrespondent i gazetës më të përhapur të Rusisë Jugore, “Kijevskaja Misl

(mendimi i Kievit)”, pasi ka vizituar trojet Shqiptare, ka shfaqur indinjatën e tij, për dhunën dhe gjenocidin Sllavo – Serb kundër shqiptarëve në vitet 1912 – 1913.

Ai ka shkruar: “Ika i tmerruar se do të kishte qenë pa dobi çdo përpjekje për t'u dalë shqiptarëve në mbrojtje.....ika i tmerruar për të mos dëgjuar britmat e shkaktuara nga dhimbjet... nuk isha në gjendje as t'i ndihmoja”.

Ndërsa, duke ju drejtuar një prej figurave politike sllavofile, ai shprehet: “Ç'ka keni për të thënë lidhur me këto metoda për të siguruar fitoren e elementit sllav..... a nuk ju bën ju bashkë-fajtorë për këto akte shtazarake, të cilat do të lënë damka të zeza për tërë epokën”. Për fat të keq këto veprime dhe sjellje gjenocidale kanë vazhduar edhe më pas, madje më të shtuara në vitet 1990.

Kaq e madhe ka qenë qëndrimi poshtërues dhe përbuzja e serbëve ndaj shqiptarëve, në ato vite, sa në hyrje të hotel “Grand” në Prishtinë ishte vënë kjo pllakatë: “Është e ndaluar hyrja për qen dhe shqiptar”.

Por në dallim nga të gjithë gjenocidet e mëparshme të pandëshkuara, këtë herë në këtë gjenocid të fundit të egër dhe masiv, i vërtetuar me saktësi edhe nga ekzaminimet e shumta mjekoligjore të viktimave shqiptare, reagoi më me vendosmëri dhe këmbëngulje populli shqiptar duke krijuar UÇK-në që u ndesh me ushtrinë dhe paramilitarët serbë. Nga ana tjetër këto masakra të tmerrshme u njohën dhe tronditën të gjithë botën mbarë e të qytetëruar, sidomos SHBA, që ndërhyu me shpejtësi dhe e çliruan njëherë e përgjithmonë Kosovën nga zgjedha e gjatë dhe e urryer serbe.

Në përfundim të kësaj paraqitjeje duhet theksuar se:

-Mjekësia ligjore në një kuptim të gjerë të saj, përbën një provë shumë të rëndësishme për zbulimin e vrasjeve gjenocidale.

-Në gjenocidin e fundit ndaj popullit të Kosovës, provat mjekoligjore të krimeve të egra dhe të shëmtuara ndaj shqiptarëve, padyshim që i zhvlerësojnë në mënyrë të pakundërshtueshme argumentet mjekoligjore të Serbisë, krejt të parëndësishme, shumë herë edhe false, sipas të cilave kanë qenë gjoja shqiptarët që kanë vlarë Serbët.

HEROI KOMBËTAR

Halit Daci vjen me librin “Skënderbeu në prozën dhe shtypin amerikan”

SI E LEXOI AMERIKA SKËNDERBEUN, STUDIMI

Nga Halil RAMA & Sakip CAMI

- Përmes narrativave të tyre përkatëse, Ludlow dhe Crabb zbulojnë se si heroi shqiptar i shekullit të pesëmbëdhjetë u rikthye dhe u riimagjinua në forma që gëzuan rezonancë përtej kufijve kombëtarë dhe kohorë....
- Reverend James M. Ludlow, dhe John H. Crabb, me penat e tyre të fuqishme e shpallën, e përhapën dhe e ruajtën në prozë legjendën e Skënderbeut në Amerikë...



Studiuesi Halit Daci, ish Nënkolonel i ushtrisë shqiptare, tani me banim në Nju Jork të ShBA, pas disa kërkimeve e studimeve për Heroin tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, botime në gjuhën angleze dhe amerikane, sjell për lexuesit librin voluminoz me mbi 600 faqe me titull: “Skënderbeu në Prozën dhe Shtypin Amerikan”.

Ndërsa libri i N/Kol. Dacit është shkruar për një audience) anglishtfolëse, në vijim po japim për lexuesin shqiptar poi u referohemi parathënies, shënimeve editoriale, hyrjes dhe permbledhjes në faqen e pasme të librit.

Libri përmbledh dy romane të panjohura, si për lexuesit e apasionuar pas shkrimeve për Skënderbeun, ashtu edhe për kritikët letrar, të shkruara nga autorët James M. Ludlow dhe John H. Crabb.

Romani i autorit Ludlow është aq i njohur për lexuesit e huaj dhe ato shqiptar, saqë një botim

tjetër, në dukje, është pothuasje i panevojshëm. Ai është botuar si serial i përditshëm në vitin 1905 në 15 shtete Amerikane dhe 26 gazeta Amerikane.

Botimi i N/Kol Dacit është krejt i ndryshëm nga botimet e mëparshme dhe ato aktuale që gjenden në shitje në formë libri dhe digjitale. Ai bën të ditur se romani i njohur i autorit Ludlow u përgatit për botim në formë seriali të përditshëm nga Shoqata e Shtypit Amerikan në vitin 1903.

Ndryshe nga botimet në formë libri, që përmban 56 kapituj, seriali gazetaresk përmban 38 kapituj dhe është i pasuruar me illsutrimë të piktururara nga piktorë të panjohur më parë nga lexuesit aktual për më shumë se një shekull.

Romani tjetër i botuar nga Dorrance Publishing në vitin 1952, është i plotësisht i panjohur dhe nuk gjendet lehtë në shitje.

Studiuesi Halit Daci na i jep të plotë këto dy romane të hershme për Skënderbeun nga autorët amerikanë.

Libri i tij i sapobotuar, pavarësisht se është botim privat (jo nga shtëpi botuese por që gjendet në Amazon) ndjek rregullat standarte të industrisë amerikane të botimeve, atë të Chicago Manual of Style.

Botimi sjell për here të parë, pas më se një shekulli, më shumë se 150 ilustrime, piktura, imazhe të marra nga arkivat, gazetave të kohës dhe koleksionet private, duke filluar nga viti 1885 deri në vitin 1970, deri tani të panjohura për publikun.

Përmbajtja është ndarë në tre pjesë kryesore dhe ndjek strikt e stilikisht formën e pasqyrës, paralelizmit, për pjesët dhe autorët.

Pjesa e parë jep detaje mjaft të çmuara dhe deri tani të panjohura në lidhje me angazhimin e James M. Ludlow me figurën e Skënderbeut, duke filluar nga viti 1885. Më tej në pjesën e parë jepet një pasqyrë e burimeve arkivore të botimit në formë seriali, kryesisht në vitin 1905, formë e cila e rriti ndjeshëm numrin e lexuesëve të përditshëm amerikan dhe ju dha mundësi të njohin



me hollësi figurën legjendare të Skënderbut.

Në pjesën e dytë jepet transkriptimi i plotë i serialit të nxjerrë nga gazeta të ndryshme amerikane nga shkurti i vitit 1905 deri në tetor 1911.



Në pjesën e tretë N/Kol Daci prezanton burimet hulumtuese arkivore në lidhje me romanin e panjohur *In the Crescent's Dark Shadow* (Nën Hijen e errët të Gjysëm Hënës). Në këtë pjesë, autori gjithashtu sjell të dhëna deri tani të panjohuara me anë të të cilave rindërton biografinë John H. Crabb. Ai paraqet për lexuesin një analizë kritike të romanit të Crabb-it, dhe e sjell atë më të plotë (nga ai i skaduar copyright ose i parinovuar).

Libri gjendet në Amazon ose mund të porositet direkt nga autori, duke paguar vetem koston e shtypshkrimit, pa fitim.



PREZANTIMI I LEGJENDËS SË SKËNDERBEUT NË NJË PUBLIK TË GJERË AMERIKAN

“Skanderbeg në Prozën dhe Shtypin Amerikan” riprezanton dy tregime fantastike për heroin leg-

jendar shqiptar, Gjergj Kastriotin — i njohur gjithashtu si Skanderbeg ose Iskender Beu. Autori Halit Daci ka meritën se i sjell ato për lexuesin pas një distance kohore prej rreth gjysmë shekulli. Rëndësia e këtij botimi konsiston në faktin se, këto tregime kapin momente të ndryshme në transmetimin transatlantik të legjendës së Skanderbeut.

“Ndërsa njëri prej këtyre novelave, ai i James M. Ludlow, ka pasur një prani të qëndrueshme, edhe pse në evolim, për lexuesin nëpërmjet botimeve të ndryshme që nga viti 1886 deri në ditët e sotme nëpërmjet pranisë digjitale, tjetri, ai i John H. Crabb është pothuajse i panjohur për lexuesin dhe kritikët letrar. Megjithatë, këto tekste të rikthyer mbeten thuajse të panjohura për lexuesit dhe studiuesit bashkëkohor”, shkruan autori në parathënie të librit. Sipas tij, romani i njohur i James M. Ludlow, *The Captain of the Janizaries*, ka qenë mjaft i sukseshëm si në format librash ashtu edhe dixhital, duke e bërë një botim të ri të vetë tekstit në dukje të panevojshme. Ky volum, megjithatë, rikthen një manifestim të shquar të punës së Ludlow: serializimin e ilustruar të saj në gazetë. Përgatitur për botim serial në gazetë e përditshme amerikane në 1903 dhe botuar në 1905, ky version — i dallueshëm nga botimet e librit të lidhur — ishte i pari që e prezantoi legjendën e Skanderbeut në një publik të gjerë amerikan. Në kontrast, vepra e dytë, *In the Crescent's Dark Shadow* e John H. Crabb, botuar në 1952, është zhdukur pothuajse nga kujtesa letrare amerikane. Vetëm një numër i vogël kopjesh mbijetojnë në koleksionet e bibliotekave dhe koleksione private, dhe romani nuk ka prani të njohur dixhitale. Mungesa e tij në diskursin akademik është e dukshme, veçanërisht duke pasur parasysh angazhimin e vazhdueshëm me narrativën legjendare të Iskender Beut.

“Pavarësisht nëse romani ishte një ushtrim i hershëm në ardhjen e një autori (historiani) të ri ose thjesht i mungonte mbështetja promovuese e një botuesi të vendosur, ai rrëshqiti në heshtje nga qarkullimi publik”, shprehet autori H. Daci.

Së bashku, këto dy romane gjurmojnë lëvizjen e legjendës së Skanderbeut përmes prozës amerikane dhe shtypit periodik. Ato tregojnë se kjo trashëgimi u formua jo vetëm nga imagjinata autoriale, por edhe nga mekanizmat specifikë të kulturës së shtypit — përkatësisht, serializimi, ilustrimi dhe praktikatat e leximit të një audiene

në zgjerim. Përmes narrativave të tyre përkatëse, Ludlow dhe Crabb zbulojnë se si heroi shqiptar i shekullit të pesëmbëdhjetë u rikthe dhe u riimagjinua në forma që gëzuan rezonancë përtej kufijve kombëtarë dhe kohorë.

Rikthimi i këtyre teksteve për këtë botim nga Halit Daci u bë i mundur falë arkivave rajonale, shoqatave historike, bazave të gjera të të dhënave të gazetave dixhitale dhe koleksioneve private të librave. Prandaj, sipas autorit Daci, ky volum ofron një mundësi të re për të shqyrtuar se si historia e Skanderbeut u ndërta, u përhap dhe u riimagjinua në kulturën e shtypit amerikan.

“Ky botim shërben si një rivendosi e veprave letrare të harruara prej kohësh dhe si një ftesë për rishqyrtimin e përfaqësimit të Skanderbeut brenda kornizës më të gjerë të historisë letrare amerikane”,-pohon autori Halit Daci.

ORIGINALITETI I TEKSTEVE



Skanderbeg në Prozën dhe Shtypin Amerikan riprezinton dy tregime të rralla: historinë e ilustruar të serializuar të James M. Ludlow, *The Captain of the Janizaries*, dhe tekstin e plotë të romanit të vështirë për t’u gjetur të John H. Crabb, *In the Crescent’s Dark Shadoë*. Autori Halit Daci, ka meritën e padiskutueshme se pas një punë studimore skurpuloze disaveçare ka rritur ka arritur t’i paraqesë këto tekste në formën e tyre origjinale, me ndërhyrje redaktuese të kufizuar në korrigjimin e gabimeve të dukshme tipografike dhe të pikësimit për qartësi.

Karakteristikat periodike tipike — duke përfshirë dikcionin karakteristik, praktikën e ndarjes me vizë, mospërputhjet e brendshme dhe strukturat episodike — janë ruajtur gjatë gjithë tekstit.

Për të ruajtur integritetin historik të veprave, gjuha që mund të duket tashmë arkaike është lënë e pandryshuar — duke përfshirë ruajtjen e përdorimit të ndryshueshëm të Crabb-it të drejtshkrimin britanik dhe amerikan.

Tekstet pasqyrojnë gjuhën, qëndrimet dhe supozimet e periudhës dhe preferencat e të dy shkrimtarëve, dhe ato mund të përmbajnë terma ose përfaqësime që disa lexues bashkëkohorë

mund t’i gjejnë ofenduese.

Autori Daci bën të ditur se të gjitha materialet e përfshira në këtë volum janë verifikuar se janë në pronësi publike (public domain) ose janë përdorur nën licencë të përshtatshme në kohën e botimit. Shënime të hollësishme të burimit shoqërojnë tekstet.

RIFORMATIMI I HISTORISË SË ISKENDER BEUT BRENDA KONVENTAVE TË ROMANIT HISTORIK

Në këtë botim të një rëndësie tejet të veçantë, Heroi ynë ombëtar Gjergj Kastrioti (rreth 1405–1468), i njohur gjithashtu si Skanderbeg ose Iskender Beu, qëndron ndër kundërshtarët më të fortë të Perandorisë Osmane në histori. Në hyrje të librit, autori Halit Daci, qëllimisht jep një historik të shkurtër të Gjergj Kastrioti Skënderbeut.

“Një fisnik shqiptar i marrë në oborr osman përmes sistemit devshirme në rini, ai u rrit dhe edukua ushtarkisht në shkollat ushtarake osmane, duke u ngritur më në fund në gradën e sanxhakbeut. Në 1443, ai hoqi dorë nga besnikëria osmane dhe e kërkoi përsëri tokën e tyre të paraardhësve. Nga ajo kohë deri në vdekjen e tij në 1468, Skanderbeg zhvilloi një rezistencë të vazhdueshme dhe shumë efektive kundër forcave osmane shumë superiore. Fitoret e tij i siguruan titullin “Mbrotës i Kryqit”, dhe emri dhe reputacioni i tij kanë zgjatur për shekuj, duke e siguruar vendin e tij në histori dhe duke frymëzuar një traditë të pasur dhe të vazhdueshme letrare”,-shkruan autori i këtij libri. Ndërkohë ai argumenton se megjithëse sulmet ushtarake të Skanderbeut u zhvilluan në të gjithë Shqipërinë dhe Perandorinë Osmane, ruajtja dhe transmetimi i trashëgimisë së tij letrare u formuan kryesisht nga shkrimtarë evropianë — dhe më vonë amerikanë. Kjo për faktin se nga Rilindja e tutje, sulmet e tij frymëzuan historianë, poetë, dramaturgë, novelistë dhe artistë të tjerë.

“Teksti themelor në këtë traditë ishte *Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarum principis e Marin Barleti*, e botuar për herë të parë në Romë në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. E përkthyer gjerësisht, kjo biografi tipike siguroi vendin e Skanderbeut në kujtesën kulturore evropiane dhe vendosi kornizën narrative mbi të cilën janë bazuar shumica e autorëve historik dhe letrar”, pohon autori H. Daci. Ai argumenton se tradita evropiane gjeti shprehje të rinovuar

në Amerikë, ku legjenda e Skanderbeut hyri në kulturën letrare amerikane përmes qarkullimit transatlantik të librave, periodikëve dhe arsimit klasik. Ndërsa studiuesit dhe kritikët letrar, sipas tij, kanë vënë në dukje prezantimin e figurës së Skanderbeut në vepra të tilla si— si George Castriot, Surnamed Scanderbeg, King of Albania (1850) e Clement C. Moore, poema “Scanderbeg” (1873) e Henry W. Longfellow, dhe The Captain of the Janizaries (1886) e James M. Ludlow — nuk ekziston aktualisht asnjë studim gjithëpërfshirës në lidhje me prezantimin e Skanderbeut në letërsinë amerikane, për ta veçuar atë nga letërsia dhe botimet specifike angleze.



“The mark!”

“My father's death!”

Në të vërtetë, kërkime të mëtejshme zbulojnë se Skanderbeg u shfaq në një gamë të gjerë të produkteve letrare dhe artistike amerikane, duke përfshirë drama, prozë, poezi, ese dhe artet vizuale. Shumë prej këtyre materialeve janë dokumentuar në librin e botuar privatisht nga autori në Amazon, Skanderbeg (2022) — botimi me i plote për veprat anglo-amerikane deri më tani — i cili bashkoi si vepra të njohura më parë ashtu edhe vepra të risjella angleze dhe amerikane, së bashku me evidenca të adaptimeve të tjera dramatike të skenizuara në kolegjet katolike në fillim të shekullit të njëzetë.

“Një arritje mjaft e rëndësishme e atij projekti ishte rindërtimi i historisë së dramës më të spikatur të periudhës për këtë temë, Iskander, Soldier of the Cross (2022) — performanca dhe pritja kritike e së cilës u dokumentuan dhe ruajtur gjerësisht në shtypin periodik të kohës — duke kulmuar në një

studim të rrallë arkivor, gjithashtu të panjohura për lexuesit. Me këtë bazë të vendosur, ky volumen i kthehet dy tregimeve të harruara fantastike amerikane që dikur hynë — dhe më vonë u zbehën nga — vetëdija letrare amerikane, duke gjurmuar se si legjenda dhe trashëgimia e Skanderbeut u përfaqësuan në prozë dhe u përhapën përmes shtypit periodik në Shtetet e Bashkuara”, shkruan autori i këtij libri. Ai bën të ditur për lexuesin se e para, The Captain of the Janizaries e Ludlow, transkriptohet nga serializimi i saj i gazetave të 1905-ës, një adaptim i mëvonshëm dhe i dallueshëm i botimit të njohur të librit të 1886-ës.

I përmirësuar nga ilustrime të rralla, ky version i lejoi lexuesve të përballeshin me narrativën vizualisht dhe në mënyrë episodike. Rikthimi i tij nxjerr në pah rolin qendror të shtypit periodik në formimin e angazhimit letrar amerikan me Skanderbeun.

Vepra e dytë, In the Crescent’s Dark Shadow e John H. Crabb, e riformaton historinë e Iskander Beut brenda konventave të romanit historik. Ajo thekson çështjet e formimit të identitetit dhe zgjimit kombëtar në Shqipërinë e shekullit të pesëmbëdhjetë, ndërsa detajon me kujdes pozicionin gjeopolitik të Shqipërisë midis Perandorisë Veneciane dhe Osmane. Pavarësisht meritave mjaft të çmuara për prezantimin e figurës së Skanderbeut, romani është harruar plotësisht, është i panjohur dhe mbijeton sot vetëm në kopje të rralla, vetëm në tre biblioteka, dhe është e vështirë për t’u gjetur në shitje. Si pasojë, si Crabb ashtu edhe vepra e tij kanë mbetur marginale në studimet për Skanderbeun dhe kryesisht të panjohura për lexuesit bashkëkohor.

Së bashku, këto romane tregojnë përshtatshmërinë e vazhdueshme dhe të qëndrueshme të legjendës së Skanderbeut në letërsinë amerikane. Ato ilustrjnë se si pena autoriale nga periudha dhe profesione të ndryshme e përshtatën legjendën e Skanderbeut në periudha të ndryshme. Duke i vendosur këto vepra brenda konteksteve të tyre specifike historike dhe studimeve më të gjera mbi Skanderbeun në Amerikë, kjo botim kritik ofron një kuptim të ri se si një figurë e vetme legjendare bëri të mundur të lidh shekuj, kontinente, dhe median.

JUBILARE

30 VJET NGA THEMELIMI I AKADEMISË SË SHKENCAVE SHQIPTARO-AMERIKANE NË NEW YORK

Prof.dr. Flori Bruqi

- Rritja në numër e anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Artit me seli në Nju Jork, Tiranë, Prishtinë e Shkup, ka sjellë prej kohësh nevojën e një enciklopedie, ku do të pasqyrohej kontributi i anëtarëve të kësaj Akademie që jetojnë në trojet shqiptare dhe në Diasporë.
- Libri “Leksikon enciklopedik” vjen si një kontribut i çmuar i kësaj akademie, që nga themelimi i saj në vitin 1995 e deri më sot.



Prishtina, Peja, Tetova, Shkupi, Gostivari, Kumanova, Presheva, Bujabovci, Plava, Ulqini, Gjirokastra, Shkodra, Çamëria, Malësia e Madhe si dhe nga Diaspora.

Bashkërisht në këtë Akademi organizuam një sërë aktiviteteve shkencore dhe kombëtare si fjala vjen: Konferenca kushtuar 600 vjetorit të lindjes së Heroit kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeut, 70 vjetorit të lindjes së shkrimtarit të shquar Ismail Kadare. Konferenca për gjuhën e njësuar shqipe, ku senatori i gjuhës dhe kulturës kombëtare prof. Peter Prifti mbrojti me argumente origjinale rëndësinë historike të Kongresit të Drejtshkrimit në Tiranë 1972, kundër qëndrimeve subjektive, politike dhe

antishkencore të Arshi Pipës.

Akademia e Shkencave dhe Arteve Shqiptare Amerikane në Nju Jork punimet e veta shkencore i ka botuar në revistën shkencore të Akademi-

misë “Dituria” si dhe në gazetat tjera prestigjioze: “Iliria”, “Dielli”, “Fjala e lirë”, “Drini”, “Albania-Press_Romë”, “Bota sot”, “Epoka e re”, “Kosova sot”, “Telegrafi,” etj.

Ndërsa në vitin 2019 kjo Akademi i botoi dhe përuroi në Prishtinë dy libra të autorëve nga Kosova: Dibran Fylli “Tokë e mbjellë në Varre” (Krimet Serbe në Kosovë 1998-1999), si dhe librin e Jahja Llukës “Përmbledhje shkrimesh”.

Në mars të vitit 2020 është botuar libri i parë i “Leksikoni enciklopedik”, i cili sadopak e ka

Më datën 28 Nëntor 2025 u mbushën plot 30 vjet (nga 28 nëntor 1995) që kur u bë një kthesë e madhe historike, pasi që me këtë datë u themelua edhe Akademia e Shkencave Shqiptaro- Amerikane në NewYork.

Themelues të Akademisë janë Akademik Prof. Dr. Skënder Kodra, Dr. Ulvi Vehbiu, Dr. Adem Harxhi, Dr. Namik Shehu, Mentor Mata, Sanie Selita etj.

Akademia në fakt është një institucion mbarë kombëtar, ngase ka anëtarë nga Tirana,

plotësuar zbrazëtitrat që janë hetuar në zhvillimin e shkencës, letërsisë, artit, kulturës etj, ngase një leksikon i tillë biografik dhe bibliografik deri me tash nuk ka ekzistuar në botë.

Akademia e Shkencave dhe Arteve Shqiptare Amerikane në Nju Jork punimet e veta shkencore i ka botuar në revistën shkencore të Akademisë “Dituria” si dhe në gazetat tjera prestigjioze: “Iliria”, “Dielli”, “Fjala e lirë”, “Drini”, “Albania-Press_Romë”, “Bota sot”, “Epoka e re”, “Kosova sot”, “Telegrafi,” etj.

Shkencëtarët, shkrimtarët dhe artistët tanë, edhe pse jetuan dhe krijuan në rrethana të caktuara, ata identitetin kombëtar e dëshmuar me veprat e tyre, me përmbajtjet e veprave, me personazhet, me ambientin, e madje edhe deklaratat e tyre se janë shqiptarë.

Gjatë shkrimit dhe botimit të këtij leksikoni, për 4 vjet pandërprerë na kanë përcjellë edhe probleme të ndryshme në grumbullimin, verifikimin dhe sistemimin e të dhënave enciklopedike.

Rritja në numër e anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Artit me seli në Nju Jork, Tiranë, Prishtinë e Shkup, ka sjellë prej kohësh nevojën e një enciklopedie, ku do të pasqyrohej kontributi i anëtarëve të kësaj Akademie që jetojnë në trojet shqiptare dhe në Diasporë.

Libri “Leksikon enciklopedik” vjen si një kontribut i çmuar i kësaj akademie, që nga themelimi i saj në vitin 1995 e deri më sot.

Pas një pune të mundimshme dhe të suksesshme, autori i leksikonit, Kryetari i Akademisë Akademik Prof.dr.Skender Kodra, më bashkë-punëtorët e tij kanë arritur që t`i japin lexuesit Enciklopedinë biografike dhe bibliografike të akademikëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencës dhe Artit, si dhe

disa intelektualëve tjerë që kanë lënë gjurmë në shkencë, letërsi, art, film etj.

Në këtë mënyrë kemi një tablo të plotë të këtyre autorëve dhe veprave të tyre në Shqipëri dhe Kosovë, Maqedoni dhe Malin e Zi, në Luginën e Preshevës, Medvegjës, Bujanocit, Çamërisë dhe në Diasporë.

Kryetari i Akademisë Akademik Prof. dr.Skender Kodra, Autori i leksikonit Flori Bruqi, së bashku me stafin redaksional ka punuar me dashuri dhe përkushtim në mbledhjen e këtyre biografive dhe bibliografive të njerëzve të shquar të trojeve shqiptare dhe të diasporës.

Shumë prej tyre nuk rrojnë më, ndaj edhe marrja e informacionit ka paraqitur vështirësi.

Mirëpo këmbëngulja e stafit tonë ka bërë që asnjë prej anëtarëve të Akademisë Shqiptare Amerikane të Shkencave dhe Arteve të mos mungojë, madje të mos mungojë asnjë vepër e tyre. Kjo tregon seriozitet dhe përgjegjësi, kur merr përsipër të shkruash vepra të përmasave të tilla madhore.

Nuk kanë hyrë në “Leksikon enciklopedik” ata që nuk kanë vepra shkencore, letrare etj., të botuara, si dhe ata që nuk i kanë dërguar më kohë biografite dhe bibliografite e tyre.

Njerëzit e interesuar do të kenë mundësinë të njihen, jo vetëm me shtrirjen gjeografike ku veprojnë këta autorë, por edhe me prurjet shkencore që ata kanë sjellë në të gjitha fushat e dijes njerëzore.

Libri enciklopedik do t`ju vijë në ndihmë mësuesve, nxënësve, pedagogëve dhe studentëve, kërkuesve të rinj shkencorë dhe gjithë atyre që janë të interesuar të thellojnë dijet e tyre akademiko – shkencore.

**Akademik PHD Skender Kodra, Kryetar
Akademik PHD Mehdi Hyseni, NënKryetar**

Akademik PHD Flori Bruqi, drejtor për mardhënie më publikun

NDERIMI

Kryetari i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork vlerësohet nga Imazhi Shqiptar & Identiteti Kombëtar

PROF. DR. SKËNDER KODRA - “AMBASADOR I IMAZHIT SHQIPTAR NË BOTË”



29 Dhjetor 2025 - Sot, në Selinë Qendrore të Imazhit Shqiptar në Botë, në Tiranë, u zhvillua ceremonia solemne e vlersimit të Prof. Dr. Skënder Kodrës me titullin “Ambasador i Imazhit Shqiptar në Botë”.

Fondacioni “Forumi Imazh & Media” e vlerësoi Prof. Dr. Skënder Kodrën me çmimin “Ambasador i Imazhit Shqiptar në Botë – Imazhi shqiptar patriotik në mërgatë”, me motivacionin:

“Për kontributin e jashtëzakonshëm atdhetar, arsimor dhe kulturor të dhënë ndër dekada, në të gjitha hapësirat shqiptare të Gadishullit Ilirik dhe në diasporë; për misionin e pandërprerë në promovimin e vlerave të identitetit kombëtar dhe të imazhit shqiptar në botë.”

Çmimi u akordua nga Fondacioni “Forumi Imazh & Media” (FIM) dhe iu dorëzua laureatit nga Kryetari i FIM, Prof. Dr. Astrit Memia, në praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të Fondacionit, Prof. Dr. Hysen Muçeku, Mjeshtrit të Madh Halil Rama dhe Prof. Arjan Hamiti.

Ceremonia u moderua nga Mjeshtri i Madh Defrim Methasani.



Falënderimi i Prof. Kodrës për Fondacionin “Forumi Imazh & Media”

Çmimin e pranoi me fisnikëri dhe krenari të veçantë Prof. Dr. Skënder Kodra, i cili shprehu falënderimin e tij për Fondacionin “Forumi Imazh & Media” dhe për Kryetarin e tij, Prof. Astrit Memia. Ai theksoi se ky vlerësim përbën një nder të madh jo vetëm personal, por edhe institucional, si dhe një obligim moral për të vijuar me përkushtim edhe më të shtuar misionin e tij akademik, shkencor dhe kombëtar.



Prof. Kodra u shpreh se ky çmim është një motivim i ri për diasporën shqiptare, e cila vazhdon të mbajë lart imazhin, dinjitetin dhe identitetin kombëtar shqiptar në botë.

***Përkushtimisht Astrit Memia,
Tiranë, më 29 Dhjetor 2025!***

PROF. DR, SKËNDER KODRA, SIMBOL PËR KOMUNITETIN SHQIPTAR NË SHBA, KOSOVË E SHQIPËRI

Me veprimtarinë e tij të gjithanshme akademiko-shkencore dhe si kontributor i rrallë për çeshtjen kombëtar shqiptare, Prof. Dr. Skënder Kodra, është kthyer në një simbol për komunitetin shqiptar në SHBA, Kosovë dhe Shqipëri

Veprimtaria e tij është e larmishme si profesor, psikolog e shkencëtar. Ligjeron në tri universitete me studentë nga e gjithë bota. Ai ka një veprimtari të begatë veçanërisht në Psikologjinë klinike, të cilën e ka pasuruar dhe me përvojën e madhe në spitalet ushtarake të psikiatrisë në Neë York, ku punoi për dhjetë vjet me pacientë të Luftës së Dytë Botërore dhe të Luftës së Vietnamit.

Diturinë dhe përvojën e tij si psikolog dhe shkencëtar, Prof. Dr. Skënder Kodra e ka përcjellë në tetë libra si: Evoluimi i Trurit Dje, Sot dhe Nesër Library of Congress (June 11. 2001) Definition of personality. Tiranë (Library of Congress (2003) Drugs and its Impact. Tirane Library of Congress (June, 11.2004) Road Map Opportunities in Cilinical Psychology, Tiranë Library of Congress (June 12.2006) Library of Congress 101 Independence Ave, S.E. Uashington D.C. 20559-6000.

I brumosur me ndjenja të larta atdhedashurie dhe si intelektual i përgatitur në SHBA, Skënder Kodra ka dhënë një kontribut të çmuar dhe për popullin shqiptar. Në vitin 1995 ai themeloi Akademinë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me qendër në Neë York dhe vazhdon të jetë aktiv si kryetar i kësaj Akademie.

Me ndryshimet demokratike në Shqipëri, Prof. Dr. Skënder Kodra vazhdoi të kontribuoj edhe në dheun amë. Ai punoi dy vjet në Tiranë si klinikist pranë Klinikës psikiatrike të Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin e Tiranës, ku përgatiti dhe ligjëroi leksione të ndryshme. Me kënaqësi ai i dhuroi kësaj klinike një bibliotekë të pasur me literaturë masive të psikiatrisë klinike amerikane. Gjatë kësaj kohe në Radio Tirana ai mbajti një

rubrikë të përjavshme me temë nga psikiatria.

Në këtë periudhë Prof. Dr. Skënder Kodra viziton sërish vendlindjen e tij Kosovën, ku zhvillon një veprimtari të dendur shkencore dhe patriotike, aq sa siç thoshin dhe vendasit, klinika e tij u kthye në një istikam lufte. Pushtuesit serb ia bastisën klinikën dhe e arrestuan për ta detyruar të pajisej me dokumente serbe. Zoti Skënder Kodra nuk pranon dhe largohet i detyruar nga atdheu i tij.

Në verën e vitit të Luftës në Kosovë, Prof. Dr. Skënder Kodra shkoi në ndihmë të të dëbuarve kosovarë, në kampet e shumta në Shqipëri, si dhe në spitalin Ushtarak në Tiranë. Djali i tij Isai ushtarak dhe i lindur në SHBA, u radhit në radhët e UÇK-së në Kosovë, ashtu si dhe shumë të tjerë nga të afërmit e familjes Kodra.

Personaliteti i Prof. Dr. Skënder Kodra është i njohur në SHBA, në vende të ndryshme të Evropës dhe në të gjitha trojet shqiptare. Ai ka qenë këshilltar pranë Ministrisë së Shëndetësisë në Shtetin e Neë Yorkut, është anëtar i Shoqatës së Doktorëve në Shtetin e Neë Yorkut, Anëtar i Shoqatës të sëmundjeve psikike “Sigmund Frojd” të Austrisë, nënkryetar i Akademisë së Intelektualëve Shqiptarë të Shkencës dhe Artit në Kosovë, anëtar i Shoqatës së Psikiatërve në Shqipëri, etj.

Prof. Dr. Skënder Kodra vazhdon të jetë aktiv si mjek, si pedagog, si shkencëtar. Ai vazhdon të publikojë libra dhe studime shkencore në revistën “Dituria”, organ i Akademisë Shqiptaro_Amerikane me qendër në Neë York, Akadmi të cilën e drejton me pasion dhe profesionalizëm, si dhe në shumë revista e gazeta prestigjioze në SHBA dhe Shqipëri.

Figura poliedrike e Prof. Dr. Skënder Kodra, është kthyer në një simbol për komunitetin shqiptar në SHBA, Kosovë dhe Shqipëri, si një njeri me energji të pashtershme humane e patriotike.


Prof.Dr.Astrit Memia

LOBIMI

VOTA PËR AKTIN E LUGINËS SË PRESHEVËS, DËSHMI E POTENCIALIT TË LOBIMIT SHQIPTAR NË SHBA

Botuesi i gazetës “Illyria”, Vehbi Bajrami flet për bashkëpunimin me Anëtarin e Lartë të Komitetit, Gregory Meeks dhe kongresistë të tjerë, senatorin John Thune, udhëheqës i shumicës në Senatn Amerikan, lobimin e gjatë për Kosovën dhe Luginën e Preshevës dhe nevojën për organizim që projektligji të miratohet nga Kongresi Amerikan.

Nga RUBEN AVXHIU



Delegacioni i Luginës së Preshevës në Kongresin e SHBA

Fati i shqiptarëve të harruar të Luginës së Preshevës ka marrë më së fundi vëmendjen e duhur.

Komiteti për Punët e Jashtme të Dhomës në Kongresin Amerikan sapo miratoi me votën masive 43-3 një rezolutë e cila detyron Sekretarin e Shtetit që të përgatisë brenda 180 ditëve një raport për gjendjen e shqiptarëve në Serbi.

Raporti duhet të ndalet në problemet që shqetësojnë shqiptarët prej vitesh siç janë: Pasivizimi i adresave, e drejta e votës, e pronës dhe dokumenteve, përfaqësimi në institucionet dhe shërbimet rajonale, njohja e diplomave dhe gradave shkencore, përdorimi i gjuhës shqipe etj.

Hapi tjetër për “Aktin e Shqyrtimit të Diskriminimit në Luginën e Preshevës” tani është që të votohet nga Dhoma e Përfaqësuesve, por kalimi i pragut të Komitetit me një votë kaq masive ishte një arritje e rëndësishme. Ajo dëshmoi se çështja e Luginës tani nuk mund të fshihet më nën rrogëz dhe se Serbia në një mënyrë apo një tjetër, do të fillojë të ndjejë presionin amerikan.

Vota e suksesshme në nivel Komiteti nënvizoi

edhe dy mesazhe të rëndësishme. I pari na thotë se kur komuniteti shqiptar në Amerikë angazhohet, rezultatet nuk vonojnë dhe se mbështetja jonë në Kongres dhe Washington vijon të jetë dypartiake. Rezultati 47-3 nuk ishte një rastësi. Ai reflektoi drejtësinë e kauzës së Luginës së Preshevës që përfshinë komunat Preshevë e Bujanoc me shumicë shqiptare dhe Medvegjë, por edhe punën e madhe të bërë nga shqiptaro-amerikanët.

Një meritë të madhe kanë veprimtarët e shoqatës “Albanians for America” (Shqiptarët për Amerikën), si Doc Vranici, Gino Mulliqi, Gezim Rushiti e të tjerë për miqësinë dhe bashkëpunimin e ngushtë që kanë krijuar me kongresistin Keith Self, nga Texas, i cili tani drejton Nën-Komitetin për Evropën në Komitetin për Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Për më tepër, ata kanë krijuar lidhjen me kongresistin Brian Mast nga Florida, një veteran i luftës që i ka humbur të dy këmbët dhe që sot shërben në postin e fuqishëm të Kryetarit të Komitetit për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Dhomën e Përfaqësuesve. Këtë pozicion ka pasur dikur në fund të karrierës kongresisti Eliot Engel dhe pas tij, për disa vite kongresisti Gregory Meeks.

Kongresisti Keith Self mori pjesë dhe mbajti fjalim në shtator të vitit të kaluar në darkën mbresëlënëse të Këshillit të Marrëdhënieve Shqiptaro Amerikane (AARC), në Manhattan, ku u njoh edhe më mirë me forcën e komunitetit shqiptar në SHBA e ku merrnin pjesë si mysafirë nderi presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj dhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Aty edhe mbajti një nga fjalimet më të mira në përkrahje të

shqiptarëve. Të nesërmen ai u takua me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti.



Vehbi Bajrami (majtas) me kongresistin Gregory Meeks.

Takime me të dhe kongresistë të tjerë kanë organizuar edhe Liga Qytetare e DioGuardit që drejtohet tani nga Agim Aliçkaj.

Projektligji për Luginën e Preshevës u paraqit në fillim nga kongresisti Self në Nënkomitetin e tij dhe pastaj u referua për miratim në Komitetin për Marrëdhënie me Jashtë. Aty fitoi me votën e vendimtare 43-3.

Ky rezultat sjell mesazhin e dytë, apo nxjerr në pah fenomenin tjetër, mbështjen për kauzën shqiptare në mbarë spektrin e politikës amerikane. Kjo ka qenë karakteristikë e vazhdueshme e lobimit shqiptar në Amerikë dhe mesa duket vazhdon edhe sot e kësaj dite me gjithë polarizimin në politikën amerikane. Republikanët dhe demokratët në Washington po ndahen për shumë gjëra këto ditë por u bashkuan për votën e Luginës së Preshevës. Kjo nuk është rastësi, por rezultat i punës së shqiptarëve në Amerikë.

Self dhe Mast janë republikanë përkatësisht nga Texas dhe Florida, kurse demokratët në këtë Komitet udhëhiqen nga Gregory Meeks, kongresist nga Queens, New York, i zgjedhur në Kongres që nga viti 1998 dhe tani anëtar i Lartë i Komitetit të Punëve të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve.

Pas largimit nga politika i kongresistit Engel, Meeks u bë demokrati më i fuqishëm në Komitet. Për të mos lejuar humbjen e ndikimit shqiptar, në një kohë ngadalësimi të lobimit tonë në SHBA, para disa vitesh, botuesi i gazetës “Illyria” Vehbi Bajrami, në bashkëpunim me Halil Ahmetajn, veprimtar i njohur dhe pronar i disa restoranteve në Manhattan, organizuan një darkë të rëndësishme për të krijuar lidhje dhe bashkëpunim me zëvendësuesin e Engelit, kryetarin Komitetin e Marrëdhënieve me Jashtë, kongresistin Gregory Meeks.

Me ftesën e tyre në takim mori pjesë edhe kongresistja e fuqishme Carolyn Maloney, kryetare e Komitetit të Mbikqyrjes në Dhomën e Përfaqësuesve si dhe kongresisti Mondaire Jones.

Botuesi i gazetës “Illyria”, autor dhe ish drejtor i seksionit shqip të “Zërit të Amerikës”, gjatë takimit me tre kongresistët për të mbështetur fushatat e tyre elektorale, u dorëzoi atyre një dokument për Kosovën ku përfshihej edhe kërkesa që Kongresi të ndikojë tek administrata amerikane për ta detyruar Serbinë që shqiptarët e Luginës së Preshevës të kenë të drejtat që kanë serbët e Kosovës.

Komuniteti iu përgjigj ftesës së Vehbiut dhe Halilit. Mes pjesëmarrësve në takimin prezantues ishte Jim Xhema, figurë e madhe e lobimit shqiptar në SHBA si dhe Christopher Hyland, njeriu që prezantoi komunitetin shqiptar me kandidatin për President, Bill Clinton, në vitin 1992. Marash Nucullaj kishte udhëtuar nga Detroiti për të dëshmuar se shqiptarët mbeten të bashkuar pavarësisht se nga cilat troje vijnë e ku banojnë në SHBA. Për të folur për çështjen e Vëllezërve Bytyçi, që u vranë nga forcat serbe në vitin 1999, kishte ardhur Ilir Bytyçi, i cili ka dëshmuar dhe në Kongresin Amerikan.

Që atëherë, Vehbi Bajrami ka mbajtur një raport bashkëpunimi me zyrën e kongresistit Meeks e të tjerë, duke e ushqyer me raporte dhe propozime për të ndihmuar Kosovën, ngritjen e Forcave të Armatosura të saj, hyrjen në NATO, shkeljen e të drejtave të shqiptarëve në Serbi etj.

“Në një nga takimet e shpeshta që kam pasur me kongresistin Meeks”, thotë Bajrami, “i shpreha shqetësimin për humbjen e kongresistit Elliot Engel, duke shtuar se shqiptarët humbën një kampion të mbrojtjes së Kosovës në Kongres. Më tha: “Tani më keni mua aty në Kongres në vend të

tij. Unë do të jem përkrahës i Kosovës. Para bombardimeve të NATO-s në Serbi, vazhdoi ai, unë e mbështeta presidentin Clinton kur ai kërkoi ndihmën time. Më tha se e ndjente veten fajtor që nuk mundi të ndihmonte kundër gjenocidit në Ruanda dhe tani nuk mund të mos ndihmonte Kosovën”.



Nga e majta, Don Vranici, kryetari i Komitetit Brian Mast, Gezim Rushiti, dhe Gino Mulliqi.

Këto lidhje kanë qenë të rëndësishme që projektligji për Luginën, i cili u propozua nga republikanët Self dhe Mast, të merrte mbështetjen edhe nga opozita demokrate.



Kongresisti Keith Self me presidenten e Kosovës. Vjosa Osmani gjatë një takimi në Texas (maj 2024).

“Vota për projektligjin në Kongresin Amerikan është një arritje e jashtëzakonshme dhe për këtë një meritë të veçantë kanë aktivistët e Texas-it, bashkë me Faton Bislimin dhe Lidhjen Qytetare Shqiptaro – Amerikane. U jam mirënjohës të gjithë kongresistëve që votuan për projektligjin e veçanërisht kongresistëve Keith Self dhe Gregory Meeks, ky i fundit një mik imi për shumë vjet”, shprehet për këtë ngjarje botuesi Vehbi Bajrami. “Megjithatë, lobimi për të drejtat e shqiptarëve në Serbi, në Washington ka filluar më heret. Personi që ka bërë më së shumti në këtë drejtim nga Luginia e Preshevës dhe i pari që ka denoncuar pasivizimin e adresave është Prof. Muharrem Salihu, në kohën kur ishte këshilltar komunal në Medvegjë. Aktiviteti i tij ka qenë tejet i rëndësishëm për njohjen e Kongresit dhe institucioneve evropiane për pasivizimin e adresave nga qeveria serbe dhe shkeljet e tjera të shqiptarëve në Luginën e Preshevës”.

Bajrami tregon se si bashkë me prof. Muharrem Salihun dhe Skender Perollin në vitin 2019 u takuan në New York dhe Washington me kongresistin Eliot Engel dhe Robert Hand nga Komisioni i Helsinkit, organ ky i themeluar nga Kongresi Amerikan për të monitoruar të drejtat e njeriut në Evropë.

“Dëshmia e Prof. Muharrem Salihut gjatë këtyre takimeve shërbeu si bazë e projektrezolutës në Kongresin Amerikan”, thotë ai. “Salihu gjatë këtyre takimeve në Washington dhe më pas në Komisionin e Helsinkit në Beograd, që drejtohet nga humanistja Sonja Biserko, paraqiti dokumente mbi diskriminimin e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë dhe ato u morën si bazë faktografike e shkeljes së të drejtave të njeriut”.

Si tregon botuesi i gazetës “Illyria”, zyrtarët amerikanë më pas udhëzuan ambasadën e SHBA-së dhe Komisionin e Helsinkit në Beograd që të merren me këtë problem dhe vijuan pastaj vizitat e ambasadorit amerikan dhe Sonja Biserkos (drejtuese e Komisionit të Helsinkit në Beograd) në Luginën e Preshevës për t’u njohur me diskriminimin e shqiptarëve.

Robert Hand i rekomandoi prof. Salihut të takoj edhe me ambasadorin e OKB-së për pakicat në Hagë, Lamberto Zanier, ish administrator në Kosovë pas Luftë. Prof. Salihu u takua edhe me të dhe e informoi me fakte për shkeljen e të

drejtave të shqiptarëve në Serbi nga qeveria serbe.

Bajrami shton se raporti i Komisionit të Helsinkit i bazuar nga dëshmitë e Prof. Salihut është referenca më relevante në tryezat ndërkom-bëtare, duke përfshirë edhe projektligjin aktual në Kongresin Amerikan.

Hapi tjetër tani do të jetë miratimi nga mbarë Dhoma e Përfaqësuesve në Kongresin Amerikan, e cila ka 435 anëtarë.

Vehbi Bajrami, i cili e ka vendlindjen pikërisht në Luginën e Preshevës, u shpreh me këtë rast se shqiptarët duhet të organizohen dhe të përdorin të gjithë lidhjet e tyre kur të vijë dita e votimit në Dhomën e Përfaqësuesve.



Prof. Muharrem Salihu (në mes) me kongresistin Eliot Engel (majtas) dhe Skeder Perollin gjatë vizitës në Washington.

Viteve të fundit ai ka bashkëpunuar me disa kongresistë amerikanë për të lobuar për Kosovën, Preshevën dhe çështjet shqiptare në Ballkan. Të paktën tre prej tyre, pas kërkesës së tij, kanë pranuar të bëhen anëtarë të Kaukusit të Çështjeve Shqiptare në Kongres: Grace Meng, Seth



Pamje nga kakimi me kongresistët Meeks, Malony dhe Johns në Manhattan.

Moulton dhe Joe Morrelle. Vitin e kaluar, Jim Xhema bashkë me të dhe aktivistë të tjerë të komunitetit në New York, organizoi një mbrëmje për të mbështetur senatorin e fuqishëm, John Thune, i cili më pas u zgjodh udhëheqës i shumicës në Senatën Amerikan.

Aktivistët, në mesin e kërkesave, të cilat iu paraqitën në formë të shkruar nga z. Bajrami, ishte që Kosova të anëtarësohej në NATO si mënyra më e mirë për sigurinë e saj nga Serbia si dhe stabilitetin e rajonit ballkanik.

“Ka zëra se ndikimi i diasporës shqiptare në Kongres, Senat e Shtëpinë e Bardhë është zbehur. Kjo nuk është e vërtetë. Aktivistët shqiptarë kanë lidhje me shumë ligjvënës amerikanë dhe me zyrtarë të tjerë të lartë në administratën amerikane. Me këtë rast do të veçoja senatorin John Thune, udhëheqës i shumicës në Senatën Amerikan dhe John Ratcliffe, drejtor i Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA).

Vendimet e mëdha presidenti amerikan nuk i merr pa mendimin ose aprovimin e kryetarit të Senatit dhe CIA-s.

Megjithatë, qeveria e Kosovës duhet të kontrakttojë një firmë të fuqishme lobuese në Washington, e cila do të forconte edhe më shumë lidhjet e Kosovës me Amerikën dhe do të demantonte gënjeshttrat e lobistëve të paguar nga Serbia në Washington, që po punojnë fort në favor të Serbisë e në dëm të Kosovës.

Kjo firmë do të ndihmonte aktivitetin lobues të ambasadave tona e të komunitetit, i cili mbetet forcë e pazëvendësueshme e këtij lobimi”, thotë z. Bajrami.

“Kur të afrohet dita e miratimit të projektligjit për shkeljen e të drejtave të shqiptarëve në Serbi nga Dhoma e Përfaqësuesve, shqiptarët në Amerikë duhet të organizohen.

Të kontaktojmë të gjithë kongresistët që njohim dhe t’u kërkojmë të votojnë për projektligjin, madje të bindin edhe kolegë të tjerë”.

Angazhimi i shqiptarëve me politikën amerikane ka dëshmuar që jep fryte. Ai është jetik për fatin e kombit shqiptar dhe i shërben jo vetëm shqiptarëve por edhe vetë sigurisë së Amerikës.

HISTORIA

Pse harrohet Çamëria dhe kontributi i çamëve në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë

HERONJTË ÇAME TË 1912-S, KUSH UA FSHIU EMRAT?!



Nga HYQMET ZANE

Shpallja e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912 është dita e shënuar në kalendarin historik mbarë-kombëtar shqiptar. Si shqiptar ndjehem krenar për ata burra të nderuar që u bënë mbështetës të shpalljes së Pavarësisë nga gjithë trojet shqiptare që nga Mitrovica e Kosovës deri në Prevezë të Çamërisë. Jemi krenarë për një ditë të tillë që na jep mesazhin e madh se shqiptarët u bënë të zot për të bërë shtet dhe Ismail Bej Qemali Vlora mori përsipër të realizonte ngjarjen e madhe. Duhet të themi se një akt i tillë madhor nisi nga Elbasan me Aqif Pashë Biçakçiun Elbasani me burra të shquar të këtij qyteti. Më pas Pavarësia u shpall në çdo qytet, në Peqin më 26 nëntor e kështu deri më 28 nëntor në Vlorë. Historia ka folur edhe për prezencën e birit të Kosovës Isa Boletini që kur arriti në Vlorë u ul në gjunjë dhe puthi flamurin në prani të Ismail Qemalit. Historia ka folur se në atë Vlorën e historisë së Pavarësisë morën pjesë edhe personalitete nga Elbasani si Dervish Bej Biçaku, Lef Nosi, Shefqet Daiu, Mit'hat Frashëri, Qemal Karaosmani. Porse në historinë tonë kombëtare pothuajse nuk përmenden emrat e atyre burrave nga Çamëria që morën pjesë në Pavarësinë e kombit? Edhe pse me pak vonesë për shkaqe të pengesave që iu krijua nga Greqia këtyre burrave, ata kanë emër e mbiemër, por që të pyesësh një njeri sot se cilët

ishin ata, zor se bëhet e mundur të dinë ata emra burrash të nderuar.



ÇAMËT E PAVARËSISË

Që në fillim dua të them se në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë kanë shkuar:

1. Veli Gërra, nga Gumenica
2. Jakup Veseli, nga Margëllëçi
3. Rexhep Demi, nga Filati
4. Azis Tahir Ajdonati, nga Paramëthia

Vetëm thuhet se Ismail beu priste Muharrem Rushitin nga Koska e Çamërisë me trupat mbrojtëse të Vlorës, sepse dihet që lebërit dhe çamët kanë qenë bashkë për mbrojtjen e territoreve të tyre. Ndërkohë që thuhet se në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, Ismail Bej Qemali dërgoi Mehmet Konicën, Filip Nokën dhe Rasih Dino nga Çamëria. Por burrat e Pavarësisë nga Çamëria që cilësova më sipër për ata asnjë fjalë, asnjë dijeni, asnjë vlerësim, sikur ata të ishin grekë e jo shqiptarë të vërtetë dhe trashëgimtarë që mbajnë mbi vete si trashëgimtarë të historisë e lashtësisë së Çamërisë. Një penë dhe një mendjeje çame shkruan "Sa herë është 28 Nëntori mos harroni që nga lashtësia para erës së re historia ka njohur Pirron e Epirit gjak shqiptar nga Ledhësi.

Pirrua i Epirit me Olimbinë (Olimpia), nënën e Aleksandrit të Madh ishin nga fisi i Aiakidëve të Molloisës. Pra, ishin kushërinj me diferencë disa brezash, gati njëqind vjet, që e bënte krenar Pirron që mburrej me kushërirën e tij paraardhëse dhe vetë bëri emër në histori. Për hir të së vërtetës Olimpia gruaja e Filipit II mbretit të Maqedonisë ishte nga Çamëria, së bashku ata lindën e rritën Aleksandrin e Madh. Pra, Aleksandri i Madh është çam nga nëna. Por edhe Ali Pashë Tepelena gjithashtu e kishte gruan e tij Vasilikën nga Çamëria, nuk patën fëmijë edhe pse Pashai ishte tmerrsisht i marrosur pas saj, aq sa fortesën në Porto Palermo e bëri në emër të saj. Edhe Ismail Qemali e kishte gruan e tij çame, të rritur nga një familje arvanitase së bashku me Kleonikin lindën e rritën 9 fëmijë. Të gjitha këto kanë lidhje me Çamërinë, me krahinën trashëgimtare të pellazgëve të lashtë që nuk kanë asnjë lidhje me Greqinë dhe historinë e manipuluar nga grekët si mashtrues të historisë dhe të vërtetave”.

E VËRTETA HISTORIKE

Edhe pse kjo është historia e të vërtetave historike, përse kaq shumë heshtje dhe harresë, përse kjo sjellje me dy standarde, përse historia e djeshme dhe e sotme sillet kaq keq më historinë e Çamërisë dhe personalitetet e saj? Jo sot, por që pas 1944-ës ata që shkruan historinë e Shqipërisë u treguan të padrejtë dhe për të mos thënë se ka pasur një tradhti të imponuar nga ideologjia internacionaliste dhe e frymëzuar nga urrejtja greke për shqiptarët në përgjithësi dhe çamët në veçanti. Edhe progrekët në strukturat e larta të qeverisjes që nga Nesti Kerënxhi e deri tek Rita Marko apo të tjerë e kungonin Enver Hoxhën që të tregonte zellin e pashuar antiçame që tashmë njihet që nga mosdhënia e një ndihme ps 27 qershorit 1944 me gjenocidin grek, me internimet në Llozhan më 1949 pse çamët nuk pranuan të shkonin të luftonin në Greqi me flamurin grek, më pas më 1956 pas Konferencës së Tiranës dhe me tej më 1960-1961 me arrestimet dhe pushkëtimet e çamëve që nga Teme Sejko e Tahir Demi

me të tjerë. Vetëm pas 1991 nga studiues të pavarur u korrigjuan shumë të pavërteta. Por ajo që ka mbetur e pakorigjuar është fakti se Pavarësia e Shqipërisë ka qenë e kërcënuar nga Ligji i Luftës i Greqisë me Shqipërinë, që padrejtësisht është në fuqi edhe pse jemi dy shtet në NATO. Por më shumë se kaq ka një vëmendje të stërzgatur që në programet që përpunohen për shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme nuk ka asnjë korrigjim të historisë, vazhdon të mos thuhet të vërtetët historike deri sa ka një marrëveshje të heshtur në mospërmendjen e fjalës Çamëri dhe të emrave të atyre burrave nga Çamëria që morën pjesë në Shpalljen e Pavarësisë.

KONTRIBUTI I ÇAMËVE

Brezat duhet të dinë se historia shqiptare ka kryekëput edhe gjakun dhe kontributin e krahinës sonë Çamërisë, kaq të bekuar, por vazhdohet ndër brez pas brezi të heshtet, por me shtrembërim për krahinën e Çamërisë dhe personalitetet e saj. Nga kush kanë frikë ata që bëjnë programet e shkollave, kush e këshillon kryeministrin dhe politikën shqiptare që të mos shprehet për historinë e Çamërisë? Kur themi “Gëzuar Pavarësinë” e Shqipërisë, duhet të thuhet se edhe Kosova u shpall e Pavarur, edhe Çamëria u shpall e Pavarur. Në Vlorë vjen Presidentja e Kosovës Vjosa Osmani, po nga Çamëria kush do vijë për Pavarësinë ? Kjo është e vërteta e madhe se historinë e shtrembëruar dhe të manipuluar na e kanë diktuar dhe shkruar të tjerët dhe ata historianë dinjitozë shqiptarë që shkruajnë të vërtetat, anashkalohen ose nuk përmenden. Vlora ka shumë shqiptarë trashëgimtarë nga Çamëria dhe ata kontribuojnë si në rastin me Ansamblin “Krahu i shqiptarëve Taip Madani” që drejton i palodhuri Sali Nuredini. Por emrat e atyre burrave që sakrifikuan në kohëra të vështira për të ardhur në Vlorë në mbështetje të Pavarësisë dhe qeverisë së Ismail Bej Qemalit, ata nuk u përmendet emri dhe as që thuhet se erdhën nga Çamëria martire.

HISTORIA

Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës u vendos në Tiranë dhe që nga ai moment, Tirana mbetet kryeqytet i Shqipërisë

KONGRESI I LUSHNJËS JANAR 1920 DHE ROLI I KONSULLIT BRITANIK MORTON FREDERIK EDEN



Nga SAKIP CAMI

- **Organizimi i kongresit ishte një veprimtari politike me karakter kombëtar, por nuk flitet sa duhet për faktorin ndërkombëtar dhe konkretisht për rolin britanik, veçanërisht të konsullit britanik Morton Eden**

Kongresi i Lushnjës është ngjarja më e madhe dhe vendimtare për shpëtimin dhe ringritjen e shtetit shqiptar pas Luftës së Parë Botërore. Historiografia shqiptare e paraqet me të drejtë Kongresin e Lushnjës si sukses i politikës shqiptare të kohës, por duhet nënvizuar fakti se ky sukses erdhi pas një lufte të ashpër politike midis dy grupeve rivale politike, midis grupit të Esat pashë Toptanit dhe të Qeverisë së Durrësit dhe grupit të politikanëve patriotë e mendjendritur të kryesuar nga Aqif pashë Elbasani (Biçakçiu), Ahmet Zogu, Sulejman Delvina etj.

Organizimi i kongresit ishte një veprimtari politike me karakter kombëtar, por nuk flitet sa duhet për faktorin ndërkombëtar dhe konkretisht për rolin britanik, veçanërisht të konsullit britanik Morton Eden.

Qeveria Britanike nuk ishte dakord me praninë e trupave italiane në Ishullin e Sazanit dhe në qytetin e Vlorës, nuk ishte dakord me politikën nënshtruese të Qeverisë së Durrësit ndaj italianëve, nuk ishte dakord me kërkesat ekspansioniste të Serbisë dhe të Greqisë për zgjerim të tyre në dëm të Shqipërisë, prandaj përkrahu mbajtjen dhe vendimet e Kongresit të Lushnjës dhe ndikoi nëpërmjet konsullit të saj Morton Eden. Mbështetës për organizimin e Kongresit të Lushnjës ishin edhe ministrat e qeverisë së Durrësit, që morën pjesë në Konferencën e Paqes në Paris Mehmet Konica, Mihal Turtulli dhe imzot Liugj Bumçi, të cilët u takuan në





Paris edhe nga konsulli i Anglisë Morton Eden.

Eqerem Bej Vlora që ishte kundër zhvillimit të Kongresit në kujtimet e tij tregon se konsulli Morton Eden fliste hapur me nacionalistët shqiptarë për dëbimin e italianëve dhe zhvillimin e një kongresi kombëtar. Ai e kishte prituri konsullin në shtëpinë e tij. Në një dorëshkrim të Ahmet Shehut që ruhet në Shtëpinë Muze të Kongresit të Lushnjës jepen të dhëna për një takim të konsullit Eden në Teqenë e Karbunarës ku foli për nevojën e një kongresi kombëtar pasi sipas tij pavarësia e Shqipërisë ishte në rrezik. Pas marrjes së vendimit për mbajtjen e kongresit në Lushnjë, Eden shkoi në Peqin, Tiranë, Mat dhe Shkodër.

Gjatë udhëtimit për në veri ku shoqërohej nga Preng pasha ai u plagos, por nuk e përhapaj lajmin se kjo do ta dëmtonte misionin e tij. Në Kongresin e Lushnjës ai merr pjesë së bashku me kolonelin britanik Philips. Ndërkohë, Qeveria e Durrësit, e mbështetur edhe nga forcat ushtarake italiane, u përpoq me çdo mjet të pengonte zbatimin e vendimeve të Kongresit të Lushnjës. Përballë presioneve dhe kërcënimeve të armatosura, disa delegatë nga Tirana, Elbasani, Kavaja dhe Shijaku shprehën mendimin që të qëndronin përkohësisht në Lushnjë, nga frika e sulmeve të mundshme nga forcat italiane, të nxitura nga qeveria e Durrësit. Në detyrën e Ministrit të Brendshme, Ahmet Zogu

luajti një rol të pazëvendësueshëm në vendosjen e rendit dhe autoritetit shtetëror në një Shqipëri të trazuar. Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës u vendos në Tiranë dhe që nga ai moment, Tirana mbetet kryeqytet i Shqipërisë.

Menjëherë pas përfundimit të kongresit në Lushnjë, po atë pasdreke të 31 janarit, Ahmet Zogu që u zgjodh Ministër i Punëve të Brendshme, u dërgoi të gjitha prefekturave një qarkore nga qyteti i Lushnjës, me anë të së cilës i bënte të ditur popullit shqiptar arsyet për mbajtjen e Kongresit Kombëtar të Lushnjës dhe u shpjegonte atyre vendimet që mori ajo mbledhje historike, për shpëtimin e Shqipërisë nga rreziqet që e kërcënonin.

Kongresi i Lushnjës, që u mbledh me 21 janari 1920, ishte shfaqje e vullnetit kombëtar, si një akt trimërie në mes të dëshpërimit. Përfaqësuesit e krahinave, që u mbledhën në Lushnjë nga të gjitha anët e Shqipërisë, ishin të vendosur të bënin bashkimin kombëtar, t'i jepnin fund anarkisë, të ndërtonin një shtet shqiptar të përqëndruar mbi forcat e tij dhe të pavarur. Kjo ishte e vetmja rrugë shpëtimi.

Ndaj Kongresi nuk u tund nga vështirësitë e gjendjes. U shpall si një Kuvend kombëtar i plotfuqishëm, i tregoi botes se Shqipëria ish e pavarur dhe e pandashme dhe iu përvesh punës për organizimin e shtetit shqiptar.


IN MEMORIAM

AUTORI I 60 VEPRAVE STUDIMORE SHKENCORE DHE DISA DOKUMENTARËVE TELEVIZIV

TRASHËGIMIA STUDIMORE-SHKENCORE DHE PUBLICISTIKE E PROMOVUESE E FATOS DACIT



Nga Halil RAMA – Mjeshtër i Madh



- **Libri më i fundit i Fatos Dacit “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibrë”, me fakte, argumente shkencore, referenca nga autorë vendas e të huaj, është një kontribut i veçantë në historinë skënderbegiane...**
- **Ishte ndër anëtarët më aktiv të Akademisë ASHqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork dhe për disa vite drejtoi me talent, kompetencë e profesionalizëm revistën “DITURIA”, si kryeredaktor i saj...**

Me mbi 60 libra të botuar në harkun kohor të tri dekadave, disa prej të cilave vepra studimore-shkencore që hedhin dritë mbi historinë e Dibrës dhe vendoriginën dibrane të Skënderbeut, Fatos Daci padyshim ishte dhe mbetet një

prej autorëve më produktivë e cilësorë të këtij çerekshekulli.

Ai u nda nga jeta të dielën e 7 dhjetorit 2025, duke lënë në fondin e artë të librit shqip një trashëgimi mjaftë të pasur letrare, publicistike, studimore e shkencore. Krijimtaria e tij rrok një larmi temash, ku dominon historia...Historia, e shkruar me vërtetësi, bazuar në të dhëna arkivore, në një bibliografi tejet të pasur si dhe në dëshmi gojore nga personazhe realë bindës.

Mbi këtë bazë e ka shkruar ai veprën monumentale “DIBRA-HISTORIA E PLOTË”, ashtu siç ka shkruar edhe veprat tjera: “Enciklopedia e Dibrës”, “Penat e Dibrës”, “Nga lashtësia deri në vitin 1940”, “Skënderbeu i vërtetë”, “Të vërtetat për Skënderbeun”, “Kastriotët e Çidhnës së Dibrës”, “Peshkopia”, “Çidhna dhe Kastriotët”, “Sillova përgjatë një shekulli”, “Histori e shkruar me pushkë e penë”, “Vendlindja ime (Dibra e Bulqi-za), “Gryka e Vogël”, “Radomira”, “Shqiponjat e kreshtave të Veriut”, “Të pavdekshmit”, “Burrat e Kullës së Canit, “Kukësi”-Enciklopedi”, si dhe disa monografi për patriotë të Dibrës e Kukësit.

Krenar, si rrallëkush për historinë e lavdishme të Dibrës, Fatos Daci shkroi me kurajo e vërtetësi veprën e tij madhore “Fitorja e Kosovës në duart e Dibrës”, bazuar kjo në kontributin e shquar të personaliteve dibrane që nga epoka e lavdishme skënderbegiane e deri tek Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Dhe po si rrallëkush, Fatos Daci ka dhënë një kontribut të veçantë në pasurimin e letërsisë sonë dokumentare. Këtë e dëshmojnë botimet e tij: “Historia arsimit shqip në Dibrë”, “Historia e mjekësisë dibrane”, “Historia e kulturës dibrane”,

“Antologjia e poezisë dibrane” (në dy vëllime) “Dibra 07” – antologji”, “Shqiponja fluturoi nga foleja”, “Një shekull poezi dibrane”, “Histori e shkruar me pushkë e penë”, si dhe “Në Amerikë flakëron atdhetaria dibrane”.

Një ndër gjinitë më të lëvruara, ku spikat stili i tij origjinal është monografia. Janë dhjetra monografi të këtij autori kushtuar figurave të ndritura të Dibrës, luftëtarë e patriotë të mëdhenj, artistë e mësues, ndër të cilat mund të përmendim ato me titull: “Lirie Rasha - identiteti i vlerave”, “Burri i madh i Bulqizës”, “Mehmet Duriçi”, “Krushqit elirisë”, “Mahmut Daci, princi i trimërisë”, “Rahman Doda i Reçit”, “Met Kaca dhe pasardhësit”, “Hysen Bara, pari e Dibrës”, “Pilket e Dibrës”, “Estref Gjoshi...”, “Dodajt e mëdhenj të Dibrës”, “Pasardhës të Dodajve të mëdhenj”, “Njeriu që di të bëjë gjera të mira”, “Miftar Fana, Nderi i Kombit”, “Rahman Rasha” etj. Përveçse pasurimit të mendimit estetik nga vepra në vepër, F.Daci nuk la pas dore edhe promovimin e vlerave më të mira të Dibrës e të gjithë Shqipërisë. Këtë e ka bërë më së miri në botimet e tij: “Pena e Dibrës”, “Vendi i artistëve”, “Shpërthime rinore”, etj.

Po në këtë këndvështrim duhet parë edhe kontributi i këtij autori në fushën e së drejtës, i reflektuar më së miri në librin e tij “Trajtime juridike”.

Gjatë një studimi për veçoritë e LANÇ në Dibër, kolegu dhe bashkëautori im në disa botime, Sakip Cami, më tha para disa ditësh se nga shfletimi i arkivës së gazetës “Ushtima e Maleve” të 30 viteve (1970-1990) kishte evidentuar Fatos Dacin si autorin me më shumë artikuj publicistikë, si reportazhe, skica, esse, fejtone.

Veprimtarinë e tij publicistike Fatos Daci, jo vetëm që nuk e ndërpreu në vitet ‘90, por e pasuroi dhe çoi edhe më tej gjatë këtij çerekshekulli, kur nga viti 1998 boton gazetën e pavarur “Dibra”, e cila nga numri i parë e deri më sot (edhe në versionin online) në qendër ka pasur Dibrën, dibranët dhe historinë e lavdishme, të djeshme e të sotme, të tyre. Ndërkohë, si kryeradaktor ka drejtuar edhe gazetën “Zëri i Lirë” dhe “Trojet shqiptare”.

KONTRIBUT REAL NË HISTORINË SKËNDERBEGIANE

Libri më i fundit i Fatos Dacit “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër”, me fakte, argumente shkencore, referenca nga autorë vendas e të huaj, është një kontribut i veçantë në historinë skënderbegiane. Për herë të parë ai sjell në shqip një dokumentar të Institutit të Studimeve Ushtarake të Turqisë (Milli Savunma Universitesi-Universiteti i Mbrotjtjes Kombëtare) të Turqisë ku saktë dhe qartë thuhet: “Gjergj Kastrioti Skënderbeu u lind më 1405, në fshatin Sinë të Dibrës (Kjo shqiptohet qartë në dy fjalitë e para të dokumentarit në fjalë)”.

Duke e publikuar këtë të vërtetë në librin e tij voluminoz me 497 faqe, studiuesi Fatos Daci – Mjeshtër i Madh, shprehet entuziast për faktin se: “Për herë të parë, Turqia vulos: Skënderbeu lindi në Sinë të Dibrës! Dhe kur vulos Turqia, ish-superfuqia e kohës, nuk ka më fjalë. Shqip: Skënderbeu ishte dibran. Pra, ishte shqiptar!”

Po në këtë libër (fq.59) studiuesi Daci sjell referenca nga Akademia e Shkencave të RSH, konkretisht nga Sesioni Shkencor rreth origjinës dhe prejardhjes së Kastriotëve mbajtur në Peshkopi më 2 Nëntor 1985 me rastin e 580-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, Skënderbeut dhe inaugurimit të Muzeut të Kastriotëve në Sinë të Dibrës.

Dhe nëse Prof. Sterfanaq Pollo ka deklaruar në fjalën e tij përmbyllëse të këtij sesioni shkencor se: “Tani mund të themi se origjina e Kastriotëve është Çidhna, është Sina”, Fatos Daci argumenton, se “Ky dokumentar i tanishëm, i serialit turk ‘Jetë luftëtarësh’, i dha publikisht të drejtë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit të saj të Historisë për ngritjen në Sinë, në nëntor 1985, të Muzeut të vetëm të Kastriotëve”. Autori i librit mjaftë voluminoz “Të gjitha rrugët të çojnë në Dibër”, me të drejtë ndjehej mirë me këtë konkluzion të pritshëm të shkencës ushtarake turke, për faktin se me argumentet e tij, për gjatë 20 vjetëve, në katër libra që ka shkruar e botuar për Skënderbeun, në qindra artikuj që ka botuar



në organe të ndryshme të shtypit ditor dhe atij periodik, në dhjetëra intervista televizive dhe në dhjetëra veprimtari publike që ka zhvilluar në institucionet publike të Tiranës, në Peshkopi a në Dibër të Madhe, ka thënë e shkruar, ka këmbëngulur vazhdimisht me zë të lartë se, për një mijë arsye, Skënderbeu është dibran dhe ka lindur në Dibër, në krahinën e Çidhnës.

KA REALIZUAR DISA DOKUMENTARË TELEVIZIV

Me profesionalizëm dhe talent të rrallë Fatos Daci ka realizuar disa dokumentarë televiziv. Në memorien e bashkëkohësve janë të freskët dokumentarët e realizuar prej tij me titujt: "Origjina e vërtetë e Ataturkut", "Kuvndet e Dardhës së Dibrës", "70 vjet shkollë pedagogjike", "Slloma mes heroizmit dhe ndryshimit", "Didajt e mëdenj të Reçit të Dibrës", "Kalisi përkuqjon dëshmorët", "Kalisi në festë", "Mahmut Daci" etj,(të shfaqura në ekranet e televioneve kryesore publike shqiptare). Po ashtu ka spikatur në intervistat e emisionet televizive e radiofonike, duke promovuar vlerat atdhetare, patriotike, kulturore, krijuese e historike të Dibrës dhe dibranëve.

Kësisoj, i lindur në Dacallarë të Sllovës, Fatos Daci ia kushtoi jetën dijes, shkrimit dhe doku-

mentimit historik të trojeve shqiptare, duke lënë pas një trashëgimi të pazëvendësueshme.

Në një krijimtari mbi pesëdekadëshe, ai botoi më shumë se 60 vepra historiko-enciklopedike me mbi 15 mijë faqe, duke dokumentuar figura, ngjarje, tradita dhe dëshmi historike të Dibrës dhe mbarë shqiptarisë.

Veprat e tij shoqërohen me mijëra fotografi të rralla, portrete e dokumente, që sot përbëjnë një pasuri të rrallë kombëtare.

Fatos Daci ishte, Anëtar i përhershëm i Akademisë Amerikano-Shqiptare të Shkencave dhe Arteve, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë dhe kryetar i Unionit të shkrimtarëve dhe artistëve dibranë dhe i disa shoqatave kulturore e atdhetare, Fatos Daci mbetet një prej personaliteteve më prodhimtare të letrave shqipe.

Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm, ai u nderua me tituj të shumtë, mes tyre "Mjeshtër i Madh", si dhe u shpall disa herë "Qytetar Nderi" nga Bashkia Peshkopi, Komuna Dibër e Madhe, Maqedoni dhe disa komuna të Dibrës.

Siç shkruan djali i tij Jordani, një prej emrave më të spikatur të drejtësisë shqiptare: "Fatos Daci largohet nga jeta, por jo nga kujtesa jonë, ai lë pas një pasuri të pamatë shpirtërore e dokumentare, që do t'i shërbejë brezave përjetësisht".

PERSONAZH

Bordi i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork vlerëson emblemën e qytetarisë dhe fisnikërisë matjane e mbarëkombëtare

“AKADEMIK”, TITULL MERITOR PËR PROF.DR. SALI KURTIN



Nga Akademik/e Sanie Selita



- **Prof. dr. Sali Kurti, në harkun kohor të një dekade është dekoruar me titullin e lartë “Mjeshtër i Madh” nga ish Presidenti i Republikës Bujar Nishani; Atij i është dhënë Titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Burrel nga Këshilli Bashkiak i këtij qytetit, ndërsa Federata e Paqes Univerasale Shqipëri i ka dhënë titullin “Ambasador për paqe” dhe e ka shpallur “Personaliteti i vitit 2023”. Nga ky gjerdan i artë dekoratash, medaljesh dhe titujsh, Dr.Sali Kurti është ndër më të nderuarit e të vlerë-**

suarit e rrethit të Matit të metropolit shqiptar. Por nderimi që iu bë paraditen e 29 Dhjetorit 2025, duke i akorduar titullin “Akademik” nga Akademia Shqiptaro – Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, për atë, si dhe për të gjithë pjesëmarrësit e shumtë në atë ceremoni mbresëlënëse ishte ndër më të veçantët.

Si pjesë të axhendës së tij të ngjeshur gjatë vizitës dhjetëditore në Tiranë, Shkup e Gjilan, Prof. dr. Skënder Kodra – Kryetar i Akademisë Shqiptaro – Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, realizoi edhe ceremoninë mbresëlënëse të dhënies së titullit “Akademik” Prof. dr. Sali Kurtit, një nga emrat më të spokatur në shërbimin stomatologjik shqiptar.

Që në nisje të kësaj ceremonie, si realizues i saj, falenderova prof.Kodrën që konsideroi propozimin tim për të vlerësuar Dr. Sali Kurtin me këtë titull merit, edhe si emblemë e qytetarisë e fisnikërisë matjane e mbarëkombëtare.

Prof. Kodra, një emër i mirënjohur, jo vetëm në SHBA e hapësirën mbarëshqiptare në botë por në rang ndërkombëtar, si ndër kontributorët më të mëdhenj të çështjes kombëtare shqiptare, evidentues dhe promovues i personaliteve akademike, të letrave, artit e kulturës të diasporës shqiptare të Amerikës, pasi i dorëzoi Dr. Sali Kurtit Çertifiktatën e titullit “Akademik”, ndër të tjera tha se personalitete të tilla janë nderi dhe krenaria dhe ja rrisin prestigjin Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, që ai e themeloi dhe e drejton me kompetencë, profesionalizëm e përkushtim të rrallë prej më se çerek shekulli.

Në praninë e dhjetra mjekëve dentistë të kësaj klinike, Prof. Kodra vlerësoi standardet ndërkombëtare të Klinikës “Mat-Dental”, të themeluar dhe drejtuar nga prof. dr. Sali Kurti.

Vetë Dr. Sali Kurti, mes emocionesh, ndër të



tjera tha se gjatë karrierës së tij profesionale është nderuar me tituj e medajle nga institucione të larta shtetërore e vendore si dhe nga Federata e Paqes Universale me titullin “Amabasador i Paqes” e “Njeriu i Vitit” i kësaj Federate, por titulli “Akademik” që ju akordua nga Akademia prestigjioze Shqiptaro – Amerikane e Shkencave dhe Arteve Nju Jork, është më i larti, më i merituari dhe njëherazi më surprizuesi për të e familjen e tij, në këtë vigjilje të Vitit të Ri 2026.

Në këtë ceremoni mbresëlënëse, në mjediset e kësaj klinike, ndër më modernet e më konkurrueset në metropolin shqiptar, kreu i Akademisë Shqiptaro – Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, prof. Kodra shoqërohej nga akademik Arjan Hamiti e prof. Josif Risto të Universitetit prestigjioz “Luarasi”, Prof. dr. Astrit Memia – Kryetar i Forumit Botëror “Imazh & Media”, nga kryetari i Federatës së Paqes Univerasale Shqipëri, Defrim Methasani – Mjeshtër i Madh, ndër moderatorët më të spikatur të eveneteve kulturore e promovuese në rang kombëtar dhe nga bashkëshortja e tij Sanie Selita.

Personalitete me rrezatim kombëtar çmohen kështu nga njerëzit e mençur e me vizion bashkëkohor. Kjo sentence, bashkëudhëtare e historisë së njerëzimit, gjeti mishërim të plotë edhe në këtë takim ceremonial, ku elita intelektuale kombëtare vlerëroi Prof. Dr. Sali Kurtin si personalitetin më të spikatur, mishërues dhe përçues i vlerave më të mira njerëzore, profesionale dhe intelektuale.

PAK NGA CV E PROF.DR. SALI KURTIT

Dr. Sali Kurti është një nga mjekët më të mirënjohur në Shqipëri, me një përvojë 45-vjeçare në fushën e stomatologjisë. Gjatë karrierës së tij si mjek e si drejtues i shërbimit stomatologjik ka njohur shumë arritje dhe është nderuar me titujt: “Mjeshtër i madh” nga Institucioni më i Lartë në vend, pikërisht nga Presidenca e Republikës së Shqipërisë, si dhe me titullin “Qytetar Nderi” nga Bashkia e qytetit të Burrelit dhe me Çertifikatë Mirënjohje nga Këshilli i Qarkut Dibëtar.



Ai lindi në fshatin Karicë të rrethit të Matit dhe mësimet e para i mori po aty. Në qytetin e Burrelit, në Ulëz dhe Komsit shtegtoi i etur për dije, ku mes shumë sakrificash përfundoi shkollën



7-vjeçare. Më pas ka vijuar shkollën e mesme në Politeknikumin Mjekësor në Tiranë, ku për 4 vjet radhazi studioi në profilin stomatologji, duke fituar diplomë “ndihmësmjek dentist”.

Më pas, ka ndoqi studimet e larta në Universitetin e Tiranës, në degën e Stomatologjisë, duke u diplomuar me rezultate shumë të mira.

Në vitin 1979, dr. Sali Kurti kreu studimet pasuniversitare, duke fituar titullin “Specialist në protezë”. Ai spikati si nxënës dhe si student i shkëlqyer në të gjitha ciklet studimore. Bazat themelortat të studimit e ndihmuan atë të ndërtonte profilin e mjekut shumë të aftë dhe të përgjegjshëm. Suksesi i punës së tij si mjek është vlerësuar jo vetëm nga qytetarët e pafund, të cilët janë pacientë të tij prej dekadash, por edhe nga instancat më të larta shtetërore. Qysh në vitin 1981 është dekoruar nga Kuvendi Popullor për shërbim të mirë ndaj popullit (stimul që jepej rrallë në atë kohë).

Në vitin 1982 u emërua drejtor i Shërbimit Stomatologjik të rrethit të Matit, detyrë që e mbajti deri në vitin 1993, kohë kur shërbimi dentar u privatizua. Në këtë periudhë mori jetë edhe klinika “Mat Dental”, e cila nisi vetëm me një poltron, por në sajë të profesionalizmit të profesor Saliut, u zgjerua me 5 poltrone shërbimi dentar, me sallë kirurgjike dhe me laborator stomatologjik, dukë marrë trajtën e një poliklinike me të gjitha shërbimet në një vend.

Në vitin 2007 Bashkia e Burrelit e vlerësoi Dr. Saliun, duke e nderuar me titullin “Qytetar Nderi” me motivacion “për shërbim të mirë ndaj popullit” në rrethin e Matit e më gjerë. Ndërsa në vitin maj të vitit 2017, presidenti i Republikës Bujar Nishani, i akordoi titullin e lartë “Mjeshtër i madh”, një vlerësim tepër i rrallë në këtë fushë, sepse të paktë janë mjekët stomatologë, që mbajnë mbi supë një nderim të tillë. Ka punuar

si pedagog i jashtëm për disa vite në Universitetin “Aldent”, Tiranë, ku ka lekturuar lëndët e praktikës profesionale me studentët e vitit të dytë të degës së Stomatologjisë. Që prej vitit 2010 mban edhe pozicionin e Zv/President të Sindikatës së Stomatologëve të Shqipërisë. Në këtë kuadër, por edhe si pedagog, ka marrë pjesë në konferenca me karakter kombëtar e ndërkombëtar.

Pikërisht për këto merita dhe veçanërisht për shpirtin human, vlerat njerëzore dhe intelektuale e krijuese që mishëron dhe përçon tek publiku i gjerë edhe nëpërmjet librit të tij “Një jetë në shërbim të njerëzve”, Ai është vlerësuar edhe me titullin “Anëtar Nderi” i Klubit Letrar “Pjetër Budi”. Ndaj dhe ndjehet më krenar se kurrë si përfaqësues dinjitoz i elitës matjane, si një nga bijtë e Matit me histori të lashtë, djep i kulturës dhe artit kombëtar. Të Matit, ku që nga Pjetër Budi e brez pas brezi, fjala poetike matjane nuk ka shterur kurrë. Dr.Sali Kurti ka të drejtë të krenohet. Tashmë edhe si “Anëtar Nderi” i Klubit Letrar që mban emrin e të Madhit të letrave shqipe, Pjetër Budi, nga Guri i Bardhë i Klosit të rrethit të Matit, në faqen zyrtare të cilit, me të drejtë vlerësohet si poeti dhe prozatori i pare i letërsisë sonë, autor i katër veprave fetare në gjuhën shqipe, organizator dhe udhëheqës i masave popullore në luftën për çlirim nga zgjedha osmane, përkthyes dhe krijues origjinal në fushën e letrave shqipe, për të mbrojtur identitetin etnik e kulturor të popullit tone....

Prof. dr. Sali Kurti, në harkun kohor të një dekade është dekoruar me titullin e lartë “Mjeshtër i Madh” nga ish Presidenti i Republikës Bujar Nishani; Atij i është dhënë Titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Burrel nga Këshilli Bashkiak i këtij qytetit, ndërsa Federata e Paqes Univerasale Shqipëri i ka dhënë titullin “Ambasador për paqe” dhe e ka shpallur “Personaliteti i vitit 2023”. Nga ky gjerdan i artë dekoratash, medaljesh dhe titujsh, Dr.Sali Kurti është ndër më të nderuarit e të vlerësuarit e rrethit të Matit të metropolit shqiptar. Por nderimi që iu bë paraditen e 29 Dhjetorit 2025, duke i akorduar titullin “Akademik” nga Akademia Shqiptaro – Amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork, për atë, si dhe për të gjithë pjesëmarrësit e shumtë në atë ceremoni mbresëlënëse ishte ndër më të veçantët.

PROFILI

Një jetë në shërbim të njerëzve. Një mision që nuk njih orar, lodhje apo interes personal.

ARJAN HAMITI – DOKTORI QË E KA BETUAR HIPOKRATIN ME ZEMËR, JO VETËM ME FJALË



Nga Denada Isa Dapellari

- **Anemia në sëmundjet kronike të veshkave”, botim me vlera shkencore i akademik Arjan Hamitit**



Në këtë kohë ku shpesh mjekësia përballët me dyshime, me mungesë besimi dhe me sfida morale, ka ende figura që rikthejnë besimin tonë tek fjala “mjek”. Një prej tyre, dhe ndoshta më i spikaturi, është Profesor Doktor Arjan Hamiti – njeriu që e ka të skalitur fort betimin e Hipokratit jo vetëm në memorien e profesionit, por në vetë ADN-në e tij.

Kush e njih nga afër, e di se për Doktor Hamitin mjekësia nuk është thjesht profesion. Është

një thirrje e shpirtit, një mision i përditshëm, një betejë e pandalur në shërbim të jetës, të shëndetit dhe dinjitetit njerëzor.

Ai nuk është thjesht një doktor që përshkruan receta. Ai është njeriu që dëgjon, që kupton, që ndan dhimbjen me pacientin dhe që, me një përkushtim të rrallë, përpiket të jetë gjithmonë zgjidhje – jo vetëm për sëmundjen, por për vetë njeriun përballë tij.

Në një shoqëri ku shpesh ndihma jepet me kushte, Doktor Hamiti është shembulli i ndihmës pa kushte. Ai nuk pyet për statusin social, për pozicionin ekonomik apo për emrin mbi derë. Për të, çdo jetë është e shenjtë, çdo pacient është një thirrje për të vepruar, çdo vuajtje është një apel për ndihmë.

Ai është më shumë se një profesionist. Është mjeshtër i përlësisë, një burrë i urtë dhe i heshur, por me një energji që frymëzon çdo koleg, çdo student dhe çdo pacient që ka fatin të kalojë në duart e tij. Ai nuk shfaqet në media, nuk kërkon lavdi, por lavdia e ndjek vetë – sepse njerëzit e mëdhenj nuk kanë nevojë të flasin shumë; vepra e tyre bërtet për ta.

Të kesh përballë një mjek si Arjan Hamiti është një fat. Të kesh në vendin tënd një profesionist të tillë është një privilegj. Dhe të shkruash për të, është një përpjekje e përulur për të thënë faleminderit në emër të atyre mijëra njerëzve që ai i ka ndihmuar, i ka shpëtuar, i ka përkrahur.

Në një botë që ka nevojë për më shumë ndriçim, ai është një dritë e qetë, por e fuqishme. Një simbol i vërtetë i mjekut me shpirt, i njeriut me zemër, i profesionistit që është gjithmonë në krah të atyre që kanë më shumë nevojë.

Faleminderit, Profesor Doktor Arjan Hamiti!

Jo vetëm për kurën, por për dinjitetin. Jo vetëm për profesionin, por për humanizmin. Jo

vetëm për ditët në spital, por për netët pa gjumë për të shpëtuar jetë.

Ti nuk je vetëm doktor.

Ti je besimi i rikthyer tek njerëzimi.

Kontributi akademiko-shkencor i Dr. Arjan Hamitit

Libri i Dr.Arjan Hamitit “Anemia në sëmundjet kronike të veshkave” është një udhërrëfyes, që nëpërmjet informacionit dhe përshkrimit të praktikave mjekësore bashkëkohore, do ndihmojë Mjekët e Familjes dhe specialistët në diagnostikimin e hershëm të të sëmurëve me anemi në Sëmundjet Kronike të Veshkave. Ai është mirëpritur dhe vlerësuar nga personalitete të elites mjekësore shqiptare. Kësisoj, vlerat njerëzore çmohen kështu nga njerëzit e mençur. Kjo sentencë, bashkudhëtare e historisë së njerëzimit, gjen mishërim të plotë në profiling e Dr.Arjan Hamitit (Akademik – Anëtar i Akademisë Shqiptaro-amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork).

në kurimin e anemisë. Si i tillë ky libër vlerësohet edhe nga prof.Isuf Kalo, që sipas tij është një udhërrëfyes për klinikat më të mira.

Ndërsa ish-Presidenti i RSH, Bamir Topi vlerëson kontributin në aspektin social, shoqëror dhe politik, si një dimension i ri i Dr.Arjan Hamitit. Sipas z.Topi, libri “Anemia në sëmundjet kronike të veshkave” është një analizë thellësisht shkencore për një sëmundje që shpesh neglizhohet.

Si akademik, doktor i shkencave mjekësore, Arjan Hamiti demonstroi një model të ri sjelljeje dhe përkushtimi ndaj bashkëqytetarëve të vet. Këtë e dëshmon edhe me këtë veprë dinjitoze shkencore, të mbështetur në të dhënat statistike, të cilat janë ballafaquar me standardet të bazuara në K-DOQI standard dhe evidence shkencore. Në libër shtjellohen disa aspekte të trajtimit të anemisë, por disave, si psh vlera “target” për Hemoglobininë iu kushtohet një rëndësi e veçantë. Kjo për faktin, se gjatë përvojës së tij si mjek, në praktikën mjekësore e veçanërisht në atë laboratorike,

• *Si akademik, doktor i shkencave mjekësore, Arjan Hamiti demonstroi një model të ri sjelljeje dhe përkushtimi ndaj bashkëqytetarëve të vet. Këtë e dëshmon edhe me veprën e tij dinjitoze shkencore “Anemia në sëmundjet kronike të veshkave”, të mbështetur në të dhënat statistike, të cilat janë ballafaquar me standardet të bazuara në K-DOQI standard dhe evidence shkencore. Libri i tij është mirëpritur dhe vlerësuar nga personalitete të elites mjekësore shqiptare. Kështu Prof.Nestor Thereska, si recensent i librit, e vlerëson veprën e Dr.Arjan Hamitit në një aspekt elitar, por dhe për dimensionin njerëzor të tij në Shekullin e sotëm që njihet si “Shekulli i Veshkës”. Kësisoj, vlerat njerëzore çmohen kështu nga njerëzit e mençur. Kjo sentencë, bashkudhëtare e historisë së njerëzimit, gjen mishërim të plotë në profilin e Dr.Arjan Hamitit (Akademik – Anëtar i Akademisë Shqiptaro-amerikane të Shkencave dhe Arteve Nju Jork).*

Kështu Prof.Nestor Thereska, si recensent i librit, e vlerëson veprën e Dr.Arjan Hamitit në një aspekt elitar, por dhe për dimensionin njerëzor të tij në Shekullin e sotëm që njihet si “Shekulli i Veshkës”. Duke u ndalur më konkretisht në meritat e autorit, ai vlerësoi informacionin teorik por dhe studimin skurpuloz në praktikën mjekësore, rezultatet dhe konkluzionet, rekomandimet dhe referencat që përbëjnë targetin që duhet arritur

Dr.Arjan Hamiti ka vërejtur se kjo patologji (SKV) paraqet një problematikë aktuale, sa shkencore dhe ekonomiko-sociale.

Dr.Arjan Hamiti, i diplomuar për Mjekësi, që para 35 vitesh, i specializuar për “Mjek laborant” dhe që mban gradën “doktor i shkencave”, erdhi me këtë botim shkencor, pas një përvoje të vyer si mjek në spitalin e Librazhdit dhe si shef i Shërbimit Spitalor-Peqin; si Shef Laboratori në Poliklinikën Nr.6-Tiranë dhe si mjek në DRSH,

Tiranë. Ai ka kryer disa kualifikime në fushën laboratorike, si në përdorimin e aparaturave bashkëkohore laboratorike të zhvilluar nga Banka Botërore dhe nga qeveria italiane. Nga viti 2004 e në vazhdim është pedagog i jashtëm në Fakultetin e “Shkencave Mjekësore Teknike”, Tiranë. Për veprimtarinë bamirëse ndaj komunitetit të dhënë pranë Klinikës Mjekësore “HIPPOCRATI” është dekoruar me Titullin “Ambasador për Paqen”, nga Universal Peace Federation. Personaliteti dhe karakteri i tij në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos dinjitoz për më shumë se tre dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të shkencave mjekësore. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësues i elitës intelektuale shqiptare. Dhe jo vetëm kaq, si intelektual bashkëkohor, demokracinë e konsideronte sfidë ndaj sistemit që u shemb; sfidë në dinjitet, në vlerë, në përpjekje, në arritje. Thelbi i mendimit dhe veprimit të tij ishte vetëm konkurrenca në vlera. Ai besoi dhe dëshmoi se njeriun në jetë e mban vetëm dija. Një miqësi me dijen nuk ka moshë, por mbetet e përjetshme. I qetë, i pjekur, shumë i kulturuar nuk pajtohej me asnjë devijim nga parimet e virtytshme dhe njerëzore, por mbante qëndrim. Shpërthyes dhe autoritar në ndëshkimin e tij individual, sepse përherë qëndronte në vendin e nderit, sinqeritetit dhe dinjitetit. Kup-tohet ai ishte individ dhe jo institucion, por idetë dhe praktika e tij mund t’i shërbenin shumë një institucioni, një misioni. Këto cilësi i manifestoi dukshëm edhe si Shef i KEMP-it, Tiranë në vitet 2006-2013. Aktualisht, me botimin e ri synon të vlerësojë korrelacionin biomjekësor të Anemisë në Sëmundjet Kronike të Veshkave dhe trajtimin bashkëkohor të Anemisë tek të sëmurët me SKV. Për Dr.Arjan Hamitin, “Është e qartë, që trajtimi me Eritropoetinë (ilaç, sot i rimbursueshëm nga shteti) duhet të konsiderohet tek të gjithë grupmoshat, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës por, me depistimin dhe diagnostikimin e hershëm të SKV tek moshat e reja, përdorimi i Eritropoetinës merr një rëndësi të veçantë”. Në bazë të rezultateve të studimit jepen disa rekomandime për trajtimin e Anemisë tek të Sëmurët Kronikë të Veshkave që kanë si qëllim të ndihmo-



jnë mjekun e shërbimit primar apo sekondar në identifikimin e të sëmurëve me SKV dhe të atyre që kanë nevojë për një mjekim specifik të Anemisë. Aktualisht, Dr. Arjan Hamiti është ndër pedagogët më me emër të Universitetit prestigjioz “Luarasi” në Tiranë.

I qëndroi besnik betimit të Hipokratit

Të jesh mjek dhe të gezosh emer të mirë në shoqëri do të thotë të ndihesh i qetë me veten dhe me njerëzit që u shërben, me “nevojtarët e shëndetit” gjatë ushtrimit të profesionit human...

Të njohësh doktor Arjan Hamitin është krenari pasi ai për shumë vite në profesionin e mjekut ka bërë emër dhe ka gdhendur personalitetin e vet, jo vetëm si mjek i aftë, po edhe si njeri human, që për çdo rast është në shërbim të qytetarëve në nevojë.

Asnjëherë nuk ka preferuar të duket, as të mbajë funksione të larta, por është humanizmi i tij, bujaria dhe sakrificat e shumta që e kanë “ekspozuar”! Njerëz të tillë, lindin humanë... Edhe kaq, do të ishte e mjaftueshme për një Mjek të tillë që i qëndroi besnik betimit të Hipokratit, që u dallua nga të tjerët jo nga bluza e bardhë por mbi të gjitha nga humanizmi dhe përkushtimi ndaj asaj ç’ka është më e shtrenjtë, jetëve njerëzore.

Mirënjohje dhe falenderime pafund për ju doktor Arjan Hamiti...

FESTIVALI

Jo vetëm ngjarje kulturore, por akt kujtese, vetëdijeje dhe qëndrese kombëtare

KOMBI SHQIPTAR ME IMAZH TË UNIFIKUAR NË NJË FESTIVAL VLERASH



Halil RAMA – Mjeshtër i madh

- Me këtë event, ky Forum ka tejkaluar kufijtë e një aktiviteti ceremonial, duke u shndërruar në një hapësirë bashkimi për intelektualë, artistë, studiues dhe veprimtarë shqiptarë nga të gjitha trevat dhe diaspora

jtimit Kombëtar të vitit të mbrapshtë 1997; Drejtori për Ballkanin i Federatës Universale të Paqes Gani Rroshi, Kryetari i FPU Shqipëri Defrim Methasani, si dhe 50 personalitete tjera akademike e të letrave nga hapësira mbarëshqiptare në botë...

Në këto kohë të globalizmit, kur politika e mbrapshtë shqiptare e ka njollosur skajshëm, është Forumi Imazh & Media, që në kuadër të jubileut 30- vjetorit të krijimit dëshmon lavdinë e epokave në të cilat ka ndritur kombi ynë, krenarinë dhe guximin me të cilin ka mbijetuar nëpër shekuj dhe krijimtarinë e punën, me të cilat është përfaqësuar dhe ka dhënë një shembull unik herë pas here.



- U vlerësuan me “Çertifikatë Mirënjohjeje” dhe me titullin “Ambasador i Imazhit Shqiptar”: Dr. Ibradhim Rugova – Presidenti i parë i Republikës së Kosovës; Heroi legjendar i UÇK-së Adem Jashari; Dr. Arian Starova, ish Ministër i Jashtëm i Qeverisë së Pa-

Në një epokë kur globalizimi rrezikon të zbehtë identitetet kombëtare, ky Forum me vizion, përkushtim dhe ndjenjë të thellë përgjegjësie ka realizuar misionin e tij historik: ruajtjen dhe promovimin e vlerave shqiptare.

Festivali i 22-të Ndërkombëtar që ky Forum organizoi para disa ditëve, në prag të festave të

fundvitit, për vetë praninë e më shumë së 200 personaliteve nga hapësira mbarëshqiptare në botë ishte ngjarja më kulmore e 2025-ës.

Me këtë event, ky forum ka tejkaluar kufijtë e një aktiviteti ceremonial, duke u shndërruar në një hapësirë bashkimi për intelektualë, artistë, studiues dhe veprimtarë shqiptarë nga të gjitha trevat dhe diaspora.

Organizatori i këtij festivali ka një emër. Ai është Prof. dr. Astrit Memia, një nga ata personalitete që ka ditur ta shndërrojë trashëgiminë historike në një mision kulturor të gjallë, duke i dhënë figurës shqiptare zë dhe dinjitet në arenën ndërkombëtare. Dhe po me këtë vizion, Prof. Memia, (nip i Haxhi Xekës, një prej figurave themelore të Rilindjes Kombëtare) e konceptoi dhe realizoi këtë festival mbresëlënës sipas një programi që konsistonte në hapjen e fototekspozitës “Fotoimazhi Shqiptar”, promovimin e veprës së tij enciklopedike “Ambasador i Imazhit Shqiptar në botë”, shfaqjen e dokumentarit “Lufta e Kosovës në masmedian perëndimorë” dhe ceremoninë e Ambasadorëve të rinj të Imazhit Shqiptar në botë.

EKSPOZITA FOTOIMAZHI SHQIPTAR




Jo më kot, Kozeta Zavalani, një zë i spikatur i medias, poete dhe prozatore e mirënjohur, e vlerëson Festivalin e XXII Ndërkombëtar “Imazhi Shqiptar” si një dritare drite dhe dinjiteti ku fjala, fotografia dhe kujtesa u bënë një frymëmarrje e vetme kombëtare në moderimin e mrekullueshem të ikonës së gazetarisë sportive dhe dokumentarit televiziv Defrim Methasani. Sepse qoftë dhe vetë Ekspozita “Fotoimazhi shqiptar” në çelje të këtij festivali ishte një leksikon enciklopedik i kujtesës dhe mirënjohjes, ku historia nuk rri e heshtur, por flet me emra që kanë lënë gjurmë drite. Është historia në qindra e mijëra foto, sin-tezë e një aktiviteti të dendur 30 vjeçar për pro-

movimin e imazhit të Shqipërisë në botë.

Një fotoekspozitë gjeniale ku është Kombi ynë me imazh të unifikuar, që vizitohet me kureshtje e interesim të jashtëzakonshëm nga qindra pjesëmarrësit në këtë festival të veçantë për nga forma, idea, konceptimi e përmbajtja.

Një ekspozitë që pasqyron me madhësi bardhësinë e imazhit shqiptar dhe dy perla nga ekspozita e Vlorës e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Breda saj bashkohen intelektualë, figura të shquara të politikës, artit dhe kulturës, si dhe kontributorë të kombit dhe paqes, nga të gjitha trevat shqiptare dhe diaspora.

PROMOVIMI I VEPRËS “AMBASADOR I IMAZHIT SHQIPTAR NË BOTË”



Ndërsa Flutura Maçi, një nga artistet dhe poetet e spikatura e vlerëson Ekspozitën fotografike të “Imazhi Shqiptar” në 22 vite si pjesë dinjitoze të një Festivali elitare, po i tillë i dinjtetshëm vlerësohet nga personalitete të shumta akademike dhe të letrave edhe “Leksioni enciklopedik – monografi e Imazhit Shqiptar në botë”, një vepër madhore prej mbi 600 faqesh, ku janë përfshirë personalitete dhe figura të ndritura të kombit, të cilët gjatë tri dekadave janë identifikuar e përzgjedhur si bartës të epitetit “Imazhi Shqiptar në Botë”.

“E hartuar me vizion dhe përkushtim nga Prof. Dr. Astrit Memia dhe botuar me profesionalizëm e dashuri nga Semi Haxhiu, në shtëpinë botuese Fast Print, kjo vepër u bë pasqyrë dinjiteti. Aty, emrat nuk janë thjesht shkronja, por ura që lidhin kombe, zëra që udhëtojnë përtej kufijve, ambasadorë shpirti që mbajnë Shqipërinë gjallë në imazhin e botës”, shprehet Kozeta Zavalani.

Ndërsa Prof. dr. Vullnet Ameti, ish-ректор i Universitetit të Tetovës, (Ambasador i Imazhit



Shqiptar në Botë, laureat në vitin 2012, me rastin e 100- vjetorit te pavarësisë së Shqipërisë ne TKOB) e vlerëson këtë monografi, me karakter enciklopedik e dokumentar, një dëshmi të rrallë të përpjekjeve shumëdimensionale për të ndërtuar e promovuar imazhin kombëtar shqiptar, duke e lidhur me vlerat universale të paqes, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Më pas Akademik, Prof. dr. Jusuf Bajraktari referoi temën: “Imazhi, Diplomacia, Ruajtja e Identitetit Kombëtar në Mërgatë dhe Ringjallja e Neoshqiptarizmit (në fokus Dardania).

“Imazhi, Diplomacia, Ruajtja e Identitetit Kombëtar në Mërgatë dhe Ringjallja e Neoshqiptarizmit”, në fokus Shqipëria, ishte tema që referoi Dr. Arian Starova, diplomat i shquar, ish Ministër i jashtën i RSH-së, në kohë të trazirave 1997 në Qeverinë e Pajtimit Kombëtar.

Mjafton qoftë dhe një vështrim i përgjithshëm i kësaj vepre enciklopedike për të konkluduar se autori i saj, Prof. dr. Astrit Memia – një nga pedagogët më të suksesshëm dhe të vlerësuar të Universitetit të Tetovës, ka ndjerë përgjegjësinë e madhe për të lidhur të kalurën me të tashmen dhe për të ofruar një pasqyrë të integruar të shqiptarizmit në dimensionin diakronik dhe sinkronik. Si i tillë e vlerëson këtë botim edhe prorektori i Universitetit të Tetovës Prof. Dr. Agon Memeti që është më shumë se një enciklopedi, është një testament i dijes, identitetit dhe imazhit shqiptar në shekullin e XXI.

Njëherësh dhe konsulenti kryesor i dizenjosh

së koopertinës së leksikonit enciklopedik “Ambasador i Imazhit Shqiptar në Botë”, monografi, Pro- Rektori i UT-së, Prof. Dr. Agon Memeti, shprehet se ishte kenaqësi e krenari të stafi drejtues i Festivalit XII Ndërkombëtar” Imazhi Shqiptar” më zgjodhen se konsulentin kryesor. Kjo më obligon për të ardhmen progresive të eventeve kombëtare të Imazhit Shqiptar e Identitetit Kombëtar në Botë.

DOKUMENTARI “LUFTA E KOSOVËS NË MEDIAN PERËNDIMORE”



Dokumentari që përmes imazheve rrënoqethëse, në plotë gjysëm ore tregon heroizmin e UÇK-së, gjakun e sakrificën në Luftën heroike legjendare të liri-pavarësisë së Kosovës gjatë viteve 1998-‘ 99, u ndoq padyshim me interes të veçantë, jo vetëm nga pinjollët e heronjve të Kosovës martire, por nga gjithë pjesëmarrësit në këtë festival. Ndodhi vërtetë ashtu siç e përshkruan emocionalisht Kozeta Zavalani: “... salla u mbush me solemnitete dhe zemrat rrahën në një zë të vetëm. Pas atij momenti të shenjtë, fjalla mori dritë, arti mori frymë...në këtë Festival Ndërkombëtar që u hap si një portë krenarie... Hymni u shua në tinguj, por jo në shpirt: ai mbeti si flamur i padukshëm mbi çdo fotografi, mbi çdo fjalë, mbi çdo dëshmi që pasoi me dinjitet e vizion, duke e kthyer sallën “Alfred Moisiu” të



Federatës së Paqes Universale në shtëpi të identitetit, ku imazhi shqiptar foli botërisht”.

Dhe më e bukura e këtij dokumentari ishin insertet e medias perëndimorë që paraqisnin objektivisht heroizmin e UÇK-së.

Dhe jo vetëm kaq. Në këtë dokumentar të ideuar dhe realizuar me mjeshtri të rrallë artistike nga Prof. dr. Astrit Memia dëshmohej gjithashtu edhe kontributi i madh dhe i pamohueshëm që kanë dhënë jo vetëm personalitetet, intelektualët e figurat e këtij kombi ndër vite, por edhe puna e madhe që ka bërë Forumi Imazh & Media për nxjerrjen në pah dhe vlerësimin e tyre. Kështu ky Forum pas një turneu të gjatë, i cili ka zgjatur me aktivitetin e tij artistik gjatë gjithë këtij viti dhe ka përshkuar qytete si: Vjena, Gjilani, Istogu, Klina, Drenica, Prishtina, Gjakova, Durrësi, Korça, Vlora, Elbasani, Tetova, Ulqini, etj erdhi triumfalisht me këtë festial madhështor në kryeqendrën e gjithë shqiptarëve për të kurorëzuar të gjithë punën e tij.

Të ngazëllyer nga imazhet e shfaqura dhe tërësia e këtij festivali, shprein vlerësime maksionmale edhe Mehmet Prishtina, Adnan Imeri i fondit humunitar Preshevë.

DEKORIMI I DHJETRA PERSONALITETEVE ME TITULLIN “AMBASADOR I IMAZHIT SHQIPTAR NË BOTË”

Gjatë Festivalit të XXII të Forumit Imazh & Media u përcollën shumë mesazhe si dhe u bë ndarja e çmimeve të reja dhe titujve “Ambasador

i Imazhit shqiptar në botë” për personalitete të dalluara të kombit shqiptar.

Nga Juria e festivalit u vlerësuan lartë kontribuesit për vlera kombëtare në fushat e ndryshme.

Përveç personaliteteve për vlera në arsim, kulturë, shkencë, politikë, shëndetësi, shtetndërtim, diplomaci ishin të ftuar edhe epror nga Br. 138 “Agim Ramadani”.

U vlerësua lidershipi i Presidentit të Parë të Republikës së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, Komandanti Adem Jashari, Mehmet Prishtina, nipi i patriotit të madh Hasan Prishtina etj.

Po ashtu u dekoruan eprorë dhe dhjetra veteranë të Br. 138 “Agim Ramadani”.

Mes ovacionesh u ndanë edhe Çertifikata Mirënjohjeje për Fondin Humanitar për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë në Zvicër, me Kryetar Prof. Adnan Imeri; për Këshillin Integruës Kombëtar të Kosovës “Dardane”, me Kryetar vep-rintarin atdhetar, Z. Idriz Brahimaj si dhe për Shoqatën Bamirëse Humanitare “Mërgimtari”, me kryetar Z. Agim Antoni, me motivacionin: “Për bashkëpunimin dhe mbështetjen e dhënë në organizimin e Festivalit XXII Ndërkombëtar ‘Imazhi Shqiptar’, mbajtur në FPU, në Tiranë.

Mirënjohje dhe falenderim të veçantë, kryetari Memia dhe moderatori Methasani shprehën për artistin e madh me famë botërore Xhevat Limani dhe për Presidentin e Shoqërisë Kulturore Dibër e Madhe Miçe Duka.

Duke falenderuar qindra pjesëmarrësit që përjetuan këto momente të rëndësishme feste dhe gëzimi, në Festivalin e 22-të kushtuar kësaj radhe 30 – vjetorit të Forumit “Imazh & Media”, drejtuesit e këtij eventi bënë të ditur se ju lënë takim për vitin e ardhshëm në Festivalin tjetër të ndarjes së çmimeve që jep ky Forum i një rëndësie të veçantë, vatër e shenjtë shqiptarie, në odeonin e diplomacisë publike e kombëtare, ku fjala ka peshë, ku besa ka ligj, dhe ku marrëveshjet nuk vulosen me letër, por me sy, me zemër dhe me nder — si dikur motit, në logun e burrave.

REÇENSA

Çfarë ka dashur të thotë Shaban Sinani me librin studimor “Për prozën e Kadaresë”

“PROGRAMI KADARE”, NJË DRITARE MES DY BOTËSH



Nga Prof. Dr. Fatmir Terziu

Libri studimor i Shaban Sinanit “Për prozën e Kadaresë” shkon përtej një leximi kritik të veprës së Ismail Kadaresë. Ai është, në thelb, një ndërhyrje konceptuale në historinë e letërsisë shqipe. Shfaqet si një përpjekje për të riformular marrëdhënien midis letërsisë kombëtare dhe botës, midis kulturës periferike dhe metropoleve kulturore, midis krijimtarisë dhe pushtetit. Ajo që Sinani synon të thotë është se Kadareja nuk është vetëm shkrimtar i madh, por një program kulturor, një model i ri i ekzistencës së letërsisë shqipe në hapësirën universale.



Duke u nisur nga vërejtja e hershme e Eqrem Çabejt se letërsia shqipe është zhvilluar kryesisht si “letërsi mërgimtarësh”, Sinani e vendos Kadarenë në një vijë ndarëse historike. Për shekuj me radhë, shkrimtarët shqiptarë janë detyruar ta ndërtojnë veprën e tyre jashtë truallit kombëtar, në gjuhë të huaja dhe nën ombrellën e kulturave

të mëdha. Sipas Sinanit, Kadareja, përkundrazi, e përmbys këtë prirje. Kadare e shkruan gjithë veprën e tij në Shqipëri. E shkruan në gjuhën shqipe, dhe vetëm më pas ajo hyn në qarkullimin botëror përmes përkthimit. Kjo përmbysje është shndërrim paradigme. Sinani e sheh këtu lindjen e një letërsie shqipe dhënëse, jo më vetëm marrëse.

Në këtë kuptim, “programi Kadare” nënkupton dëshminë se kultura shqiptare mund të prodhojë vepra me vlerë universale pa u shpërngulur nga vetvetja. Kadareja nuk e braktis gjuhën, historinë dhe mitologjinë shqiptare për t’u bërë i lexueshëm në botë; përkundrazi, pikërisht përmes tyre ai bëhet i kuptueshëm dhe i domosdoshëm për lexuesin ndërkombëtar. Sinani këmbëngul se ky është çasti kur kompleksi i inferioritetit kulturor shembet: trualli shqiptar nuk është pengesë, por burim frymëzimi.

Një tjetër bosht themelor i librit është analiza e marrëdhënies së Kadaresë me pushtetin në periudhën ideokratike. Sinani e trajton letërsinë si “çështje shtetërore”, jo për ta politizuar veprën, por për të treguar se në shoqëritë totalitare letërsia e personaliteteve bëhet fushë beteje midis lirisë krijuese dhe kontrollit ideologjik. Dokumentet arkivore, “kritika e zyrave”, recensimet e fshehta, debatet në Byronë Politike dhe autokritikat e imponuara tregojnë se konflikti kryesor nuk ishte politik në kuptimin e drejtpërdrejtë, por estetik dhe etik: një talent i madh nuk mund të shprehej brenda kufijve të ngushtë të lirisë zyrtare.

Në këtë prizëm, Kadareja shfaqet si figurë emblematike e “Brezit 1968” në Shqipëri, si shkrimtar që, përmes alegorisë, mitit dhe historisë, ndërtoi një diskurs antitotalitar pa e shpallur gjithmonë haptazi. Sinani argumenton se ajo që pushteti e ndiente si kërcënim nuk ishte ndonjë mesazh i drejtpërdrejtë politik, por autonomia estetike e veprës, aftësia e saj për të krijuar kup-

time që i shpëtonin kontrollit ideologjik.

Në plan ndërkombëtar, libri i Sinanit tregon se fati i Kadaresë nuk u përcaktua vetëm nga censura vendëse, por edhe nga beteja interpretuese jashtë Shqipërisë. Akuzat e fabrikuara, keqleximet ideologjike, përpjekjet për ta paraqitur si shkrimtar të komprometuar ose si nacionalist të errët, janë pjesë e asaj që Sinani e sheh si një mbikëqyrje ideologjike globale. Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, vepra e Kadaresë arriti të imponojë vetveten si letërsi e madhe, duke e bërë letërsinë shqipe të denjë për dialog me metropolet kulturore.

KADARE PËRFAQËSON MOMENTIN KUR LETËRSIA SHQIPE NDRYSHON STATUS HISTORIK

Në vazhdim, ajo që Shaban Sinani ka dashur të thotë me “Për prozën e Kadaresë” është se Kadareja nuk përfaqëson vetëm kulmin e një individualiteti krijues, por momentin kur letërsia shqipe ndryshon status historik. Nga letërsi e mënjanisë dhe e mërgimit, ajo shndërrohet në letërsi të pranishme, konkurruese dhe dialoguese në hapësirën botërore. “Programi Kadare” është, pra, dritarja mes dy botësh: asaj kombëtare dhe asaj universale, ku Shqipëria hyn jo si periferi e heshtur, por si zë me identitet të plotë kulturor.

Duke e çuar më tej këtë lexim, bëhet e qartë se Shaban Sinani nuk synon vetëm të mbrojë apo të lartësojë figurën e Kadaresë përballë keqleximeve ideologjike apo polemikave të brendshme e të jashtme. Qëllimi i tij është më i thellë: të tregojë se me Kadarenë ndryshon vetë logjika e funksionimit të letërsisë shqipe. Ajo nuk matet më me kritere krahinore, morale politike të ditës apo shërbime ideologjike, por me kapacitetin për të prodhuar kuptim universal.

Në këtë pikë, libri i Sinanit ndërton një koncept të heshtur, por thelbësor: letërsia si institucion simbolik i shtetit kulturor. Në kushtet kur shteti real, ideokratik, e shihte artin si instrument disiplinimi, vepra e Kadaresë krijoi një shtet paralel simbolik, ku historia, miti, gjuha dhe kujtesa kombëtare riorganizoheshin sipas ligjeve të artit. Pikërisht kjo e bëri letërsinë e tij të rrezikshme për pushtetin dhe njëkohësisht të pazëvendësueshme për identitetin kulturor shqiptar. Sinani

këtu e lexon Kadarenë jo vetëm si shkrimtar që i mbijetoi censurës, por si autor që e sfidoi vetë konceptin e shtetëzimit të letërsisë, duke e kthyer krijimtarinë në hapësirë autonome.

Një nga idetë më të forta që përshkon librin është se raporti i Kadaresë me pushtetin nuk mund të gjykohej me skema morale të thjeshta: bashkëpunim apo rezistencë, konformizëm apo disidencë. Sinani argumenton se këto janë kategori të pamjaftueshme për të shpjeguar fatin e një shkrimtari të madh në një shoqëri të kontrolluar. Ajo që ndodhi ishte përplasja e një talenti strukturues me një sistem që kërkonte uniformitet. Konflikti nuk ishte episodik, por i vazhdueshëm, i fshehtë, shpesh i padukshëm për publikun, por i dokumentuar në arkiva, në recensime sekrete, në autokritika që shërbenin si mekanizëm mbi- jetese.

Në këtë kuptim, Sinani e zhvendos debatin nga pyetja “çfarë bëri Kadareja përballë pushtetit?” te pyetja shumë më e vështirë: “çfarë i bëri pushteti një letërsie që nuk i nënshtrohej dot?”. Përgjigjja është e qartë: një aparat i tërë mbikëqyrjeje, frike dhe manipulimi, që e trajtoi veprën si rrezik potencial, por që, paradoksalisht, e bëri atë edhe më të fortë në planin estetik.

Një dimension tjetër thelbësor i librit është rikthimi te ideja se letërsia shqipe zhvillohet jo si letërsi shkollash apo rrymash, por si letërsi personalitetesh. Duke iu referuar vëzhgimit të Jorgo Bulos, Sinani e vendos Kadarenë në vijimësinë e një tradite ku figurat e mëdha, jo manifestet teorike, janë ato që i japin drejtim kulturës. Kjo e bën “programin Kadare” jo të riprodhueshëm mekanikisht, por shembullor: ai tregon se afirmimi i një kulture të vogël nuk vjen nga imitimi i modeleve të huaja, por nga krijimi i personaliteteve që e tejkalojnë kontekstin e tyre.

Në fund, Sinani rikthehet te Çabej, por tashmë me një përfundim të rishikuar. Po, letërsia shqipe ka qenë për një kohë të gjatë “letërsi mërgimtarësh”, e kushtëzuar nga historia, nga mungesa e institucioneve dhe nga presioni politik. Por Kadareja dëshmoi se kjo nuk është fat biologjik apo etnopsikologjik. Është rrethanë historike. Dhe rrethanat mund të përmbysen nga një vepër e madhe.

LIBRI I AKADEMIKUT SHABAN SINANI ËSHTË MË SHUMË SE NJË STUDIM LETRAR

Prandaj, libri “Për prozën e Kadaresë” është më shumë se një studim letrar. Mbetet apriori një tekst i rëndësishëm i vetëdijes kulturore shqiptare. Ai i fton studiuesit, shkrimtarët dhe lexuesit të dalin nga skemat e ngushta gjyquese dhe të shohin shkrimtarin si fenomen që ndryshoi raportin e Shqipërisë me botën. Në këtë dritë, “programi Kadare” nuk është vetëm historia e një shkrimtari, por prova se një kulturë e vogël, kur arrin kulmin e saj estetik, mund të hyjë në qytetërimin botëror jo si imitim, por si bashkëbiseduese e barabartë.

Në një lexim edhe më të thelluar, Sinani e shtrin “programin Kadare” përtej kufijve të kritikës letrare dhe e shndërron atë në një kategori hermeneutike, pra në një mënyrë për të kuptuar jo vetëm veprën e Kadaresë, por edhe fatin e kulturës shqiptare në shekullin XX dhe në fillim-shekullin XXI. Kadareja, sipas këtij këndvështrimi, nuk është thjesht subjekt analize; ai bëhet instrument matës i pjekurisë së shoqërisë shqiptare për të përballuar mendimin e lirë, kompleksitetin estetik dhe ambiguitetin moral.

Sinani vëren se polemikat e pafundme rreth Kadaresë, nga akuzat për konformizëm deri te mitizimi i pakushtëzuar, tregojnë më shumë për shoqërinë që i prodhon këto debate sesa për vetë shkrimtarin. Në këtë pikë, libri merr edhe një funksion kritik ndaj kulturës sonë publike: paaftësia për ta lexuar letërsinë jashtë skemave ideologjike është një trashëgimi e drejtpërdrejtë e mendësisë totalitare. “Programi Kadare” kërkon, në mënyrë implicite, një lexues të ri shqiptar, të aftë të pranojë kontradiktat dhe tensionet pa i shndërruar ato në gjyqe morale të shpejta.

Një tjetër shtresë e rëndësishme e analizës së Sinanit lidhet me raportin midis mitit dhe historisë në prozën e Kadaresë. Sinani argumenton se Kadareja e përdor historinë jo si arkiv faktesh, por si hapësirë simbolike ku shqyrtohen mekanizmat e pushtetit, frika kolektive dhe ciklet e dhunës. Ky përdorim i historisë e bën veprën e tij të lexueshme njëkohësisht si narrativë kombëtare dhe si reflektim universal mbi fatin njerëzor. Në

këtë mënyrë, letërsia shqipe kalon nga funksioni dëshmues në funksion interpretues të historisë.

Këtu Sinani thekson një ide kyçe, universalialia nuk arrihet duke braktisur lokalitetin, por duke e çuar atë deri në fund. Kadareja nuk i zbut mitet shqiptare për t’i bërë të pranueshme për botën; ai i thellon, i errëson, i problematizon. Pikërisht kjo e bën veprën e tij të krahasueshme me traditën e madhe evropiane, nga Kafka te Borges, nga Orwell te Camus, pa u shkrirë kurrë në imitim të tyre.

PËRKTHIMI I VEPRËS SË KADARESË NË DHJETRA GJUHË TË BOTËS SI AKT KULTUROR, JO THJESHT TEKNIK



Në këtë kuadër, Sinani flet edhe për përkthimin si akt kulturor, jo thjesht teknik. Përkthimi i Kadaresë në gjuhë të mëdha evropiane nuk është vetëm transferim teksti, por përkthim i një përvojë historike dhe ekzistenciale. Kjo është arsyeja pse vepra e tij, edhe kur lexohet jashtë kontekstit shqiptar, ruan një tension të brendshëm që e bën të dallueshme. Për Sinanin, suksesi ndërkombëtar i Kadaresë nuk është rastësi, por pasojë e faktit se ai përfaqëson një përvojë kufitare, atë të një kulture të vogël nën presion të madh historik.

Duke iu kthyer dimensionit etik, Sinani nuk e idealizon figurën e shkrimtarit. Përkundrazi, ai e sheh Kadarenë si figurë tragjike moderne, të detyruar të manovrojë midis mbijetesës personale dhe besnikërisë ndaj artit. Kjo tragjicitet nuk e zvogëlon veprën; përkundrazi, ia shton densitetin moral. “Programi Kadare” nuk është program heroizmi politik, por program përgjegjësie estetike, ku shkrimtari i qëndron besnik së vërtetës


artistike edhe kur kjo e vërtetë nuk mund të thuhet drejtpërdrejt.

Në këtë mënyrë, libri i Sinanit përfundon duke e vendosur Kadarenë në një hapësirë që tejkalon biografinë dhe konjukturën. Ai bëhet pikë referimi për të kuptuar se si letërsia mund të funksionojë si kujtesë, si rezistencë simbolike dhe si urë komunikimi me botën. “Programi Kadare” është, në fund të fundit, një thirrje për ta marrë seriozisht letërsinë si formë të lartë të mendimit dhe për ta lexuar Kadarenë jo si monument të ngrirë, por si sfidë të vazhdueshme intelektuale për kulturën shqiptare.

Në kapitujt përmbyllës të këtij vizioni kritik, ajo që Sinani e bën gjithnjë e më të qartë është se “programi Kadare” nuk mbyllet me veprën e Kadaresë, por hap një detyrim kulturor për pasardhësit. Ai nuk është model për t’u kopjuar stilistikisht, por standard për t’u përballur. Në këtë kuptim, Kadareja shërben si masë krahasimi: çdo shkrimtar, kritik apo studiues i mëvonshëm, dashur pa dashur, matet me nivelin e kompleksitetit, autonomisë estetike dhe përgjegjësisë intelektuale që ai vendosi.

Sinani sugjeron se një nga rreziqet më të mëdha pas rënies së totalitarizmit është banalizimi i lirisë. Në mungesë të censurës së drejtpërdrejtë, letërsia rrezikon të humbasë densitetin e saj etik dhe simbolik, duke u shndërruar në narrativë të shpejtë, dëshmitare ose thjesht konsumiste. Në këtë kontekst, rikthimi të Kadareja nuk është nostalgji, por akt kritik: një kujtesë se liria artistike nuk është vetëm e drejtë, por edhe barrë.

Një nga momentet më të mprehta të librit është reflektimi mbi mënyrën se si shoqëria shqiptare e ka trajtuar Kadarenë pas viteve ’90. Sinani vëren se nga kontrolli ideologjik u kalua shpesh në një gjyq publik emocional, ku vepra u lexua përmes biografisë dhe jo anasjelltas. Kjo, sipas tij, është shenjë e mungesës së një kulture të konsoliduar të kritikës letrare, e cila di të ndajë tekstin nga




miti, pa e shkatërruar as njërin, as tjetrin. “Programi Kadare” kërkon pikërisht këtë maturi: aftësinë për të lexuar një autor të madh pa e absolutizuar dhe pa e relativizuar deri në zbrazëti.

Në një plan më të gjerë, Sinani e lidh fatin e Kadaresë me fatin e vetë Shqipërisë në Evropë. Kadareja, sipas tij, është një nga rastet e rralla kur një kulturë e vogël arrin të artikulojë përvojën e saj në një gjuhë që kuptohet nga qytetërimi evropian pa përkthyes ideologjik. Prandaj, pranimi ose refuzimi i Kadaresë në diskursin publik shqiptar bëhet tregues i gatishmërisë sonë për t’u ballafaquar me Evropën jo si nxënës të përjetshëm, por si partnerë kulturorë.

Në këtë pikë, libri merr një dimension pothuajse programatik për politikën kulturore. Sinani nënkupton se pa mbështetjen e një kritike serioze, pa arkiva të hapura dhe pa institucione që e trajtojnë letërsinë si pasuri strategjike, “programi Kadare” rrezikon të mbetet thjesht referencë simbolike. Kadareja, në këtë kuptim, nuk është fundi i rrugës, por prova se çfarë mund të arrihet kur talenti individual, gjuha dhe historia kombëtare hyjnë në një marrëdhënie krijuese.

Në përmbyllje, Sinani e lë lexuesin me një ide thelbësore: vepra e Kadaresë nuk ka nevojë për mbrojtje apologetike, por për lexim të përgjegjshëm. “Programi Kadare” është një ftesë për ta çliaruar leximin nga komplekset, nga hakmarrjet ideologjike dhe nga adhurimi i verbër. Vetëm në këtë mënyrë, letërsia shqipe mund të vazhdojë dialogun e nisur nga Kadareja me botën dhe me vetveten. Kështu, libri “Për prozën e Kadaresë” i Shaban Sinanit shfaqet edhe si një manifest i heshtur i pjekurisë kulturore, një dëshmi se letërsia shqiptare, kur lexohet me seriozitet dhe thellësi, është në gjendje të prodhojë mendim, jo vetëm emocion, kuptim, jo vetëm narrativë, dhe universale, pa humbur rrënjët e saj.



REPORTAZH

Nga persekutimi komunist te nderimi në SHBA, saga e familjes Boletini

PËRJETËSIA E HEROIT, RRUGA “ISA BOLETINI” NË NEW YORK



Akademik XHELAL MARKU



Duke ndjekur Ditën e Inaugurimit të Rrugës “Isa Boletini” në Staten Island, New York – 30 Nentor, 2025

- Ky tubim i organizuar nga Naser Nika, banues në Staten Island, u ndoq gjithashtu nga afër nga deputeti i PD-së, Belind Këlliçi, ambasadorët shqiptarë Suela Janina dhe Blerim Reka; ish diplomati Mal Berisha, gazetari Beqir Sina – ish i persekutuar politik nga regjimi komunist në Shqipëri, gazetari Halil Mula etj...

1.

Në pamundësi për të marrë pjesë fizikisht në inaugurimin e Rrugës “Isa Boletini” në Staten Island, së bashku me familjen time, mundëm ta ndiqnim nëpërmjet televizorit në banesën tonë në Tiranë. U gëzova shumë, vura re se kishin

marrë pjesë personalitete të shumta amerikane, shqiptarë nga Shqipëria, Kosova dhe Shkupi.

Organizatori kryesor i asaj ceremonie ishte Naser Nika, banues në Staten Island, i cili në bashkëpunim edhe me shoqata të tjera dhe përfaqësues të politikës amerikane, arritën këtë ditë suksesi, ku emri i Heroit Isa Boletini të zerë vend përkrah firmëtarit të Pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemali në një nga rrugët në New York.

Ishte kënaqësi për mua që në atë tubim të rëndësishëm të shikoja që e pranishme ishte edhe njëra nga vajzat e mikut tim Enver Dajçi, si një ndër pasardhëset e familjes Boletini, gazetarja dhe veprimtarja e njohur e komunitetit shqiptar në SHBA, Zj. Mimoza Dajçi, e cila me penën e saj është e vetmja femër shqiptare që ka shkruajtur gjatë, gjerë e vazhdimisht për jetën dhe sakrificat sublime të Isa Boletinit e familjes Boletini për çështjen kombëtare.



Edhe pse moti ishte i keq me shi, pata mundësi të flas direkt me Mimosën në telefon, e cila i ndihej falenderuese Naser Nikës, Këshilltarit të Bashkisë në Neë York, David Carr, si dhe të gjithë

shoqatave që morën iniciativën për realizimin e vendosjes së emrit të heroit tonë kombëtar Isa Boletini përkrah plakut të urtë e udhëheqësit të Pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemali. Bisedova pak me Mimozën e cila ndodhej atje së bashku me vajzën e saj, violinisten e talentuar Merlinin. U ndjeva krenar për to, që po ecin në rrugën e patriotizmit dhe humanizmit, njëjtë si paraardhësit e familjes së tyre.



Belind Këlliçi, Mimoza Dajçi dhe
NYC Councilman David Carr

KRIMET NDAJ SHQIPTARËVE

Mimoza më citoi edhe një shprehje të nënshkruesit të Pavarësisë së Shqipërisë Ismail Qemali, me rastin e mbërritjes së Isa Boletinit në Vlorë: “I madhi Isa, luftërat tuaja ishin bazë e përpjekjeve të mia për Pavarësinë e Shqipërisë”.

“Unë jam këtu sot – tha Zj. Dajçi – për t’i dëshmuar shkja, serbit se gjaku i Boletinëve është gjallë dhe nuk i harron kurrë krimet që historikisht kanë kryer ndaj popullsisë së pafajshme shqiptare në Kosovë. Krime që vazhduan edhe më pas, ku mes të vrasësve dhe të masakruarve mbetën gra, fëmijë e pleq, u vranë djemtë më të mirë të kombit, shqiptaro – amerikanë, vëllezërit Bytyci që edhe ata sot i kujtojmë me respekt. Nga makineria serbe në Kosovë u malltrajtuat dhe u përdhunuan mbi 20 mijë gra e vajza shqiptare.

Gjithashtu – tha ajo – Falenderoj mbesat dhe nipin e Isa Boletinit Ariana Hoxhën, Arieta dhe Armend Muratin si pasardhës të denjë të Heroit Isa Boletini, të cilët vazhdojnë të ngrenë lart figurën emblematike të Gjeneralit me qeleshe të

bardhë Isa Boletini në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare”.

Isa Boletini lindi më 15 janar 1864 në Mitrovicë, ai u bë një nga prijësit kryesorë të shqiptarëve të Kosovës në luftërat e tyre kundër pushtuesve osmanë, serbo-malazezë dhe grekë. Një nga ngjarjet më të njohura të jetës së tij, është pjesëmarrja në ngritjen e Flamurit në Vlorë në nëntorin e 1912-ës, ku Ismail Qemali shpalli Pavarësinë e Shqipërisë. Isa Boletini u vra nga forcat serbo-malazeze të Gjeneralit Vukoviq, teksa ishte duke kaluar në urën e Ribnicës në qytetin e Podgoricës. Bashkë me Isa Boletinin, atë ditë u vranë dhe shtatë pjestarë nga familja e tij.

KTHIMI I ESHTRAVE

Pas vrasjes së Heroit Isa Boletini, djemve, nipave dhe luftëtarëve të tij në Podgoricë më 23 Janar 1916, eshtrat e tyre qëndruan më tepër se 80-të vite në varrezat e Malit të Zi. Që nga viti 1978, autoritet Kosovare filluan përpjekjet e para për tërheqjen eshtrave të Isa Boletinit dhe luftëtarëve të tjerë në Podgoricë dhe për t’i rivarrosur ato në vendin e lindjes në Kosovë, ku një nga këmbëngulësit e mëdhenj që eshtrat e Isa Boletinit të mbërrinin nga Mali i Zi në Kosovë, ka qenë edhe Presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova.

Meritë e veçantë për këtë i takon edhe ish Kryetarit të Bashkësisë Islame në Mal të Zi, Idriz Demiraj, i cili njoftoi familjarët në Mitrovicë për marrjen e eshtrave të Isa Boletinit.

Si dhe nipit të Isa Boletinit, Remzi Muratit, djalit të Shehides, vazjës së Isa Boletinit, që në maj të vitit 1998 mes reziqeve të mëdha si amanet i nënës së tij Shehides, arriti të sjellë eshtrat e Isës dhe luftëtarëve të tjerë në Kosovë.

Si rezultat i politikës të ndjekur nga Beogradi dhe Tirana komuniste, që pas vrasjes së Isës nga familja Boletini u vranë apo ekzekutuan 15 vetë, dhjetë të tjerë kaluan vite të tëra në burgje dhe internime politike duke vuajtur dënimet nëpër burgjet e tmerrshme të Serbisë dhe Shqipërisë, ku mes tyre mund të veçoj edhe babanë e Mimoza Dajçit, që e kam njohur personalisht dhe ruaj konsideratën dhe respektin më të veçantë për të, si patriot, intelektual, zotërues i shtatë gjuhëve të huaja, ish i burgosur politik në Shqipëri dhe xhaxhain e saj pushkatuar pa gjyq nga forcat sllavo komuniste në Prizren në vitin 1944.

Represioni dhe hakmarrja e sllavo-komunistëve ndaj familjes së njohur të Isa Boletinit filloi që në nëntorin e vitit 1943, kur komunistët në Shkodër vranë nënkolonel Adem Boletin, djalin e tretë të Isës, i cili kishte mbaruar Akademinë Ushtarake në Vjenë.

PERSEKUTIMI KOMUNIST

Pas kësaj, si në Mitrovicë ku jetonte pjesa më e madhe e Boletinëve, ashtu edhe në Shqipëri, familja Boletini u gjend nën një persekucion të egër dhe barbar nga regjimet komuniste të Titos dhe të Enver Hoxhës. Regjimi komunist i Enver Hoxhës ndaj familjes së Boletinëve ndoqi po atë politikë të cilën kishte ndjekur për shumë vjet regjimi komunist i Titos.



Në një material publicistik, Mimoza Dajçi shkruan: “Kur im atë kryente një pjesë të dënimit të tij si i ish i burgosur politik në burgun e Ballshit në Shqipëri, atë kohë në atë burg vuante dënimin si i burgosur politik edhe nipi i gjeneralit Vukoviq, që kishte vranë Isa Boletin. Svetko, kështu quhej nipi i Vukoviqit, ishte ankuar në drejtorinë e atij burgu, që të largonin nga ai burg Enver Dajçin, me pretekstin se jeta e tij nuk ishte e sigurtë aty nga nipi i Isa Boletinit, Enver Dajçi, i cili mund të hakmerrej ndaj atij. Kur babai im dëgjoi këto fjalë – shkruan Mimoza – si një personalitet me integritet të lartë intelektual dhe me gjakftohtësi të plotë përgjigjet: “Svetko për mua, të qëndrojë i qetë, pasi unë nuk jam hakmarrës. Kur xhaxhai i tij Vukoviq vrau Isa Boletin, Svetko nuk kishte lindur ende, dhe nuk ka asnjë faj për atë krim, që do ta dënojë koha”. Dhe vërtetë ashtu ndodhi, Svetko doli gjallë nga ai burg, pa asnjë kërcënim për jetën nga im atë, ndërsa babain tim e izoluan për disa javë në një birucë në burgun e Ballshit vetëm pse tha “Atë krim do ta dënojë koha”.

Në ceremoninë e inaugurimit të Rrugës “Isa Boletini” në Staten Island, i pranishëm ishte edhe patrioti dhe aktivisti i njohur Esad Rizai, i cili në nëntorin e vitit 2018 me rastin e Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë, me iniciativën e tij dhe mbështetjen e Presidentit të Bashkisë në Bronx Ruben Diaz, Jr., i akordoi Proklamata të Nderit Heroit tonë kombëtar Isa Boletini. Ky tubim u ndoq gjithashtu nga afër nga deputeti i PD-së, Belind Këlliçi, ambasadorët shqiptarë Suela Janina dhe Blerim Reka; ish diplomati Mal Berisha, gazetari ish i persekutuar politik nga regjimi komunist në Shqipëri Beqir Sina, gazetari Halil Mula etj...

Isa Boletini i është akorduar titulli i lartë “Heroi i Popullit” nga shteti shqiptar, ndërsa në vitin 2010, Kosova i dha Çmimin “Urdhëri Hero i Kosovës”.

I paharruar qoftë jeta, vepra dhe kujtimi i Tij!

2.

NIPI I ISA BOLETINIT PË RBALLË NIPIT TË GJENERAL VUKOVIQIT, VRASË SIT TË HEROIT NË BURGUN BALLSHIT

HISTORIA E ENVER DAJÇIT NË QELITË E DIKTATURËS....



Enver Dajçi vinte nga një derë e njohur atdhetare, ishte nip i Isa Boletinit. Ai u bë një figurë e njohur gjatë Luftës së Dytë Botërore, por pas ardhjes së Enver Hoxhës në pushtet, përfundoi

në qelitë e errëta të hetuesisë komuniste.

Ai nuk mund të pajtohej me shitjen e Kosovës te Jugosllavia, as me kthimin e Shqipërisë në një shtet-burg dhe shprehu pakënaqësitë hapur. Rreth tri vite i kaloi në tortura të skajshme në qelitë e ftohta të Hetuesisë së Enver Hoxhës që ia kalonte dhe atyre të Hitlerit. Pas gjyqit të inskenuar atë do ta dërgonin në Ballsh në kampin-burg, ku do të kryente dënimin pa bërë faje, madje edhe do ta ridënonin. Mimoza Dajçi aktiviste e njohur e komunitetit shqiptar në SHBA, presidente e Organizatës së Gruas Shqiptaro-Amerikane “The Ē omen’s Organization” “Hope & Peace” shprehet se: “Kur im atë kryente një pjesë të dënimit të tij si i ish-i burgosur politik në burgun e Ballshit në Shqipëri, atë kohë në atë burg vuante dënimin si i burgosur politik edhe nipi i gjeneralit Vukoviq, që kishte vrrarë Isa Boletinin.

Svetko, kështu quhej nipi i Vukoviqit, ishte ankuar në drejtorinë e atij burgu, që të largonin nga ai burg Enver Dajçin, me pretekstin se jeta e tij nuk ishte e sigurt aty nga nipi i Isa Boletinit, Enver Dajçi, i cili mund të hakmerrej ndaj atij. Kur babai im dëgjoji këto fjalë – shkruan Mimoza – si një personalitet me integritet të lartë intelektual dhe me gjakftohtësi të plotë përgjigjet: “Svetko për mua, të qëndrojë i qetë, pasi unë nuk jam hakmarrës. Kur xhaxhai i tij Vukoviq vrau Isa Boletinin, Svetko nuk kishte lindur ende, dhe nuk ka asnjë faj për atë krim, që do ta dënojë koha”. Dhe vërtetë ashtu ndodhi, Svetko doli gjallë nga ai burg, pa asnjë kërcënim për jetën nga im atë, ndërsa babain tim e izoluan për disa javë në një birucë në burgun e Ballshit vetëm pse tha “Atë krim do ta dënojë koha”. Enver Dajçi jetonte pranë vajzës së tij Mimoza dhe mbesës Merlin në Bronx, NY derisa ndërroi jetë në vitin 2015.

PERSEKUTIMI I BOLETINËVE

Hakmarrja e sllavo-komunistëve ndaj familjes së njohur të Isa Boletinit, filloi që në nëntorin e vitit 1943, kur komunistët shkodranë të udhëhequr nga Vasil Shanto vranë me atentat babanë tim nënkolonel Adem Boletinin, djalin e tretë të Isës i cili kishte mbaruar Akademinë Ushtarake në Vjenë (sidhe djalin e Ademit, Isain). Pas kësaj si në Mitrovicë ku jetonte pjesa më e madhe e Bo-

letinëve, ashtu edhe në Shqipëri, familja jonë u gjend nën një persekucion të egër dhe barbar nga regjimet komuniste të Titos dhe të Enver Hoxhës. Nga ky represion i paparë që u ndoq ndaj djemve, nipave dhe mbesave të Isa Boletinit, numri i të vrrarëve dhe të ekzekutuarve nga familja jonë arriti në 15 vetë dhe dhjetë të tjerë vuajtën për vite të tëra në burgjet e tmerrshme të Serbisë dhe Shqipërisë.

Regjimi komunist i Enver Hoxhës ndaj familjes së Boletinëve ndoqi po atë politikë të cilën kishte ndjekur për shumë vjet regjimi komunist i Titos dhe si rezultat i kësaj vetëm në vitin 1962-in, Isa Boletinit iu akordua titulli i lartë i Heroit të Popullit. Edhe pas kësaj familja e tij pati vetëm një ftesë zyrtare për të shkuar në Vlorë në përvjetorët e ditës së ngritjes së Flamurit dhe në 1981 kur u inaugurua monumenti i Isa Boletinit në Shkodër. Vepra e Isa Boletinit është nderuar në çdo kohë në gjithë Shqipërinë etnike. Emrin e tij e mbajnë shkolla, rrugë, lagje e sheshe. Gjithashtu ka një batalion special të ushtrisë shqiptare, që u instalua në Irak, që mban emrin e Isa Boletinit.

DITA E VRASJES

I lindur më 15 janar 1864 në kullën e Boletinëve, afër Mitrovicës, patrioti shqiptar Isa Boletini, ishte vrrarë pabesisht nga malazetët në Podgoricë më 23 janar 1916, së bashku me bijtë e tij Halilin dhe Zahidin, dy nipërit dhe tre luftëtarë të tjerë. Isa Boletini, vitet e rinisë i kaloi në vendlindje. Në prill të vitit 1881, si 17-vjeçar, ai mori pjesë në betejën e Shlivovës, ku u ndeshën trupat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me ushtrinë osmane. Edhe pse në vitin 1908 ishte në krahun e xhonturqve, kjo lidhje u prish shumë shpejt. Në nëntor të vitit 1908, Porta e Lartë dërgoi një ushtri prej 7 mijë ushtarësh për të nënshtruar Kosovën.



Komandën antiosmane e kishte në dorë Isa Boletini. Gjatë tërheqjes, osmanët i dogjën kullën në shenjë hakmarrjeje. Më pastaj, Isa Boletini udhëhoqi kryengritjet e kosovarëve në Prishtinë, Prizren e gjetiu. Ai ishte një ndër udhëheqësit kryesorë të kryengritjes së pranverës së vitit 1910. Isa Boletini ishte bërë i njohur edhe për atë që i kishte ndodhur në Londër, kur edhe pas kontrollit që i kishin bërë rojat kur hyri për të takuar ministrin e jashtëm, Eduard Grej, ai ia kishte dalë që njërin revolver ta fuste brenda. Greji kishte bërë shaka me Boletinin duke i thënë se “atë që se bëri ushtria osmane, e bëra unë”. Me etjen për hakmarrje, serbët dhe malazezët u bënë bashkë me rusët dhe francezët për ta eliminuar Isa Boletinin. Atë që nuk e kishin arritur ta bënin në luftë ballore në fushëbeteja, ata e bënë në urën e shtetit fqinj, Malin e Zi. Konsulli francez në Podgoricë, Bichoc, është njeriu që nisi aplikimin e kurthit duke e ftuar Isa Boletinin të shkojë në Cetinjë, në mënyrë që prej andej ta dërgonte jashtë Malit të Zi. Boletini i besoi kësaj ndihme pa e menduar se në fakt po shkonte drejt ekzekutimit. Teksa ndodhej në Podgoricë ai u gjend në një kurth që i solli vdekjen. Në fakt, ajo nuk ishte thjesht një vrasje, por një kasaphanë.

U vra gjatë një shkëmbimi zjarri me malazezët në Podgoricë së bashku me 17 shoqëruesit e vet. Me 19 janar 1916 në Podgoricë, te Ura e Ribnicës, i zënë me pabesi nga malazezët, vritet Isa Boletini. “Pobjeda” e përditshme nga Titograd, më 26 maj 1980 e botoi kronikën e atëhershme ku thuhet se ngjarja kishte ndodhur më 19 janar. Isa Boletini u varros dy dytë pas vrasjes në Podgoricë, në një ceremoni ku morën pjesë një numër i madh njerëzish. Në vitin 1973, u bë kërkesa e parë për kthimin e eshtrave në vendlindje. Falë përpjekjeve të familjarëve dhe studiuesve varri u zbulua dhe më 15 nëntor të vitit 1979 u krye zhvarrimi. Në fakt këtë proces e shpejtoi dhe një projekt bashkisë së Podgoricës që në tokën ku preheshin eshtrat do të ndërtohej një park. Bashkë me eshtrat e Isa Boletinit u nxorën edhe eshtrat e të shtatë të vrasësve të tjerë të masakrës së 23 janarit 1916. Ishin dy fakte që vërtetuan se ato eshtra i përkisnin Isa Boletinit: Epitafi mbi gurin e varrit, por edhe mungesa të eshtrat e gishtit të mesit në dorën e majtë. Sipas familjes Boletini, Isa e kishte prerë këtë gisht në moshën 3-vjeçare me sëpatë. Eshtrat u vendosën me kujdes në një arkë dhe u varrosën në një kënd të oborrit në xhaminë e Mitrovicës në fshehtësi të plotë.

Muhamet Shukriu, Latif Berisha, Asllan Murati ishin tre personat që u betuan me njëritjetrin që nuk do t’ia tregonin askujt këtë sekret. Një sekret që u mbajt deri në lirinë e Kosovës e më pas për të ndërtuar një memorial të veçantë. Ndërkohë, pas 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, nisi procesi i verifikimit të eshtrave për të kryer një ceremoni zyrtare varrimi. Në korrik të vitit 2011, mbetjet mortore të Isa Boletinit dhe të bashkëluftëtarëve të tij, iu dorëzuan Komunës së Mitrovicës. Ato ia dorëzoi imami i kësaj komune, Mulla Asllan Murati, i cili 13 vjet pas rivarrimit nga Podgorica i ruajti në një vend të fshehur. Instituti i Mjekësisë Ligjore në Universitetin e Strasburgut, në janar të vitit 2014, konfirmoi se eshtrat e dërguara për ekzaminim ishin të Isa Boletinit. Më 10 qershor 2015, Isa Boletini u varros në oborrin e kullës së tij në Buletin të Mitrovicës.



ESSE

KURESHTJE PËR “PARAJSËN” SOVJETIKE



Prof. Dr. Eshref Ymeri

Në vitin 2025, Shtëpia Botuese zvicerane “Sandermoen Publishing” hodhi në qarkullim librin me titull “The Soviet Union through the eyes of witnesses” (Bashkimi Sovjetik me sytë e dëshmitarëve). Në parathwnie thuhet:

Ky libër nuk ka autor, por aty ka një mori zërash, të cilët rrëfejnë historitë e veta, ndajne me njëri-tjetrin kujtimet e tyre, dhe, e përbashkëta në të gjitha këto rrëfime, është e vërteta për Bashkimin Sovjetik në dhjetëvjeçarët e fundit të ekzistencës së vet, e cila përcillet për lexuesit nga njerëz që qenë rritur në Bashkimin Sovjetik, që kanë qenë të njohur me atë epokë jo me të dëgjuar. Pra, në këtë mes kemi të bëjmë me një të vërtetë që pasqyrohet jo me syze bojërozë, përmes së cilave është bërë e modës të shikohet e kaluara nga periudha passovjetike, nga Rusia e ditëve tona dhe të shprehet nostalgjia për Bashkimin Sovjetik.

Libri hapet me citatin e specialistes së krijimtarisë së poetit Aleksandër Bllok (1880-1921) dhe të historisë së simbolizmit rus, Zara Minc (1927-1990). doktore e shkencave filologjike, profesore e Tartu University (Estoni):

“Ja cila është njëra nga detyrat themelore të çdo njeriu të kulturuar: të mos lejojë të zhduket ajo pjesë e historisë, dëshmitar i së cilës është ai dhe vetëm ai”.

Me fjalë të tjera, para lexuesit shpaloset një libër-dialog, një libër-mozaik, në të cilin janë pasqyruar mbresa nga jeta në Bashkimin Sovjetik, kur mungesa e produkteve ushqimore ishte shqetësimi kryesor i çdo qytetari. Ideja për kri-

jimin e këtij libri pati lindur gjatë diskutimit me një grup qytetarësh në fb.



Mbresat e 75 qytetarëve sovjetikë, i ka regjistruar analistja Ludmilla Novikova, e cila është edhe hartuesja e këtij libri. Por këtu jemi mjaftuar me përkthimin e mbresave vetëm të disave prej tyre, meqenëse shqetësimet e përditshme të qytetarëve për mungesën e furnizimit me produkte të dorës së parë, janë të njëllojta.

Në vijim citohen disa anekdota nge jeta sovjetike dhe mandej vazhdojnë mbresat e qytetarëve:

Në Bashkimin Sovjetik nuk ka papunësi, por askush nuk punon.

Askush nuk punon, por planin të gjithë e realizojnë.

Planin të gjithë e realizojnë, por shitoret janë bosh.

Shitoret janë bosh, por tryezat janë plot.

Tryezat janë plot, por askush s'është i kënaqur.

Askush s’është i kënaqur, por ama të gjithë votojnë “pro”.

Tatjana Litvinova

Mesi viteve 1970. Unë jam nxënëse, jetoj në Pjatigorsk. E mbaj mend si tani. Pjesën dërrmuese të fëmijërisë sonë sovjetike e kemi kaluar bashkë me prindërit, duke mbajtur radhë para shitoreve të produkteve ushqimore. Fëmija, për një sërë arsyesh, ishte e domosdoshme të zinte radhë. Së-pari, në qoftë se ndonjë produkt ushqimor ishte i pamjaftueshëm dhe, papritur, dilte në shitje, si, fjala vjen, gjalpi, lajmi përcillej gojë më gojë në mbarë rajonin dhe para shitores njerëzit rreshtoheshin në një radhë të gjatë. Duke mbajtur radhën, njerëzit mundoheshin të blenin sa më shumë, për të mbushur frigoriferët, për të mos zënë më radhë për njëfarë kohe. Dhe prandaj fëmijët ishin të domosdoshëm në radhë, për të ndihmuar prindërit në mbajtjen e torbave. Së-dyti, në një tjetër banak të shitores qëllonte që nxirrnin në shitje një tjetër produkt ushqimor, prandaj duhej zënë një tjetër radhë dhe fëmija përsëri duhej marrë me vete.

Anastasia Fjodorova

Novosibirsk. Gjysma e dytë e viteve 1980. Njerëzit kanë zënë radhë për produktet bazë. Isha 8-10 vjeçe. Prindërit më dërguan në shitore për të blerë një copë djathë dhe pak gjalpë.

Aleksej Llomakin

Moskë. Ishte mesi i viteve 1980. Një radhë para ushqimoreve e zinin vetë prindërit, në një tjetër radhë vendosnin fëmijët, të cilët ndiqnin me sy prindërit. Ja, pikërisht në një radhë të tillë, gjyshja ime pësoi infarkt.

Aleksandër Shepctov

Perm. Në mëngjes mua më kishte vënë gjumi poshtë. Në orën 8 hapej bulmetorja. Radhë e gjatë njerëzish. Duhej ardhur herët. Prindërit kishin shkuar në punë. Motra e madhe – në shkollë. Në mbrëmje qumësht s’ke ku gjen.

Ana Jushkjeviç

Kiev. Viti 1961, dimër, janar, dhëborë. Ora 5:30 e mëngjesit. Errësirë dhe acar. Dhe unë me mamane nisemi për të blerë bukë në bodrum, në rrugën Iskrovskaja. Duhej të zinin radhë. Unë isha 6 ose 7 vjeçe. Dhe mamaja më mori me vete

për të blerë dy bukë. Se asokohe të jepnin vetëm nga një bukë...

Anekdote

Takohen socializmi, komunizmi dhe kapitalizmi. Dikush, papritur, kalon pranë me vrap dhe bërtet:

– Në shitoren matanë qoshes njerëzit kanë zënë radhë. Po shitet sallam.

Socializmi nisat me vrap. Kapitalizmi pyet:

– Ç’do të thotë fjala radhë?

Ndërhyn me pyetje edhe komunizmi:

– Ç’do të thotë fjala sallam?

Në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i cili i zhvilloi punimet prej 17 deri më 31 tetor 1961, Nikita Hrushovi pati deklaruar:

“Me afrimin e viti 1980, në Bashkimin Sovjetik do të ndërtohet komunizmi dhe brezi i sotëm do të jetojë në komunizëm”. Dhe propaganda sovjetike u binte teneqeve në të gjitha udhëkryqet e vendit, duke u shpjeguar qytetarëve ndryshimin mis parimit socialist dhe parimit komunist të jetesës: “në socializëm njerëzit jetojnë sipas parimit: secili sipas mundësive, secilit sipas punës. Kurse në komunizëm, si faza më e lartë e zhvillimit shoqëror, njerëzit do të jetojnë sipas parimit: secili sipas mundësive, secilit sipas nevojave”.



Se çfarë “komunizmi u ndërtua” në Bashkimin Sovjetik, u duk fare qartë në sytë e mbarë botës

- **Në Kongresin XXII të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, i cili i zhvilloi punimet prej 17 deri më 31 tetor 1961, Nikita Hrushovi pati deklaruar:**
- **“Me afrimin e viti 1980, në Bashkimin Sovjetik do të ndërtohet komunizmi dhe brezi i sotëm do të jetojë në komunizëm”. Dhe propaganda sovjetike u binte teneqeve në të gjitha udhëkryqet e vendit, duke u shpjeguar qytetarëve ndryshimin mis parimit socialist dhe parimit komunist të jetesës: “në socializëm njerëzit jetojnë sipas parimit: secili sipas mundësive, secilit sipas punës. Kurse në komunizëm, si faza më e lartë e zhvillimit shoqëror, njerëzit do të jetojnë sipas parimit: secili sipas mundësive, secilit sipas nevojave”.**
- **Se çfarë “komunizmi u ndërtua” në Bashkimin Sovjetik, u duk fare qartë në sytë e mbarë botës në fundin e viteve ’80 dhe fillimin e viteve ’90 të shekullit që kaloi, kur ai mori tatëpjetën përfundimisht.**

në fundin e viteve ’80 dhe fillimin e viteve ’90 të shekullit që kaloi, kur ai mori tatëpjetën përfundimisht.

Frederik Kemp (Frederick Kempe – 1954), gazetar amerikan, komentator radioteleviziv, është autor i librit me titull “Berlin 1961: Kennedy, Khrushchev and the World’s Most Dangerous Place” (Berlin 1961. Kenedi, Hrushovi dhe vendi më i rrezikshëm në botë)”, të botuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në vitin 2011. Në kreun e 7-të të atij libri, ai përshkruan takimin e ambasadorit amerikan në Bashkimin Sovjetik Tomson (Llewellyn Thompson – 1904-1972) me Hrushovin. Takimi që zhvilluar në Siberi, në qytetin e Novosibirskut, më 09 mars 1961. Në atë takim, në të cilin biseda që vërtitur rreth Berlinit dhe Gjermanisë Perëndimore, Hrushovi i pati deklaruar ambasadorit Tomson:

“... Bashkimi Sovjetik në vitin 1965 do t’ia kalojë Gjermanisë Perëndimore në prodhimin e mallrave për frymë të popullsisë, kurse pesë vjet më vonë do t’i lërë prapa edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës”.

Kjo ishte një deklaratë paradoksale e Hrushovit, për arsye se autori i librit, duke u ndalur në deklaratatë të tilla, të cilat Hrushovi i nxirrte si simitet nga furra poshtë e përpjetë nëpër Bashkimin Sovjetik, se, demek, do ta fituakej garën ekonomike me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, citon edhe anekdotat që qarkullonin asokohe mes njerëzve sovjetikë. Aty ai përmend dy të tilla:

E para:

Pyetje: Çfarë kombësie kishin Adami dhe Eva?

Përgjigje: Ata ishin rusë.

Pyetje: Po pse jeni i këtij mendimi?

Përgjigje: Sepse vetëm rusët mund të vrapojnë zbathur dhe me prapanicën të zbuluar, pa një strehë ku të futin kokën, të hanë një mollë dy veta dhe të bërtasin se jetojnë në parajsë.

E dyta:

Presidenti Xhon Kenedi shkoi te Zoti dhe e pyeti:

– Më thuaj, o Zot, pas sa vjetësh populli im do të jetë i lumtur?

– Pas pesëdhjetë vjetësh, – iu gjegj Zoti.

Kenedi filloi të qante dhe u largua.

Presidenti De Gol shkoi te Zoti dhe e pyeti:

– Më thuaj, o Zot, pas sa vjetësh populli im do të jetë i lumtur?

– Pas njëqind vjetësh, – ia ktheu Zoti.

De Goli filloi të qante dhe u largua.

Hrushovi shkoi te Zoti dhe e pyeti:

– Më thuaj, o Zot, pas sa vjetësh populli im do të jetë i lumtur?

Zoti filloi të qante dhe u largua.

Më 04 korrik 1958, Nikita Hrushovi mbajti një fjalim para punëtorëve të uzinës “Kirov” në Leningrad. Aty, ai, midis të tjerave, deklaroi:

– Ne, shokë, së shpejti jo vetëm do t’ia arrijmë, por edhe do t’ia kalojmë Amerikës.

Ndërhyn një punëtor nga turma:

– Që t’ia arrijmë Amerikës, ne, Nikita Sergejeviç, jemi dakord. Vetëm se për t’ia kaluar nuk do të ishte e nevojshme.

– Po pse? – e pyeti Hrushovi.

– Sepse do të na shikojë prapanicën lakuriq!

TRAJTESË

Referuar konceptit të NATO-s dhe përvojës personale në terren

ROLI I MEDIAS NË OPERACIONET E MBËSHTETJES SË PAQES



Nexhbedin Basha

Gazetar & Poet, Major në rezervë

Hyrje

Forcat e Armatosura janë pjesë e pandashme e shoqërisë dhe veprimtaria e tyre, veçanërisht në operacionet e mbështetjes së paqes, është vazhdimisht nën vëzhgimin e medias. Në realitetin bashkëkohor, media nuk është më vetëm një pasqyrë e ngjarjeve, por një faktor aktiv që ndikon drejtpërdrejt në perceptimin publik, legjitimitetin e misioneve dhe në vetë suksesin ose dështimin e operacioneve ushtarake. Këtë realitet e kam përjetuar jo vetëm si gazetar, por edhe si oficer në shërbim dhe më pas si pjesëmarrës në misione ndërkombëtare, ku fjala, imazhi dhe heshtja kanë pasur shpesh po aq peshe sa arma.

Siç e theksonte Henri Kissinger gjatë Luftës së Vietnamit: “Dikur ambasadorët më pyesnin se çfarë duhet të bënin; sot më pyesin se çfarë duhet të thonë.” Ky vlerësim mbetet thelbësor edhe sot dhe shpjegon pse komunikimi publik është kthyer në një element strategjik të politikës, diplomacisë dhe operacioneve të mbështetjes së paqes. Përvojat personale në Shqipëri gjatë krizave të tranzicionit, në raportimet nga ngjarje të ndjeshme kombëtare dhe në misione jashtë vendit, më kanë bindur se keqmenaxhimi i informacionit shpesh prodhon dëme më të rënda se një dështim taktik në terren.

Media dhe ushtaraku: subjekt dhe objekt i informacionit




Ushtaraku modern është njëkohësisht objekt dhe subjekt i medias. Ai jo vetëm vëzhgohet, por edhe komunikon, shpesh pa qenë i përgatitur për peshën e çdo fjale. Gjatë përvojës sime si gazetar dhe më pas si oficer, kam parë se vështirësitë në përballjen me median nuk lidhen vetëm me mungesën e karizmës apo autoritetit, por me mungesën e një kulture komunikimi institucional dhe personale. Raste si kriza shqiptare e vitit 1997, shkatërrimi i strukturave ushtarake apo tragjedia e Gërdecit treguan se, në mungesë të një komunikimi të qartë dhe profesional, përgjegjësia publike përqendrohet shpejt dhe shpesh padrejtësisht mbi Forcat e Armatosura. Këto përvoja e bëjnë të domosdoshme rolin e këshilltarëve për median, strukturave të marrëdhënieve me publikun dhe përgatitjen sistematike të eprorëve për daljet publike. NATO e konsideron këtë aspekt si pjesë përbërëse të komandimit dhe kontrollit, ku komunikimi nuk është shtesë, por komponent operativ.

Media e sotme në zonat e operacionit

Në realitetin aktual, media nuk kufizohet më te gazetari i akredituar apo televizioni tradicional. Media sot përfshin mediat ndërkombëtare dhe kombëtare, portalet online, rrjetet sociale, organizatat joqeveritare, si dhe vetë civilët dhe ushtarët

e pajisur me telefona inteligjentë. Çdo dëshmitar okular mund të transmetojë një incident në kohë reale dhe ta kthejë atë në ngjarje strategjike brenda minutash. Në misionet ku kam qenë i përfshirë, kam kuptuar se kontrolli i informacionit nuk do të thotë censurë, por aftësi për të komunikuar shpejt, saktë dhe me përgjegjësi. Në mungesë të këtij reagimi, boshllëku informativ mbushet nga burime alternative, shpesh të pasakta ose të qëllimshme në dezinformim.

Media si armë ndikimi



Historia e konflikteve tregon se media është përdorur gjithmonë si armë ndikimi. Sot, me teknologjinë satelitore dhe rrjetet globale, ajo është kthyer në një element vendimtar të luftës moderne. Shprehja se “fjalët janë armët e reja” merr kuptim të plotë në operacionet e mbështetjes së paqes, ku legjitimiteti moral është po aq i rëndësishëm sa kontrolli i terrenit.

Abraham Lincoln dhe Thomas Jefferson e kuptuan herët fuqinë e informacionit në demokraci, ndërsa doktrina moderne e NATO-s e trajton median si “force multiplier”, por edhe si rrezik operacional nëse nuk menaxhohet siç duhet.

Media, lufta në zona të banuara dhe incidentet fatale

Operacionet e mbështetjes së paqes zhvillohen kryesisht në zona të banuara, në mjedise komplekse urbane dhe multietnike. Çdo veprim ushtarak kryhet nën vëzhgim të vazhdueshëm dhe çdo incident fatal, qoftë ndaj ushtarëve apo civilëve, merr menjëherë përmasa strategjike në momentin që pasqyrohet nga media. Përvoja ime në raportim dhe në shërbim më ka treguar se një incident i vetëm i keqmenaxhuar mediatikisht mund të dëmtojë besueshmërinë e një misioni të tërë. Në Bosnje, Kosovë, Afganistan e më gjerë, është dëshmuar se fiton jo domosdoshmërisht

ai që kontrollon terrenin, por ai që kontrollon narrativën.

Gaza dhe Ukraina: mësimet për operacionet e mbështetjes së paqes

Lufta në Ukrainë dhe konflikti në Gaza përfaqësojnë laboratorë bashkëkohorë të rolit të medias në konflikt. Në Ukrainë, përdorimi i koordinuar i medias dhe rrjeteve sociale ka krijuar një narrativë të fortë rezistence, duke ndikuar drejtpërdrejt në mbështetjen ndërkombëtare. Media këtu ka funksionuar si shumëfishues force dhe mjet strategjik. Në Gaza, media vepron në një mjedis ekstremisht të ndjeshëm, ku humbjet civile dhe shkatërrimi urban transmetohen në kohë reale. Në këtë rast, media shpesh shndërrohet në fushëbetejë narrativesh, ku emocioni, imazhi dhe interpretimi mbizotërojnë mbi analizën faktike. Këto dy raste tregojnë qartë se, për operacionet sipas konceptit të NATO-s, menaxhimi i informacionit është po aq i rëndësishëm sa menaxhimi i forcës.

Media si faktor sukcesi ose dështimi

Kur media bashkëpunon në mënyrë profesionale me strukturat ushtarake, rritet besimi i popullsisë lokale, shmangen tensionet dhe forcohet mbështetja politike. Në të kundërt, mungesa e transparencës dhe komunikimit të qartë mund të çojë në diskreditim të misionit, ulje të mbështetjes publike dhe deri në tërheqje të kontingjenteve.

NATO e trajton këtë realitet përmes komunikimit strategjik, strukturave të marrëdhënieve me publikun dhe bashkëpunimit civilo-ushtarak (CIMIC), duke synuar ruajtjen e legjitimitetit politik dhe moral të misioneve.

Përfundim

Në operacionet e mbështetjes së paqes, media nuk është më vetëm dëshmitare e ngjarjeve, por aktor operacional më vete. Përvoja ime si gazetar dhe si oficer më ka bindur se paqja nuk ndërtohet vetëm me armë, por edhe me fjalë, imazhe dhe besueshmëri. Sipas konceptit të NATO-s, fitorja strategjike arrihet atëherë kur operacioni jo vetëm realizohet ushtarakisht, por edhe kuptohet, pranohet dhe mbështetet nga opinioni publik.

Në këtë kuptim, menaxhimi profesional i medias është një domosdoshmëri strategjike dhe një nga sfidat kryesore të paqeruajtësit modern.

REÇENSA

“DIELLI NË MËRGIM” DHE ANI WILMS NJË DIELL QË PO LIND NË LETËRSINË TONË




SHPENDI TOPOLLAJ

Historia e mbrojtjes dhe shpëtimit të hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore nga ana e popullit tonë, atëherë kur kjo ishte një gjë me rrezik të madh është e njohur edhe ndërkombëtarisht. Humanizmi dhe guximi i treguar si nga njerëzit e thjeshtë ashtu dhe nga ana e qeverive që zëvendësonin njëra - tjetrën, me të drejtë na bën të ndihemi krenar. Por përfytyrimi ynë të këto ngjarje, mbështetur kryesisht në kujtime sporadike apo mirënjohja e vetë dëshmitarëve hebrenj që i përjetuan ato, ka ndalur të strehimi, fshehja, ushqyerja apo pajisja me dokumente false e tyre. Dhe askush nuk është përpjekur të përshkruajë imtësisht, si kohën, ashtu edhe gjendjen emocionale, psikologjinë, mentalitetin, solidaritetin, respektimin e riteve e praktikave zakonore e fetare, vuajtjet, përpjekjet për mbijetesë, dëshirën për punë e kulturë në çdo rrethanë, mbajtjen gjallë të shpresës, zhgënjimet apo dhe ruajtjen e dinjitetit të vetë hebrenjve.

Kështu që tabloja e këtij momenti, nisur qysh kur hebrenjtë, me intuitën e mprehtë nga ndjekjet e përndjekjet e pafundme, i besuan gojëdhënës, se “kushdo që kapërcen kufirin dhe ia del të hyjë në Shqipëri, është i shpëtuar”, ka qenë disi i cunguar. Dhe ja ku vjen vajza e miqve të mi të hershëm e të respektuar, mjekëve Dezdemona dhe Bashkim Habibi, shkrimtarja Ani Wilms,

me romanin e saj voluminoz “Dielli në mërgim”, botim i “Dudaj”, dhe me një talent të rrallë dhe saktësi të mahnitëshme e plotëson mjeshtërisht këtë peizazh. Këndvështrimi i kësaj autoreje për strukturimin e këtij romani është krejt i veçantë.



Ajo, në njëzet kapituj dhe njëqintedyzetedy nënkaptuj i përcjell lëvizjet dhe qëndrimet e personazheve të saj në sfondin e madh dhe shumë të ngarkuar të momentit, pra qysh kurse Shqipëria u pushtua e deri pas vendosjes së të ashtuquajturit pushtet popullor. Në të dy kahjet, ka një intensitet ndodhish, me të papritura, kthesa e befasisira të çuditshme, si dhe përthyerje karakteresh, opinionesh e qëndrimesh të aktorëve të rëndësishëm apo kalimtarë. Në dukje, gjithçka vërtitet rreth Josef Jakoelit, një njeri paqësor që ndihet sa hebre aq edhe shqiptar. Ai e do shumë familjen e tij, por po aq edhe shqiptarët. Beson në ideale dhe vetë është njeri i ndershëm. Bukurinë e jetës e sheh te puna, te shkolla, te muzika, te filozofia, te libri. Ndaj dhe lexon pareshtur Shopenhauer-

in, Balzakun, Çehovin, Haidegerin dhe Frojdin, dhe di ta çmojë miqësinë, si e gjithë familja e tij. Jo më kot Ungj Mateo u drejtohet vlonjatëve të pranishëm me fjalët: “Miqësia juaj peshon për ne më shumë se floriri. Një jetë pa miqësi është gjëja më e trishtë në botë”. Kjo është edhe arsyeja përse zoti Kurti në emër të Këshillit Bashkiak u drejtohet atyre: “Vëllezërit e mi hebrenj! Ky qytet ju admiron për fuqinë dhe durimin tuaj. Ju jeni nga ata që edhe mund të përkulen, por asnjëherë nuk thyhen”. Hebrejtë kudo që i përplasi fati, nuk ndenjen duarkryq. Ata e gjenin mundësinë që me djersën e ballit ta përballonin jetesën e tyre. Edhe familja e Josef, qysh nga babai i tij Rafaeli, kishin ngritur tregtinë e manufakturës me emrin “Levi & Jakoel” si në Vlorë, ashtu dhe në Durrës. Josefi punonte, por edhe mezi i priste takimet me intelektualë, dhe lumturohej me bisedat me doktorin Quandt, të cilin e quante mentorin e tij. Formimi i tij e kishte shpënë në përfundimin se “Kultura është diçka që i jep një ndjesi pavdekësie atij njeriu që e kupton. Sepse ajo krijon një lidhje mes realitetit shqisor dhe të mbinatyreshmes”. Por ja që shpesh realiteti i egër e bën krejt të pafuqishëm si perceptimin, ashtu edhe vetë qëndrimin ndaj ndaj tij. Se po të ishte për mbivlerësimin dhe fetishizimin e kulturës dhe ndikimin e saj në jetën e përditëshme, nuk kishte pse populli gjerman, me shpikjen e tij, ideologjinë naziste, t’i shkaktonte aq e aq dhimbje e vuajtje të papërshkrueshme një populli tjetër, po ashtu mjaft të kulturuar, siç ishin hebrenjtë, të cilit i shkaktoi jo pak, por plot gjashtë milion viktima.

Natyra njerëzore është e çuditshme; edhe doktori nuk e shpjegon përse edhe “shqiptari nuk e kupton dot, madje i vjen keq, se përse këto dy kombësi të admirueshme, gjermanët dhe hebrenjtë, të jenë të armiqësuar me njëri - tjetrin”. Nga kjo, mesa duket Josefi sheh ëndrra me ulërima tmerri dhe kur e pyet doktorin, ai i përgjigjet si psikolog që është se “...lufta vjen nga brenda... Orteku i maktheve dhe tmerreve merr përpara trutë e njerëzisë dhe i varros nën vete. Njerëzit rezistojnë për një fare kohe, por pastaj dorëzo-

hen dhe tmerri u pushton shpirtat. Ky është burimi i gjithë luftërave: dhimbjet e ngërçet e padurueshme që shtynjë njerëzit deri në pragun e çmendurisë. Kjo është arsyeja që ata ngrihen e bëjnë pastaj gjëra që në kushte normale s’do i bënin kurrë. Vdekja në këtë rast shërben si rrugëdalje, si shpëtim, si kapak floriri”. Dhe ai përfundon se “...tërbimi dhe dhimbja rriten derisa e mundin arsyen. Deri sa vjen çasti që njeriu e harron se ç’është arsyeja”. Dhe kur Rafaeli mbron mendimin se duhet ndihmuar Lëvizja Nacional - Çlirimtare që lufton pushtuesin, i pavendosuri Mateo, sjell fjalën e urtë se “erën nuk e kthen dot, por velat po”. E vërteta është se në këto situata bashkësia hebreje është e çoroditur. Ata mbledhen e diskutojnë rregullisht për qëndrimet që duhet të mbajnë dhe përgjithësisht janë për ta mbështetur me gjithçka mundin rezistencën e djemve dhe vajzave që kanë dalë malit.

Edhe vetë Josefi bashkohet me ta dhe shërben te ai manastiri ku drejton prifti patriot që e thërrisnin Papa Theodhosi. E sheh nga afër guximin e sakrificat e partizanëve dhe partizaneve, ku ishin përfshirë edhe ato bukuroshet delikate të kursit të baletit që dikur e drejtonte Miriam. Ama, kjo nuk do të thotë se edhe midis vetë shqiptarëve, nuk ndikon kjo çoroditje; ata me bindjen se po luftojnë armikun e jashtëm, ndahen në komunistë, ballistë dhe legalistë. Pastaj, lufta për parësi e pushtet i hedh kundër njëri - tjetrit. Ky është dhe momenti më i vështirë për ta trajtuar, për autoren e këtij romani. Por Ani Wilms, me një zgjuarsiri dhe paanësi të pandeshur më parë, as historikisht dhe as artistikisht, nuk gabon askund në zgjidhjen e këtij rebusi, të nisur qysh nga e famshmja Marrëveshje e Mukjes, që na ka zënë për fyti e s’po na lëshon, prej tetëdhjetëepesë vitesh. Ja, Zaho Panari, me partizanët, piktori Lazar, me nacionalistët, e mira Aulona që aq shumë e dashuronte në heshtje Zahua, e cila vetëm përhap libra e kulturë te Librari Gega, kjo vajzë e një atdhetari të shquar, ankohet se po e shohin si armike, dhe ndëshkohet nga gjyqet e analfabetëve se donte të konkuronte në zgjedhje me një parti të re, Kaninët janë stepur, miqtë

e Kavajës, familja e Shyqyri Myrtos, që e kishin mbajtur si birin e tyre Josefin e kishin pësuar, dhe Kurti përfundon keq, për nipin, Adrianin.

Kjo situatë që solli këtë përçarje, natyrisht që lë mbresa të mëdha te Josefi, dhe trondit bindjet e tij. Dhe kur sheh se ligjet e reja që në nxitim e sipër, përpiluan fitimtarët, e prekën edhe familjen e tij, pa as më të voglin faj, por dhe pa asnjë mëshirë e mirënjohje, për më tepër që edhe i kishin ndihmuar ata, pashmangësisht vjen zhgënjimi. Burgosje të pasanikëve hebrenj, konfiskim pasurie, taksa mbi fitimin e jashtëzakonshëm gjatë luftës, dorëzim deri me tortura të florinjve, kishin dalë në rend të ditës, ashtu siç kishte parë plot intelektualë e nacionalistë të pushkatuar rrugëve nga vëllezërit e një gjaku. Jakoelevë, si shumë të tjerëve, pasi iu shkatërrua biznesi, iu morën edhe shtëpitë. Familjes së Josefit, përveç babait dhe të afërmëve që ia burgosën, i morën gjithë ç`kishin dhe i degëdisën në mjerimin e një kasolleje.

Tani, askush nuk i ndihmonte dot, qofshin ata dhe nga miqtë e dikurshëm. Njerëzit ishin tjetërsuar dhe spiunët gëlonin ngado. I trembur ishte dhe vetë Zaho që pasi ishte plagosur rëndë atje në mal, tani kishte një farë funksioni, ai Zaho që dikur e konsideronte vëlla dhe i quanin si vëllezërit Dioskurë, Kastori dhe Polluksi. Mesa dukej edhe në jetën e vërtetë, me ta po ngjiste njësoj si në mitologji, ku pasi Kastori u vra nga Linkeu dhe ky nga Polluksi, duke qenë se njëri ishte i vdekshëm dhe tjetri jo, Zeusi iu përgjigj lutjes, duke i vendosur në mes të yjeve, me emrin Binjakët, por kur njëri shfaqej, tjetri fshihej, pra nuk shiheshin kurrë. Josefi habitet sesi ndryshuan gjërat dhe njerëzit kështu. Ai ishte rritur mes murgjëve në Janinë dhe dikur komunizmi ia kishte ngrohur zemrën, por kishte filluar të ftohej me të kur shihete se shokët atje në Moskë u kërkonin të rinjve të gënjenin dhe të vidhnin etërit e tre për të financuar lëvizjen. Dhe paskej pasur të drejtë: Si ishte e mundur që ata vlonjatët e mirë e mikpritësa, tani rrinin pas dyerve të gjyqeve, dhe duke dëgjuar ato broçkullat që dilnin nga altoparlantët, ulërinin “Armiqtë, në litar!” Në libër thuhet: “Vlora e

mençur ishte zhdukur nga faqja e dheut, kishte mbetur vetëm ajo e marra”. Paskej pasur të drejtë Aulona e Gegajve kur i thosh atij se: “Kush djalin është Enver Hoxha? E dëgjove atë fjalim që mbajti? Si lehje qeni, më keq se Mussolini. Një dështak universitar, një injorant province me delir madhështie, ja kush është”. Ishte lodhur kot Aristoteli të gjente mbretin e mirë, pavarësisht emrit; perandor, president, duçe, fyhrrer apo sekretar i parë. Po çkallmohej gjithçka ishte ngritur me aq mund, me arsytimin se do të ndërtonin botën e re. U pa se tipari kyç i revolucionit qenka deliri i shkatërrimit.

Gjithçka po shkonte drejt Jugosllavisë e Stalinit, se tani ata po e bënin ligjin dhe nuk qenë të pakët të tjerët që shpresonin te ndërhyrja e Perëndimit e kryesisht e Britanikëve. Por, aha... Nga ana e tyre, familja e Josefit, edhe atje në ftohtësinë e kasolles me mure me vrime, respektonte ritualet e hebrenjve dhe, lumturohej se pasi kishin ndrequr radion, do dëgjonin me zë të ulët muzikën e drejtorit të teatrit Skala, Arturo Toskaninit (1867 - 1957), me zërin e Tancredi Passeros dhe Renata Tebaldit. Dhe përfundimi: Josef Jakoeli, të cilit tani shokët dhe miqtë i largoheshin, me keqardhje shpreh bindjen se “Shqipëria është bërë një burg i madh nën qiell të hapur”. Dhe i vetmi ngushëllim në këtë valle të madhe të popujve, siç e quante doktori, mbetej ta pranonte katastrofën si çast historik, në vend që ta linte veten të dërrmohej shpirtërisht prej saj.

Nuk mund të rri pa përmendur faktin se Ani Wilms, ia shton vlerat librit dhe e bën tërësisht të tërheqës, të këndshëm dhe të besueshëm atë, duke na i dhënë me imtësinë më të madhe dhe duke na i përshtuar sikur të ishte vetë hebrenj, festat e tyre apo ditët e shënuara që ata praktikonin. Pa asnjë mëdyshje, mendoj se ky roman i bën nder letërsisë tonë dhe do të zërë pa tjetër një vend të rëndësishëm në gjerdanin e artë të romanit shqiptar. Gjithashtu, na paralajmëron se një prozatore me të ardhme të ndritur po duket andej nga Dielli lind!

ESSE

NËNA MIHANE LUSHI, DHIMBJA QË U BË DINJITET, SAKRIFICA QË U BË LIRI




Akademik Rajmonda Maleçka

Historia e një kombi nuk shkruhet vetëm me data, harta dhe traktate, ajo shkruhet, mbi të gjitha, me jetët e njerëzve të thjeshtë që u bënë shtylla të mëdha morale në çastet më të errëta të historisë. Në historinë e Kosovës, nëna shqiptare është një figurë që qëndron përtej simbolit, ajo është burim qëndrueshmërie, sakrifice dhe dinjiteti. Në këtë rrugëtim të dhimbshëm drejt lirisë, shumë nëna dhanë bijtë e tyre, por pak prej tyre mbartën një barrë aq të rëndë sa Nëna Mihane Lushi. Figura e saj nuk imponon veten me fjalë të mëdha, ajo nuk kërkon përmendore, as lavdi. Ajo qëndron në heshtje, si një plagë e hapur që nuk mbyllet. Dhimbja e saj u shndërrua në dinjitet, ndërsa sakrifica e saj u kthye në themel të lirisë. Nëna Mihane nuk është vetëm një nënë që humbi pesë bij, ajo është ndërgjegje e gjallë e një kombi që u çlirua duke paguar çmimin më të lartë njerëzor.

Në kulturën shqiptare, nëna është figura që mban shtëpinë, gjuhën, kujtesën dhe shpirtin. Ajo është ajo që pret, që lutet, që duron. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, kjo figurë mori përmasa tragjike dhe heroike njëkohësisht. Nëna shqiptare u bë dëshmitare e djegies së shtëpive, e ikjes së fëmijëve, e varrimit të bijve. Por ajo mbeti në këmbë, jo nga mungesa e dhimbjes, por nga forca për ta përballuar atë. Në këtë kontekst, jeta dhe fati i Nënës Mihane Lushi nuk janë vetëm histori personale. Ato janë pasqyrë e fatit kolektiv, ajo u bë nënë e pesë bijve që do të rriteshin në një tokë të robëruar, do të jetonin nën represion dhe, në

fund, do ta paguanin me jetën e tyre ëndrrën e lirisë. Ajo u bë dëshmitare e shuarjes së shtëpisë së saj, por jo e shuarjes së kuptimit të jetës.

Ky rrëfim nuk është thjesht një kronikë dhimbjeje, është një përpjekje për të kuptuar se si një grua e thjeshtë, pa armë dhe pa pushtet, u shndërrua në një figurë monumentale të qëndrësës morale. Si mundet një nënë të jetojë pasi ka humbur gjithçka? Çfarë e mban njeriun gjallë kur jeta i ka marrë gjithçka që kishte më të shtrenjtë? Përgjigjja gjendet në heshtjen e Nënës Mihane, në ecjen e saj të qetë përmes dhimbjes, në pranimin e fatit pa u thyer. Është një përpjekje për ta vendosur Nënë Mihane Lushi aty ku e ka vendin, në qendër të kujtesës sonë historike, jo si figurë e së kaluarës, por si mësim i përhershëm për brezat që vijnë. Sepse liria nuk është vetëm fitore ushtarake, ajo është, mbi të gjitha, trashëgimi morale.



Nëna Mihane Lushi vinte nga një trung i fortë dhe i lashtë shqiptar. Bijë e Sadriajve nga Lëbusha e Deçanit, ajo u rrit në një mjedis ku fjala burrërore, nderi i shtëpisë dhe besa ishin themele jete. Lëpusha nuk ishte thjesht vendlindje, ishte shkollë karakteri. Aty mësohej që toka nuk ishte

vetëm pronë, por amanet, dhe se familja ishte mburoja e parë e identitetit shqiptar.

Në këtë mjedis u formua shpirti i Nënës Mihane, që herët, ajo mësoi të durojë, të punojë dhe të mbajë peshë pa u ankuar. Jeta e grave në ato anë ishte e lidhur ngushtë me tokën, me shtëpinë dhe me rritjen e fëmijëve. Por mbi të gjitha, ajo ishte e lidhur me ruajtjen e dinjitetit familjar. Nëna Mihane u rrit duke dëgjuar histori që përcilleshin brez pas brezi, histori që flisnin për qëndresë dhe për mbijetesë në kohë të vështira.

Ajo e lidhi fatin e saj, në fisin Lushi, me një tjetër trung të njohur për qëndrueshmëri dhe ndershmëri. Shtëpia e saj u bë vatër jete, zëri i fëmijëve u përzie me punët e përditshme, ajo ishte nënë e përkushtuar, grua e shtëpisë, shtyllë e heshtur që mbante gjithçka në këmbë.

Pesë djemtë e saj ishin vazhdim i gjakut, i emrit dhe i ëndrrave të një familjeje shqiptare në Kosovë. Ajo i rriti me frymën e respektit, të punës dhe të dashurisë për atdheun. Nuk i mësoi urrejtjen, por as përluljen përballë padrejtësisë, ajo u mësoi se nderi nuk negociohet dhe se liria është vlerë që kërkon sakrificë.

Para se lufta të trokiste në portën e shtëpisë së saj, jeta e Nënës Mihane ishte e mbushur me përpjekje të zakonshme, por edhe me shpresë. Asgjë nuk e paralajmëronte se fati do ta zgjidhte atë për një provë kaq të rëndë, megjithatë, rrënjët e saj shpirtërore po përgatiteshin, pa e ditur, për të përballuar një dhimbje që do ta tejkalonte kufirin njerëzor. Pesë bijtë e saj u rritën nën syrin e një nëne që dinte të ishte e butë dhe e fortë njëkohësisht. Ajo u mësoi punën që në moshë të vogël, respektin për të tjerët dhe dashurinë për tokën ku kishin lindur. Në atë shtëpi, buka nuk ishte vetëm ushqim, por simbol i mundit të ndarë; sofrat ishin vend ku flitej pak, por kuptohej shumë. Nëna Mihane dinte të dëgjonte, dinte të heshtte dhe dinte të fliste vetëm atëherë kur fjala kishte peshë.

Jeta familjare nuk ishte e lehtë, varfëria, pasiguria dhe presioni i vazhdueshëm i regjimit serb ishin pjesë e realitetit të përditshëm. Megjithatë, ajo shtëpi nuk u shndërrua kurrë në vend frike. Nëna Mihane e mbante derën hapur dhe shpirtin të fortë. Ajo besonte se fëmijët duhej të rriteshin me ndjenjën e dinjitetit. Pesë djemtë ishin shtylla

të një shtëpie që mbahej më shumë nga dashuria se nga muret. Secili prej tyre kishte ëndrrat e veta, karakterin e vet, por të gjithë ishin të lidhur fort me nënën. Ajo ishte pika e kthimit për secilin prej tyre, vendi ku ktheheshin për fjalë, për këshillë, për qetësi. Nëna Mihane e dinte se koha ishte e trazuar, por si çdo nënë, shpresonte se stuhia do të kalonte pa i prekur bijtë e saj.

Në ato vite para luftës, shtëpia e Lushëve ishte një vatër shqiptarie. Aty ruhej gjuha, zakoni dhe ndjenja e përkatësisë. Edhe pse fjalët për liri shqiptoheshin me zë të ulët, ato ishin gjithmonë të pranishme në mendje dhe në zemër. Nëna Mihane nuk i nxiti bijtë drejt rrezikut, por as nuk i ndaloi të ishin vetvetja në një tokë që kërkonte guxim për të jetuar. Ajo nuk e dinte se po jetonte ditët e fundit të asaj qetësie të brishtë. Nuk e dinte se zërat që mbushnin shtëpinë do të shuheshin një ditë me dhunë. Por në mënyrën si i rriti, në vlerat që u la, ajo kishte mbjellë tashmë diçka që as lufta nuk do të mund ta shkatërronte: dinjitetin njerëzor, nënë e pesë djemve dhe 28 nipër e mbesa.

Mëngjesi i 14 majit 1999 erdhi i rëndë, sikur toka vetë ta parandiente atë që do të ndodhte. Qyshku, fshat i qetë pranë Pejës, u zgjua nën zhurmën e hapave ushtarake dhe nën hijen e një rreziku që nuk ishte i panjohur, por që atë ditë mori formën më të egër. Pas sulmeve të hershme në Pavlan dhe Zahaq, forcat e kombinuara ushtarake dhe paramilitare serbe u drejtuan me shpejtësi drejt këtij fshati shqiptar, me një plan të qartë shfarosjeje. Shtëpitë u rrethuan, zërat u shuan, gratë, fëmijët dhe pleqtë u nxorën me dhunë jashtë, nën kërcënimin e armëve, ndarja ishte e menjëhershme dhe e pamëshirshme, burrat u mbajtën mënjanë, ndërsa të tjerët u dëbuan. Në ato çaste, askush nuk kishte nevojë për shpjegime, Nëna Mihane u përball me çastin më të rëndë të jetës së saj, duke parë bijtë e saj të ndarë prej saj, njëri pas tjetrit, pa mundur t'i mbrojë, pa mundur t'i përqafojë për herë të fundit.

Ekzekutimi i meshkujve shqiptarë në Qyshk të Pejës ishte i planifikuar dhe i zbatuar me egërsi çnjerëzore. Dyzet e dy burra u pushkatuan dhe u masakruan barbarisht. Mes tyre ishin edhe pesë bijtë e Nënës Mihane: Avdullahu, Uka, Xhaferri, Skënderi dhe Ramizi. Ata u vranë jo për atë që kishin bërë, por për atë që ishin, shqiptarë në

tokën e tyre, pesë jetë u shuan në pak orë, pesë shtylla u rrëzuan njëkohësisht. Për Nënë Mihane, ajo ditë nuk ishte vetëm humbje e bijve, ishte shembje e botës. Çdo emër që u tha më pas ishte një plagë e re, çdo lajm ishte një goditje që e copëtonte shpirtin, por në mes të asaj dhimbjeje të paimagjinueshme, ajo nuk bërtiti, nuk u rrëzua, qëndroi, qëndresa e saj ishte e heshtur, por e pathyeshme.

Raportet ndërkombëtare, përfshirë ato të Human Rights Watch dhe American Radio Works, e kanë dokumentuar masakrën e Qyshkut si një krim të planifikuar dhe të ekzekutuar me qëllim terrorizimin dhe shfarosjen e popullsisë shqiptare. Por asnjë raport nuk mund ta përshkruajë plotësisht atë që përjetoi një nënë kur pa pesë djemtë e saj të shkonin drejt vdekjes. Historia mund të shkruajë numra dhe data, dhimbja e Nënës Mihane mbetet përtej fjalëve. Ajo ditë e zezë e shndërroi Nënë Mihane në simbol, jo sepse ajo e kërkoi këtë rol, por sepse dhimbja e saj përfaqësonte dhimbjen e një populli të tërë. Qyshku u bë plagë kombëtare, ndërsa Nëna Mihane u bë fytyra njerëzore e asaj plage, një nënë që humbi gjithçka, por që nuk e humbi dinjitetin.

Pas humbjes së pesë bijve, Nënë Mihane mori mbi supë përgjegjësinë e 28 jetimëve të tjerë, duke u bërë nënë, mbrojtëse dhe shpresë për ata që kishin humbur gjithçka. Shpirti i saj nuk njohu kufij, dhimbja u shndërrua në një forcë që mbajti gjallë jetën dhe dinjitetin për të gjithë ata që mbetën pa familje.

Masakra e Qyshkut nuk goditi vetëm një familje, ajo synoi shuarjen e një fisi të tërë, në të njëjtën ditë, përveç, pesë bijve të Nënës Mihane, ranë edhe anëtarë të tjerë të trungut Lushi, duke e kthyer atë 14 maj në një plagë të përbashkët, ku dhimbja individuale u shndërrua në tragjedi kolektive. Po atë ditë u vranë edhe Sefedin Haxhi Lushi dhe Osman Haxhi Lushi, bij të Nënës Hatmone. Humbja e tyre e dyfishtë ishte një tjetër goditje shkatërruese për familjen. Dy nëna, dy shtëpi, dy botë u shembën në të njëjtën kohë. Nëna Hatmone, ashtu si Nëna Mihane, u përballën me një dhimbje që nuk njeh masa njerëzore. Humbja e bijve nuk ishte vetëm humbje personale, por një goditje ndaj vazhdimësisë së jetës familjare.

Tragjedia mori përmasa edhe më të rënda me

vrasjen e Çausht Lushit dhe të djalit të tij, Arianit, babë e bir ranë së bashku, të bashkuar jo vetëm nga gjaku, por edhe nga fati tragjik. Vdekja e tyre simbolizon prerjen brutale të brezave, shuarjen e një vazhdimësie që duhej të ishte e natyrshme. Në atë ditë, jo vetëm njerëz, por edhe e ardhmja u vra. Kjo shfarosje e përqendruar në Qyshk të Pejës, dëshmon për qëllimin e qartë të dhunës që serbët, bënë në Kosovë, frikësimin dhe thyerjen e strukturës shoqërore shqiptare. Familjet ishin shtylla e rezistencës morale dhe shkatërrimi i tyre ishte një përpjekje për të shuar vetë shpirtin e komunitetit. Por ajo që ndodhi ishte e kundërta, dhimbja e përbashkët i bashkoi njerëzit, i bëri më të vetëdijshëm për çmimin e lirisë.

Në këtë sfond, figura e Nënës Mihane qëndron si qendër gravitacioni e dhimbjes. Humbja e pesë bijve u ndërthur me humbjen e të afërmeve, duke e kthyer shtëpinë e saj në simbol të një fisi të shuar. Megjithatë, edhe në këtë errësirë të plotë, ajo nuk u bë simbol thyerjeje, por dëshmi e qëndrueshmërisë njerëzore. Fisi Lushi u godit rëndë, por kujtimi i tij u bë pjesë e pandashme e kujtesës shqiptare.

Kur heshtja e armëve mbuloi Kosovën, shumë shtëpi qëndruan të shkatërruara, por pak qenë më bosh se ajo e Nënës Mihanës. Pesë djemtë e saj ishin zhdukur përgjithmonë, por ajo nuk u shkatërrua nga dhimbja. Ajo mbijetoi, dhe mbijetesa e saj ishte heroizëm i heshtur. Shtëpia bosh nuk ishte vetëm muret e rrënuara, ajo ishte vendi ku çdo hap, çdo zë i mungonte, ku çdo gjë i përkiste kujtimit dhe boshllëkut. Nëna Mihane jetoi me heshtjen që fliste më shumë se çdo fjalë. Kur fjalët nuk mjaftonin, ajo i lejonte lotët të rridhnin vetëm në heshtje, duke mos i treguar askujt brenngat e saj më të thella. Çdo ditë ishte një përballje me vetveten, një betejë e heshtur mes dhimbjes dhe përpjekjes për të qëndruar në këmbë. Për Nënë Mihane, mbijetesa ishte më shumë se një instinkt, ishte mision moral.

Ajo nuk u shndërrua në zë vajtimi, nuk lejoi që dhimbja ta përvetësonte shpirtin e saj. Përkundrazi, ajo e shndërroi dhimbjen në forcë të brendshme, në një përpjekje të vazhdueshme për të jetuar me krenari. Secili hap që bënte, çdo gjë që kujdesej, çdo kujtim që ruante, ishte një mënyrë për të nderuar jetën e bijve të saj. Nënë

Mihane u bë simbol i qëndrueshmërisë, ajo përballoi çdo ditë me vullnet dhe me dashuri jetën, edhe kur çdo gjë dukej e shuar. Mbijetesa e saj u bë mësim për komunitetin, duke treguar se edhe kur dhimbja është më e madhe se gjithçka, dinjiteti mund të mbetet i pacënuar.

Nëna Mihane nuk jetoi vetëm për veten, ajo ruajti kujtimin e pesë bijve të saj, u bë dëshmi e së kaluarës dhe simbol i krenarisë së një kombi. Heshtja e saj, shtëpia bosh dhe shpirti i pathyeshëm tregojnë se heroizmi nuk ka nevojë për armë, as për lavdi, por vetëm për fuqinë për të qëndruar dhe për të mbajtur gjallë kujtimin e dashurisë dhe sakrificës. Në atë stuhi lufte, Nënë Mihane nuk gjeti qetësi. Një plagë e re iu shtua dhimbjes, nipi i saj, Naim Lushi, u burgos në vitin 1998, në kulmin e represionit serb. Ai përjetoi dhimbjen e torturave dhe pse kishte plagë në trup, duke kaluar dhunën dhe padrejtësitë që ishin pjesë e përditshmërisë e shqiptarëve nën okupim. Për Nënë Mihane, burgosja e nipit ishte një tjetër provë mbi plagët e hapura. Çdo ditë ishte një pritje e vështirë, një betejë e heshtur mes shpresës dhe frikës. Ajo nuk mund të ndërhynte, nuk mund të shpëtonte të afërmin, por mund të lutej dhe të priste. Lutja e saj nuk ishte thjesht fjalë, por një shprehje e dashurisë që e lidhte me të gjitha brezat e familjes.

Në pritjen e saj të gjatë, ajo kujdesej për gjithçka rreth saj, duke u përpjekur që dhimbja të mos mbante peng jetën e përditshme, heshtja ishte e thellë dhe e plotë, një heshtje që flet më shumë se çdo fjalë. Ajo ruante shpresën se nipi do të kthehej i gjallë dhe i lirë, duke besuar se mbijetesa e tij do të ishte vazhdimësi e jetës që ajo kishte humbur me pesë bijtë e saj. Kur Naim u lirua në fund të nëntorit të vitit 2000, takimi i tyre ishte një çast që nuk përshkruhet me fjalë. Përqaftimi i gjyshes që kishte humbur bijtë e saj, por që në nipin shihte jetën që vazhdon, ishte një përzierje e dhimbjes, krenarisë dhe shpresës. Ishte dëshmi se sakrifica nuk shkoi kot, dhe se dashuria e nënës mund të mbijetojë edhe kur gjithçka tjetër duket e shuar.

Përqaftimi i tyre nuk ishte thjesht një akt fizik, ai ishte simbolik. Ai përfaqësonte mbijetesën e një fisi, krenarinë e një kombi dhe dinjitetin që nuk mund të thyhet nga dhuna. Për Nënë Mi-

hane, Naimi u bë pjesë e asaj force që i lejon të përballojë çdo ditë të ardhshme. Në shikimin e tij, ajo pa të kaluarën e dhimbshme, por edhe të ardhmen që ishte ende e mundur për të ndërtuar. Ky rikthim i jetës dhe shpresës u bë mësim për të gjithë komunitetin. Ai tregon se sakrifica dhe dhimbja nuk janë të kota, se edhe pas humbjes më të madhe, ekziston mundësia për të gjetur forcën për të vazhduar. Për Nënë Mihane, çdo ditë që vinte pas atij përqaftimi ishte një dëshmi se liria, dashuria dhe dinjiteti janë më të fuqishme se çdo dhimbje individuale.

Nëna Mihane Lushi sot nuk jeton mes nesh, por ajo nuk u zhduk, dhimbja dhe sakrifica e saj jetojnë përmes kujtimit të pesë bijve të saj, të nipit dhe të gjithë atyre që ranë për liri. Ajo është një kujtesë e gjallë për brezat e ardhshëm, një mesazh i qartë se liria, dinjiteti dhe dashuria nuk shuhet me vdekjen, por vazhdojnë të ndriçojnë përmes kujtimeve dhe përpjekjeve të atyre që mbeten.

Në amshim, nëna Mihane u bashkua me bijtë e saj – Avdullahun, Ukën, Xhaferrin, Skënderin dhe Ramizin, si dhe me të gjithë të afërmit që ranë në të njëjtën ditë të zezë: Sefedin dhe Osmanin, Çaushtin dhe Arianin, babë e bir dhe me të gjithë ata që i dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Nëna Mihane la pas një trashëgimi që nuk mund të shuhet, forcën e një nëne, guximin e një gruaje dhe krenarinë e një populli që nuk harron. Kujtimi i saj dhe i familjes së saj na bën krenarë dhe na detyron të jemi të vetëdijshëm për çmimin e lirisë, për të mbajtur gjallë historinë dhe për të transmetuar dinjitetin të brezat e rinj. Në këtë mënyrë, Nëna Mihane Lushi nuk do të jetë kurrë vetëm një emër në librat e historisë, por një frymë që udhëheq dhe një ndërgjegje që kujton: liria nuk blihet pa sakrificë, dhe dashuria nuk shuhet kurrë.


Kujtimi i nënës Mihane dhe i familjes Lushi na obligon të mos harrojmë kurrë çmimin e lirisë, të mbajmë gjallë historinë dhe të transmetojmë të brezat e ardhshëm mesazhin e guximit dhe të dashurisë së një nëne të pathyeshme. Në këtë mënyrë, ajo dhe bijtë e saj jetojnë përgjithmonë në zemrat tona, një bashkim i shenjtë që nuk mund të ndahet, një dritë që ndriçon përtej kohës dhe hapësirës.

OPINION

Një përvojë nga Amerika për “tapinë” e librit “Viza Amerikane”

E DREJTA E AUTORIT...

Shefqet MEKO – shkrimtar&publicist



Pak kohë më parë, shkrimtari Liridon Mulaj përcillte një shqetësim në lidhje me mbrojtjen e të drejtës së mendimit dhe pronësinë e autorëve. Natyrisht nuk është ndonjë gjë e re, as debat i pararhur në rrjetet sociale. Në rastin që përmend, autori Mulaj, një mbrojtës dhe lëvruer plot fantazi i artit dhe letërsisë së sotme, mundi të merrte një reagim ndaj atyre që “grabitën” idetë e tij, dhe kjo ishte një shenjë emancipimi.

Mendoj se mbrojtja e autorëve shqiptarë është, sipas meje, një “çështje e harruar”. Nuk jam shumë i informuar mbi sistemin ligjor që ekziston në Shqipëri për këtë temë, por më duket e udhës të sjell një rast konkret nga Amerika. Sipas ligjit të këtushëm, e drejta e autorit lind sapo një mendim hidhet në letër dhe ka “vulën” e vet: autorin. Por, në këtë shoqëri të lirisë dhe llojshmërisë së pafundme të kulturave dhe etnive, ka një institucion të posaçëm që i jep “tapinë” çdo mendimi dhe krijimi profesional. Në Librarianë e Kongresit Amerikan, ka një zyrë të posaçme që merret vetëm me këtë problem: dokumentimin e pronësisë intelektuale të çdo autori. (The United States Copyright Office-Zyra e të Drejtës së Autorit në Shtetet e Bashkuara).

Sapo kam mundur të regjistroj pranë këtij institucioni prestigjioz, të drejtën e autorit për novelën e përkthyer dhe botuar në Anglisht “The America Visa” (Viza Amerikane), duke marrë zyrtarisht edhe certifikatën në fjalë. Duke qenë se ishte libri im i parë botuar në Amerikë, unë punësova botuesin për të ndjekur këtë procedurë, që në fakt pagova

“si frëngu pulën” siç themi nga anët tona. Por kjo nuk është ajo që dua të flas, sepse jetojmë kohën që çdo gjë ka çmimin e vet, “merre ose lere”. Pra është zgjidhje e individit. Edhe pse procedura kaloi gati në “Kalendrat greke”, vura re një lloj këmbëngulje të pazakontë nga Zyra e Autorit, për të verifikuar çdo gjë. Edhe pse konfirmova se isha unë autori i novelës në fjalë, duke provuar me gjithshka, sipas ligjit, ata shënuan në certifikatë edhe tim bir, Jon Meko, i cili bëri përkthimin, duke kërkuar edhe një deklaratë prej tij që “nuk ishte autor” por përkthyes dhe i paguar për punën e kryer. Sikurse shihet në këtë dokument, përkthyesi ka marrë autorësinë e përkthimit, ndërsa pronësia mbi novelën si krijimtari është e imja. Kjo është një “tapi” e librit në fjalë, e cila gjendet në këtë institucion qendror amerikan, por që ka përjashtuar çdo gjë tjetër në përkatësitë e mia si autor shqiptar. Pra Zyra e Autorit në SHBA, ishte tmerrësisht këmbëngulëse që siç themi në “haka tek i zoti”, duke ndjekur një procedurë strikte. A ka një përpikmëri të tillë në Shqipëri? Kush realisht ndjek dhe inventarizon këto botime që, siç shohim, janë të panumërta dhe shtohen përditë. Pra a kemi edhe ne një institucion zyrtar që bën kujdes të jetë mburojë ligjore për autorët duke ruajtur pronësinë përkatëse nga plagjiaturat dhe grabitjet e mundshme? Po në Kosovë si funksionon e drejta e autorit? Me sa di në Tiranë çdo botues depoziton 5 kopje të autorit në Bibliotekën Kombëtare, por a është kjo e mjaftueshme dhe ligjërisht një mbrojtje e vërtetë?

Mbase postimi në fjalë është një shkëputje nga realiteti shqiptar, dhe nëse kështu, kërkoj ndjesë, por sidoqoftë, është mirë që gjithë këto libra dhe botime, të kenë një mbrojtje zyrtare dhe një procedurë, sikurse dëshmon shembulli Amerikan, sepse jetojmë “shekullin e hajdutërisë” në çdo drejtim. Zot na ruaj! Hodha një mendim duke sjellë një përvojë, i nxitur edhe nga shënimi më i hershëm i shkrimtarit Liridon Mulaj. Me siguri që Shqipëria ka një sistem ligjor që mbron botimet në shqip, por fati jonë shpesh varet nga ata që zbatojnë ligjet, sepse dihet batuta e shqiptare “Ligji dhe Maliqi...” Uroj të jem i gabuar në hamendjet e mia, por një debat i tillë ja vlen sipas meje.

VEPRA & AUTORË


Mbresa dhe mesazhe nga libri “Horizonti i ëndrrës amerikane” të Ahmet Prençit

E DUAM AMERIKËN, POR MË SHUMË SHQIPËRINË



Nga SAKIP CAMI

Shkrimtari Ahmet Prençi është mesazhepërçues në të gjitha krijimet e tij, në poezi, prozë dhe publicistikë letrare. Kjo veçori e tij nuk bën përjashtim as në librin e tij të fundit: “Horizonti i ëndrrës amerikane” me mbresa nga udhëtimi dhe vizitat në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Të dish t’u japësh mesazhe lexuesve në tërësi është një aftësi dhe mundësi që jo të gjithë e kanë. Por për shkrimtarin Ahmet Prençi kjo është dhunti, falë përvojës së madhe jetësore që ka patur ndër vite dhe përvojës letrare të suksesshme. Pas vizitave të punës si shtetar dhe drejtor i policisë së shtetit shqiptar, kjo vizitë tre javore ishte një vizitë ndryshe, vizitë për qef, i ftuar nga miku i vjetër gazetari dhe shkrimtari Shefqet

Meko, megjithatë, megjithëse shkante pas dhjetë vjetësh, doganieri amerikan, pasi i skanoi pasaportën, e priti me fjalët mikpritëse: “mirëse vini në ShBA zoti drejtor i policisë së shtetit shqiptar, njëkohësisht shkrimtari Ahmet Prençi ! Këtu duket dallimi, që një lexues dhe shqiptar i vëmendshëm e pikas që në krye të herës. Autori e nis librin me këto dallime midis dy shteteve, midis dy demokracive.

” Mund të them me bindje se në këtë epokë, në vendin tim, me gjithë përparimet e bëra, nuk ka udhëhequr në masën e duhur arsyeja shtetformuese. Drejtësia nuk ishte asnjëherë e balancuar. Ishte herë herë e fortë, herë herë e butë dhe herë herë e paaftë. Nuk u bë asnjëherë humane, bindëse, e qëndrueshme dhe e drejtë. Toleranca si forcë morale në këto situata u përbuz me shumë arrogancë. Ja, pra, në këtë situatë e me këto turbullira mendimesh e nisa këtë udhëtim.” Mirënjohja është një cilësi tjetër e shkrimtarit dhe njeriut të mirë Ahmet Prençi.

Që në faqet e para të librit ai shpreh mirënjohjen për redaktorin e gazetës lokale të Dibrës “Ushtima e Maleve”, gazetarin e njohur Kamber Faruku që ja botoi ciklin e parë me poezi, një cikël i shkruar me shkrim dore dhe dërguar me postë nga Reçi i Dibrës, cikël tek i cili redaktori i vëmendshëm K. Faruku dalloi tharmin poetik të poetit dhe të shkrimtarit të ardhshëm Ahmet Prençi, ndaj e pajisi këtë cikël me një shënim për tërheqje vëmendje të lexuesit. Gjithashtu ai shpreh mirënjohjen për mikun e tij të kahershëm, kryeredaktorin e gazetës “Studenti i bujqësisë”, gazetë ku Ahmeti botonte herë pas here, gazetarin dhe shkrimtarin shqiptaro-amerikan Shefqet Meko.

Ai nuk ngurron të shkruajë as për vështirësitë e shtypshkrimit me germa plumbi, as për ecjen në këmbë pas mezit të natës, pas shtypjes së gazetës, bashkë me Shefqetin, nga Poligrafiku (qendra botërore e bektashizmit) te lagja “Ali Demi” deri

te Universiteti Bu-
jqësor në Kamëz.
Çfarë sakrifice !
Kur e krahason
me ditët e sotme,
kur disa shkojnë
me veturë të mar-
rin bukën nga
shtëpia te furra e
lagjes. Le të kthe-
hemi te udhëtimi
magjik në disa
shtete të ShBA-së,
që siç shprehet



autori ishte diçka që shpesh, fjala nuk ka fuqinë ta rrëfejë. “Në Dakota u frymëzova nga gurët, që ruajnë kujtesën e një kombi. Në Arizona ndala frymëmarrjen para madhësisë së kanioneve. Në Nevada humba më dritat që duken të pavërteta. Në Teksas ndjeva gjurmët e historisë.

Dhe në Kaliforni e pashë jetën si një film që nuk do të doja të mbaronte.” Udhëtimi fillon nga Shqipëria në Minesota dhe vazhdon më tej në Dakotën e Jugut, në Utah, në Nevada, në Las Vegas, në Arizonë, në Teksas, në Dallas, në Misuri e Misisipi, në San Francisco, San Hose, El Granada, San Diego, Los Angelos, një ditë edhe në Kanada, plot tre javë udhëtime të këndshme me “Shevroletin” dhe shoferin në dispozicion, mikun për kokë Shefqet Meko. Nuk dua të zbuloj magjinë e këtij udhëtimi dhe përshkrimin me shpirt të autorit, por do të ja lë lexuesit që ta shijojë nga ky libër. Udhëtimi i vërtetë është ai që vazhdon të jetojë brenda nesh edhe pasi rruga ka mbaruar, shkruan autori Ahmet Prençi. Dhe ky libër, ky udhëtim e shoqëron lexuesin edhe pas mbarimit të keximit të librit.

VEPRA DINJITOZE E AHMET PRENÇIT E RENDIT ATË ME ELITËN KRIJUESË TË KOMBIT

Ahmet Prençi lindi në Dibër më 1968. Studimet e larta i kreu në degët Ekonomi dhe Drejtësi në Universitetin e Tiranës, si dhe studime e kualifikime pasuniversitare në Vjenë në vitet 2006-2007. Botimet e para letrare i pati që në rini në disa gazeta të kohës. Ka publikuar në vazhdim me dhjetëra artikuj, analiza dhe intervista në shtypin shqiptar dhe të huaj.


Prej vitit 1985 poezitë e tij janë botuar në gazetatat dhe revistat letrare të kohës. Është i pranishëm me opinione, analiza dhe intervista për mediat vendase dhe ndërkombëtare

Në vitin 2016 doli vëllimi me poezi “Udhë në pasqyrë”.

Ka botuar librat, “Udhë në pasqyrë” – përmbledhje poezish, “Artan Cuku in memoriam”, “Vice versa” -ese dhe publicistikë, “Anja” - roman. Është shpallur laureat i Çmimit të Karrierës ” Gjergj Fishta”, për romanin “Anja” - 2021.

“Anja” është një prej 10 veprave të vlerësuara nga Ministria e Kulturës për Çmimet e Letërsisë në vitin 2021. Romani “Anja”, është përkthyer dhe botuar edhe në Turqi.

Pas suksesit me romanin “Anja”, Ahmet Prençi vjen me romanin “Brenga e prokurorit”, një tjetër sage nga realiteti shqiptar, e ngjashme me mjedisin mafioz të Italisë së jugur. Rudolf Marku - Poet laureat, shkrimtar vlerësuar se “Romani “Brenga e prokurorit” është një dëshmi e epokës sonë në mjedisin social politik. Romani vjen me mjeshtërinë e stilit, gjuhës dhe kompozimit. E veçanta



më e madhe është se shkrimtari ka krijuar personazhin: Martin Guri që ndodhet në qendër të romanit, me dilemat dhe karakterin, të kujton personazhin e Franc Kafkës te “Procesi”, Jozef. K.

“Në emër të gjakut është një tjetër vepër letrare dinjitoze e shkrimtarit elite Ahmet Prençi. Nuk është thjeshtë letërsi por testament për brezat, kujtesa është përgjegjësi. Ahmeti e rrëfen atë me peshën dhe mjeshtërinë e fjalës. Është rrëfim letrar i ‘97’- tës nga një pjesëtar i drejtpërdrejtë i atyre ngjarjeve, i atyre që ranë në krye të detyrës. Ahmet Prençi i flet ndërgjegjes sonë kombëtare, e në kontekst kjo vepër vjen si ftesë për reflektim për të kuptuar se pa institucione të forta historia mund të përsëritet.

VEPRA & AUTORË


“DINASTIA DOMI E CERENIT TË KALASË SË DODËS”, NË PËRMASAT E NJË VEPRE ENCIKLOPEDIKE



Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

- Historia e familjes së atdhetarit që solli abetaren e parë nga Bukureshti dhe përhapri dritën e diturisë si mësuesi i parë i shkollave shqipe në krahinën e Lumës në librin e ish kryetarit të Shoqatës “Bijtë e shqipes” Filadelfia, Tajar Domi
- Ky trung familjar është i veçantë, pasi në të shohim të pleksen të gjitha gjenerratat, të arsimuar deri në nivelet më të larta. Nga 115 të shkolluar me arsim të lartë të kësaj familje ka një shpërndarje të tillë interesante, që duket se kanë “pushtuar” botën. Koncretisht në Shqipëri 36 persona, në Kosovë 30, në SHBA 17, në Angli 14, në Blegjikë 7, në Spanjë 4, Gjermani 3, Itali 2, Katar 1 dhe Kroaci 1. Midis tyre ka me tituj e grada shkencore, akademike e diplomatike...

Libri “Dinastia Domi e Cerenit të Kalasë së Dodës” është vlerësuar nga personalitete akademike dhe të letrave si një enciklopedi shumëvlerëshe, që për nga stilistika dhe for-



ma kompozicionale është krejt i veçantë. Sepse autori Tajar Domi (ish kryetar i Shoqatës “Bijtë e Shqipes” Filadelfia) ka trashëguar asetin fundamental të familjes së tij në tre breza dhe e ka treguar atë më së miri, gjer në detaje për të 115 personalitetet e kësaj dinastie.



Në të vërtetë, kur më besoi redaktimin e këtij libri nuk ngurova, si në ndonjë rast tjetër. Kjo për faktin se para dy vitesh, kur Tajari më dha të shkruar historinë e gjyshit të tij, Harunit, ndër të tjera mësova që, i integruar në shoqëritë patriotike të Bukureshtit, kur u kthye para një shekulli në vendlindje, ai nuk solli që andej ndonjë shumë të konsiderueshme parash, por solli abetaret për t’u mësuar fëmijëve të bashkëfsharëve të tij shkrim e këndim shqip.

I frymëzuar nga kjo histori e shkruar nga Tajari, që pas dy vitesh do të ishte lënda e letrarizuar bukur e këndshëm e këtij libri, unë atëherë ndër të tjera, shkrova dhe botova në të përditshmen më të madhe shqiptare “Panorama” se: “Atdhetarë të shquar si Harun Domi, mbetën pishtarë të dritës në altarin e lirisë së kombit. Kjo për faktin se ai solli në një krahinë si Luma emërndritur abetaret e Veqilharxhit, të cilat u përhapën dorë më dorë dhe u bënë pishtarë drite për shqiptarët dhe halë në sy për pushtuesit.”

Nisur nga përvoja ime gati 50 vjeçare lexi-

more shkrimore dhe readktoriale besoj se ky ka qenë dhe lajtmotivi i Tajarit në këtë sipëmarrje, sa të vështirë aq edhe të domosdoshme për të përçuar ndër breza amanetin e gjysh Harunit, dhe jo vetëm, por edhe të dy djemve të tij, Xhemalit e Shefqetit që shtruan më tej shinat e shkolimit, për të mbrritur sot në kuotën më të lartë të ndonjë familje të derisotme shqiptare – në 115 të diplomuar me arësim të lartë, me tituj e grada shkencore e akademike, si diplomatë, mësues, mjekë, financier, inxhinierë, etj, me kontribute evidente, jo vetëm në institucionet shtetërore e shoqërore të Shqipërisë, por pothuajse kudo në hapësirën mbarëshqiptare në botë.

Tajar Domi, ka meritën që si pasues i denjë i Harun, Shefqet e Xhemal Domit, me këtë libër të shkruar me kompetencë e profesionalizëm të spikaur prej shkrimtari, e ka ngritur në piedestalin që meriton emrin e familjes së tij.

Në portretet letrare të pothuajse 115 personave me arsim të lartë dhe me tituj shkencorë, akademik e diplomatik, në historitë e rrëfyera me një gjuhë të pasur e mjete shprehëse interesante, qoftë të veprimtarisë patriotike të gjysh Harunit..., të hallës Lulije (Alië Harun Domi-Krasniqi), që fati i rezervoi një fëmijëri të lumtur në familjen e hallës Meleqe në Prizren, por që pas mbylljes së kufijve midis Shqipërisë dhe Kosovës përjetoi dhimbjen e mallit të pashuar për babain, nënën, vëllezërit, motrat e të afermit tjerë në Ceren.. si edhe në essetë e refleksionet që mbyllin kapitullin e fundit të librit, një lexues i vëmendshëm nuk do ta kishte të vështirë të dallonte forcën metaforike dhe formimin kulturor të autorit, duke krijuar kështu muzeun e fjalës për këtë familje të madhe, emërndritur në historinë tonë kombëtare.

Nga ky libër që unë pata fatin ta lexoj ndër të parët e të isha redaktor i tij, mësojmë se si proverbial popullor “Bëmë baba, të të ngjaj” jetëzohet më mirë se kudo tjetër në trungun familjar të Harun Jakup Domit. Ndaj nuk është rastësi që nga kjo

familje e madhe numërohen sot 115 djem e vajza me arsim të lartë, një armatë e tërë me: arsimtarë e pedagogë, inxhinierë mekanikë, elektrikë kompjuterikë, mjekë, stomatologë, diplomatë, në shkencë politike, juristë, ekonomistë, financier, në fushat biznes menaxhim, me gjuhë të huaja, të diplomuar në psikologji, arkitekturë etj, të shpërndarë në gjithë vendin dhe në diasporë, të orientuar në atë çfarë i pari i këtij trangu, Harun Jakup Domi bëri kryesisht me gjuhën e shkollën shqipe. Ai ishte themeli nga ku mori rrugë shkolimi i familjes deri në ditët e sotme.

Prandaj unë jam besimplotë dhe shpreh bindjen, se autori Tajar Domi, një emër i njohur jo vetëm në Kala të Dodës, në gjithë Dibrën e në Tiranë ku punoi për disa vite në funksione të rëndësishme, por edhe në diasporën shqiptare të SHBA si kryetar për dy mandate i Shoqatës “Bijtë e Shqipes” në Filadelfia, me këtë libër ka plotë-



suar dukshëm njohjen më të mirë për lexuesin, jo vetëm të historisë në përgjithësi, por edhe të figurave e personaliteteve të veçanta, jo vetëm të familjes së tij në tre breza, por edhe të zonës së Kalasë së Dodës, me rolin e luajtur në kohë të ndryshme.

Po ashtu, në tërësinë e librit, në 6 pjesët e tij është evident koncepti kombëtarist i këtij autori, i dëshmuar më si miri ky edhe në veprimtarinë e tij në diasporën shqiptare të SHBA.

Siç doli edhe në dokumentarin e shfaqur në ditën e promovimit të këtij libri me poraninë e 300 personaliteve nga Shqipëria, Kosova e dias-

pora shqiptare e SHBA, të përgatitur me nivel të lartë artistik nga ikona e gazetarisë sportive, Mjeshtri i Madh Defrim Methasani, autori Tajar Domi, edhe me këtë libër, si në gjithë veprimtarinë e tij si kuadër e veprimtar shoqëror shembullor, udhëheq dinjitetshëm brezin e tretë të intelektualëve të këtij trangu.

Folësit në këtë veprimtari promovuese, si politikani i njohur Petro Koçi, ish kryebashkiaku i Dibrës dhe ish Ministri i Punës e Çështjeve Sociale Kadri Rrapë, akademik Fatos Daci, ish – kryetari i Këshillit të Qarkut Kukës Abdulla Domi, njëherësh nënkryetar i Federatës së Paqes Universale Shqipëri e Dr. Fejzulla Gjabri, drejtuesit e shoqatës “Korabi” të Radomirës, Dr. Hasan Domi e Dr. Petrit Gjorgji, ndërsa e vlerësuan si një prurje të veçantë, shprehën bindjen se ky libër zë vendin e merituar në fondin e artë të letërsisë sonë dokumentare.

KALAJA E DODËS, VEND I BEKUAR NGA ZOTI DHE NJERËZIT E SAJ

Në dokumentarin e përgatitur me mjeshtri të rrallë artistike nga Defrim Methasani shfaqet Kalaja e Dodës, një vend i bekuar nga Zoti dhe njerëzit e saj që kanë gjurmët e tyre përmes historisë, traditave, punës së ndershme dhe vlerave njerëzore. Aty nën këmbët e malit më të lartë në vend, Korabit; mes lumit të Veleshicës, bjeshkëve të Gramës dhe Sorokolit, në krah me Kalisin, Vilën dhe Bushtricën por edhe me Kallën e Vleshën e Sllovës, shtrihen fshatrat e Kalasë së Dodës, ku në qendër ndodhet Cereni, fshati i besimit të fesë myslimane, por edhe i njerëzve të punës e dijës.

Emërtimi i Kalasë së Dodës si qendër krahnarie, na jepet i dokumentuar edhe në vitin 1864 nga konsulli austriak – albanologu J.G. Hahhn, në librin e tij “Udhëtim nëpër viset e Drinit e Vardarit“. Në faqen 221 të këtij libri, shkruhet se: “Patëm rastin të kalojmë vetë pranë vendeve ku gjenden gjurmët e qyteteve të hershme, ku dikur kanë ekzistuar kisha të krishtera dhe banesat pranë të cilave ne patëm rastin të kalojmë, dëshmojnë, pothuajse të gjitha, që banorët e tyre gëzojnë një mirëqënie, e cila e kalonte parashikimin që mund të bëhej, duke pasur parasysh to-

kat e tyre bujqesore”. (- M. Skeja “Kalaja e Dodës, një zambak i Korabit”, 2022, fq. 165).

Prof. Dr. Hajri Shehu bën këtë cilësim të shkurtër: “Dheu i Kalasë së Dodës ka kufinj natyror e historik Veleshicën e Ujin e Lapave. Është një dhé me kroje e kopështe. Me ara e me livadhe. Me kullota e me bjeshkë. Me ujë e ujëvara. Me nëntokë të pasur. Me shtëpi të pastra e sofra bujare. Me një të folme melodioze e me një folklor magjepsës ...”. Ndërsa autori i këtij libri Tajar Domi vlerëson se “Banorët e Kalasë së Dodës, kanë personalitet dhe karakter të fortë, që i vemë re sidomos në rezistencën ndaj trysnive të pushtetit, kur ata bashkohen me fuqinë e këtij karakteri dhe që i nxjerr gjithmonë fitues”. Më tej ai shkruan se “Cereni kishte besë dhe bashkim. Në vitet e diktaturës komuniste, ashpërsia e ligjeve të kohës ndjehej më butësisht në Ceren. Aty, punonjës shteti, anëtar partie e të persekutuar nga ai sistem, i shihje bashkë në biseda, në punë e në konaqe. Asnjë kufizim nuk kishte, bie fjala, për Sabriun e Sheh Mahmutit, djali i të cilit (Xhelali) ishte arratisur nga vendi e për pasojë Sabriu u internua familjarisht dhe iu hoq karta e frontit. Atë e shikoje kudo të shkonte për vizita, për kafe edhe tek një nëpunës apo anëtar partie i Cerenit. Dhe, duke respektuar moshën e zgjuarsinë e tij, shpesh kryesonte vargun e gjatë të njerëzve ku kishte edhe komunistë. Kjo ndodhte veçmas në Ceren, jo në fshatrat e tjerë të zonës...”.

Në zemër të tij familja Domi, shembulli i duhur që vlen, jo vetëm për trevën por edhe për gjithë vendin.

Dokumentari flet për faktin se për më shumë se një shekull, protagonistët e dijes kanë emrat e burrave e grave, djemve e vajzave ët Familjes së Madhe Domi.

Ka prindër apo gjyshër që luftojnë në jetë t’ju lënë brezave pasuri, para, shtëpi, toka, dyqane apo objekte tjera. Por libri i Tajar Domit dhe dokumentari televiziv i shfaqur ditën e promovimit të tij evidentojnë faktin që, si pak kush, Familja Domi, pasuri të saj la dijen dhe arsimin. Mjaf-ton të përmendësh një shifër dhe duket se i ke thënë të gjitha. Nga kjo familje janë 115 veta të shkolluar me arsim të lartë (midis tyre dhjetra personalitete shkencore, akademike e diplomatike) dhe ky shembull vlen si një rast për librin

gines.

Harun Domi që para një shekulli solli abetarën e parë nga Bukureshti punoi si mësues dhe ndikoi së tepërmi në arsimimin e parë të banorëve të kësaj zone në prehër të maleve. I martuar me Adilen, të bijën e Hasan Dehar Manallarit, një derë e mirë të Radomirë, ai lindi dhe rriti 9 fëmijë, gjashtë djem dhe tre vajza; konkretisht: Halili, Shefqeti, Hidajetja, Musa, Xhemali, Ahmeti, Alija, Besimi dhe Milihatja. Mes tyre spikatën dy, Shefqeti dhe Xhemali, njëri mjek e tjetri drejtori i parë i arsimit në Kala të Dodës..

“Dr. SHEFQET DOMI JETOI NJË JETË SI NJERI POR PUNOI DY JETË SI MJEK”

Dr. Shefqeti la shumë gjurmë në spitalin e Peshkopisë dhe në Tiranë, ku do që ai punoi me përkushtim e profesionalizëm si mjek, si një shembull i qartë i betimit të Hipoktarit në shërbim të njerëzve. Jo rastësisht, laboratorit i Spitalit të Dibrës mban emrin e tij, në respekt të punës shkencore, botimeve po të tilla dhe shërbimit profesional e njerëzor në Tropojë, Dibër e Tiranë.

Në këtë libër evidentohet vlerësimi i njërit prej kolegëve e bashkohësve të tij, Prof. Dr. Nazmi Koçi, sipas të cilit: “Dr. Shefqeti jetoi një jetë si njeri por punoi dy jetë si mjek”. Para largimit nga kjo jetë ai la një arkiv të madh të punimeve të tij shkencore, por edhe dy botime të rëndësishme për vendlindjen, të cilën e dashuronte shumë “Cereni – Histori e Tradita” (2012) dhe “Kalaja e Dodës apo Qafa e Bilbilit” (2024).

HISTORIA E ARSIMIT NË KALANE E DODËS MBAN EMRIN E XHEMAL DOMIT

Një tjetër personalitet i kësaj famije është Xhemali, një mësues që arriti të ngjiste majat e tij edhe si drejtues, edhe si botues. Nga libri i Tajarit si dhe nga dokumentari televiziv mësojmë se Historia e arsimit në Kala të Dodës dhe zomat përreth mban firmën e tij. Kjo falë punës shumëvjeçare si ish mësues por edhe drejtor në shkollën e Radomirës, ndërsa ka privilegjin e hapjes të të parës shkolle të mesme në Ceren të Kalasë së Dodës. Në 100 vjetorin e shpalljes së pavarësisë të Shqipërisë ai botoi në tre vëllime

veprën “Dibra në hulli të historisë”, botime këto shkencore dhe profesionale, të arsimit dhe mendimit pedagogjik në trevat e Dibrës, duke shpalosur një punë kolosale profesionale dhe arkivore në vite me radhë.

DY TË BURGOSURIT POLITIK NGA FAMILJA E MADHE DOMI

“Në vitin 1967 kur nga shteti i kohës punohej dhe u realizua ngritja e kooperativave bujqësore në të gjithë vendin, një grup shtetëror drejtuesish që ishin ngarkuar për Kalanë e Dodës në “ndërgjegjësimin” e banorëve, një ditë ishin takuar me Musën (djalin e katërt të Harunit) për ta bindur që familja e tij e madhe të futej në kooperativë. Por ata kishin hasur në kundërshtimin e tij, i cili u kishte argumentuar vështirësitë e mëdha që do të kishte familja në zbatim të këtij ligji edhe në Ceren. Pas kësaj kundërshtie, grupi i punës takohet me Harunin, babain e Musës, dhe në bisedë me të i thonë: “Musain e kishe të sertë, jo si djemtë e tjerë”. Ndërsa Haruni u përgjigjet: “Një shtëpie të madhe, i duhet një djalë si Musa”, -shkruan autori i këtij libri. Dhe pikërisht kjo rezistencë për të mos pranuar kolektivizimin do të ishte shkaku i burgosjes së Musës dhe vëllait tjetër Ahmetit, të cilët u dënuan pas një gjyqi popullor politik.

“Në vjeshtën e vitit 1968, me datën 3 nëntor, Besimi do të martohej me Zemrite Abedin Litën nga fshati Matranxh i Bushtricës. Megjithëse ngjarjet dhe kushtet në familjen e Harunit atë vit ishin shumë të mbrapshta, pasi dy djemtë e tij (Musa e Ahmeti) ishin dënuar me burgim për kundërshtim të pushtetit popullor, ndërsa Haruni kishte vdekur me 28 shtator të atij viti, vetëm një muaj para dasmës, prapë se prapë “dasma” u bë dhe nusja u muar”. Tajari e rrëfen në librin e tij atë ditë, kur për arsye të burgosjes së Musës e Ahmetit, kjo dasëm nuk pati asgjë të afërt me të tjerat. E megjithatë gjithçka vazhdoi bukur në vitet në vazhdim në këtë familje. “Në vitin 1968, një vit pasi u krijuan kooperativat bujqësore, Ahmeti ishte bashkëvuajtës me Musën për gjashtë muaj në burg, me vendimin e padrejtë të gjyqit shembullor të Slllovës kundër familjes tonë, për të cilin u kërkua falje më vonë!!!”, shkruan autori i këtij libri.

RUAJTJA DHE PROMOVIMI I IDENTITETIT, GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPE NË DIASPORË

Po kaq emër me vlerë si dy djemtë e rilindasit Harun Domi që solli abetarën e parë nga Bukureshti në këtë zonë, Dr. Shefqeti e mësues Xhemali që i përkasin brezit të dytë, shpalosin edhe brezi tjetër i intelektualëve të kësaj familje të madhe. Njëri prej tyre që kaloi edhe kufijtë e Shqipërisë është Tajari i cili jeton në Filadelfia. Pikërisht në ditën e promovimit të librit të tij “Dinastia Domi e Cerenit të Kalasë së Dodës” ai vlerësohet nga Këshilli Bashkiak me titullin më të lartë “Qytetar Nderi” i Dibrës, me motivacionin: “Për kontributin e tij të çmuar në ruajtjen dhe promovimin e identitetit, gjuhës dhe kulturës shqipe në diasporë. Ai ka përfaqësuar me dinjitet komunitetin dibran në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e Shoqatës ‘Bijtë e Shqipes’ në Filadelfia, duke qenë një urë lidhëse mes brezave dhe një model frymëzimi për komunitetin shqiptar”. Titulli ju dorëzua në mënyrë ceremoniale nga nënkryetari i Bashkisë Dibrë Lorenc Cibaku, ndërsa ishte i pranishëm edhe ambasadori i Republikës së Kosovë në vendin tonë Z. Skënder Durmishi.



Një mirënjohje për autorin e këtij libri vjen edhe nga Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe Arteve Nju jork, me president prof.dr. Skënder Kodra. Kjo, “Për kontributin intelektual e atdhetar të tij, gjatë kohës që është bërë pjesë e Diasporës Shqiptare në Amerikë, veçanërisht në Filadelfia. Si pjesëmarrës në veprimtaritë shkencore e historike, në emisionet e ndryshme televizive dhe në shtypin e shkruar,

këtu në Amerikë por edhe në vendlindje, z. Tajar Domi ka përcjellë gjithmonë mesazhe mirënjohje, dashurie e bashkimi...”.

Krahas tij, në librin dhe dokumentarin përkatës evidentohen dhe flitet edhe për profesionistë e personalitete tjera. E ndër ta Nuri Shefqet Domi – fizikant&diplomat në Katar që mban titullin doktor i shkencave. Ai mbahet mend kur gjatë kohës studentore u përzgjedh që në televizionin publik shqiptar të drejtonte emisionin shkencor për fëmijë “Dritare diturie”, ku pati një audiencë shumë të gjerë. Në harkun kohor të 10 viteve ka botuar artikuj e studime të shumta dhe të vlerësuar edhe në vendet e zhvilluara. Midis tyre, përmendet libri voluminoz enciklopedik “Mendjendriturit e njerëzimit”(2014); “Arti i diplomacisë” (përkthim i vitit 2023) dhe libri “Historia nëpërmjet aktorëve të saj”që pritet të dalë nga botimi së shpejti. Të tjerë emra personalitetesh të kësaj familje që përmenden në librin “Dinastia Domi e Cerenit të Kalasë së Dodës” janë: Mimoza Halil Domi – mësuese në Belgjikë; Jakup Halil Domi-ekonomist në Filadelfia; Naim Shefqet Domi – inxhinier topograf me emer në Shqipëri; Përparim Shefqet Domi – ekonomist, biznesmen në Shqipëri; Resul Musa Domi – mjek në Tiranë; Mahmudie Musa Domi – financiere në Filadelfia; Bashkim Xhemal Domi – inxhinier elektrik në Londër; Defrim Xhemal Domi – mësues në Tiranë; Maslime Xhemal Domi – financiere në Shqipëri; Lavdrim Xhemal Domi – Ing. Pyjesh në Shefiled Angli; Dina Xhemal Domi – juriste në Tiranë; Lindita Ahmet Domi – mësuese në Tiranë.

Ky trung familjar është i veçantë, pasi në të shohim të pleksen të gjitha gjeneratat, pjestar të arsimuar deri në nivelet më të larta.Nga 115 të shkolluar me arsim të lartë të kësaj familje ka një shpërndarje të tillë interesante, që duket se kanë “pushtuar” botën; konkretisht në Shqipëri 36 persona, në Kosovë 30, në SHBA 17, në Angli14, në Blegjikë 7, në Spanjë 4, Gjermani 3, Itali 2, Katar 1 dhe Kroaci 1. Midis tyre ka me tituj e grada shkencore, akademike e diplomatike.

Në librin e Tajar Domit, si dhe dokumentarin përkatës, mbresëlënës qenë interpretimi mjeshtëror nga diva e skenës dhe ekranit Margarita Xhepa – Nderi i Kombit, i poezisë së shkruar

po nga ky autor “Për Cerenin”, nga e cila veçojmë vargjet e strofës së fundit: “Ky është fshati ynë i lindjes/ ku vlla-llëku kurrë s’u prish/ Ku “kulaku”e “Partia”/ Ishin bashkë në çdo mexhllis”. Mbi 200 pjesëmarrësit në këtë event duartrokitën ngohëtisht gjithashtu përshëndetjen e ish – ministrit e deputetit Petro Koçi që ka shërbyer disa vite si mësues në Kala të Dodës, fjalën e ish – kryebashkiakut të Peshkopisë dhe ish – Ministër i Punës e Çështjeve Sociale Kadri Rrapi, përshëndetjen e ish – kreut të Këshillit të Qarkut Kukës Avdulla Domi; reçensat mjaftë profesionale të akademik Fatos Dacit, Dr. Fejzulla Gjabrit e Dr. Petrit Gjorgjit, si dhe rrëfimet në dokumentar të Ajaz Vishës – bashkohës i atdhetarit Harun Domi dhe djalit të tij Besim Domi.

Emocione të forta gjatë promovimit ngjalli regjisor, aktori dhe shkrimtari mjaft produktiv e cilësor në hapësirën mbarëshqiptare në botë Xhevat Limani me interpretimin e poezisë “Gjuha jonë”. Po ashtu edhe përshëndetja me skype nga Filadelfia e personalitetit kukësi Enver Parllaku, e gjirokastritit Arqlile Hila – bashkëstudent i të autorit të këtij libri, e në veçanti përshëndetja e shkrimtarit Hys Hasa në emër të Shoqatës “Bijtë e Shqipes” Filadelfia. Impresionues për pjesëmarrësit në këtë event qe njoftimi i moderatotit Methasani se të ardhurat nga shitja e librit “Dinastia Domi e Cerenit të Kalasë së Dodës” do të shkonin si donacion për shkollën



“Ibrahim Gjorgji” të Radomirës.

“Jam me fat që shoku im Tajari, përmbush për mua shprehjen e popullit ‘ zgjidhe shokum më të mirë se vetja’, shprrhet bashkëstudenti gjirokastrit Arliqe Hila, ish-kryetar i komunës së Zagorisë.

Më të larmishëm e bëri këtë event edhe shfaqja e videoklipit të këngës “Abetarja e Harunit”, me interpretimin mjeshtëror nga Liri Rasha – pasaporta artistike e Dibrës. Në vitet, dekadat e shekujt që do të vijjnë, Refreni i kësaj kënge: “Abetarja e Naumit/ Fsheh në gjirin e Harunit/ Ndezi dritën e Europës /Deri në Kala të Dodës” do të frymëzojë brezat tjerë të kësaj familjeje. Ashtu si edhe ky libër i Tajar Domit, për të cilin siç shkruan Kadri Rrapi në parathënien e librit: “...me një pasion të pashoq, përshkruan historinë dhe kulturën e kësaj treve me një qasje të thelluar dhe gjithëpërfshirëse. Duke ndërthurur

burime historike, dëshmi të autorëve vendas, udhëtarëve e albanologëve të huaj si dhe rrëfime personale, ai krijon një panoramë të pasur dhe të gjallë. Shkrimi i tij spikat për tonalitetin emocional dhe respektin e thellë ndaj traditave të zonës. Përshkrimet e tij mbi Cerenin dhe mbarë zonën e Kalasë së Dodës krijojnë një mozaik të pasur historik, kulturor dhe personal. Dhe këtë e bën me një stil tërheqës dhe të detajuar, duke trajtuar me mjeshtëri tema thelbësore”.



VEPRA & AUTORË

Pas “Nishani”- t, shkrimtari i mirënjohur shqiptaro-amerikan me siguri do na gostitë me krijime të tjera të bukura


ROMANI “NISHANI” I AUTORIT SHEFQET MEKO, NJË HISTORI TRONDITËSE



Fuat Memelli

- **“Viza amerikane” ka kaluar Atlantikun dhe i përkthyer në anglisht, është paraqitur në disa ekspozita të librit deri në Kinën e largët**

Shefqet Mekon e kam njohur vite më parë. Të dy gazetarë, vërtet të ndryshëm në moshë, por të përkushtuar për të lënë ndonjë gjurmë në median shqiptare. Jeta e solli të mërgonim, si “ikanakë” të shekullit 21-të siç



shkruan Shefqeti, por ai gjithçka e mori me vete, jo një “trastë kujtimesh” por një “hambar” të madh të mbushur me ndodhi, fate, njerëzish, apo ngjarje si në atdheun amë edhe këtu në Amerikë. Gazetar impulsiv, me interesa të gjëra shpirtërore, shkruan, polemizon; nuk di të heshtë, i nxitur nga e tashmja, por edhe nga e shkuara...me shikimin nga të dyja anët, si në Shqipëri ashtu edhe në Amerikë.

Ndërkaq gazetaria e ka mbërthyer fort pas letërsisë, pas prozës artistike, apo publicistikës dhe deri tash ka botuar dhjetë libra, romane, tregime, novela, të cilat janë pritur me interes, madje romani “Viza amerikane” ka kaluar Atlantikun dhe i përkthyer në anglisht, është paraqitur në disa ekspozita të librit deri në Kinën e largët.

Kohët e fundit shkrimtari Shefqet Meko ka botuar romanin “Nishani”, një subjekt interesant që merr jetë nga Pogradeci dhe krahina e Mokrës. Ky roman është një kronikë e marrëdhënieve në familje, është provë e dinjitetit, sakrificës për të përballuar goditjet e fatit që është pjesë e jetës sonë.

Rreth “nishanit”, kësaj shenje-enigmë në trupin e Dorina Moravës, është edhe epiqendra e romanit. Libri është i ndarë në 22 kapituj. Megjithëse episodet duken të ndarë, ata i bashkon një fill, ai i jetës së Dorinës, shumica në Shqipëri, një pjesë edhe në Amerikë. “Zhiva e tensionit” për fatin e Dorinës dhe të bashkëshortit, Agonit, të vjehrrës Fatime, apo prindërve të saj, vajzave binjake, etj, sa vjen e ritet. Ndër episodet e para të romanit, është ai i njohjes së papritur së Dorinës me profesion farmacistë, me Agon Shkëmbin, me profesion inxhinier pyjesh. Gradualisht ngjizet dashuria e tyre. Me që ai jetonte larg saj, vjen dhëndër (ose kollovar siç i thonë në Shqipëri) në shtëpinë e nuses ku jetonin edhe dy prindërit e saj.

Nëna e tij mbeti vetëm dhe Agoni ngul këm-

bë që edhe ajo të vinte aty. Dhe kështu ndodhi. Ky fakt e mërzi Dorinën, pasi “u mbush shtëpia me tre pleq” ndërkohë që ajo donte të jetonte veçmas me të shoqin.

Por historia e nënës Fatime përbën në thelb intrigën e romanit, që të shtyn ta lexosh me kureshtje dhe një shqetësim të brendshëm për mënyrës se si rrjedhin ngjarjet. Nënë Fatimja është “kurban” i rastësisë, lakmisë dhe egoizmit. Në të vërtetë është një histori që nuk zhbëhet dot kurrë. Në thelb është një ngjarje dramatike, provë qëndrese dhe morali për vete familjen e Agon Shkëmbit. Kam përshtypjen se nënë Fatimja është një figurë e njohur në letërsinë shqipe, madje edhe në trashëgiminë gojore.

Duke “udhëtuar” në faqet e romanet ndesh të papritura të tjera të ngarkuara me dramacitet. Një ditë prej ditësh për të “shlyer mëkatin”, vjen në shtëpinë e Dorinës Llazi Kodra, personi që kishte bërë “gjëmën” në maternitet sepse pati ndërruar fëmijën e lindur të regullt nga nënë Fatimeja, kur ishte vajzë e re dhe e pamatuar. E kishte ndërruar me një foshnjë të vdekur për t’ja dhënë kundrejt pagesës, të jatit të Dorinës me që nuk kishin fëmijë.

Doemos Llazar Kodra do që të shlyejë mëkatin, madje të kthejë edhe të hollat që u kishte marrë prindërve të Dorinës, që tashmë kishin ndërruar jetë. Pas këtij rrëfimi si dhe ato që i kishte treguar më parë vjerra -nënë për nishanin, Dorina bindet se çfarë kishte ngjarë me trupin e saj. Mëdyshjet që e kishin munduar prej vitesh u zbardhën. Por, siç thotë populli “u hoq gozhda, por mbeti vrima”, mbeti plaga në thellësi të shpirtit të saj.

Për bukurinë e tyre, për krahasimet e spikatura, për mendimin filozofik që përcjellin, shumë fjali të mbeten në mendje: “Retë e bardha si ameba gjigande vijonin të luanin me hënën.” “Kishte nevojë të ulërinte sa ta çante qiellin e asaj nate”. “Njeriu është si një pus i thellë ku

nuk arin dot t’i shohësh fundin.” “Ndarja në një martesë ferr, është shpëtim.” Ashtu si në romanet e tjerë edhe “Nishani” të çon sa në Shqipëri edhe në Amerikë, pasi janë realitete që Shefqeti i njeh mirë duke u bërë pjesë e pandarë në krijimtarinë e tij. Diku ai thotë: “Fatkeqësisht në vendin tonë shqiptarët dehen me politinë e gënjeshtër, ndërsa në Amerikë ka punë, para dhe liri.” Por, le të mos zgjatemi më, pasi diku kam lexuar “bukuria qëndron në shkurtësinë e gjërave.” Pas “Nishanit”, Shefqeti me siguri do na gostitë me krijime të tjera të bukura.

Shefqet Meko prej dekadash jeton në Amerikë, por krijimtarinë e vet e ka kthyer në një urë shpirtërore me Shqipërinë. Librat e Mekos si “Saga përtej Atlantikut”, “Viza Amerikane”, “Rënia” e tashmë “Nishani” janë neurone letrare që përcjellin realitete përballë njëri-tjetrit me një oqean në mes. Meko mbetet shkrimtar i dy kohëve që “vrapojnë” bashkë me autorin! Darina, është në të gjashtëdhjeta e saj. Që në krye ajo na shfaqet e tronditur nga një e fshehtë e llahtarshme, të cilën e merr vesh rastësisht nga e vjehrra. Shkak për këtë bëhet nishani që ka në shpinë. Aty zë fill gjithçka. Bota e saj përmbyset, por ajo mëson të ringrihet. Është vetëm. Nuk ka me kë ta ndajë atë që mëson: prindërit dhe i shoqi nuk jetojnë më, vajzat binjake janë në Amerikë. Vetëm ajo dhe e vjehrra kanë mbetur në vilën e madhe. Shpresa se mos fjalët e plakës janë lajthitje e moshës, shuhet nga rrethana të çuditshme që qartësojnë çdo dyshim. Pavarësisht nga ato që mëson, Darina qëndron e ftohtë me nënën e burrit dhe mezi pret vdekjen e plakës, pasi për shkak të saj nuk mund të shkojë te vajzat në Amerikë, por edhe e sheh si mënyrën më e sigurt për të varrosur misterin që i rrëfeu. Enigma e nishanit do ta ndryshojë krejtësisht jetën e saj dhe do ta përfshijë në të tjera të papritura që do ta shoqërojnë edhe në Amerikë.

VEPRA & AUTORË

“Bimët mjekësore të Korabit” i plotëson të gjithë parametrat për ta quajtur enciklopedi në llojin e vet

LIBRI I DR. HASAN DOMIT “LETËRNJOFTIM” PËR 200 BIMË MJEKËSORE TË KORABIT



PROF. DR. HA.JRI SHEHU


- **Jo gjithkush mund të fotografojë. Autori ka ditur të fotografojë. Me estetikë. Me art. Dhe jam i bindur që është lodhur shumë se ka foto edhe në faza të ndryshme të bimës, që do të thotë se ka ndenjur në përgjim si puna e gjahtarit. Dhe Korabi na vjen, jo vetëm me majat e tij, por edhe me bukuritë e tij lulore, madje, edhe me aromat e luleve sepse kur shohim fotot, virtualisht ndiejmë aromën e tyre. Ajo nuk është, thjesht aromë. Aroma e luleve të Korabit, - thuhet në libër, - ndikon në mjekimin e sëmundjeve mushkëriore...**

Virtualisht. pa auditor, libri i doktor Hasan Domit, “Bimët mjekësore të Korabit”, 705 f. është përruruar që para se të shkonte në shtyp me katër recensionet, njëherësh - parathëniet e katër profesorëve të nderuar: Prof. Petrit Bara. Prof. Dr. Skënder Durrësi, Prof. Nafail Biba dhe Prof. Luigj Turmalaj: profesor Petrit Bara, me sentencat e tij; profesor Skënder Durrësi me gjykimet aq vlerësuese për bimët mjekësore në praktikën e përditshme; profesor Nefail Biba, me vlerësimet profesioniste-shkencore edhe përtej fushës së bimëve mjekësore; profesor Luigj Turmalaj, me vlerësimet për pasuritë e jashtëzakonshme të Korabit tone, të florës e veçanërisht, të bimëve mjekësore dhe aromatike.

Janë 4 parathënie profesorësh, shumë vlerësuese, që do të thotë që libri tashmë e ka fituar emrin e mirë. Ajo që mund të themi ne të tjerët e gjithsesi, jashtë fushës, është ndonjë shtesë, por shtesë e thënë përzemërsisht.

Autori, është doktor Hasani, është mjek veterinar. Tashmë - farmacist veterinar. Me një bilanc shumë të pasur pune. Në të gjitha punët - i përkushtuar, me ndezëlli të veçantë. E veçanta në punët dhe veprimtaritë e tij: gjithmonë i matur, i paqtë, i qetë. Po të rrudhë vetullat dr. Hasani, dije se ke bërë gabim jo të vogël. Besojmë se edhe këndej i vijnë sukseset.

Doktor Hasanit nuk i ka munguar asnjëherë dija dhe fjala. Sot na ka ardhur me dijen dhe fjalën për 200 bimë mjekësore të Korabit. Më pëlqen ta them që në fillim: Është një punë e madhe shkencore. Vetëm një fakt do të përveçoj: Në morinë e bimëve dhe të luleve të Korabit, ka njëjtësuar 200. I ka identifikuar. U ka vënë emër. U ka dhënë letërnjoftimin. Çfarë tjetër? Përveç identifikimit e emërtimit shkencor, ka vënë emërtimin popullor - shumë i nevojshëm, siç do ta përsërisim më tej, për pasurimin e gjuhës shqipe standarde me fjalë të burimit popullor. Pastaj na vjen përshkrimi, që na thotë çfarë është e si është aksh bimë. Zëri tjetër, që ka të bëjë, gjithashtu drejtpërdrejt me identifikimin, është historiku i përdorimit mjekësor të bimës - shumë i këndshëm për çdo lexues. (Në parantezë, po ma pranoi sug-



jerimin, dr. Hasani mund ta bëjë botim më vete këtë tryezë të lëndës së librit). Janë kuriozitetet që e shtojnë shumë karakterin shkencor të librit. E shtojnë shumë besimin e lexuesit dhe të përdoruesit për këtë a për atë bimë mjekësore.



Zëri tjetër i librit është përmbajtja e esencës që merret nga bima (lëndët minerale sheqernat, vitaminat etj.), shpesh, edhe me formula kimike (në parantezë, këtu shpjegimet janë domosdo me terminologjinë shkencore të fushës, që do të thotë se libri është edhe për më të diturit) dhe përdorimi - ky është për publikun e gjerë. Dy tryezat e tjera janë përgatesat dhe ruajtja. Edhe këto dy rubrika janë për ne, për publikun e gjerë. Përfundimi: Doktor Hasani na ka sjellë në shtëpitë tona farmakologjinë dhe farmacinë e 200 luleve (më pëlqen të them lule e jo bimë) të Korabit, të Fushës së Korabit e të Gramës (në parantezë, ka Gramë edhe në Karaburun / është uniteti i gjuhës).

Renditja e bimëve është alfabetike. Edhe Treguesi /Indeksi në fund të librit është alfabetik. Libri prihet nga një hyrje e thukët e autorit dhe mbyllet me një bibliografi mjaft të pasur. Po të bëjmë një përgjithësim vetëm me një fjali, themi: Libri “Bimët mjekësore të Korabit” i plotëson të gjithë parametrat për ta quajtur enciklopedi në llojin e vet.

Që të mos më mbetet merak se nuk e thashë: Teknologjia e librit është shumë e pëlqyeshme. Radha e paraqitjes së zërit është shumë e këndshme: paraprin fotoja e lules dhe pastaj, siç u tha, emërtimi shkencor, emërtimi popullor etj. Të gjitha - lidhur fort si një e tërë: ja lulja, ja emri, ja përshkrimi etj. Ja ku e ke. Mos e shkel! Mos e dëmto! Përdore!

Jo gjithkush mund të fotografojë. Autori ka ditur të fotografojë. Me estetikë. Me art. Dhe jam i bindur që është lodhur shumë se ka foto edhe në faza të ndryshme të bimës, që do të thotë se ka ndenjur në përgjim si puna e gjahtarit. Dhe Korabi na vjen, jo vetëm me majat e tij, por edhe me bukuritë e tij lulore, madje, edhe me aromat e luleve sepse kur shohim fotot, virtualisht ndiejmë aromën e tyre. Ajo nuk është, thjesht aromë. Aroma e luleve të Korabit, - thuhet në libër, - ndikon në mjekimin e sëmundjeve mushkëriore. Shih, p.sh., foton e aguliçes dhe thënien e autorit: Fusha e Korabit konsiderohet shtëpia e primulave (aguliçeve) të bukura të vendit tonë (f. 63). Dhe të mos harrojmë që aguliçja është lule e pranverës së hershme. Le të imagjinojmë pastaj zambakun e Korabit (f. 669-671), kokrrat gjak të kuqe të mjedrës e të luleshtrydhes, mërquinjën, mëllagën, luledelen, hithëbutën e bardhë, gjineshtrën, fillikaten (anemonën), boçëborën e dhjetëra e dhjetëra të tjera! Dhe, tani, propozimi im i dytë: Autori të bëjë një album me lulet mjekësore të Korabit. Do të ishte i bukur shumë.

Historiku i përdorimit të bimës është shumë interesant: sanëza është zbuluar nga mbreti Genti; këputja është bimë parahistorike (600-375 milionë vjet më parë); rrënjët e gjembbardhës janë përdorur si perime nga anglezët në shek. XVII; çdo pjesë e manaferrës ka fuqi të madhe shëruese; farat e murrizit i përkasin neolitit; në mitologjinë greke, fillikatja (= anemona) është ninifa Anemonë. Shumë interesant është historiku i njohjes së gramit, trëndafilin, vadhës, shtarës, shpatores, pelinit, lajthisë, kullumbrisë, qinglës e rrodhës etj. Dhe, edhe një herë dëshira: libër me historikun e përdorimit të bimëve mjekësore.

Libri është më së pari, për të gjithë ne. Në recensionin e tij, prof. Nefail Biba thotë se libri është kontribut për të gjithë ata që duan të ruajnë shëndetin. Profesor Skënder Durrësi thotë se sipas OBSH-së, 80% e popullsisë së botës i përdor bimët mjekësore si pjesë e kujdesit të përditshëm shëndetësor” (f. 10). Aty përfshihemi edhe ne, sigurisht. Prof. Luigj Turmalaj thotë se për herë të parë, autori ka ilustruar me formula kimike përmbajtjen e lëndëve aktive për secilën bimë.

Libri është për më të diturit. Dhe më të diturit janë botanistët, farmakologët, farmacistët, pedagogët, mësuesit e studentët e këtyre shkencave, mjekët popullorë, ekologjistët, herbalistët,


gjeografët etj. Edhe për profesionistët që grumbullojnë bimët mjekësore e tregtarët e tyre. Edhe për lulishtarët. Edhe për udhëpërshkruesit. Edhe për dashatarët e natyrës, të vendlindjes etj. Radomirën e kanë përshfaqur disa studiues: inxhinier Vesel Hoxha - nëntokën; poeti Jahe Delia - folklorin e etnografinë; mësuesi Metush Skeja - arsimin e shkollën; Dhe tani, doktor Hasan Domi - bimët mjekësore. I urojmë shpirtërisht.



Në recensionin e tij, prof. Nefaili, kur flet për këtë është libri "Bimët mjekësore të Korabit" i doktor Hasan Domit, pas një enumeracioni të gjatë, thotë: Pse jo, edhe për gjuhëtarët. Vlerësimi i profesorit është i saktë. Janë termat botanikë, kimikë etj. (Termi është emërtim në një fushë të shkencës; në fushën e botanikës, tipi *lulesë*). Janë emërtimet popullore të bimëve (tipi *shpatore* ose *luleshpate* për *Iris Germanica*). Në punë të termave: Kur përshkruan vetitë mjekuese të bimës, veprimin kimik e mjekësor etj., autori përdor gjuhën e shkencave përkatëse. Domsdo kështu duhej. Sepse janë koncepte shkencore. Dhe konceptet janë ndërkombëtare e nuk mund të cenohen. Emërtimet janë gjuhësore. E kërkon mënyra e informimit. (Në parantezë, këto të dhëna të librit janë për më të diturit, siç u tha, për specialistët, mjekët, kimistët etj.). Kur përshkruan bimën, kemi konceptim të dyfishtë - një herë si fushë dijeje (tipi gjethe sjetullore / heshtake), një herë si veprimtari praktike (emërtimi popullor / përpunimi i bimës / përdorimi / ruajtja etj.). Dhe kemi kështu emërtime që pasqyrojnë konceptet teorike të botanikës, tipi *lulesë*, rrethlule etj. dhe emërtime që pasqyrojnë konceptet praktike të dijes botanike (tipi lule, gjethe, rrënjë, pelin / emri shkencor *Artemisia vulgaris* etj.). Dhe kështu, në libër kemi një sistem të plotë koncep-

tor - gjuhësor. Është tjetër punë pastaj përpjekja për pastërtinë e mundshme gjuhësore terminologjike.

Jemi tek emërtimet popullore të bimëve. Ato i përkasin, siç u tha, nivelit praktik - përdorimor. Ai që merret me shfrytëzimin, mbledhjen, tharjen, ruajtjen etj. të aksh bime mjekësore e do informacionin me këtë gjuhë. Por, për emërtimet popullore në libër duam të përveçojmë edhe një vlerë tjetër të tij. Tashmë për gjuhën e përbashkët letrare shqipe. Për arsye historike që dihen, gjuha shqipe është shkruar vonë., dhe pasuria e saj e vërtetë është te gjuha e popullit. Pjesë e kësaj pasurie janë edhe etnobotanizmat, d.m.th. emërtime popullore bimësh ose pjesë bimësh që rrojnë në këtë a atë të folme, të panjohura për gjuhën e sotme standarde, me vlerë letrare potenciale. Besoj se auditori nuk ka nevojë për shpjegime të tjera gjuhësore. Dhe unë them se në librin e doktor Hasanit ka mjaft fjalë popullore me vlerë letrare potenciale, më së pari, për Fjalorin kombëtar të gjuhës shqipe. Unë e kam vjelë librin (edhe gjuhësia ka termin vjel si në botanikë e në bujqësi). Ka nga ato fjalë që potencialisht mund të shkojnë deri tek termi e ta pasurojnë edhe terminologjinë e botanikës.



Autori i përshkruan me shumë kujdes e vëmendje vetitë mjekuese të 200 bimëve të Korabit. Për ne e ka këtë kujdes e këtë vëmendje. Në një botim të dytë, me siguri do të bëjë zbulime të tjera dhe numri 200 me siguri do të shtohet. Në një botim të dytë, me siguri do të gjejmë edhe etnobotanizma të tjera nga e folmja e bukur e Radomirës.

E urojmë përzemërsisht.

VEPRA & AUTORË


ARTI I PËRJETËSIMIT PËRMES PORTRETEVE DHE MONOGRAFIVE TË AUTORIT XHELAL MARKU



Fran Lleshi, poet, shkrimtar

- Pas veprës së parë “Turizmi shqiptar”, ku Xhelal Marku me një vështrim të kthjellët studimor e historik, dëshmoi resurset dhe mundësitë e mëdha, për zhvillimin me ritme të shpejta të industrisë turistike në vend, ai rikthehet me një libër tjetër në frymë, po aq me rrënjë të thella në realitetin shqiptar

Në librin e ri “Portrete & Monografi”, (vëll. i parë), autori Xhelal Marku na fton në një udhëtim njerëzor e shpirtëror, ku takohen njerëzit e punës, të dijës dhe të urtësisë - ata që me përkushtim ndërtuan jetën e një kohe dhe të një vendi. Janë minatorë, që nxirrnin flori nga nëntoka, gjeologë që njihnin zemrën e maleve, ndërtues që ngritën themelet e qyteteve, mësues që mbollën dritë në mendje, mjekë që shpëtuan jetë, shkrimtarë e drejtues, që lanë gjurmë me fjalë e vepra. Të gjithë gjejnë vend në këtë mozaik njerëzor, ku çdo



faqe është një nderim dhe një kujtesë.

Pas veprës së parë “Turizmi shqiptar”, ku Xhelal Marku me një vështrim të kthjellët studimor e historik, dëshmoi resurset dhe mundësitë e mëdha, për zhvillimin me ritme të shpejta të industrisë turistike në vend, ai rikthehet me një libër tjetër në frymë, po aq me rrënjë të thella në realitetin shqiptar.

“Portrete & Monografi” është një udhëtim drejt njeriut - drejt atyre fytyrave të përditshme, që e mbajnë në këmbë jetën, punën dhe kujtesën e një komuniteti. Në këtë vepër janë përfshirë 25 figura njerëzore, që përbëjnë një mozaik të gjerë: punëtorë e teknikë, inxhinierë, mësues, mjekë e shkrimtarë, njerëz të zakonshëm në pamje, por të jashtëzakonshëm në vlerë. Janë një galeri portretesh, që vizatohen nga dora e studiuesit dhe e shkrimtarit Xhelal Marku si: Bardhok Gjokolaj, Lek Rajta, Mahmut Laçi, Sheh Ymeri, Rrahman Doda, Nikoll Pjetër Doçi, Llesh Zef Doçi, Isuf Hysen Kuçi, Sadik Prethi, Hasan Aliu, Rifat Poga, Nuzet Xheneti, Preng Llesh Bardhoku, Dr. Mehdi Cani, Ndue Dod Gjokolaj, Sali Ajazi, Nikoll Brozi, Idriz Kukeli, Hane Mena Vladi, Prof. Dr. Hajri Shehu, Marjana Sulejmani, Haziz Mena, Gjergj Kolmarku, Dod Legisi dhe Vera Gjonaj. Përmes tyre, autori ndriçon jo vetëm individin, po edhe kohën, në të cilën ata kanë jetuar - një kohë përpjekjeesh, ndershmërie dhe përkushtimi.

Nëpërmjet portreteve, Xhelal Marku ndalet me ndjesi, me fjalë të ngrohta dhe përfytyrime të gjalla, duke i dhënë secilit frymë e ngjyrë, duke e bërë të ndjesh pulsimin e shpirtit njerëzor, ngrohtësinë e karakterit dhe fisnikërinë e thjeshtësisë. Ai nuk ndalet vetëm në biografinë e thatë, por depërton në botën shpirtërore të personazhit, në gjestet, fjalët, mënyrën e të menduarit e të vepruarit. Ndërsa në monografi, autori flet me gjuhën e kujtesës dhe të dokumentit, duke dokumentuar me përpikëri dhe duke e vendosur çdo figurë në kohën, hapësirën dhe kontributin e saj të vërtetë. Kështu, libri bëhet një bashkëbisedim mes shpir-

tit dhe arshivës, mes ndjenjës dhe faktit, mes artit dhe dëshmisë - ku çdo emër fiton peshën e përjetësisë. Në dy figura, autori ndalet pak më gjatë: tek ish-drejtori i ndërtimeve Bardhok Gjikota dhe tek mësuesi Nikoll Doçi. Tek Bardhoku, ai kujton ndërtuesin e përkushtuar, që ngrii jo vetëm godina, por edhe besimin në punë. Studiuesi e sheh portretin me syrin e një kuratori, duke e ndërtuar atë përmes: Metaforës së kullës: ku Bardhoku është një gur në themelet e trashëgimisë, përmes Atmosferës së kujtesës: ku Portreti i tij frymon, përmes kujtimeve të vendit, familjes dhe vlerave dhe përmes: Simbolikës së pasionit: ku Ai nuk përshkruhet me fjalë të zakonshme, por si një drejtues i pasionuar - si një figurë, që mbart energji krijuese dhe përkushtim.

Tek mësuesi Nikoll Doçi, autori nderon njeriun, që ndezi dritën e dijes në breza të tërë. Ai për 40 vjet me radhë, në mbi 30 shkolla, nuk reshti së punuari me dëshirën e zjarrtë të pasionit dhe vullnetin e përkushtimit, për arsimimin e mbarë brezave mirditorë në të gjithë rrethin. Madje kontributi i tij i mësimdhënies njihet edhe në rrethet e tjera fqinj, si në: Kukës, Pukë e Lezhë, ku banorët vendas dhe ish nxënësit e tij, ruajnë mbresa e kujtime të veçanta për këtë figurë të njohur e të respektuar të arsimit në Mirditë. Dhe nuk janë pak, por mbi katër mijë nxënës e nxënëse, që ka kaluar nëpër duart e tij si mësues, gjatë katër dekadave të mësimdhënies në shkolla. Në këto dy monografi, shkrimi i Markut fiton thellësi studimore, pa humbur ngrohtësinë njerëzore - një gërshetim i rrallë ndërmjet saktësisë dhe përulësisë. Portrete iu kushtohen edhe mësuesve Sali Ajazi i Lurës dhe Sadik Prethi i Luznisë në Dibër. Kështu, në tërësi, libri bart një frymë përkujtime e reflektuese. Shumë prej personazheve që përmenden nuk jetojnë më. Por, përmes fjalës së autorit, ata marrin frymë sërish - shfaqen në kujtesë si njerëz, që ecin, flasin, punojnë, japin këshilla. Kësisoj, libri bëhet një homazh për ata, që kanë lënë gjurmë, për ata që nuk kërkuan kurrrë lavdi, por e merituan me dinjitet.

Stili i Xhelal Markut është i qetë, i ndërtuar me durim dhe vëmendje. Ai nuk kërkon të bindë me fjalë të mëdha, por me thjeshtësi që depërton. Në rrëfimet e tij ndihet respekti për njeriun, për punën, për vendlindjen. Ai shkruan sikur flet me miqtë, me bashkëkohësit, me ata që i njeh dhe i ndien pranë. Pikërisht kjo e bën librin të ngrohtë

dhe të besueshëm. Nëpërmjet “Portreteve dhe monografisë”, autori dëshmon, se historia e një vendi, nuk është vetëm ajo që shkruhet në librat e mëdhenj, por ajo që ruhet në kujtimet e njerëzve të thjeshtë, në jetët e tyre të heshtura, në vlerat që mbeten pas. Kjo është një histori njerëzore, e ndërtuar me dashuri dhe kujdes, që flet për vlera të përbashkëta - për ndershmëri, besnikëri, punë e përkushtim.

“Portrete & Monografi” është më shumë se një përmbledhje shkrimesh - është një akt falënderimi ndaj brezave, që punuan me ndershmëri, duke lënë pas gjurmë, që nuk i fshin koha. Ai nuk është vetëm kujtesë për njerëzit e shquar të punës e dijes, por edhe një nderim për vlerat që mbajnë gjallë shpirtin e një kombi. Në çdo faqe librit, ndien praninë e autorit si dëshmitar dhe bashkëkohës, si një njeri që nuk kërkon të gjykojë, por të kuptojë. Prandaj, “Xhelal Marku - mes portreteve dhe monografisë” nuk është vetëm një titull, por një pozicion shpirtëror dhe krijues. Një vend ku njeriu takohet me kujtesën, ku fjala bëhet urë midis jetës dhe kujtimit, midis së djeshmes që ikën dhe së sotmes që ende e ndien mungesën e saj. Ndaj, në fund të leximit, mbetet ndjesia e mirë, se ke kaluar nëpër njerëz të vërtetë - njerëz që kanë ndërtuar, që kanë mësuar, që kanë jetuar me dinjitet. Dhe ndoshta ky është edhe mesazhi më i bukur i këtij libri: se jeta e njeriut nuk shuhet, për sa kohë kujtohet me dashuri...! Teksa përfundon së lexuari, këtë libër, të mbeten në mendje shumë figura të realizuara, si ato të Gjergj Kolmarkut, inxhinierit Dod Legisi ashtu dhe e të shkrimtareve dhe poeteve Vera Gjoni e Marjana Sulejmani.

Një vlerësim të veçantë tek libri: “Portrete & Monografi”, i autorit Marku, meriton edhe redaktori i librit, poeti dhe shkrimtari Zekrija Idrizi, i cili ka dhënë një kontribut të çmuar në strukturimin dhe pasurimin stilistik të veprës. Me ndjeshmëri gjuhësore dhe intuitë letrare, ai ka ndihmuar, që fjala të rrjedhë natyrshëm, duke ruajtur frymën e kujtesës dhe përkushtimin e autorit. Shpresojmë që ky libër, të shërbejë si hap i parë për reflektime dhe studime të mëtejshme, duke i hapur autorit rrugë, për të thelluar dokumentimin dhe analizën e figurave që përshkruan.

Urime autorit Xhelal Marku për këtë përmbledhje unike, ku portretet dhe monografitë bashkëjetojnë për të ruajtur kujtesën dhe nderuar jetët e njerëzve të shquar.

VEPRA & AUTORË

Në 65-vjetorin e ditëlindjes së Halil Ramës dhe promovimit të librit të tij të ri “Oda Dibrane”

HALIL RAMA, KRIJUESI QË NGRITI FJALËN NË KULT TË MEMORIES KOMBËTARE



Dr. Mujë Buçpapaj

1.

28 Tetor 2025 - Sot, në këtë përvjetor të shënuar, përulemi me respekt e nderim përballë një personaliteti të kulturës bashkëkohore shqiptare, mikut tim Halil Ram, publicistit, poetit, prozatorit, monografistit dhe studiuesit, i cili prej më shumë se tri dekadash ka shenjuar me përkushtim, finesë dhe qëndrueshmëri një itinerar të plotë të fjalës së shkruar dhe të mendimit intelektual shqiptar.



Në panoramën e letrave shqipe të fundit të shekullit XX dhe fillimshkullit XXI, emri i Halil Ramës shfaqet si një ndër zërat më të qëndrueshëm, më të përkushtuar dhe më poliedrikë të publicistikës dhe të kulturës shqiptare bashkëkohore. Poet, prozator, publicist, studiues dhe veprimtar i shquar i fjalës artistike dhe mendimit

kombëtar, Rama i ka dhënë letërsisë dhe mendimit publik shqiptar një profil të veçantë, profilin e intelektualit që e shenjtëron fjalën, historinë dhe identitetin. Në çdo fushë të veprimtarisë së tij, ai ka ndërthurur me mjeshtëri krijimtarinë estetike me ndërgjegjen qytetare, duke u bërë një dëshmitar i ndjeshëm i kohëve dhe një ruajtës i denjë i kujtesës së përbashkët.

Në fushën e poezisë, Halil Rama përfaqëson një traditë të ndritur të frymëzimit historik e atdhetar, ku vargu shndërrohet në një akt vetëdijeje kombëtare. Ciklet poetike “Frymëzime nga historia”, “Vendlindja”, “Familja” dhe “Personalitete në vargje” përbëjnë një korpus të pasur poetik që vjen si ndërthurje e kujtesës me meditimin, e mitit me realitetin, e përkushtimit me reflektimin filozofik. Vargu i tij është i disiplinuar, por emocionalisht i dendur; në të ndërthuren muzikaliteti popullor me një ritëm epiko-lirik që e ngre poezinë e Ramës në nivelin e një “arkeologjie shpirtërore” shqiptare. Nëpërmjet figurash si Skënderbeu, Haki Stërmilli, Margarita Xhepa apo Shefki Karadaku, poeti ndërton një panteon moral e artistik të kombit, duke i kthyer personalitetet reale në simbole të pavdekshme të dinjitetit e mendimit.

2.

Krijimtaria poetike e Halil Ramës përfaqëson një simbiozë midis atdhedashurisë, kujtesës historike dhe ndjeshmërisë së hollë njerëzore, duke shfaqur një vizion poetik ku historia kombëtare ndërthuret me përvojën intime e familjare. Vargu i tij, i ndërtuar mbi një strukturë metrikore të qartë dhe shpesh me tonalitet elegjiak, mbart një funksion dokumentues e identitar: poeti nuk e sheh historinë si mit të ngrirë, por si frymë të gjallë që vazhdon të ripërtërihet në ndërgjegjen e kombit. Në ciklet “Frymëzime nga historia” dhe


“Vendlindja”, Rama i jep dimension metafizik toponimisë dibrane, duke e sublimuar atë në një hapësirë simbolike ku bashkohen kujtesa, sakrifica dhe krenaria. Poezitë si “Vendlindja e Skënderbeut” apo “Oda dibrane” shndërrohen në arkeologji shpirtërore, ku fjalët janë gurë themeli të një identiteti që sfidon harresën.

Analizë stilistiko–figurative e poezisë së Halil Ramës

Krijimtaria poetike e Halil Ramës në këtë libër përbën një kontribut të veçantë në letrat bashkëkohore shqipe, në të cilën spikatin përmasat estetike të fjalës së kultivuar, përqendrimi figurativ dhe ndërthurja harmonike midis tonit lirik dhe atij epiko–patriotik. Poezia e tij është një formë e ligjërimit poetik që mbart vlera identitare, etike dhe artistike, duke e kthyer fjalën në mjet memorie dhe në instrument të vetëdijes kombëtare.

Në planin figurativ, Halil Rama përdor një sistem tropesh të gërshetuar me elemente të frazeologjisë tradicionale dibrane, ku metafora, epiteti, paralelizmi dhe simboli marrin funksionin e përforcimit të vlerave shpirtërore dhe morale. Poezia “Oda dibrane” është një tekst paradigmatic për këtë frymë poetike: oda shndërrohet në simbol të identitetit kolektiv shqiptar, në një hapësirë ku ndërthuren besa, qëndresa dhe mikpritja – tri shtylla themelore të etikës tradicionale dibrane. Përsëritja anaforike e vargut “Oda dibrane:” në fillim të çdo strofe krijon një strukturë ritmike–rituale, që i jep poezisë një karakter himnik dhe sakralizues, ndërsa figura e metonimisë realizohet përmes bashkëlidhjes së elementeve konkrete (“çerdhe e patriotizmit”, “vatër mikpritje”) me koncepte shpirtërore të vlerës kombëtare.

Në poezinë “Nëna ime, më e mira...”, ndjenja individuale merr përmasa universale përmes



hiperbolës dhe personifikimit moral, ku nëna përfaqëson parimin e mirësisë absolute. Vargu “ajo që vetë mirësia” është shembull tipik i metaforës identifikuese, ku nocioni i mirësisë përshkruhet jo si cilësi, por si thelb ontologjik i figurës amtare.

Poezia “Me penë e pushkë” shfaq një ndërthurje të diskursit historik me atë estetik, përmes një metafore binare që sintetizon veprimin intelektual dhe atdhetar. “Pena” dhe “pushka” funksionojnë si dy pole semantike që përfaqësojnë dijen dhe sakrificën, ndërsa shprehja “Bombë e flamur e kishte veprën” është një metaforë alegorike, ku fjala e shkrimtarit barazohet me aktin çlirimtar. Në këtë mënyrë, Rama afirmon idenë e fjalës si forcë vepruese, një motiv që përshkon tërë poetikën e tij.

Në “E Madhërishmja Margaritë”, poeti arrin një sublimim estetik të figurës artistike, përmes epiteteve të vlerësuara (“e madhërishme”, “margaritare”) dhe metaforës së Feniksit, simbol i pavdekësisë shpirtërore dhe artistike. Këtu ndodh transcendenca e figurës njerëzore në mit poetik, çka dëshmon për prirjen e autorit drejt estetikës së përjetësimit.

Në poezitë kushtimore si “Shefki, Shefki...”, “Teodor Laços” dhe “Në kujtim të Kolit”, Rama përfaqëson figurën e krijuesit si archetip kulturor, duke i dhënë dimension etično–estetik aktit të krijimit. Përdorimi i paralelizmit sintaksor (“në ditën që vdiqe, linde sërish”) dhe kontrastit midis jetës dhe vdekjes e përforcon idenë e pavdekësisë përmes artit.

Në “I urti dhe i mençuri Sulë Dika”, autori i rikthehet diskursit etno–moral, duke portretizuar figurën e mençurisë popullore në trajtë proverbiale. Përdorimi i dialogut poetik dhe i figurave sentenciale (“Burrin e prishin tre gjana...”) i jep tekstit një karakter aforizmatik, ku poezia shndërrohet në bartëse të filozofisë jetësore dibrane.

Në poezinë “Të fitosh titullin Njeri”, Rama afirmon njeriun si kategori etike, duke përdorur metaforën morale (“e shkroi librin e jetës”) dhe epitetet e fisnikërisë shpirtërore (“duararti”, “mendjendrituri”). Kjo poezi përfaqëson një formë të poetikës së humanizmit, në të cilën njeriu është masë dhe vlerë e çdo veprimi krijues.

Në fund, në “Arti bashkon dy Dibrat” dhe “Lot shpirti për Kosovën”, Halil Rama arrin di-

mensionin pan-shqiptar të poetikës së tij, duke përdorur metafora të zjarrit, fluturimit dhe dritës si shenja të unitetit dhe lirisë kombëtare. Figura e shqipes, në vargun “Fluturon shqipja mbi Korab”, përfaqëson simbolin arketipal të identitetit shqiptar, që përkon me motivin e bashkimit shpirtëror përtej kufijve politikë.

Në përfundim, gjuha poetike e Halil Ramës karakterizohet nga pastërti leksikore, sintaksë ritmike dhe ngarkesë e lartë figurative. Ai ndërthur traditën etnografike me dimensionin modern të ligjërimit poetik, duke ndërtuar një poetikë të kujtesës kolektive dhe moralit kombëtar. Përmes fjalës së matur e simbolit të ngjeshur, Rama ngre një univers poetik ku përbashkohen historia, arti dhe humanizmi shqiptar.

Proza

Në prozën e tij tregimtare Halil Rama shpalos një univers estetik ku ndërthuren realizmi kritik, simbolika filozofike dhe reflektimi antropologjik mbi natyrën njerëzore, erotizmin dhe moralin.

Tregime si “Dashuri të stuhishme në ‘Plazhin e Gjeneralit’”, “Zonja me tri shtetësi dhe tri shtëpi” dhe “Rebelimi i qenit Mavis” dëshmojnë një autor që zotëron aftësinë për ta kthyer përditshmërinë në hapësirë semiotike, ku ndeshen pasionet, kujtesa dhe ndërgjegjja shoqërore.


Rama ndërton rrëfimin si një palimpsest ku shtresat e realitetit bashkëjetojnë me ato të mitit dhe nënvetëdijes: deti në “Plazhin e Gjeneralit” bëhet metaforë e eros-it si energji ringjallëse dhe dekadente; femra nomade e “Zonjës me tri shtetësi” shndërrohet në simbol të mbijetesës dhe vetëpërbushjes përmes transformimit identitar; ndërsa qeni Mavis, në rebelimin e tij arketipal, përfaqëson revoltën e natyrës ndaj hipokrizisë morale të njeriut. Në të tria këto rrëfime, Halil Rama e përdor erotizmin jo si qëllim sensual, por si mjet epistemologjik për të zbuluar mekanizmat

e pushtetit, nënshtrimit dhe lirisë. Diskursi i tij narrativ lëviz me finesë ndërmjet groteskut dhe ironisë, introspeksionit psikologjik dhe filozofisë së instinktit, duke krijuar një stil që mund të quhet postrealist në strukturë dhe antropologjik në përmbajtje. Në thelb, proza e Ramës është një reflektim i thellë mbi qenien – mbi mënyrën si dashuria, mëkati dhe besnikëria ndërthuren për të formësuar dramën e njeriut modern që endet midis kujtesës, trupit dhe shpirtit.

Tek tregimi në ‘Plazhin e Gjeneralit’, Halil Rama ndërthur me mjeshtëri realizmin kritik me simbolikën e eros-it si shenjë të ringjalljes së njeriut përballë dekadencës morale dhe rrënim-it shoqëror. “Plazhi i gjeneralit” shndërrohet në një hapësirë alegorike, ku përplasen dy botë: ajo e mitologjisë politike të së shkuarës totalitare, e mishëruar nga gjenerali i pragshekullit, dhe ajo e banalitetit konsumist të tranzicionit, e përfaqësuar nga Maksi, gazetari i zhgënjyer. Rama e përdor detin si metaforë të pasioneve të errëta e të stuhishme, një hapësirë e lëngshme ku përzihen dëshirat, kujtesa dhe dështimet. Brenda kësaj topografie semiotike, dashuria e papritur e Valdetes për gjeneralin fiton përmasat e një paradoksi ekzistencial — eros si akt i shpëtimit dhe njëkohësisht i poshtërimit, ku trupi bëhet arenë e ringjalljes dhe dekadencës.

Në planin stilistik, autori shfaq një ndjeshmëri të hollë ndaj gjuhës figurative dhe ironisë situative.

Ai përdor një realizëm sensual me ngjyrim grotesk, ku detaji erotik nuk shërben për provokim, por për të zbuluar zbrazëtinë morale të epokës postdiktatoriale. Dialogët ndërmjet Maksit dhe gjeneralit janë ndërtuar me një finesë dramatike që i jep tregimit tonin e një eseje morale të maskuar. Teksa përplasen ideologjia e vjetër dhe rel-



ativizmi i ri moral, përmes Valdetes krijohet një figurë gati biblike e femrës që ringjall, provokon dhe shkatërron njëkohësisht. Në këtë kuptim,

Rama shfaq një aftësi të rrallë për të kapur erosin si energji arketipale të historisë, duke e kthyer tregimin në një pasqyrë të pasioneve njerëzore që sfidojnë kufijtë e moshës, moralit dhe sistemit.

Në planin kompozicional e stilistik, në tregimin “Zonja me tri shtetësi dhe tri shtëpi” Rama lëviz me finesë ndërmjet realizmit dokumentar dhe estetikës psikologjike introspektive. Gjuha e tij është fluide, ritmike, e mbarsur me figura të ndërtuara me kujdes letrar: kontraste të dritës dhe errësirës, të puritetit dhe mëkatit, të nderit dhe përuljes. Autori i jep tregimit një dimension postmodern, ku biografia personale bëhet tekst i historisë dhe erotika shndërrohet në instrument të shpërbërjes së kufijve moralë e kulturorë. “Zonja me tri shtetësi” është, në thelb, një metaforë e femrës shqiptare që kalon nga sakrificat e vetëpërmbytjes, një simfoni e identiteteve që ndërtohen mbi humbje, por përfundojnë në afirmim.

Në tregimin “Rebelimi i qenit Mavis”, Halil Rama realizon një ndërthurje mjeshtrorë midis realizmit të detajit dhe simbolizmit filozofik, duke përdorur një strukturë rrëfimorë që lëviz ndërmjet tri planeve kohore dhe psikologjike: realitetit bashkëkohor familjar, kujtesës së fëmijërisë dhe metaforës universale të besnikërisë e revoltës. Në thelb, tregimi është një meditim mbi marrëdhënien midis njeriut dhe instinktit, mbi kufijtë e arsyes, moralit dhe pasionit që shfaqen si energji të pashlyeshme në çdo qenie të gjallë, njerëzore apo shtazore.

Në planin e parë, Mavis, qeni i mbesës së rrëfimtari, shfaqet si figurë e instinktit të shtypur. Ndërsa mbetet i izoluar, i braktisur nga njerëzit për shkak të rregullave shoqërore dhe moralit të nënkuptuar (“nuk merret qeni në plazh”), ai shpërthen me një akt rebelimi arketipal, ndotjen, rrëmbimin e objekteve, prishjen e rendit. Ky veprim nuk është thjesht hakmarrje e kafshës, por shenjë e revoltës së natyrës ndaj hipokrizisë njerëzore, që e shenjtëron dashurinë e vet, por e ndëshkon instinktin e tjetrit. Rama e ndërton këtë situatë si një paradigmë të nënshtrimit dhe ringritjes së natyrës, duke e parë Mavisin si figurë që e përfaqëson rebelimin ndaj kufizimeve të mo-

ralit borgjez. Në planin e dytë, përmes kujtesës së rrëfimtari për mixhën Arif dhe episodin erotik në mal, autori realizon një kalim të guximshëm nga anekdota realiste në rrëfim antropologjik. Erotika e njeriut dhe e kafshës shfaqet në një paralelizëm tronditës, që thekson unitetin e pulsit jetësor, por edhe hipokrizinë morale të shoqërisë patriarkale shqiptare, që e dënon sensualitetin, ndërsa e kultivon në fshehtësi. Këtu ndjejmë ndikime të dukshme të Freudit dhe Bataille-it, ku erotizmi trajtohet si energji transgresive që e sfidon ligjin dhe normën për të riafirmuar lirinë e trupit. Përmes këtij rikthimi kujtese, rrëfimtari shndërrohet në vetëdije ndërbreznore të njeriut që përjeton ndalimin si trashëgimi morale.

Dimensionin e formimit dhe të ethosit intelektual

Figura e Halil Ramës përfaqëson modelin e intelektualit që ndërthur harmonikisht racionalen me intuitiven, faktin me ndjenjën, analizën me estetikën. Ai është përfaqësues tipik i asaj kategorie krijuesish që e shohin gazetarinë dhe letërsinë jo si fusha të ndara, por si dy rrafshë komunikimi që ushqejnë njëra-tjetrën: gazetaria si akt dokumentues i së vërtetës dhe letërsia si sublimim i shpirtit dhe i përjetimit njerëzor.

Në thelb të këtij profilit krijues qëndron një etos i lartë qytetar dhe humanist, që e bën Halil Ramën të jetë jo vetëm dëshmitar i kohës së tij, por edhe ndërgjegje kritike e saj.

Formimi i tij universitar në fushën e drejtësisë dhe përvoja profesionale si avokat i kanë dhënë penës së tij një shkallë të lartë racionimi analitik, një prirje për verifikim dhe argumentim, që më pas janë shndërruar në elemente përbërëse të metodës së tij kërkimore dhe interpretative.

Në këtë mënyrë, krijimtaria e tij përfaqëson një model epistemologjik të ndërdisiplinaritetit, ku arti i fjalës bashkëjeton me logjikën e shkencës.

2. Publicistika si ndërgjegje qytetare dhe kronikë kohe

Në hapësirën e gazetarisë shqiptare, Halil Rama ka zënë një vend të veçantë si një zë reflektiv dhe i besueshëm, i cili e sheh realitetin jo në formën e spektaklit, por të procesit shoqëror e etik.


Artikujt dhe analizat e tij janë shembuj të pub-

licistikës me vlerë dokumentare dhe interpretative, ku fjala nuk është instrument retorik, por mjet ndërgjegjësimi kolektiv.



Në gazetën Rilindja Demokratike, ku patëm fatin të punojmë së bashku për shumë vite, Halili spikati për integritetin profesional, qartësinë konceptuale dhe kulturën e debatit argumentues.

Ai i dha fjalës dimensionin e përgjegjësisë publike, duke e trajtuar gazetarinë si akt qytetar, jo si mjet propagandistik.



3. Letërsia dokumentare dhe monografizimi i kujtesës kombëtare

Në universin e gjerë të krijimtarisë së tij, Halil Rama ka ndërtuar një poetikë të veçantë të dokumentit dhe të kujtesës.

Në mbi tridhjetë veprat e tij letrare e studimore, spikat prirja për ta shndërruar figurën njerëzore në metaforë të kohës dhe për ta lidhur biografinë individuale me narrativën historike të kombit.

Monografitë si “Dine Hoxha – Një filozof popullor në Oborrin Mbretëror”, “Muharrem Xhediku – Kompozitori i tangos shqiptare”, “Rrahman Parllaku – Një legendë në kufirin e dy kohëve”, “Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave” apo

“Të fitosh titullin Njeri”, nuk janë thjesht shkrime biografike, por studime të tipologjisë së njeriut krijues dhe të intelektualit shqiptar.

Në këto tekste, Rama arrin të krijojë një raport organik ndërmjet faktit dhe interpretimit, duke ndërtuar portrete që ruajnë autenticitetin historik, por që njëkohësisht përshkohen nga një lirizëm i përmbajtur dhe një humanizëm i thellë narrativ. Ai është mjeshtër i personazhit real të poetizuar, që flet me tonin e jetës, por tingëllon me emocionin e artit.

4. Kërkimi estetik dhe metodologjia shkencore

Në planin teorik, vepra e Halil Ramës shfaq një strukturë metodologjike të konsoliduar, që ndërtohet mbi tri shtylla kryesore:

Empiria dokumentare – kërkimi sistematik në burime të para dhe dëshmi të drejtpërdrejta;

Analiza hermeneutike – interpretimi i jetës dhe veprës së personazheve në kontekstin historik dhe kulturor;

Estetika e rrëfimit – përthyerja e të dhënave në një gjuhë artistike, të përkorë e emocionale.

Në këtë mënyrë, Rama arrin të krijojë një diskurs hibrid ndërmjet letërsisë dhe historiografisë, që e pasuron panoramën e kritikës dhe të monografizmit letrar shqiptar bashkëkohor.

Në tekstet e tij spikat një sintaksë e dendur poetike, e mbështetur në figuracionin e pasur dhe në një ndjeshmëri të lartë gjuhësore, ku fjalët nuk emërtojnë vetëm realitetin, por e riformësojnë atë.

5. Dibra si arketip kulturor

Në shumicën e veprave të tij, Dibra shfaqet si topos i identitetit, si hapësirë e kujtesës dhe burim i pashtershëm i mitologjisë së karakterit shqiptar. Në librat “Muhurri, histori dhe personalitete” dhe “Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave”, autori projektton një panteon shpirtëror të krahinës, ku individualitetet dibrane shndërrohen në arketipe të përbashkëta të kulturës shqiptare.

Nëpërmjet tyre, Halil Rama krijon një model të identitetit lokal që rrezaton universalisht, duke i dhënë letërsisë shqiptare një përmasë të re të lidhjes mes vendlindjes dhe atdheut shpirtëror.

6. Kontributi audiovizual dhe dimensionin multidisiplinar

Si skenarist dhe bashkautor i 12 dokumentarëve televizivë, Halil Rama ka projektuar në ekran portretin filmik të kujtesës kombëtare, duke e zgjeruar kufirin e veprës së tij nga fjala në imazh.

Këto dokumentarë, që variojnë nga figurat e Rrahman Parllakut e deri te Mehdi Luca apo Dine Hoxha, përbëjnë një arkiv të gjallë të kulturës kombëtare, ku historia, arti dhe personaliteti njerëzor ndërthuren në një narrativë integruese.




7. Përmbyllje

Në thelb të gjithë këtij universi krijues qëndron njeriu – si kategori etike dhe shpirtërore.

Halil Rama, në jetë dhe në art, është i përshkruar nga një humanizëm aktiv, i cili nuk e trajton njeriun si objekt studimi, por si qenie me dritë të brendshme, me dinjitet dhe kujtesë.

Kjo qasje e bën atë një shkrimtar të frymës së mirë, të dashurisë për tjetrin, të etikës së fjalës dhe të përunjësisë njerëzore.

Në peizazhin e letërsisë dhe mendimit shqiptar bashkëkohor, figura e Halil Ramës ngrihet si një shtyllë shumëplanëshe që bashkon në vetvete poetin dhe prozatorin, studiuesin dhe publicistin, mendimtarin e fjalës dhe hulumtuesin e shpirtit kombëtar. Në më shumë se katër dekada veprimtari, ai ka krijuar një univers që nuk njih



kufij mes artit dhe dijes, mes etikës dhe estetikës, mes realitetit të përditshëm dhe metafizikës së njeriut. Krijimtaria e tij është një lëvizje e pandërprerë nga fjala drejt mendimit, nga përvoja drejt reflektimit, nga përshkrimi drejt shpjegimit, një proces që i jep autorit statusin e rrallë të një intelektualit të ndërgjegjes kombëtare.

I uroj miku tim Halil Rama, jetë të gjatë plot shendet dhe krijimtari!

*Fjala e mbajtur në 65-vjetorin e Halil Ramës dhe promovimit të librit të tij të ri "Oda Dibrane", në salln e Kinemasë "Maks Velo", Laprakë, Tiranë.



VEPRA & AUTORË

“ODA DIBRANE” NË FILADELFIA



Nga Rajmonda Maleçka

“Oda dibrane në Filadelfia”! Ashtu siç e ka patur gjyshi i tij patriot Tafë Daut Sllatina dhe pothuajse siç e kishte ideuar dhe mbajtur për vite të tëra Hakiu në zyrën e tij të punës kur drejtonte një nga strukturat kryesore të Ushtrisë shqiptare në ish – Brigadën e Muhurrit të divizionit ushtarak të Dibrës si dhe në Komisaratin e Policisë Peshkopi, pas ‘90-tës. Si atëhere edhe sot, brenda kësaj ode spikat koncepti kombëtarist i një shqiptari me zemër të madhe...



Një dokumentar televiziv i përgatitur nga gazetarja e njohur në diasporën shqiptare Eva Dori, kushtuar “Odës dibrane” në Filadelfia të SHBA, ndër të tjera paraqet dhjetra tituj Nderi e Mirënjohje për themeluesin dhe administratorin e saj. Gjithsesi për Haki Çollakun, kontributorin dhe mbështetësin në vijimëri të shoqatës “Bijtë e Shqipes” dhe Shkollës shqipe “Gjuha Jonë” në Filadelfia, vlerësimi që i bëri Këshilli Bashkiak i Dibrës, duke i dhënë titullin “Qytetar Nderi” i

bashkisë më të madhe të qarkut verilindor është më i rëndësishmi e më i veçanti për të e familjen e tij. Kjo edhe për vetë motivacionin e këtij titulli: “Për kontributin e tij në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dibrane përmes krijimit dhe mirëmbajtjes së ‘Odës Dibrane’ në Filadelfia, një hapësirë autentike që mishëron mikpritjen, burrërinë dhe lidhjen shpirtërore me Atdheun.”

Brenda këtij motivacioni, në pak fjalë është institucioni më i veçantë që dibranët kanë krijuar në shekuj, dekada e vite: “ODA DIBRANE”.

Ajo është simbol i vatrës bujare, besa e burrit, qëndresa e trimit, mençuria e fjalës, kënaqësia e muhabetit, sheshi i përplasjes së opinioneve, urtësia e më të moshuarve, këshilla e prindit, përkrahja e mikut, shpërthimi i këngës, sheshi i kërcimit, jehona e të qeshurit, kuadrati i lodrave, dashuria e respekti midis njerëzve, zanafilla e ngjarjeve, fundi i armiqtësive, tempull për pleqtë, shkollë për të rinjtë, çerdhe e patriotizmit, burim i humorit. Oda është grumbullim njerëzish, miq,

të afërm, farefis, komshinj, për arsye gëzimi, sepse hidhërimi, mikpritjeje të të ftuarve apo udhëtarëve nga larg...

Thuajse të tillë e ka konceptuar, ideuar e ndërtuar atë Haki Çollaku edhe në Filadelfian-an e Amerikës së largët, ku siç tha në fjalën përshëndetëse vizitori i saj në disa herë të vajtjes në Amerikë, Nënkrjetari i Federatës së Paqes Universale

Shqipëri Abdulla Domi (ish-kryetar i këshillit të Qarkut Kukës): “Aty gjen Flamurin tonë kombëtar, portretin e Skënderbeut dhe të burrave të tjerë të kombit, derën e hapur dhe sofrën e mikpritjes, kësulën e bardhë dhe tirqit me koprane, gëzofin e leshtë dhe fyellin e gjatë, gjen kutinë e duhanit dhe takamet e kafes, librat e shenjtë dhe tespijtë, çiftelinë dhe sharkinë, dajren dhe akse-sorët e ahengut, veglat e punës së ustait dhe gjithshka tjetër që e lidh me vendlindjen...”

“Oda dibrane në Filadelfia”! Ashtu siç e ka patur gjyshi i tij patriot Tafë Daut Sllatina dhe pothuajse siç e kishte ideuar dhe mbajtur për vite të tëra Hakiu në zyrën e tij të punës kur drejtonte një nga strukturat kryesore të Ushtrisë Shqiptare në Brigadën e Muhurrit të ish – divizionit ushtarak të Dibrës si dhe në Komisarriatin e Policisë Peshkopi, pas ‘90-tës. Si atëhere edhe sot, brenda kësaj ode spikat koncepti kombëtarist i një shqiptari me zemër të madhe.

CEREMONIA....



Në ditën e parë të gushtit përveç të kësaj kwtij viti, qindra të pranishmit në sallën e konferencave të Ambasadës së FPU në Tiranë patën mundësinë të shikojnë nga afër dhomën dibrane të Filadelfias, kostumet tradicionale dibrane, instrumentat popullore, çifteli, sharki, fyej, sofër dibrane etj, dhe të kuptojnë veçantitë dhe rëndësinë e ruajtjes e promovimit të tyre. Ky event që u moderua me mjeshtri të rrallë artistike nga Mjeshtri i Madh Defrim Methasani dhe ku performoi si rrallë herë edhe artisti shqiptar me famë botërore Xhevat Limani (që ngjalli emocione të forta tek recitoi vargjet lapidare “Mbahu nënë mos ki frikë se ke djemtë në Amerikë”), u realizua në një atmosferë argëtuese dhe edukative, duke i bërë të pranishmit të ndihen krenarë për identitetin tonë kombëtar.

Ceremonia u karakterizua nga një atmosferë mbresëlënëse, ku u ndërthurën fjala, kënga, kujtimet dhe ndjenja e përkatësisë. Veçanërisht emocionuese qe fjala e mbesës së tij, Manjola Vasmatics, Presidente e Federatës së

Familjes, që e konsideroi këtë një veprimtari të jashtëzakonshme dedikur Haki Daut Çollakut – trashëgimtar i një gjaku patriot dibran, kontribues i palodhur në ruajtjen dhe lartësimin e vlerave dhe traditave tona, me rastin e marrjes së titullit “Qytetar Nderi” i Dibrës.

“E them me gojën plot, që ky titull shkon edhe për gjakun që rrjedh në venat e tij – për gjyshërit tanë që i janë përkushtuar atdheut me ndershmëri dhe sakrificë. Familja e Tafë Dautit, një figurë autoritare dhe përbashkuese kombëtare, që të ngjallte besim, njihet për mikpritjen dhe bujarinë,

për ndihmën në luftën Nacionalçlirimtare (Shtëpia e tij ka qenë dhe mban pllakën “Bazë e LANÇ) dhe ndikimin e vazhdueshëm përparimtar për atë kohë...”, tha ndër të tjera Manjola.

BARTËS DHE PËRÇUES I VLERAVE TË FAMILJES

Ashtu si para katër vitesh (10 tetor 2021) kur Haki Çollaku organizoi një takim

vëllazëror të ndërtesa e re e shoqatës “Bijtë e shqipes” për promovimin e librit “DAUT TAFË SLLATINA” (Kujtime, poezi e prozë), një takim vëllazëror i kthyer në një ditë feste, ku mbizotëronin në gjithë mjedisin e sallës së takimit flamujt kombëtar shqiptarë dhe ata amerikan, edhe në 1 gushtin e këtij viti, në fasadën e sallës moderne të Ambasadës së Federatës së Paqes në Tiranë përkrah flamurit kombëtar shqiptar ishin shpalosur fotot e të paharruarve Mustafë Daut Sllatinës dhe të “Haxhi” Daut Tafë Çollakut.

Dhe ashtu si para katër vitesh në Filadelfia edhe në këtë ditë të vlerësimit të nipit të tyre, Hakiut, këtu në këtë sallë komode në zemër të metropolit shqiptar, nga qindra pjesëmarrësit, u ndoq me shumë interes interpretimi i këngës kushtuar Tafë Daut Sllatinës, nga rapsodët popullor, lumjani i nderuar Xhevahir Marku dhe Fatjon Dervishi – djali i këngëtarit legjendar, të paharruarit Sherif Dervishi – Mjeshtër i Madh.

Kësisoj “Bijtë e shqipes” në Amerikë, ndër protagonistët kryesorë të së cilës është edhe Haki

Çollaku, përcjellin jehonën e traditës familjare, krahinore e kombëtare shqiptare.

Ndaj dhe në këtë takim mbresëlënës kukësiani model Adbulla Domi, në fjalën e tij veçon Hakiun edhe si prind, që së bashku me bashkshorten Dhuratën rritën dhe edukuan një vajzë ekselente, Hatixhen (Tixhi) e cila shërben si eprore në rradhët e Ushtrisë Amerikane, si dhe një djalë si Driloni për ta pasur zili.

Ndërsa dr. Hajri Mandri vlerëson se “Hapja dhe frekuentimi i Odës dibrane në Filadelfia të Amerikës, është referenca më domethënëse që simbolizon dashurinë dhe përkushtimin për vendlindjen, si leitmotiv i përhershëm i mallit dhe dashurisë që krijon jeta në emigrim, është referenca më domethënëse që shpreh dashurinë për të kaluarën e historisë dhe kulturës dibrane dhe më gjërë, është shtysa shpirtërore dhe estetike që e lidh autorin dhe drejtuesin e këtij instituti shpirtëror, real e material, Odës dibrane, ku mblidhen ata që kanë po të njejtën dashuri, po të njejtin mall, po të njejtin përkushtim ndaj vendlindjes dhe atdheut. Kjo shtysë dhe kjo forcë magjike, e ka shtyrë Haki Çollakun drejt itakës së tij shpirtërore, duke e shembëllzuar atë në Amerikë. Kushdo që shkon në Filadelfia, kalon dhe lexon emërtimin e një godine në bulevard të qytetit: “Oda Dibrane”, nuk ka se si të mos surprizohet dhe të mrekullohet njëkohësisht, duke menduar kush e krijoi këtë”.

Po. Haki Çollaku ka të drejtë legjitime që edhe në këtë takim të nderimit të tij me titullin më të lartë që jep organi më i lartë i qeverisjes vendore Dibër, të ndjehet më krenar se kurrë që mishëron dhe përçon mençurinë dhe vizionin larpamës të gjyshit të tij patriot Tafë Daut Sllatina. Të atij burri të madh dibran që njihej në gjithë Dibrën për bujarinë, mikpritjen, sofrën e madhe që shtonte në shtëpinë e tij për çdo natë për miqtë, çka i jepte një status ekstra për shkak të reputacionit dhe “bukës së dhënë” duke fituar të drejtën që të bënte një refuzim elegant të sistemit. Bashkëkohësit e mbajnë mend atë kur në mjedise miqsh në mexhelise burrash shpesh herë thoshte: “Jemi mirë, por do ishte më mirë të kishim nga tre dynim tokë, 20 berra bagëti dhe lirinë fetare”. Me këto pohime publike në kohën e shkuar të sistemit monist, dikush tjetër mund ta pëson-



te keq, por jo Tafë Sllatina që fliste si njeriu që e kishte mbështetur Luftën Nacionalçlirimtare dhe kishte kontribuar shumë në të. Kështu ai kishte fuqi të sfidonte sistemin duke i kundërqëndruar me filozofinë e tij pragmatiste.

Dhomën e vogël, por me shumë vlerë në Filadelfia, ku banon me pasion e dëshirë, me guxim, vizion bashkohor e përkushtim atdhetar, Haki Çollaku jo më kot e ka pagëzuar “Oda Dibrane”. Për mesazhet që përcjell tek vizitorë të shumtë, jo vetëm të komunitetit shqiptar, por edhe amerikanë, dikush e ka quajtur “Ambasada dibrane në diaporë”. Dhe padyshim, që “ambasadori” H. Çollaku, edhe në këtë ceremoni solemne do t’i mahniste qindra pjesëmarrësit me fjalën e tij të magjishme. Kështu i magjeps vizitorët e shumtë të kësaj ode emblematike (që e prezanton me kënaqësi të veçantë edhe në këtë fjalë magjepsse përmbyllëse të këtij takimi), brenda së cilës ata gjejnë: portretin e Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu; një minikonak kushtuar familjes së Taf Dautit; ormanente konaku si sofa; një stendë me vegla artizanale ndërtimi e bujqësie; kënde të instrumentave muzikore e kostumeve popullore, foto të trevave dibrane; kënde të ndryshme familjare e personale.

Takime të tilla i shërbejnë forcimit të unitetit mes bijve e bijave të kësaj familje të madhe, fisit e mbarë dibranëve.

VEPRA & AUTORË

PROF. DR. FLORI BRUQI, ME “DIADEMË LETRARE V”



Nga Akademik PHD, Eshref Ymeri


- **Krijimtaria e akademikut Flori Bruqi shtrihet në disa fusha të dijes. Ky libër, i shtatëdhjeti në serinë e pasur të botimeve të tij, dëshmon pa mëdyshjen më të vogël se ai karakterizohet nga një forcë e jashtëzakonshme e vullnetit.**

Vitin e kaluar, Shtëpia Botuese “Klubi i Poezisë” nxori nga shtypi dhe hodhi në qarkullim librin e Akademikut Prof. dr. Flori Bruqi, me titull “Diademë Letrare V”. Në serinë e veprave të botuara deri tani, ky është libri i 70-të i tij.

Kjo prodhimtari e jashtëzakonshme e këtij intelektualit të shquar në fushën e letrave, me solli në kujtesë një personalitet të njohur amerikan. Ky është Stiven Kovi (Stephen Covey 1932-2012), konsulent për çështjet e orientimit në jetë. Është i njohur si lektor dhe si autor i librit me titull “Shtatë shprehitë e njerëzve me prodhimtari të lartë”.

Në këtë libër ai propozon një trajtim të sistemuar të përcaktimit të qëllimeve dhe të përparësive në jetën e një krijuesi. Ai rrëfëson se si duhen formuluar dhe arritur qëllimet që krijuesi i ka vënë vetes. Ai thekson se nuk duhen pritur çudira, rezultate dhe ndryshime

pozitive do të arrijnë vetëm ata që janë të gatshëm ta kalitin durimin me këmbëngulje dhe ta administrojnë kohën me kërkesa të rrepta ndaj vetvetes.



Në të gjitha periudhat e jetës, mendjet e ndritura kanë pasë shtruar pyetjen se si kalon koha, duke dashur që të gjejnë mënyra për ta shfrytëzuar me përfitim për vetveten.

Albert Ajnshtajn (Albert Einstein – 1879-1955) ka thënë:

“Njihen mijëra mënyra për të vrarë kohën, or askush nuk e di se si ta ringjallësh atë”.

Intelektualë të formatit të akademikut Flori Bruqi, janë nderi dhe krenaria e mbarë kombit shqiptar. Intelektualë të tillë duhen nderuar dhe çmuar siç e meritojnë, sepse ata janë model për brezin e ri në shfrytëzimin e kohës me rendiment të lartë. Është e çuditshme se si është e mundur që krerëve të shtetit nuk u paska rënë në sy veprimtaria krijuese e akademikut Flori Bruqi, e pasqyruar në shtatëdhjetë libra të botuar deri tani, për çka ai duhej nderuar me medaljen më të lartë “Nderi i Kombit”.

Kaliforni, 03 gusht 2024

SUPLEMENTI LETRAT

Nga libri “AND-ja e pandryshuar e Shefki Karadaku i autorit Halil RAMA

SHEFKI KARADAKU, KHAJAMI I DITËVE TONA



Dr. Lutfi Turkeshi, Gazetar, studiues

Shkurt, poezi e veçantë, e jashtëzakonshme, e bukur... Është e tillë poezia e poetit Shefki Karadaku... Është shumë refleksive, sa më shpesh ta lexosh dhe rilexosh, gjithnjë do të nxjerrësh ndonjë ndriçim nga qielli me plot yje lirike të poetit të madh. Pra, kjo lirikë është identiteti poetik si katarzë...

Në librin tim “AND-ja e Shefki Karadaku” (monografi letrare), një kapitull i veçantë është me vlerësime të personaliteteve të letrave, ku autori i 35 veprave letrare në prozë e në poezi, portretizohet si një nga shkrimtarët e dalluar të kohës së tij. Kjo për faktin se Shefki Karadaku, me korpusin e tij letrar, ka hyrë denjësisht në historinë e letërsisë shqipe. Njëri nga analistët e veprës së tij, Prof. Dr. Lutfi Turkeshi, gazetar & studjues nga Republika e Maqedonisë së Veriut, jo më kot, e vlerëson Shefki Karadaku si “Khajamin e ditëve tona”. Në këtë konkluzion ai arrin pasi ka lexuar romanet “Puthja e ngrirë”, “Njëmijë vjet dashuri”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Filantropi”, “Panagjericus” e të tjerë, dhe vëllimet poetike “Kënga e korrave të drithit”, “Melodi të Shkumbinit”, “Ylberi”. “Lumi me njëqind zemra” e “Feniks” të poetit e shkrimtarit Shefki Karadaku.

Në kuadrin e Tetorit të letërsisë dhe arteve, i përcjell lexuesit të prestigjiozes “fjalalire.com”, pikërisht këtë analizë të të ndjerit Turkeshi, i cili,

ndër të tjera vlerëson se “Tërë vargjet e poemës ‘Feniks’ janë të harmonizuara estetikisht në të gjitha nivelet e të shprehurit emocional, individual, stilit origjinal dhe figuracionit. Këto poezi janë shprehje e një personaliteti poetik jo të zakonshëm...”



Pas shumë shekujsh, kur rebeli pasardhës do të tundë prapë selvinë, që e preku (vite më parë) me diç të “hekurt”, si me turp do ta shoh se rreth saj do të mbijnë bota, sisteme, grushte shteti, piramida... Martesa njerëzish dhe qivure.

Është ky mesazhi poetik i Khajamit të ditëve tona, poetit Shefki Karadaku, i cili me mëse 20 vepra në prozë dhe poezi amësoi në hapësirat e demokracisë letrare...

Në romanet “Puthja e ngrirë”, “Njëmijë vjet dashuri”, “Vila e magjepsur”, “Salamandrat”, “Filantropi”, “Panagjericus” e të tjerë dhe vëllimet poetike “Kënga e korrave të drithit”, “Melodi të Shkumbinit”, “Ylberi”. “Lumi me njëqind zemra” dhe “Feniks”, poeti e shkrimtari Shefki Karadaku asnjëherë nuk do t’i nënshtrohet jetës edhe pse e vuan atë... Dhe, duke mos aluduar në përmbysje biblike, synon t’i ndriçojë të errëtat e një sistemi jo perms kthesave shpirtërore, por përmes konstatimit “pesimist” se të gjithë elementet janë më të remë se ëndrra dhe thekson se vdekja është mbi të gjitha e nuk pyet hierarki ose ndon-

jë formë “makijazhi”, ndaj neveria, njeriut ia ul moralin nga përsosmëria, kur bëhet fjalë për vdekjen nga e cila edhe thelbi i jetës bashkëkohore dridhet... kur midis hidhërimit dhe gëzimit hija është ekuivoqe, prandaj poeti e di se qerrja që na tërheq dhe fjalët pa testament në largësitë e zymta të përditshmërisë, ikin tej dhimbjes njerëzore.

Këto mirazhe shpirti, që ikin me ëndrrat si një gënjeshtër tej, mes pikëllimit të paanë – janë sofrat njerëzore me kanune dhe karrare: “Bukë, kripë e zemër”! Larg tryezave dionisiane me “mish, verë e raki dhe net gri të orgjive...”. Janë çaste të fateve të grisura jo me gjumë somnambulash të poetit, por me një misticizëm të shprehur që ngjall emocione të një përkushtimi të vulosur, aludon në bindjen se çdo gjë përsëritet. Mbase edhe poezia e tij do ta ndiejë këtë rrezatim ndjesor...

“FENIKSI”, FRYT I IMAGJINATËS SË



POETIT

“Feniksi” është, pra fryt i imagjinatës së poetit që sugjeron ndjenjë të një thellësie ekzistencialiste të paqartë, por të tejdukshme në jetë, që në amplitudën figurative nuk është feniksi që zgjohet nga hiri i detyruar si shpirt i freskët i një loje të gëzuar kozmike, as ndonjë stuhi kohore që kërkon t’i hedhë tutje nga pellgu i qetë mendimet flijetare dhe t’i kthejë sërish në një ind përimtimi artistik, por një dridhje që “hap plagët e kohës”, të shprehura në çast, stinë, vite dhe dekada, të tradhëtuara nga forca e vet. Kështu nis kalvarin e mundimshëm të shprehur në linjat plot tension

me motive dhe dritë, bardi nazik i fjalës së shkruar poetike, esteti i shprehjeve kuptimore Shefki Karadaku. Ai shpesh nuk ndalet në fusha as edhe në lugina për admirime idilike. Mbase ato janë si rrjedhojë e barrës “së mëkateve” të servijuara nga syri poetik “sepse” ai e shikon edhe kohën përmes katarsisit ose lavazhit shpirtëror që s’e arrijnë kohën e vet. Megjithatë ca rreze optimiste amësojnë në botën dhe vizionin e mjeshtrit artistik, i cili në “errësirë” ndez qirinjtë e shpresës.

Leximi i veprës letrare artistike është një fenomen që manifestohet në mënyrë të ndryshme te secili individ, madje në mënyrë të ndryshme edhe tek i njëjti person me rastin e rileximit të së njëjtës vepër në intervale të ndryshme kohore, veçanërisht kur kjo vepër është poezi refleksive me plot rava asociative që e lëvizin çdo hije simbolike të filozofimit dhe tjetërsimit shpirtëror. E tillë është edhe përmbledhja filozofike “Feniks” e Shefki Karadakut. Gjatë çdo rileximi nxjerr diç të re...

LIRIKA E PËRMBLEDHJES “FENIKS”KA NJË FRYMË TË RE POETIKE

Shumë poetë kanë shkruar për sistemin monist, disa u afirmuan, të tjerët e mohuan dhe u shpallën dissident. Shefki Karadaku, që e përjetoi këtë periudhë këtë e konfiguronte përmes një përimtimi të heshtur. Similituda poetike e Shefki Karadakut ka lindur nga vizioni i një përjetimi plot 13 vjet. Soditur dhe shprehur në varg duke shtruar argumente historike të kësaj kohe dhe pasqyruar përmes krahasimeve të ndritura... Pra, Shefki Karadaku, ky “skllav” i lirikës figurative është një poet si mag i madh i shtrirë në meditim nëpër zinxhirin qiellshpues. Inventiv me plot ide të qëlluara, thellohet në të gjitha kodet jetësore ndaj periudha që e portretizon në poemën lirike “Feniks” është një “tatuazh” kohe, që ka kontinuitet dhe zhvillim të përhershëm me mesazhe plot peshë. Veku poetik i rrjetës jetësore është vargu transcendent që njëherësh e shpreh vizionin e poetit për një botë të re, sepse botës plakë (e ka fjalën për sistemin të cilin e portretizon) i kalon koha dhe se paqja me këmbët në boshllëk nuk ka perspektivë dhe është një paqe false plot luftë fronesh dhe mjegull politike në eklipset e shtetit.

Ndaj për këtë poeti prononcohet: “Isha i detyruar ta bëja këtë jetë poetike të dyfishtë... Kështu, brenda meje lindi një njeri tjetër, i cili mundi të krijojë gradualisht imazhin e pastër të një bote gati ireale, rrethuar nga një atmosferë e trashë heshtjeje dhe indiference pas së cilës modelonte e gjallë diçka stratosferike e pavëzhguar nga askush dhe e pangacmuar nga asgjë vulgare që mundi të sjellë izolimi i një shteti...”. Dhe në këtë izolim ku ndjen përplasjet poetike autori shton: “Unë mbase jam ai që s’di ç’të bëjë, ç’të ndërtojë e kokën time e kam nga blasfemitë pa kuptim, por që i trishtë qesh nga ironia pa vullnet që s’mundi të ndërtojë asgjë nga ëndrrat shtatanike dhe, pa forcë, pa pushtet u mbylla në vetmi nga ankthi, një cergë enda fort për të tronditur qeveritë e për të shkundur popujt nga letargjia si demon...”. Por, thekson më tej poeti me pesimizëm hezitues: “Mbeti kot dëshira ime... veç jehonë, e meqë s’mund asgjë të bëj me fjalë altruiste, me dhimbje gërryey fort ndërgjegjen time deri në fund e bëhem vetë makth sikur zemërimi të më mbysë nga jeta pa kuptim edhe qëllimi pa një cak...”. E konstaton këtë poeti figurshëm me ekzagjerime asociative për epokën që ec ngadalë, që çdo ditë të duket e gjatë sa muajt, vitet, e nuk ikin shpejt dhe ne durojmë nën strehët e mplakura... Dhe poeti në kërkim të bishtit të kësaj kohe të stërzgatur kërkon magjinë e madhe për të krijuar harqet e fatit për të ruajtur gamën njerëzore që të zhdukë zymtësinë e terrorit dantesk dhe “atje” ku vegjetojnë meridianët e përbotshëm, ku “e bukur dita lind, por e zymtuar perëndon”, ditë me shqetësime dhe tronditje ku frika absolute shkakton heshtje akujsh. S’ka liri. Dhe vëren poeti se njerëzit që qëndrojnë në pushtet e mbjellin këtë heshtje, me ta, pra me emrin e tyre lidhet nxitja e luftës, ndaj në një kohë të caktuar ata nuk bëjnë gjë tjetër veçse gjallërimin e këtyre instikteve ua transmetojnë edhe të tjerëve... Dhe poeti e di se njerëzit fatkeqësisht, në shumicën dërrmuese e ndiejnë nevojën t’i nënshtrohen një pushteti, nga i cili entuziazmohen edhe kur ai sillet keq me ta, që këta njerëz mos demoralizohen, por të bëjnë përpjekje që ta njohin më mirë veten dhe brenda vetes të dallojnë të keqen (Frojdi)...

Kjo vetëdije e pranisë së botës apo më saktë kjo vetëdije e afrimit të saj përmes krahasimit

shoqërohet me njëfarë devocioni ndaj gjeneratës së re. Duke mos kontestuar mesazhin për ndërrime sistemesh, tërë këto i jep me përforsime sfondesh që në poemë i kryejnë funksionet metaforike-figuracion, që në fakt është akt vetëdijeje lidhur ngushtë përmes perceptimeve ndjesore dhe shprehja e këtyre ndjesive bëhet njëllor si shprehja e një pikturë ose muzike... Lirika e Shefki Karadakut është një akt i ndërgjegjes individuale poetike dhe admirimi për imtues që vjen nga thellësia, nga fundi i ndërgjegjes, si një ndriçim i padukshëm. Emocionet nuk janë hapërim në vend, por një kohë në ecje pa pushim... Gjithnjë të varura nga mendimi njerëzor, sepse jeta ku verifikohen këto mendime është e mbështjellë me plot ngjarje...



Ëndërron poeti një vend ndryshe nga ai që e jeton, kërkon një vend: “... me gjuhë mjalti dhe hareje pa ligje-despotike dhe kushtetuta plot dyshim...”. “Dëshiroj një Eldorado ku ju të gjithë të rriini zemërjetë...”. Është vizioni i poetit dhe optimizmit të tij se: “Do vijë çasti që nga karrigia bukuroshe të shoh të kaltër botën pa dimër stinash pa mërzi?...”. Kështu këngëton me optimizmin e stinës së intuitës poeti, stinën që askush s’e sheh, por stinë që flet nga një botë e brendshme, nga disponimi i zbehur dhe i mërzi-tur dhe, si lunatik, me shpresë dëgjon se tufanet dhe rrebeshet do të pushojnë...

Kritika letrare e ndjek hap pas hapi letërsinë... Po qe se shikohet lirika e përmbledhjes “Feniks” lehtë vërehet se vëllimi ka një frymë të re poetike. Është një poemë me çelës që zhvillohet me një përpjetëz poetike alternative. Ajo ndryshon jo vetëm nga format stereotipe të poezisë shqipe, por edhe kundrejt poezisë që ka marrë përsipër të jetë avangardë e kësaj poezie...

IDENTITETI POETIK SI KATARZË

E veçanta e këtij vëllimi është se përkon me koordinata të përafërta të opsionit poetik filozofik të Khajamit. Poeti si edhe Khajami, marrëdhëniet me botën, pjesa materiale e së cilës i përgjigjet frymës poetike filozofike të poetit, shtrohet përmes asociacioneve – kjo veçanërisht vërehet në përsëritjen e dendur të metaforës së vetmisë... Ai pra, Shefki Karadaku, nuk shpall betejë për mëkatet duke shprehur përsosmërinë morale, por, përkundrazi, përmes “pasqyrës refleksive” që shikon botën i thekson krahasimet e jetës të mundimshme dhe të lodhshme shqiptare...

Si qiriri i Naimit që digjet në zgripin e honit të romantizmit evropian edhe Shefki Karadaku digjet në përimitim në “honet” e errësirës... së regjimit monist. Por, poeti thotë se poezia e tij futet thellë nëpër botra, gërmon mendimet, kohërat, thërret dhe qesh me zemrën copa-copa dhe shpërndahet në të gjitha trajtat... Si feniks, shkëlqen me ide kuarci duke ndërtuar “udhë betoni”...

I tillë është poeti Shefki Karadaku. Tërë vargjet e poemës “Feniks” janë të harmonizuara estetikisht në të gjitha nivelet e të shprehurit emocional, individual, stilit origjinal dhe figuracionit. Këto poezi janë shprehje e një personaliteti poetik jo të zakonshëm...

Ka poeti edhe idilin e vet të vendlindjes që është “... me çuka, rrape-qiparisë dhe subtropiku mund t’i flasë qershisë, por jo ajsbergë...”. Por, ka poeti edhe dashurinë e shprehur si Naimi e Çajupi: “Të këndoj ty bukuroshe si alku, unë s’jam poet i vjetër melik, po zemra po aq e lashtë sa dheu, përpara teje rreh si det antik...”, që pastaj të vijojë: “Po zemra e kërkon nudon e bukur, le të jetë ajo si mbretëreshë, që nëpër gjoksin e saj malli i shkurtër si tajfun floride të përqeshë...”.

Si të përfundojmë?! Shkurt, poezi e veçantë, e jashtëzakonshme, e bukur... Është e tillë poezia e poetit Shefki Karadaku... Është shumë refleksive, sa më shpesh ta lexosh dhe rilexosh, gjithnjë do të nxjerrësh ndonjë ndriçim nga qielli me plot yje lirike të poetit të madh. Pra, kjo lirikë është identiteti poetik si katarzë.

Gazeta “Fakti”, 8 mars 2001, Shkup

Jam si Feniks

Jam si feniks,
me dy fytyra njerëzish,
me dy fuçi të mbushura me ndjenja,
dy zemra rrahin,
njëra për ju dhe kohën e sotme
dhe tjetra është dridhje
e pavdekësisë.

Për ju ndërtoj kritikë
dhe sekserë të poezisë
ndërtesa shkatarrake

me dyer dhe dritare iluzore
në tokën e bekuar të së nesërme
jam si feniks.

I shoh ato dhe qesh me veprën time
pa linja dhe arsye poetike.

Por vetëm me një lustër gënjeshtare
jam si feniks.

Kritikë dhe censorë të patrembur
barriera ngrini me servilizmin tuaj
për zemrën time të madhe dhe të bukur
që s’rreh për ju, po për njerëzimin
jam si feniks.

Ju merruni më mirë me lirikat
e mia mendjelehta poetike,
ato i pjell dhe s’ndiej habi dhe dhimbje
por vetëm një nevojë simbolike
jam si feniks.

Pastaj, si futem thellë nëpër botëra,
gërmoj mendimet, kohërat pushtet thella,
thërres dhe qesh dhe zemrën copa-copa
e kam shpërndarë në të gjitha trajtat
jam si feniks.

1974

Lejleku ylber

Ja iku dhe një ylber i bukur,
lejleku shtegtar
ku do ta mbjellë vallë
trishtimin e Shefkiut shqiptar?

CIKËL ME POEZI NGA SHEFKI KARADAKU

ATDHEU

Shpesh bie në mendime dhe them se jeta, fati të trishtë janë si vjeshta që skuqet në drithërimë po kur kuptoj se jam një shkëmb nën emrin tënd guxim fitoj të endem, të qesh si perëndi. Kallaji yt i çmuar dhe deti valëthinjur, agimi i mbuluar me velin e njeriut dhe molot ku vaporët në pritje detesh flenë, të gjitha janë copëra nga zemra jote tokë! një rrap që një fëmijë e luan e s'heq dhe topi buçimplotë i mbushur me urrejtje, besimi në mendimin e nesërm dhe më tutje janë germa nga një emër i bukur: Shqipëri. Veçan ajo nuk ka as arin as njeriun si gjithë nocionet e tjera sinonime, por ka një gjë që zemrën e huaj nuk e prek: udha që qesh e shkon në vatrën atërore. Copëtoma zemrën ti por mos më lër pa të! Kam parë udhëtarë që vinin nga shtegtimet, me kamje pasuri të madhe, por plot lot përkuleshin ndaj shkrepit të vjetër, strall prej mali dhe s'donin asgjë tjetër veç gurët atërorë. Të gjitha mund t'i falnin por atdheun jo! Moj dorë e padukshme e vjeshtës amtare si eliksir na deh në shtratin mortar. Princ qoftë fati ynë, ose lypsar i shkretë, të lumtur venë në varr të gjyshërve të qetë.

NADOS

Fluturuan patat në Azi të lodhura dhe mbi ne lëshuan klithma një natë malli i tyre u gjymtua si terri në kodra mbeti nëpër dritat e Tiranës si alarm i artë.

Mbeti ai nëpër dritaret e Nados sime dritare njerëzore sigurisht janë ato po antinjerëzorja jetë i mërgon mendimet tok me patat në Azi pa i kthyer dot.

Po të fluturoje dhe ti si patat e shkreta s'di çfarë dhimbje do të provoje në shpirt megjithëse edhe ne mërgohemi nga jeta siç mërgohen patat në një kontinent të ri.

Edhe ne mërgohemi ngadalë nga qyteti nga sheshet madhështore hoteli vigan

po ky është asgjësimi më i pamëshirshëm i njerëzve që tej marrëzisë na shtyn si patat në tufan.

Po ky është asgjësimi më i thellë Nado që as unë as ti s'kemi të drejtë ta kthejmë vetëm të pikëllohemi mundet nëpër lulishte ndërsa patat drejt Azisë më të pikëlluara venë.

ALBANËS

I njejt ajër, i njejt det bukuroshja ime,
Të njejtat re sjellin shi në Breshia dhe Tiranë,
I njejt postier me të njejtën veshje
Sy, këmbë, qillota
Parakalon ngutshëm shtëpi
Po të njejt
Dhe po të njejtën zemër mbush përkohësisht me mall...

Megjithatë bija ime
Edhe pse në të njetën botë,
Edhe pse deti, ajri, drurët, zogjtë
Kanë të njejt at
Po të kisha krahë të fluturja gjer tek ti
S'do të më ndalnin portet,
avionët, ambasadat, pabesitë
Dhe do t'ju thoja bija ime
Se vij nga një dhé alienësh krahëzjarrtë
Dhe nga një det sterrë
Ku notojnë përbindësia ballkanikë gri
Nga një qytet me shtëpi termitesh..
Dhe do të më kthenin pas si katapultë
Duke më thënë se deti s'është njësoj
Dashuritë, sytë, pendët, fluturimi qiellor.
Ah bija ime,
Rrëzëllim i një çasti magjik,
Mallin tani e kam veshur me po ato drurë
Që më tregon çdo ditë ti
Po me ato zogj savoje përrallorë
Po me atë stil drurësh paviezë të kuq
Po me ato uniforma romake gri
Po me ato mjellma të verdha të lumit
Për të parakaluar lirisht
Gjithë ato kurthe urrejtjesh
Marrëzish pa fund
Për të parakaluar të njejtin ajër
Që thith ti....

SUPLEMENTI LETRAT

CIKËL ME POEZI NGA BUJANA MALAJ



-Fituese e titullit "Njeriu i vitit 2025" nga Federata e Paqes Universale (FPU) Shqipëri-

LERMËNI.....!

Natë.
Hapat ecin vetë,
unë qëndroj në vend.
Melodinë e këndoj në errsirë.
Errësi që ndriçon rrugën time pa ecur,
pa lëvizur, aty ku jam,
aty ku pakti im qëndron jo pezull,
jo gjithmonë në fluturim.
Më pëlqen të këndoj melodinë në errësi.
Nuk dua të shihem nga të tjerë,
dua të dëgjohem,
të dëgjohet zani im në errësinë e muzgut, të
natës,
të thellësisë së pyllit aty ku nuk shikohet
kompleksi vokali i gjithë zërave melodioz të
natës.
E herët në mëngjes bie qetësia e paqes
ku dëgjohet vetëm melodia e kangës së bylbylit
që kapërthuret nëpër degët e holla
të pemëve që lagen në vesën e hershme.
Erdha të këndoj në heshtjen e errësisë
e dritë të më bajë toka ime.
Dimër.
Akoma dimër ku mbjell melodinë e kangës së
harruar ndër vite.
Kangët e viteve po harrohen
ashtu siç po harrohet djepi e furka, unuri e
ninulla.
Prandaj dua të këndoj melodinë e kangës
në errësinë e natës e të futet thellë në shpirtin e
atyre
që s'patën mundësi të dëgjojnë kangën time,
ndarjen e zemrës në dysh, gëzim e dhimbje.
Të dëgjojë dhimbjen kur i flet zemrës në
gëzimin e saj,

mos ju përformo shumë gëzimit të më zgjojë,
lermëni të këndoj melodinë e kangës në errësi,
lermëni.....

Shkurt 2026 – Tiranë

SI VAGON TRENI.....

Shi, përsëri shi
askujt nuk i intreson
se si ndjehesh ti
retë të duken
sikur qajnë pët ty
e shi bie
bie përsëri.

Unë nisëm udhëve
të randa
më rondon koka
më rëndon kama
të kap trenin
në vagon të futem
në udhëtimin e radhës
zgjedh karriken e ulem.

Sa vite, sa rrugë
si peshoj dot
nën udhë e mbi udhë
kaloj nëpër Londër
mes për mes i bi
shpesh herë, se ku jam
as vet nik e di.

Sa ndryshime ka
shumë pak si më parë
si rrudhat tona
qëndisur mbi ballë
po ec me vitet
që ikën kaq shpejt

udhëtoj në mendime
si t'isha dyqind vjeç.

E pra, ja ku jam
në të njëjtin vend
si trenat që ikin
një shkon e një vjen
si vagonat ndiqem
me njëri-tjetrin
dje shikova botën
e sot mezi shoh vedin.

Shkurt 2026, London

MOJ E MIRË.....

Moj e mirë flokun mbi shpinë
ku ma le syzezë nusninë
me zi pres me ardh pranvera
me u pa si herat tjera.
Pa t'puth ty s'çel lul as ferra.

More djalë ti ç'ka po thue
te tan çejzin kam mbarue
ty po t'pres me ardh çdo ditë
nan's e bab's çikën me i lyp.

Me flokë synin mos ma zan
kur nuk t'shoh nuk jam tamam
shpesh herë veten kam ba fletë dushki
s'mun duroj me t'prek kërkushi.

T'kam provue shpesh ndashni
a m'don mue sa t'due ty
sikur hije flas me veti
edhe gurin dashnia treti.

Floku yt tan rica- rica
ikën vitet shpejt u rrita
një sahat m'bahet dakika
po plas zemra e po m'bjën pika.

Nuk la gur as nuk la mal
mbrapa teje vdes i gjallë
ixham (marak) shpirtit
mos me i mbet
mbi shtat tandin kisha vdek.

Lirikë shkurti, 2026

FLUTURA.....

Në cepin e krahut
një flutur ndaloj
unë buzëqesha
ajo më shikoj.

Pse flet me mua
si t'isha e rritur
ti e din mirë
pse jam e mërzitur.

I ledhatova
krahët e saj
sytë e përlotur
u l'shua në vaj.

E bashkë me të
qava dhe unë
palosi krahët
e ra në gjumë.

Kush mund të jetë
si unë e bukur
fustan me ngjyra
unë si jam flutur.


Diçka më solli
ndër vitet e mia
e pas mu rikthye
e tanë fëminia.

Ngjyrat e tua
mendjen errësoj
të dua fluturat
gjithmonë vazhdoj.

N'mëngjes u zgjova
shiko anë e anë
e bukura s'ishte
e ikur që mbramë.

2026- shkurt

SUPLEMENTI LETRAT



NË DOGANË....

Tregim nga Avokat Petraq J.PALI

-U futa në autobusin e linjës “Shqipëri-Athinë” me një biletë të prerë në çast me urgjencë mbasi më kishte vdekur një kushëri im i afërt dhe duhet domosdo të merrja pjesë në varrimin e tij.

Ishin momentet, kur autobusi do bënte nisjen drejt shtetit Helen, shtet ky, ku jetojnë e punojnë qindra emigrantë shqiptarë nga çdo krahinë që me mundin dhe djersën e tyre janë përshtatur e akomoduar si qytetarë të atij vendi prej vitesh.

Isha në ndenjësën 39 dhe në 40-tin, ishte një djalë simpatik tek te 25-tat, një tip “kaubojs” që deri sa udhëtuam për rreth 16 orë nuk e mora vesh nga ishte.

Në autobus nuk dëgjova të flitej fare shqip, që nga shoferi, dublanti i tij, plaka, pleq nuse e djem nga çdo krahinë e Shqipërisë që ishin.

Kisha mërguar edhe unë disa vite të fillimit në Elladhë, në atë kohë që nuk na linin të flisnim shqipen tonë të bukur dhe i dija fill e pe për pe gjithë hallet e tyre .

Ajo kohë e ato vite të vështira natyrisht lanë gjurmë të thella në ndërgjegjen e në karakterin e kujtdo që i sforcuar dhe i detyruar për bukën e gojës arritën të ndërrojnë edhe emrin e tyre, gjë që greku e quajti se bënte “detyrën”. Gjithsesi djemtë dhe njerëzit tanë jetuan, punuan, u lodhën, mbijetuan, por mësuan dhe një gjuhë të huaj, atë të “bukës”.

Djali që kisha në ndenjësën pranë, ishte nga ana e dritares. As ma fishkelleu, as u bë kureshtar të mësonte kush isha unë, bashkëudhëtari i sediles 39. Mua më griu të mësoja nga ishte ky

“gango”që me Iphon në dorë e me kufje në vesh, për 12 orë rresht vetëm fliste, qeshte, shkrihej e bënte cubin me partnerët (kuptojme bashkë-folësit) e tij, qofshin të seksit femër a mashkull kudo që ishin .

Grequishtja ime natyrisht nuk ishte si e tij, ai ishte “profesor” unë me shumë vështirësi kapja nga një fjalë aty këtu, se gjithë rrugës ai fliste me kode: miu, macja, mali, kalorësi, shigjeta, nis-hani, mullixhiu....O zot, u befasova! Ishte shumë simpatik pavarësisht se kishte goxha mjekër dhe trupin e kishte të qëndisur si “spartan”, i mirëushqyer dhe i mirëmbajtur. Ndoshta bënte dhe “gym” në ndonjë palestër.

Gjithsesi krijova bindjen se ose ishte përdorues droge, ose shpërndarës dhe mendova se qe pak “pordhac”, po shumë paralli, se me bashkëbiseduesit gjithmonë përdorte kodet...000000013 E, ose i thoshte, “hiqi tri zero, shto dy, hiq një, vendos katër.....dhe shkruaj 11”. Hajde të përllogaritja unë se çfarë donte të thoshte ky “lango”.

Sinqerisht m’u mërziut udhetimi se hera-herës, shqetësonte dhe të tjeret...

I rashë nja dy-tre herë me brryl në parakrah që desha t’i thoshja “fol më ulët more djaloos se e ke kambanë zërin”, se ishte dhe momenti që gjatë natës pasagjerët e robtuar “rrembejnë” dhe dremitin nga një sy gjumë, po ai s’donte t’ia dinte.

Me thënë të drejtën fillova ta urrej dhe më bezdiste qëndresa pranë tij. Hera - herës pasagjerë të tjerë kthenin kokën për t’i thënë ule “grykën” se

nuk ta kemi oreksin.....por “gangua” bënte të fortin edhe cubin..

I thashë në greqisht se nuk durova më mbas disa orësh:

- Nuk e kupton “pedhimu” se u bëre i bezdisshëm për këdo....Pse bën të fortin kur në autobus janë përgjithësisht moshatarë dhe jo të radhës tënde, aq më keq u sollën shoferi dhe partneri i tij (dublanti) si folën fare gjatë gjithë rrugës.

Për çudi “gangua”, sapo afroheshim pikës doganore ndërroi qimen, taktikën. Uli zërin dhe bënte indiferentin duke u shpërqëndruar tek muzika me kufjet. Kishte një çantë dore të cilën e hapte dhe e mbyllte me dhjetra herë, hap zinxhirat e xhepave të çantës e mbyll zinxhira. Nxirrte prej saj, natyrisht duke u ruajtur edhe nga pasagjeri i sediles 39 lloje shamiash me ngjyra, që gjoja në to ai kërkonte ndonjë “send të humbur”.

U binda që ishte trasportues droge, se u bë pulë, kur po i afroheshim kufirit dhe doganës. I iku humori, buzëqeshja, krenaria, tangërllëku, diçka e mundonte, hap e mbyll çantën..... Siç duket e pa veten keq. Unë bëja indiferentin e të pavëmendshmin, por nga ana tjetër nuk desha të më shpëtonte asnjë çast nga veprimet e tij. Po më shtohet kurioziteti, krijova bindjen se diçka e mundonte.

Autobusi ndaloi para shkopyt të doganës. Do bënte kontrollin çdo pasagjer të plaçkave e çantave, valixheve e sendeve vetjake nga të dy anët e kufirit siç behet zakonisht. Shoferi mbledh pasaportat pa përgjegjësi, ia jep një polici ose ndonjë pasagjeri, (po pa përgjegjësi) dhe dikush tjetër i merr e i shpie në sportel të vulosen. Një kontroll rutinë pa patur personin fizik përpara për ta verifikuar (kjo është një histori më vete në doganat tona..Papërgjegjshmëria me dokumenta këtu arrijn kulmin, besoj se dhe në Kandahari do jetë më i saktë ky kontroll).

Me çantat e dorës në dorë, zbritën një nga një pasagjerët. U hapën kapaket e bukaportave të autobusit dhe secili pasagjer do të vinte në bangon

e kontrollit doganor plaçkat e tij, valixhe, thasë, trasta, pako të tëra të lidhura me mitriban e me teni.....një lloj lëvizje “arexhinjsh”....!

Unë si gjithë shokët kisha dorëzuar pasaportën marrësit pa përgjegjësi dhe as pyeta për të, por ndoqa me kujdes dhe pa bërë zë pasagjerin e sediles 40, i cili lëvizte si në majë të gjembave dhe vështronte majtas e djathtas si i trembur. E kuptova që po i afrohej “çarku” doganor dhe gati po i binte të fikët këtij trimi që gjithë rrugës bënte “kokoshin”. Me pak fjalë u pordh. Çantën njëherë e vinte në bango njëherë e merrte në krah. Gjë kjo e përsëritur disa herë. Ishin çaste që unë si një “dedektiv i sprovuar vullnetar” desha të qetësoja kureshtjen, gjë që më ka munduar gjithë jetën. Jam kureshtar dhe jo indiferent, me gjëra që bien në sy si antipod i realitetit shoqëror e social,

-E kujt është kjo çantë,- tha polici doganier,- ta hap pak,- pyeste të zotin.

- Po me kënaqësi.....e kështu vazhduan e vazhduan me atë stil.

40-ta, po vinte si pordha nëpër brekë sa andej - këtej bangos , sa në krye në fund, me çantën në dorë dhe me fytyrë limoni. Nuk priti më dhe e pashë që nxorri një nga ato shamitë me ngjyrë si tip zarfe dhe me marifet ia vendosi një çante tjetër sipër bangos që i takonte një vajze po kau-bojse që kishte kaluar kontrollin. Vajza e thithi, e kuptoi, tërhoqi çanten, mori zarfin dhe me shumë “pushtllëk” marifet, ia fut ne xhep të uniformës doganierit, pas policit.....(pa e kuptuar kategorikisht doganieri).

Djali e pa, i buzëqeshi vajzës....më buzëqeshi edhe mua duke ditur se e ndiqja.

Ishte mafioz.

Kur hypëm në autobus më tha...”sa ka zanati xhaxha!”

Më vjen mirë që të erdhi, zëri i thashë, se qëparë u bëre si “mut çifuti”!

Ora 4 30 e mëngjesit na zuri në Athinë.....!


Korrik 2017

SUPLEMENTI LETRAT



DALLGËT E JETËS

Cikël me poezi nga FALI NDREKA



KOSOVE E PAVARUR

Ty Kosovë ta puthsha ballin,
Që ndër shekuj s'u mposhte kurrë,
Amanetin që baba ja la djalit,
Për k'të tokë, liri flamur.

Të dogjën shtëpi, të dogjën xhanin,
Të shkatërruan çdo pasuri,
Para syve të vranë djalin,
Ai theror ra për liri.

Çështë ai tym dhe çështë kjo flakë?!
Pyeste bota me habi,
Kosovarët me pushkë, bajrak,
Derdhën gjakun për këtë liri.

Ti Kosovë ma gëzofsh lirinë,
Mposhte dhunën, fantazmë ndër shekuj,
Shumë heronjë ranë për lirinë,
Gjak i tyre, i njomë ka mbetur.

Le ta dijë, ai që s'do t'di asgjë!
Le ta di e mbarë bota,
Është liri që s' dorëzohet më,
Për pa u përmbys qielli dhe toka.

DALLGËT E JETËS

Shpeshë herë mes dallgëve të jetës
unë u gjenda,
Dhe netë të tëra ndenja pa gjumë,
Është e vështirë që mes errësirës
të gjendet e vërteta,
Brigjet e së cilës mbulohen me llum,
baltë e shkumë.

Kështu netëve të gjata, i vetmuar pa gjumë,
Lundrova me guxim mes ëndrave të vërteta,

Edhe pse komandant dhe ushtar i vetëm isha unë,
Nuk mbeta peng i brigjeve të errëta e të shkreta.

Edhe kur jam gjendur në furtunë,
Mes ërërave të forta që të fshikullinin,
E mbajta fort këmbën që të mos bija ndënë udhë,
Atëherë nga qielli e mora bekimin.

Me mundime të shumta e mbajta këtë rrugë,
Duke mohuar çdo gjë që në mua ishte e vjetër,
Por besova drejtesinë që më sherbeu si urë,
E nëpërmjet saj kalova nga njeri breg në bregun
tjetër.

Prandaj po shkruaj këtë varg,
që përkëdo që e lexon,
Si postulat i imi le të mbesë:
Trim është ai, që drejtësinë përqafton,
Dhe jo hipokriti që tërë jetën mbetet i pabesë...

KUDO PAQE

Paqja të rilind,
Paqja të gëzon,
Paqja s'është ëndërr,
Kur në mesin tonë
ajo ekziston.

Kur paqja ekziston,
Lumturi, harmoni do të ketë
Njeriu gjithmonë gëzon,
Kur atë në çdo vend e gjen.

E bekuar është paqja
aty ku gjendet harmonia,
Në zemrën e secilit,
Që nga lindja,
Gjer në perëndim të diellit.

SI VËLLEZËR TË JETOJMË

Ngrihet nga toka fryma e drejtësisë,
Dhe ngjitet mbi re botën duke parë,
Si njerëzit e shplarë i përulen marrëzisë,
E fjalën e Zotit mënjëanë e kanë lënë.

Le të kerkojmë Zotin dhe mirësinë,
Le të kërkojmë hirin dhe drejtësinë,
Le të kërkojmë paqen të hyj në shpirtin tonë.
Të heqim nga zemra djallin,
e si vëllezër të jetojmë.

*Fali Ndreka , Itali 2026 (Marrë nga libri me poezi
“DALLGËT E JETËS”)*

PËR AT VEND GJUMI S’ MË ZË

Shqiponjat fluturojnë të lira,
Fluturojnë me syrin dritë,
Dhe foletë i ndërtojnë,
të sigurta në lartësitë.

Mu në zemrën e shkëmbinjëve,
Atje ku Cidhna shfaqet ,
Atje ku celin lule zonja,
Lule vera dhe manushaqet.

Atje ku lartohen kullat,
Si kështjellat atje dikurë,
Atje ku mbajnë fjalën burrat,
Fjala e zgjuar rrjedhë si gurrë.

Historia dhe bukuria,
janë stolitë e këtij vendi ,
Zemra trime e cdo cidhnaku.
Që nga Ruset gjer tek Bredhi.

Sopanika cdo ditë vallëzonë,
Si një nuse me vello t’bardhë,
Natë e ditë si qumësht shkumbonë,
Bijtë e sajë i pretë me mallë.

Seta e vjetër me uji kristali,
Valë pas vale tjerrë kujtime,
Si ushtimë që zbrëtë prej mali
Ma pushtonë zemrën time.

Ja dhe lisat lartojnë kokën,
i shtrijnë degët se janë krenarë,
Përmbi Cidhën e Grykë-Nokën,
Vend i rrallë me zemër të bardhë.

Për atë tokë që zemra rreh.
Për at vend që burrëri njeh,
Për të madhin Skënderbe.
Që pushtuesit i vuri fre.

Dalë në xharxhisht
Dhe puthi tokën.
E puthë Cidhnën dhe Grykë- Nokën,
Nuk i ndrojnë me ma falë Botën,

Përqafojë Dibrën me radhë,
Fshat më fshat fushë e zallë,
Pastaj ndalem më Rec e Dardhë,
Me valët e Drinit këngës ja marrë,

Në at peisazh jam lindë e rritë,
Kam njohë Zotin dhe Perënditë.
Këngët e gëzimit dhe trimëritë,
Zana e malit atje m,ka pritë.

Babai më dha një zemër t’fortë,
Kurdoherë vendin me mbrojtë,
Më dha shpresë e zgjuarsi,
Me dashtë vëllezër e miqësi.

Në krahë të shqipes
kam fluturuar,
Në dhena të tjera
jam integruar.

Dielli i paqës
më ka ngrohë mua,
Shpirt e zemër
më ka ndricuar.

Rrezja e hënës më ka kujtuar,
Më kujton vëndin, edhe Dibrën,
Skënderbeu ku ka luftuar,
Mbrojti vëndin dhe nderoi Cidhnën,

Për at vënd më digjet shpirti,
T’zbresë nga Pllaju dhe Xharxhishti,
Për atë vend gjumi s’më zë
Bëhem zog e vi mbi re,

Bëhem dritë
dhe kur është natë,
Si qiri digjem në flakë,
Zemrën loti ma pushton,
Kur vëndlindjen e kujtojë.

SUPLEMENTI LETRAT

DASMA E BLENDARIT

E jetuar - (Nën hijen e murit të hekurt)

Nga Nexhbedin Basha, Gazetar & Poet

Ishte korriku i vitit 1985. Vera digjte tokën dhe njerëzit njësoj. Dielli nuk kursente as grurin, as djer-sën, as frikën. Babai i foli Bledarit me zë të ulët, si të kishte frikë se fjala mund të dëgjohej edhe nga muret: - Bir. Shko te Selaudini, dhëndri i hallë Sevdijes. Ftoje për dasëm dhe thuaji të vijë të savatojë dhomën ku do të futet dhëndri me nusen. Dasma po afrohej. Një gëzim i madh familjar, por në atë kohë edhe gëzimi ecte me hapa të matur. Ishte kohë kur njeriu nuk gëzohej me zë të lartë dhe as qante lirshëm. Ditët digjeshin nga dielli, po aq sa edhe nga ankthi i padukshëm i kohës; ai ankth që nuk kishte zë, por ndihej kudo.

Bledari hipi në urbanin e linjës drejt një fshati kufitar, emrin e të cilit as nuk e dinte. Dinte vetëm një gjë: duhej të gjente Selaudinin, njeriun e shtëpisë, bashkëshortin e gocës së hallë Sevdisë. Zona ishte brenda lokalitetit të Maqellarës, Kooperativë me emër dhe rezultate në rreth, e njohur për grurin dhe misrin, por edhe për diçka tjetër që peshonte më shumë se çdo bereqet: ishte zonë kufitare. Një fjalë që atëherë vlente sa një akt-akuzë. Në atë kohë, askush nuk ecte serbes në zonat kufitare.

Duhej leje nga Dega e Brendshme. Duhej emër, mbiemër, arsye dhe destinacion. Por Bledari ishte ushtarak. E nënvleftësoi rregullin. Dhe pikërisht aty filloi drama Pas rreth gjysmë ore udhëtim, zbriti. Asnjë njeri në rrugë. Vetëm në largësi, silueta kooperativistësh që lëviznin nën vapë dhe zhurma e rëndë e kombanjës që korrite e hante parcelat me grurë dhe që s'gopej kurrë. Vetmia iu ul mbi shpinë si barrë. Bledari ndjeu se çdo hap dëgjohej, çdo lëvizje peshohej. Këtu, edhe kallijtë e grurit kishin vesh, edhe çatitë e shtëpive ishin lajmëtarë. Ajri ishte i trashë, si një mburojë që të zinte frymën. U afrua me hap të matur dhe pyeti: - Më falni, dua të shkoj tek Selaidin Tafçiu. A e njihni? Njëri ngriti kokën, fshiu djersën me krah.

- Po, - tha. - Është nga Bllata. Ka shtatë fëmijë. Bledari u hutua.

- Jo, jo... nuk është ky. E kemi dhëndër. Emrin e ka Selaudin... mbiemrin s'po e mbaj mend mirë. Ra një heshtje e shkurtër. Sytë u kthyen drejt tij, jo armiqësisht, por me atë kureshtje të ftohtë që të therte

më shumë se fjalët. - Atëherë nuk është ky, - tha dikush. Në atë çast, toka iu duk sikur iu drodh nën këmbë. Ai nuk e dinte, por diku, dikush tashmë po kryente “detyrën”.

- Po Hetem Xholin e njihni? - pyeti sërish. - Ka vajzën e xhaxhait për grua.

- Po, e njohim, - u përgjigj njëri shkurt. I lodhur dhe me një shtrëngim në kraharor, Bledari vendosi të shkonte në Kllubçisht, te goca e xhaxha Selimit. Atje u përqaftuan me mall, si vëlla e motër. Një çast strehë. Një çast frymëmarrjeje. Por qetësia zgjati pak. Në dhomë hyri i biri i saj, Landi. Pa përshëndetje, pa pyetje:

- Pasaportën.

- Nuk e kam. Po jam daja yt, ore! Landi ishte pionier, në klasë të gjashtë. Zëri i tij ishte i prerë, i mësuar të zbatojë. -

- Hajde me mua, në zyrën e këshillit. Zyra e këshillit ishte e ftohtë. Brenda ishte Arifi, tekniku i fortifikimit të batalionit të xhenios. Bledari e njihhte.

- Ç'paske dalë nga këto anë, o Bledar? - i tha me një buzëqeshje që nuk qetësonte.

- Martohem në gusht. Doja të gjeja Selaudin Hysenin, të vijë të na bëjë ca punë ustallëkshe savatojë dhomën e dhëndrit... Në atë çast, dera u hap me vrull. Një skuadër vullnetare u shfaq.

- Gati jemi, shoku kryetar!

- Ikni, - ua preu Arifi.

- Është i yni. Pastaj u kthye nga Bledari. Zëri iu ftoh. Në sytë e tij, ai nuk ishte më njeriu që njihnte dikur, por një figurë prej balte, e formuar nga urdhri dhe frika.


- Nga Kalaja e Dodës deri në Krujë, të gjitha zonat kufitare janë në gatishmëri luftarake. Dysohet për një kalim kufiri. Heshti.

- Dhe ai njeri... je ti.

Bledari heshti. E kuptoi se në atë kohë, një pyetje mjaftonte për t'u bërë armik. Dasma po afrohej. Por hija e murit të hekurt ishte aty; mes grurit, mes njerëzve, edhe mes dasmës; një hije që ftohte edhe gëzimin. Dasma e Bledarit nisi bukur, por çdo çast mund të mbyllej te biruci, sepse në atë kohë, një fjalë e lirë mjaftonte për të paguar shtrenjtë.

UDHËTIM

KRIJUESIT, SHKRIMTARËT DHE POETËT QË FARKËTOI UNIVERSITETI BUJQËSOR I KAMZËS



Nga Spasse Thanasi

- **Koha madhore e letërsisë për shumë bashkëkohës tanë ka filluar që në Universitetin Bujqësor me gazetën e famshme “Studenti i Bujqësisë”. Aty u ndje “pagëzimi i zjarrit” të dëshirës për art, letërsi, kulturë, aty u ndje “liria e fjalës” në kushtet e ndaluara politike dhe ideologjike, aty u formua “vetëdija krijuese” me një ngazëllim të çuditshëm të profesionit më të bukur**

Universiteti Bujqësor i Kamzës është jo vetëm Monument i Dijes, por edhe një Monument i Artit&Kulturës kombëtare shqiptare. Aty “u pagëzuan” dëshirat e para krijuese të shumë personaliteteve si Teodor Laço, Namik Dokle, Qemal Sakajeva, Cezar Agimi, Ago Nezha, Jani Gusho, Xhevdet Shehu, Fuat Memelli, Shefqet Meko, Marash Mirashi, Ahmet Mehmeti, Mujo Bucpapaj, Gëzim Llojdia, Pashko Gjerka, Xhelal Tosku, Ahmet Prençi, Mark Preçi, Klara Buda, Zef Gjeta etj që kishin studjuar për agronomi, veterinari, ekonomi apo pyje dhe sot janë figura të rëndësishme të publicistikës dhe të poezisë shqiptare.

Të gjitha talentet e brezit të viteve 1980 në ILB si: Shefqet Meko, Edmond Kaceli, Feti Zeneli, Tonin Kacaj, Zef Gjeta, Vojsava Zegali, Qani

Sherja, Gjergji Zefi, Emin Kukli, Martin Leka, Spasse Thanasi, Jak Përpali, Riza Doda, Bislim Ahmetaj, Ymer Hysa, Selmam Mëziu, Ali Cani, Pashko Gjerka, Gëzim Llojdia, Agim Deva, Lllazar Rumnici, Alfred Gjata, Mimoza Isufi, Altin Haxhinasto, Ardian Gjergji, Shkëlqim Nurja, Robert Papa, Zamir Ymeri, Qirjako Basha, Prel Ndrevataj, Ana Doko, Etleva Puto, Petro Bereti, Thoma Vogli, Pëllumb Cuni, Hysen Kobellari, Pali Goga, Jakup Gjocaj, Petrit Kaloshi, Gjovalin Gjeloshi, Lulëzim Keta, Hasan Domi, Arjan Alikaj, Monika Spahivogli, Majlinda Rama, Osman Xhili e plot të tjerë e patën gazetën “Studenti i Bujqësisë” tribunen e tyre të dashur ku publikuan krijimtari brilante në poezi, prozë, pikturë apo fotografi artistike. Ka patur shumë student që kishin “dell krijues” dhe tashmë janë autorë të disa librave. Qysh atëherë Shefqet Meko deputoi me tregimet e para “Një grusht dhe”, “Darkë në konvikt”, “Ngrohtësi”. “Letran ë zarf të hapur”, “Do shihemi...”, “Gota e thyer”, “Natë vere” etj. Plot “nerv letrar” ishin Gjovalin Gjeloshi, Osman Xhili, Mark Preci, Martin Leka, Gëzim Llojdia, që nuk mungonin në faqen e parë të gazetës studentore me shkrime problemore, me reportazhe e studime letrare.

Koha madhore e letërsisë për shumë bashkëkohës tanë ka filluar që në Universitetin Bujqësor me gazetën e famshme “Studenti i Bujqësisë”. Aty u ndje “pagëzimi i zjarrit” të dëshirës për art, letërsi, kulturë, aty u ndje “liria e fjalës” në kushtet e ndaluara politike dhe ideologjike, aty u formua “vetëdija krijuese” me një ngazëllim të çuditshëm të profesionit më të bukur. Dega profesionale e imponuar ishte atëherë vetëm “ombrella” e farkëtimit të talentit në udhën e dijes... Gumëzhiu bukur redaksia studentore nga zërat e poetëve, tregimtarëve, eseistëve, që guxuan të krijojnë bukur jashtë skemës së “Realizmit

Socialist”, përtej “doktrinës rutinore të propagandës”, duke “kapërcyer” parrullat e kohës me thirrje revolucionare... Më kujtohet sa bujë bëri atëhere fejtani i Shito Kadifeja “Kush është Berber?!”, që arriti deri në godinën e Komitetit Qendror të partisë...

Ishte kulmi i luftës kundër shfaqeve të huaja dhe përjashtoheshin studentë nga Fakulteti për flokë të gjata e pantallona të gjera të modës ekstravagante.

Marash Mirashi quhej “poeti i ftohtë” se publikonte vargje poetike me tingëllim hyjnor të vecantë, që në veshin e Partisë quhej “dekadencë”. Ai bëri disa muaj punë korektonjëse në Minierën e Valiasit deri sa iu dha rikthimi në Fakultet me ndërhyrjen e Skënder Gjinushi, atëhere Ministër i Arsimit. Ky zë i çuditshmëm poeti u bë sinjektiv dhe shumë domethënës në letrat shqipe, me farëktimin e marrë fillimisht në Universitetin Bujqësor. Mbaj mend se ai i tha atëhere me dashamirësi Rektorit Lufter Xhuveli: - “Profesor më lerë të shkruaj për fushat dhe minierën e mos këmbëngul të më rikthesh “i damkosur” në Fakultet”. Historia u mbyll me autokritikë në organizatën e rinisë dhe Komitetin e Rinisë së Institutit ku Ernest Gocaj e etiketoi si “raca që del nga kafazi!”.



Rebel dhe i shkujdesur ishte atëhere edhe Gëzim Llojdia, që nuk gjente qetësi shpirtërore në Qytezë, i ardhur këtu “pa dëshirë” dhe i “imponuar”. Në kundërpeshë me profesionin e arsimimit të tij, ai gjeti “armën e arsyes”, pasionin me letërsinë, gazetarinë dhe librin. Lexonte shumë, i pëlqente analiza e librave, dashurohej pas vargjeve poetike me tingëllim të veçantë romantik, rrëmbehej pas udhëtimeve dhe rrëfi-

meve.

Ndaj shpeshëherë kryeredaktori i gazetës “Studenti i Bujqësisë” Shefqet Meko e dërgonte atë me shërbime krjuese në Lushnjë, Fier e Shkodër bashkë me Qani Sherja, si një dyshe që gjithmonë dilte nga “situata e vështirë”.

Një tjetër krijuese, KLARA BUDA shquante për profilin e saj ngadhnjimtar mbi “rebelimin e kohës” për “dëshirat e munguara”. Erdhi nga Fieri si një qytetare “e skalitur” me kulturë e tradita që e ngrinin lart në qiell e nuk e linin “pezull” në sikletin e patreguar “të studjoj apo të braktis profesionin?!”. Dhe qendroi “stuhishëm” ajo duke studjuar, krijuar e shfaqur një imazh letrar të adhuruar.

Mark Preçi e quante Klarën atëhere “ndjeshmëria e kodrës”, pasi kishte një karakter miqësor të ndjeshëm e të hapur në marrëdhënie me shoqërinë studentore të Universitetit. Por edhe formoi një “individualitet” të veçantë krijues nëpërmjet faqeve të gazetës “Studenti i Bujqësisë”, që për të ishte një “klorofil” në shpirtë.

GËZIM LLOJDIA: NË TIRANËN E LETRAVE TË VITEVE 1984

• Nje memorie e gjatë krijuese përmes gazetës sonë “Studenti i Bujqësisë”

Në ato ditë të hershme të rinisë, ëndërrat dhe realiteti shkruinin bashkë si dy shtresa që s’mund të mbylleshin kurrë. Cdo moment ishte një mundësi e paimagjinueshme për tu afruar asaj bote që ndjehej aq e largët dhe e prekshme në të njejtën kohë. Kërkonim një rrugë, jo thjeshtë përmes fjalëve, por përmes krijimit, përmes artit ku ëndërrat përplaseshin me realitetin dhe ndiheshin më të gjallë se kurrë!...

Dija dhe pasioni kishin gjetur strehën e tyre përmes librave, poezisë dhe kritikës. Ishte një kohë kur çdo fjalë që shkruaje kishte peshë. Një periudhë ku çdo hap i vogël ishte një mundësi për tu ndjerë gjallë, për të prekur jetën dhe botën me fjalë. Të rinjë të mbushur me ëndërra. Të gjithë që ëndërronim që të bëheshim shkrimtarë. Të krijonim një botë me fjalë. Dhe ky mo-

ment me ndjesinë e pasigurisë dhe entuzizmit. Të krijonim një botë të tërë përmes fjalëve, një botë ku imagjinata mund të fluturonte lirisht. Do të na shoqeronte përgjithmonë, si një kujtim i thjeshtë, por i pashlyer kurrë në mendje !.

Në atë kohë, kur ne ishim studentë e shihnim botën përmes syve të rinisë. Dhe gjithçka ishte mbushur me mundësi dhe pyetje pa përgjigje. Vendi ynë ndodhej ende nën sundimin e një regjimi komunist. Mirëpo ai qytet i vogël që na mbante kishte dicka të vecantë. Ishte një qytet rinie. Dhe secili ndërtonte brenda një ëndërrë të paqartë dhe të largët. Qytezë që nuk ishte si çdo qytet tjetër të Shqipërisë. Tërisht rinor. Prandaj mbante të fshehura “sekrete dhe dëshira”. Atje ku gjithçka ngjante më shumë me një pasqyrë të brendëshme të mbushur me lëvizje



të heshtura dhe ëndërra të mbyllura në sirtar... Ëndërra që fluturonin në ajër. Ai gjerbërim ishte një mundësi për tu arratisur në mendime. Jeta në atë qytet për ne ishte një pasuri e paçmueshme. Cdo moment kishte një vlerë të vetën, edhe pse mund të dukeshin të thjeshta. Rrugët e ngushta e të zhurmshme ishin mbushur me të qeshurat e vajzave.

Një atmosferë tërheqëse, që ngjallte energji. Një lloj rinie e pavdekshme, që mbante gjithçka të gjallë... Na kujtohen serenatat që bënin korçaret e Fakultetit Ekonomik. Ato këndonin me pasion. Dhe tingujt e kitares dhe këngët ishin si valëzim deti. Vajzat me buzëqeshjet e tyre dilnin në dritare. Rrinin mbështetur tek parvazet dhe shijonin ato momente magjike të qytezës... Ush-

tonte kënga e njohur “Në bankat e shkollës moj mike !...”

Dy emra i gdhendëm dikur

Por unë nuk e di si më ike

Dhe zemrës i vura një gur !....

Ah, kjo këngë na shoqeronte në ditë të mbarë dhe të vështirë. Këngët kishin fuqinë e jashtëzakonshme për të shoqeruar momentet e jetës. Në bankat e shkollës, moj mike, dy emra të gdhendur në kujtimet tona të rinisë, si ky Universitet i “gdhendur” në gur, siç e portretizon Spasse Thanasi.



Dhe ndjenim çdo prekje të penës mbi letër. Gazeta jonë “Studenti i Bujqësisë” mbartenë kujtimet tona pasionin e rinisë. Kishim një zyrë të vogël në Qendrën Studentore. Një vend ku fjalët ishin më shumë se një rreshtim letre..Fuqi për të ndikuar, për të nxjerrë në pah një botë të ndryshme. Ishte edhe një rreth letrar i ILB-së. Një hapësirë ku fjalët bëheshin art. Atje thirrëm shkrimtarët më të njohur. Elena Kadare, që me penën e saj ndriçonte zemrat femërore, bëme një bisedë në Godinën Nr.7 me vajzat konviktore. Elena foli për romanin e saj “Një lindje e vështirë”. Ishim me Shefqet Meko, Martin Leka, Spasse Thanasi etj. Tek Godina Nr.3 Diana Çuli na bëri të preknim zemrën e jetës. Apo dhe Teodor Laço që çdo fjalë e tij ishte një dritare në botën e lirisë. Kishte qënë agronom, kur kishte njohur jetën e fshatit. Ishte udhërrëfyes që ndihmonte të kuptonim se letërsia mund të të shpëtonte, mund të të ndryshonte gjithçka. Çdo bisedë me ta ishte një ngjarje e paharrueshme që na mbante gjallë dhe na jepte forcë për të besuar në fuqinë e artit.

gazetadestinations.al

KRYEREDAKTORI

HALIL RAMA

- Ka lindur në Muhurr, Dibër më 28 Tetor 1960.
- Nga 1996 jeton dhe punon në Tiranë.
- Është diplomuar në Jurisprudencë (Bachelor dhe Master Shkencor) dhe pasi ka kryer edhe Shkollën Kombëtare të Avokatisë me rezultate shumë të mira, ka fituar titullin “Avokat” me Nr.Liçense 7979, datë 31.10.2014.






Ka punuar:

- Përgjegjës i Shtëpisë së Kulturës Muhurr (1980-1981) pasi kreu Kursin e Regjistrës pranë Shtëpisë Qëndrore të Krijimtarisë Popullore, Tiranë (1979);
- Punonjës Socialkulturor në Minierën e Mermerit Muhurr (1985-1988);
- Metodist kulture në Shtëpinë e Oficerëve Bulqizë (1989-1991);
- Shef i Administratës në Këshillin e Rrethit Bulqizë (1992-1997);
- Shef i Sektorit të Marrëdhënive me Publikun të Bashkisë Kamëz dhe Kryeredaktor i gazetës “Kamza” (2010-2012); Specialist në Sektorin e Koordinimit të Marrëdhënive me Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë, ku ka fituar Statusin e Nëpunësit Civil (2012-2020 e në vazhdim).
- Fillimet në gazetarinë e shkruar i ka që nga viti 1977 si bashkëpunëtor i gazetës lokale “Ushtima e Maleve” dhe i gazetave qendrore “Bashkimi”, “Zëri i Rinisë”, “Puna” dhe “Luftëtari”.
- Është kryeredaktor i gazetave periodike: “BULQIZA” (1992-1996 dhe nga 2014 e në vazhdim) dhe “VETERANI” (nga 2003 e në vazhdim).
- Nga 2010 boton në vijimësi opinione, dossier, kritikë letrare dhe reportazhe në të përditshmet: “Panorama”, “Gazeta Shqiptare”, “Telegraf”, “Koha jonë”, “Dita” dhe “Standard” e në të përjavshmen kulturore-artistike “NACIONAL”.
- Është autor i 30 librave (monografi & refleksione & reportazhe & poezi dhe tregime & kritikë letrare), si dhe redaktor i mëse 30 librave të autorëve të njohur.
- Halil Rama është i martuar me Znj.Kimete Rama (Berisha) dhe ka dy djem, Bledarin dhe Arlindin.

Halil Rama mban titujt:

- “Mjeshtër i Madh”, dhënë nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 11723, datë 17.09.2020;
- “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Bulqizë, me vendimin e këshillit të kësaj bashkie nr.. 52, datë 31.07.2024;
- Ambasador i paqes, dhënë nga Federata e Paqes Universale Shqipëri;
- Akademik, dhënë nga Akademia Shqiptaro-amerikane e Shkencave dhe Arteve.





DITURIA



Prof.dr. Jordan Daci



Halil Rama



Prof.dr. Flori Bruqi



Prof.dr. Astrit Memia




Prof.dr. Eshref Ymeri



Bujana Malaj



Sanie Selita



Prof.dr. Hajri Shehu



Xhelal Marku



Rajmonda Maleçka



Prof.Dr. Bardhyl Çipi




Sakip Cami



Nexhmedin Basha



Denada Dapellari



Akademik Petraq Pali



Spasse Thanasi

Çmimi i revistës: 1000 Lekë, 13 dollarë